

ehëNA

Revistë kulturore informative islame

www.bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk



**MULTIKULTURA,
BEGATI E
JO HENDIKAP**

Faqe 3



**Burimet nga të
cilat muslimanët e
maqedonisë
e mësojnë islamin**

Faqe 10



**Për ndërtimin e
Burmalisë nuk
kërkojmë mjete
qeveritare!**

Faqe 13



Qendra Islame Wil

Faqe 16

Tolstoi - Si e braktisi Krishterizmin?

Jolanda LILA

Kam dashuruar Krishterimin më shumë sesa Kishën, tani më shumë dashuroj të vërtetën se të gjithë botën.

Tolstoi përbën një dukuri të jashtëzakonshme në letërsinë Evropiane dhe në atë botërore. Elementi i pazakontë ndodhet jo vetëm në veprat e tij, por edhe në pikëpamjen historiciste të mënyrës së të jetuarit dhe të menduarit të tij.

Koordinatat kohore të shekullit XIX, periudhë në të cilën ai jetoi dhe krijoi, i kalojnë kufijtë deri në bashkëkohësi.

Përthyerja e rrafshit kohor dhe hapësinor vjen për shumë arsye. Të parat janë arsye që lidhen me vetë jetën e shkrimtarit, sepse Tolstoi dhe pse jetoi në Rusinë krishtere, u bë ihtar i fesë islame duke befasuar mjedisin rrethues. Kjo nismë nuk mbeti në trajtën e një bindjeje vetjake, por solli revolucion shoqëror duke ndikuar në mendimin dhe edukimin fetar rus.

Shembull i drejtpërdrejtë i këtij revolucion është botimi i broshurës së titulluar 'Muhammed', vepër e publikuar gjatë periudhës së mbretërisë ruse në vitin 1909.

Kjo vepër nuk pati suksesin e vlerave reale që mbarte, për shkak se titulli konsiderohej heretik për shoqërinë ruse.

Vetëm në 1990, pas një periudhe shtatëdhjetëvjeçare të Bashkimit Sovjetik, vepra e Tolstoit do të gjejë përsëri lexuesin dhe do të zgjohet interesi për vlerat fetare.

Populli rus, veçanërisht intelektualët e vlerësonin Tolstoin për shkak të

“*Librin e Tolstoit, ku janë tubuar disa hadithe të Muhamedit (a.s), organizatat ruse të shërbimit informativ, sikurse KKB-ja, janë orvatur që ta mbajnë në fshehtësi dhe në harresë, si dhe ta pengojnë ribotimin e mëtejshëm të tij..*

vlerave të tij në letërsi. Kjo nënkuptonte qartazi, se në qoftë se publikohej kalimi i tij në Islam, shoqëria ruse do të fillonte të kthehej fuqishëm në drejtim të Islamit.

Për këtë shkak, librin e Tolstoit, ku janë tubuar disa hadithe të Muhamedit (a.s), organizatat ruse të shërbimit informativ, sikurse KKB-ja, janë orvatur që ta mbajnë në fshehtësi dhe në harresë, si dhe ta pengojnë ribotimin e mëtejshëm të tij.

Ky libër e njohu lexuesin rus me disa hadithe të Muhamedit (a.s). Tematika e haditheve të mbledhura përqendrohet në sferën e 'varfërisë' dhe të 'barazisë', përmes të cilave orvatet të tregojë brengën e tij dhe të ndërjegjësojë ata që janë të tradhtuar e të shtypur. Përmes këtij libri Tolstoi theksoi se Islami është vendi i drejtësisë dhe i barazisë së vërtetë, vëllazërisë dhe sakrificës, respektit dhe dashurisë ndaj njeriut dhe ndaj të tjerëve.

Me krijimtarinë e tij letrare ai nixti reagime të ndryshme në planin estetik, ideor dhe në atë moral, jo vetëm për bashkëkombësit e tij, por për mbarë botën. Tregues është shtrirja e veprave të tij si, 'Lufta dhe Paqja', 'Ana Karenina', 'Ringjallja', 'Polikushka', 'Haxhi Murati' etj, të cilat janë përkthyer në njëqind e tetë gjuhë të ndryshme

të botës dhe janë botuar në më shumë se 220 milionë ekzemplarë. Kjo krijimtari është adoptuar për teatër, televizion dhe radio.

Këndvështrimi i Tolstoit ndaj Islamit mund të shihet edhe nga letrat e publikuara, veçanërisht vlen të përmendet letërkëmbimi me znj. Jelena Vekilova, e cila respekton dëshirën e fëmijëve të saj për t'u konvertuar në Islam.

Gjithashtu, ai pati guximin që në ditarët dhe në letrat e tij të parashtrijë anën kontradiktore të shenjtërisë së Kishës. Në letrën e dërguar Sinodit të shenjtë, të cilin e kishte ekskomunikuar si të pa fe, ai deklaroi: 'E kam dashur Kishën më shumë se sa paqen time; pastaj më shumë kam dashuruar Krishterimin se sa Kishën, ndërsa tani, më shumë dashuroj të vërtetën se të gjithë botën.'

Epiqendër e shqetësimit të Tolstoit është personaliteti moral i heronjve të tij, me të vërtetën dhe besimin, si kriteret më të larta të jetës. Raportin ndaj të vërtetës dhe fesë, autori e kërkoi dhe e sprovoi së pari në veten, e më pas me personazhet e veprave të tij, në të cilat çdo herë parashtron pyetje për moralin, drejtësinë, të vërtetën dhe fenë, për të mirën dhe të keqen, jetën dhe vdekjen, për çështjet e raporteve ndërmjet individëve dhe bashkësisë.

Gjeniu letrar urrente të keqen, dhunën dhe shtypjen e popujve.

Kalvarin e ndërkalimit të tij nga Krishterimi në Islam, Tolstoi e përshkruan poetikisht, përmes simboleve të fuqishme religjioze.

'Gjithë atë që kam kaluar mund ta shpjegoj në këtë mënyrë: Në një breg lumi më kishin vendosur në një barkë, e më pas barkën e drejtuan në drejtim të bregut tjetër, ndërsa në duar më dhanë lopatat dhe më lanë vetëm. Shihja se përreth meje lundronin mjaft barka, të cilat mbarteshin nga rrymat yjore. Lundrova aq larg, sa nuk munda të dëgjoj asgjë, përveç shushurimës së ujit të shpejtë. Pikërisht, në mes të ujit, në turmën e barkave dhe anijeve, unë plotësisht e kisha humbur drejtimin. U ktheva prapa, në drejtim të ujit dhe e orientova barkën nga brigjet e anës së kundërt. Bregu ishte Zoti, drejtimi ishte tradita, ndërsa lopatat për lundrim paraqisnin lirinë që m'u dha. Lopatat për lundrim më ndihmuan që të arrij deri në breg, që të afrohem tek Zoti.'

Intensiteti i madh i ideve dhe veprave të Tolstoit shpreh pikëpamjet dhe bindjen e plotë të tij për islamizmin, duke braktisur kështu një herë e përgjithmonë Krishterimin, kur ai thotë: 'Nuk mund ta pranoj fenë e krishterë, sepse ky besim nuk ishte feja, por një mënyrë e kënaqësisë epikuriste të jetesës. E kam kuptuar se ajo fe nuk i ofron njeriut qetësi; ndoshta mund t'i shërbejë dikujt, i cili është penduar në shtratin e vdekjes.'

Ky zjarr pendese nuk e zhuriti shpirtin e Tolstoit, sepse ai jetoi, krijoi dhe u varros sipas rregullave islame.





MULTIKULTURA, BEGATI E JO HENDIKAP

Hapsirat ballkanike gjithnjë kanë qenë të banuara nga popuj me përkatësi të ndryshme kulturore, konfesionale dhe civilizimi. Ky kolorit i etnikumeve të nënqielit Ballkanik, padyshim është një dhuratë nga Zoti, i cili është Krijues i të gjithëve, padallim përkatësie, e cilëso natyrë qoftë.

Shikuar historikisht, për fat të keq shpeshherë civilizimet, kulturat dhe konfesionet e ndryshme, të cilat gërshetohen njëra me tjetrën në këto troje, nga qarqe apo individë të caktuar, që vuajnë nga “egoizmi kulturor” apo “narcizmi kulturor”, nuk janë kuptuar si një mirë, si një begati e përgjithshme që i ngjanë kopshtit me lule të shumta me aromë të ndryshme.

Ky këndvështrim ndaj multicivilizimit dhe multikulturës, ka bërë që në periudha të caktuara, etnikumet të izoloohen në vetëvete, duke konsideruar kulturën e të tjerëve si rrezik e jo si përparësi. Konsumimi i idesë së këtillë sjellë mosrespekt, mosdurim ndërkulturor, ndërkonfesional, po ashtu, nga kjo ide vjenë në shprehje frika nga mosnjohja reciproke dhe kështu vjenë deri te konfliktet e ndryshme.

Përkundër këtij këndvështrimi, për fat të mirë, në këtë nënqiel, gjithnjë ka patur individë dhe subjekte të caktuara që koloritën kulturorë e shohin nga këndi pozitiv, e shohin si begati e cila duhet shfrytëzuar, andaj ata krijuan ura lidhëse mes kulturave, duke i dhënë përparësi dialogut dhe njohjës reciproke, me qëllim që sa më mirë të njihen mes veti.

Civilizimi dhe kultura islame si pjesë e mozaikut kulturor e kësaj hapsire, ndërshkuj gjithnjë ka kultivuar bashkëpunimin dhe dialogun me të tjerët. Muslimanët duke u nisur nga mësimet kur'anore, që nuk lejojnë përdorimin e dhunës në konfesionalitet, gjithnjë kanë dhënë kontributin e tyre për bashkëpunim me të tjerët. Mesazhe të këtilla, me siguri që dalin edhe nga civilizimet tjera, andaj multikultura duhet pranuar si begati e dhuruar nga Zoti dhe si e tillë duhet shfrytëzuar, për të mirën e të gjithëve që jetojnë në këtë nënqiel.

P ë r m b a j t j a



REVISTË MUJORE
INFORMATIVE
KULTURORE ISLAME



Botues:
Rijaseti i BFI në RM



Redaksia:
Agim Mehmeti
Abaz Islami
Skender Buzaku



Redaktori teknik:
Halil Berisha



Telefonat e redaksisë:
02 3117 410; 02 3117 412



www.bim.org.mk
e-mail: bim@bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk
e-mail: hena@bim.org.mk



Dorëshkrimet dhe fotografitë
nuk kthehen



18

ZGJOHU VIA- POLITIKA

DUKURITË NEGATIVE NË SHOQËRITË MODERNE




20



KONCEPTI I SUNNETIT NË EDUKIMIN E INDIVIDIT (3)

21



32

FATI I DIALOGUT NDËRFETAR

SHQIPERIA
NGA SHKEPUT-
JA ME SHTETIN
OSMAN, DERI
NE DEBIMIN E
ISMAIL
QEMALIT



42



46

LITERATURA
SHQIPE
NË TRADITËN
ISLAME

Humanizmi dhe
Dashuria per Natyren
Njerezore ... 15

Dukuritë negative në
shoqëritë moderne ... 20

Anulimi i mësimbesimit
akt antipopullor dhe
antibashkëkohor ... 22

Prominenca aklimatizuese
e sistemit Islam dhe
modelet politike
te akropolit europerehdi-
mor (2) ... 24

Domosdoshmëria e
zgjidhjes Islame ... 25

Mus'ab ibn
Umejri r.a ... 26

Amnestia ... 27

Fati i dialogut
ndërfetar ... 29

Trajtimi Biblik dhe
Kuranor në lidhje me kon-
siderimin e Marisë si
“Nëna e zotit” ... 33

Leximi i Kuranit për të
vdekurit ... 37

Zhvillimi i muzikës gjatë
shekujve pas Safijudin
Urmevijut (I) ... 38

Si tu flasim fëmijëve
tanë për All-llahun xh.
sh.* ... 39

Malajzia: një qytetërim
mes xhunglash ... 49

Xhamia e Çarshisë në Tetovë

Xhamia e Çarshisë në Tetovë, e njohur edhe me emrin Tupan Xhamia ka qenë e ndërtuar në shekullin e XVI, prezentimi i saj ka manifestuar simbolikë të veçantë në shumë aspekte dhe pikëpamje. Si shumë xhami tjera që kishin fatë të hidhur nga ish sistemi komunist, të njejtën përvojë e kishte edhe kjo xhami e cila u rrënuar në vitin 1965.

Faktet dhe e kaluara na flasin se ka qenë xhamia më e madhe në Tetovë e ndërtuar pikërisht në sheshin e qytetit.

Me performansat e saj vazhdimisht ka mahnit udhëpërshkruesit dhe gjithë ata që kanë qenë të lidhur shpirtërisht me atë.

Xhamia ishte e ndërtuar rrugës kryesore të qytetit duke shfaqur



klasën e saj të vaçant të ndërtimit. Në oborin e saj ka pasur shadërvanin autentik të saj, e rrethuar me

mure nga jashtë, obor me sipërfaqe shumë të madhe. Ka qenë e vetmja xhami e cila ka pasur kupollë të

jashtme dhe është e dalluar nga xhamitë tjera të qytetit nga ana e stilit arkitektonik. Duhet theksuar se Xhamia e Çarshisë ka pasur edhe medresenë e saj e cila ishte një vatër e diturisë dhe kulturës ku kanë mësuar dhe shkolluar dijetarë shumë të famshëm të Tetovës dhe rrethit të saj.

Hoxhallarët e fundit që shërbyen në atë xhami ishin imamët hfz. Rexhepi dhe hfz. Ibrahim Sherifi dhe muezinët hfz. Sulejman Shago dhe hfz. Shatoku.

Për rindërtimin e kësaj xhamie Qeveria e RM solli vendim më 29 janar 2008, mirëpo ky vendim nuk arriti të jetësohet dhe nuk u inkorporua në Planin Detal Urbanistik të Tetovës.

Inaugurimi i xhamisë së fshatit Mojancë

Më 15.05.2009 (e premte/xhuma) në f. Mojancë të Shkupit u bë inaugurimi i xhamisë së fshatit, financuar nga familja Shahinler nga Turqia.

Hapja solemne e kësaj xhamie u bënë në prani të një numër të madh të fshatarëve, bashkëqytetarëve dhe bashkatdhetarëve tanë nga Turqia e më gjerë.

Nga Bashkësia Fetare Islame pjesëmarrës në këtë eveniment ishin Sekretari i përgjithshëm i BFI-së H. Afrim ef. Tahiri, Myftiu i Myftinisë së Shkupit, H. Ibrahim ef. Shabani, Kryeimami i Myftinisë së Tetovës, Ejup ef. Selmani, Myftiu i Myftinisë së Kumanovës H. Abedin ef. Imeri, Myftiu i Myftinisë së Kërçovës, H. Murat ef, Huseini, Myftiu i Myftinisë së Shtipit, H. Isa ef. Ismaili, u.d. Dekan i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup M-r. Fahrudin Ebibi, u.d. Drejtor i SHMI Medreseja "Isa-Beu"- Shkup Prof. Ibrahim Idrizi. Gjithashtu të pranishëm në këtë inaugurim të xhamisë në fjalë ishin edhe Atesheu për çështje fetare pranë ambasadës së R. Turqisë, z. Bahatin Bildik dhe Prefekti i Komunës së fshatit Haraçinë z. Batri Bajrami.

Programin e hapjes solemne të xhamisë në f. Mojancë e bëri referenti për arsim pranë Myftinisë së Shkupit, Ismet ef. Bytyqi, i cili në fjalën hyrëse përshëndeti të gjithë të pranishmit në hapjen e kësaj xhamie.

Në këtë solemnitë fjalë përshëndetëse kishte anëtari i familjes Shahinler, Abdyl Shahinler i cili llogariti këtë si ditë të madhe për familjen e tij dhe banorët e fshatit



Mojancë.

Në inaugurimin e xhamisë fjalë përshëndetëse gjithashtu kishte edhe Prefekti i Komunës së Haraçinës z. Batri Bajrami i cili vlerësoi lartë kontributin e dhënë të fshatarëve dhe bashkatdhetarëve tanë nga Turqia, në veçanti familjen Shahinler.

Në këtë solemnitë fjalë rasti mbajti Sekretari i përgjithshëm i BFI, H. Afrim ef. Tahiri i cili vlerësoi lartë veprën dhe kontributin e bashkëqytetarëve tanë nga Turqia të familjes Shahinler. I cili fillimisht falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në inaugurimin e xhamisë së f. Mojancë duke shprehur kënaqësinë e tij që ishte në mesin tyre, të cilin e llogariti kopsht nga kopshtet e xhenetit të kësaj bote.

Në emër të BFI-së dhe Kryetarit të saj Reis ul Ulema, H.Sulejman ef. Rexhepi dhe në emrin tij personal, Sekretari i Përgjithshëm H. Afrim

ef. Tahiri, banorëve të fshatit Mojancë u uroi xhaminë e Re duke e lutur Allahun xh.sh. ta bekon këtë faltore, t'i bekojë gjithë ata që luten në këtë xhami dhe t'i pranon ibadetet të cilat do të kryhen këtu deri në ditën e Kijametit.

Në vazhden e fjalimit të tij, Sekretari Gjeneral citoi disa ajete nga libri i madhërishtë Kurani f.l: "Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos i lutni askujt krahas Allahut"(Suret ul Xhin:18). Në fjalimin e tij ef. Tahiri nënvizoi se...xhamitë i kushtohen vetëm Allahut,...pra që nuk i përkulen askujt pos Allahut". "Të këtillet janë ata të cilët janë të udhëzuar në rrugën e drejtë dhe për të njejtën ata marrin përsipër zhvillimin, përmirësimin, ndërtimin, mbikëqyrjen dhe ruajtjen e vlerave dhe në këtë synim të tyrin ata nuk mund të ndalen, janë të pamposhtur"- shtoi ai. "Fatkeqësisht, edhe në këtë

shekull, pra në shekullin XXI ose atë të XV sipas lixhretit - kalendarit islam, neve vazhdojmë të pengohemi për të realizuar ndërtime, pengohemi në Shkup ku dikur vetëm qyteti ka numëruar 127 xhami, shumica e të cilave u rrënuan gjatë sistemeve të ndryshme deri në vitin 1989, pengohemi gjithashtu në Kumanovë, Prilep, siç kemi qenë të penguar madje edhe në Tetovë etj. Mirëpo, u sigurojmë se neve do të japim maksimumin në përmbushjen e nevojave tona dhe besojmë se bashkërisht do t'ia arrijmë të rikthejmë, të rindërtojmë dhe meremetojmë gjithandëj.

Për Imam, Hatib, Vaiz dhe Mualim në këtë xhami u autorizua teologu-hoxha hfz. Nusretullah Ibrahim. Sekretari i Përgjithshëm i BFI, H. Afrim ef. Tahiri nderoi me mirënjohje personalitet që dhanë kontribut në ndërtimin e kësaj xhamie. Fillimisht mirënjohje pranoi Abdyl Shahinler, më pas mirënjohje morën dhe, anëtarët e këshillit iniciativ për rindërtimin e xhamisë siç ishin: Xhevahir Ibrahim, Atulla Sulejmani, Nexhati Sulejmani dhe Vullnet Ejupi.

Në fund të këtij programi ashëre këndoi M-r. Abaz Jahja, duanë e bëri myftiu i myftinisë së Shtipit, H. Isa ef. Ismaili, hutben e namazit të xhumasë e realizoi teologu i posa autorizuar Nusretullah Ibrahim, ndërsa namazin e xhumasë e realizoi atesheu për çështje fetare pranë ambasadës turke në R.M, z. Bahatin Bildik.

Për të pranishmit ishte përgatitur edhe një koktej dhe u shtrua drekë solemne.



Gusulhane për qytetarët mysliman të lagjes Gjorçe Petrov

Më datë 25.05.2009 në mënyrë zyrtare u lëshua në përdorim gusulhaneja për qytetarët e komunës së Gjorçe Petrov. Në këtë ceremoni morrën pjesë Myftiu i Myftinisë së Shkupit, H. Ibrahim ef. SHABANI i shoqëruar nga Kryeimami i Myftinisë së Shkupit, Sabedin ef. AMETI dhe referenti për arsim Ismet BYTYQI.

Në bazë të kërkesës së këshillit iniciativ për themelimin e xhematit në Gjorçe Petrov, me çka Halil ef. Selmani është autorizuar nga Myftinia e BFI, Shkup për kryerjen e ceremonive të varrimit. Komuna në fjalë me vendim të kryetarit të saj jep në shfrytëzim një parcel prej 5000 m² për nevojat e myslimanëve në këtë komunë (për varrim). Në brendësin e kësaj parcele është ndërtuar një objekt për pastrimin e të vdekurve dhe përgatitjen e tyre. Me rastin e lëshimit në përdorim të kësaj gusulhane Myftiu i Shkupit falënderoi të gjithë për kontributin e dhënë në ndërtimin e këtij objekti dhe bëri apel që edhe më tutje këta qytetarë të bashkëpunojnë në këtë drejtim, gjithashtu edhe në fusha tjera.

Kulturë Islame

Ekspozitë fetare në galerinë Çifte Amam: "Trashëgimia e Kulturës Islame në Spanjë"

Më 09 (e martë) Qershor 2009, Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi në prani të ambasadorit të mbretërisë së Spanjës në Shkup, z. Jose Manuel Paz Agueras dhe të pranishëm të tjerë bëri hapjen e ekspozitës: "Trashëgimia e Kulturës Islame në Spanjë". Në këtë ekspozitë pjesëmarrës ishin Muftitë e muftinive të BFI, Dekani dhe profesorë nga Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup, Drejtori dhe profesorë nga Medreseja "Isa-Beu", përfaqësues të koreve diplomatike në R.M, zv. Drejtori i Komisioni për çështje fetare z. Anton Sereçi, prefekti i komunës së Haraçinës z. Bastri Bajrami, përfaqësues të shoqatave qytetare, student, nxënës nga Paralelja e femrave të Medresesë Isa-Beu-Shkup, si dhe qytetarë.

Ceremoninë e hapjes së ekspozitës e realizoi referenti për arsim pranë muftinisë së Shkupit, Ismet Bytyqi. Fillimisht fjalë përshëndetëse kishte ambasadori i mbretërisë së Spanjës, z. Jose Manuel Paz Agueras i cili tha:

"Bashkëpunimi ynë me Bashkësinë Fetare Islame në R.M kohë pas kohe bëhet më i fuqishëm gjë që kjo na flet për vullnetin e lartë të dy institucioneve në promovimin e vlerave të



shoqërive demokratike. Ky bashkëpunim edhe në të ardhmen do të vazhdojë me një intenzitet më të fuqishëm dhe në forma të ndryshme. Islami ka kontribuar mjaft në këtë drejtim duke qenë pjesëmarrës në ndërtimin e kulturës botërore, fakt që e dëshmon ajo që realizuan muslimanët në Spanjë".

Në këtë ekspozitë të pranishmëve u drejtua edhe Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi me fjalimin e tij: "Më paraqet një kënaqësi të veçantë që sot ndodhemi në këtë ambient të këndshëm që i përket arkitekturës dhe kulturës Islame, në të cilin gjithashtu po bëjmë prezantimin e një prej trashëgimive më të vjetra dhe më me vlerë në Evropë, pra - Kulturës Islame në Spanjë.

Ideja për ta realizuar këtë ekspozitë lindi pas një bisede të frytshme që kishim me zotëriun e nderuar, Ambasadorin Agueras, i cili është përfaqësues i Mbretërisë së Spanjës në vendin tonë". "Edhe rrugëtimi më i

shkurtër, por edhe ai më gjati, fillojnë nga hapi i parë. Ky hap në Spanjë u vu që nga viti 711, e deri në vitin 1492, Kultura Islame ka pasur një prezencë dominante dhe fundamentale në jugun e këtij vendi, me ç'rast gjurmët e asaj kulture janë prezervuar në mënyrën më të mirë - dhe sot po rruhen si një pasuri e veçantë e këtij vendi me një traditë të vjetër demokratike... Sot në Spanjë jetojnë mbi 1 milion muslimanë, me të gjitha të drejtat e garantuara për ti kryer obligimet e tyre fetare dhe po ky shembull, po ndiqet edhe nga shumë vende të tjera Evropiane"-tha mes tjerash kreu i BFI. Ai vazhdoi duke thënë: "Nëse e sotmja për ne është e zakonit, për dikë më vonë do të jetë histori, prandaj ne po bëjmë të gjitha përpjekjet për të lënë gjurmët tona në këtë rrugëtim". Ekspozita ishte e prezentuar në galerinë Çifte Amam-Shkup dhe se ajo do të vazhdojë të jetë e hapur për vizitorët deri më 13 Qershorë.

"MUHTESAR SAHIH EL-BUHARI" NË GJUHËN SHQIPE

Jolanda Lila

AIITC sjell për lexuesit shqiptar njërin nga thesaret më të çmuara të traditës së Profetit Muhamed (a.s.), librin "Muhtesar Sahih El-Buhari", i cili për nga rëndësia dhe autenticiteti vjen pas Kuranit të Shenjtë. Versioni i tij i shkurtuar botohet për herë të parë në gjuhën shqipe nga përkthyesi Telat Sula.


Duke njohur personalitetin, veprimet, fjalët dhe miratimet e Profetit a.s., besimtari mëson se si duhet të ndjekë rrugën e Zotit, mëson se ajo duhet të jetë e ngadaltë, e kujdesshme dhe e vazhdueshme. Dijetarët islamë gjejnë në këtë traditë mënyrën se si duhet ta kuptojnë dhe ta interpretojnë Kuranin, pasi aty gjejnë arsyet e shpalljes së shumë ajeteve (vargjeve) kuranore, si dhe shpjegimin e tyre. Aty të devotshmit gjejnë kuptimin më të lartë të devotshmërisë, ashtu siç gjejnë tregtarët rregullat e tregtisë

dhe ata që janë sprovuar me fatkeqësi, modelin më të mirë për durimin dhe qëndrueshmërinë. Të rinjtë mësojnë sjelljet morale më të larta, edukatën e duhur, besimin e pastër dhe mënyrën se si duhen kryer ritualet fetare e lutjet në përgjithësi. Në traditën e Profetit Muhamed a.s. umeti islam mëson se si duhet bërë shteti. Juristët islamë, gjejnë rrugën për të materializuar ëndrrat e tyre për drejtësinë, harmoninë dhe mirëkuptimin midis të gjithë njerëzve.

Njëri nga librat që e ka përcjellë në mënyrën më autentike këtë traditë dhe që njihet si burimi i dytë i shkrimeve islame, pas Kuranit të Madhërisë, është pikërisht vepra "Sahih el-Buhari". Ai ka qenë prej kohësh në vëmendjen e Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam (AIITC) për shkak të vlerës së tij teologjike dhe për gjerësinë e mesazheve hyjnore, njerëzore e shkencore që përcjell. Duke qenë se vepra e plotë përmban një numër të madh

hadithesh të përsëritura, AIITC vendosi që të botonte përkthimin e një versioni të shkurtuar, me titull "Muhtesar Sahih el-Buhari" (Përmbledhje e librit Sahih el-Buhari), i përpunuar nga imam Zejnudin Zubejdi. Megjithatë libri përmban 2230 hadithe autentike, të cilat shërbejnë si referencë për studiuesit e Islamit, studentët e fakulteteve teologjike dhe nxënësit e medreseve, si rregullator i jetës dhe i fesë së çdo besimtar musliman shqiptar. Pas punës së kryer, është bërë e mundur që kjo vepër të dalë në një formë sa më të lehtë, në mënyrë që të përfitojë prej saj çdo lexues.

Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, e ka bërë traditë tashmë botimin e veprave të literaturës islame, për të plotësuar sadopak nevojën e lexuesit shqiptar për njohjen e botëkuptimit dhe të praktikës fetare islame. Botimet në këtë fushë kanë qenë të shumëllojshme, duke filluar me botimin e përkthimit të Kuranit në



gjuhën shqipe, me broshurat e vogla njohëse mbi parimet dhe rregullat bazë të fesë, e duke vijuar me vepra voluminoze, siç është "Fikhus-Sunneh / Legjislacioni i Traditës së Profetit Muhamed a.s.". Në kuadër të kësaj veprimtarie botuese është edhe dalja e kësaj vepre burimore të fesë islame. AIITC përveç kontributit të saj në botimin dhe publikimin e kësaj vepre ka organizuar edhe dhurimin e saj për lexuesin shqiptar.

TRIBUNË SHKENCORE



Të mbrojmë shëndetin e gruas

Resmije Xhaferi

Më 29.04.2009 (E mërkurë) në-lokalet e Bashkësisë Fetare Islame në R. M., SHMI "Medreseja Isa Beu" Paralelja e Femrave- Shkup dhe Muftinia e Shkupit në bashkëpunim me Kompaninë Amerikane MSD- Meerk Sharp & Dohme Idea Inc organizuan tribunë me temë "Mbrojtja e shëndetit të gruas".

Në këtë tribunë shkencore morrën pjesë mjekë, Profesoresha nga SHMI "Medreseja Isa Beu" Paralelja e Femrave- Shkup, nxënës, studentë dhe qytetar të sektorit civil.

Tribuna në fjalë ngjalli interes shumë të madhë tek shoqëria civile për vetë faktin se dekadave të fundit gjinia femrore po përballet me shumë sëmundje dhe për të cilat është e domosdoshme të merren masa preventive për parandalimin e paraqitjes së tyre si dhe mbrojtjen e imunitetit të femrave.

Në këtë tribunë prezentimet mjeksore nga sektori mjeksor i realizuan mjeket: Emilija Trajkovska-Gjinekologe, Dr. Nada Nasteska dhe Dr. Maja Panajotoviç-Radevska, ndërsa prezentimet e mjekeve i përktheu znja. Ardijana Isai-Pallosi.

Fillimisht tribuna shkencore filloi me këndimin e një pjese nga libri i shenjtë Kur'an f.l, ndërsa hapjen e kësaj tribune e bëri Prof. Minever Murtezi, e cila përshëndeti të pranishmit duke shprehur falënderime për pjesëmarrjen e tyre në këtë tribunë.

Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për rolin e gruas në shoqëri andaj duhet që të kujdesemi për ate me gjithë

potencialin individual dhe mjekësor, njëherit të kontribuojmë në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme. Në mes tjerash ajo theksoi se: "Koncepti i Islamit në aspektin mjekësor detyrimisht obligon që çdo individ të kujdeset për shëndetin duke dhënë mesazhe shoqërive që të zhvillojnë medicinën dhe të luftojnë ndaj çdo sëmundje që eventualisht mund të paraqitet në mesin e tyre, e gjithë këtë duke e bazuar në disa ajete Kur'anore dhe hadithe të Pejgamberit s.a.v.s që kanë të bëjnë me shëndetin.

Në vazhden e kësaj tribune prezantoi ligjërueset e tribunes të cilat njëherit shpalosën gjithë atë që po bënë mjekësia bashkëkohore në mbrojtjen e shëndetit të gruas.

Fillimisht prezantoi ligjëruesen, Dr. Emilija Trajkovska, e cila në mënyrë kronologjike prezantoi shkaqet që mundësojnë paraqitjen e sëmundjeve në mitrën e gruas.

Dr. Nada Nasteska, ligjëroi lidhur me sëmundjet e ndryshme që paraqiten tek gjinia femrore dhe që bënë të jetë në qendër të vëmendjes është sëmundja e Osteoporozës.

Dr. Maja Panajotoviç-Panatevska sqaroi mënyrën dhe hapat që duhet të ndërmerren në parandalimin dhe shërimin nga sëmundja e Osteoporozës nëse eventualisht paraqitet tek gjinia femrore.

Ky program u begatua me Ashere dhe ilahije të kënduara nga nxënëset e SHMI "Medreseja Isa Beu" Paralelja e Femrave - Shkup.

Administratore në SHMI "Medreseja Isa Beu" Paralelja e Femrave- Shkup

Promovohet libri "Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman"

Për herë të parë në studimet historike shqiptare vjen një këndvështrim i munguar, pikërisht këndvështrimi i studiuesve turq mbi Shqipërinë. Gjatë shfletimit të këtij libri, lexuesi shqiptar do të dalë më i kthjellët e do të pasurojë më tej horizontin dhe kulturën e tij historike, e për më tepër se për shumë vite radhazi rreth kësaj perandorie, shqiptarëve u ka ardhur një histori jo e plotë, ndonjëherë edhe e shtrembëruar, e falsifikuar dhe e shkruar prapa shpine.

Jolanda Lila

Është pritur më interes të veçantë nga studiuesit shqiptarë botimi më i fundit i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam (AIITC), libri "Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman".

Ky libër u promovua të shtunën, datë 2 maj 2009, në mjediset e hotel Rogner Europapark me një pjesëmarrje të gjerë studiuesish, politikanësh, përfaqësuesish të trupit diplomatik dhe intelektualë nga vendi e bota, ku vlen të përmendësh Dr. Halit Ereni, drejtor i përgjithshëm i Qendrës Kërkimore për Historinë në

Stamboll, Dr. Ali Osgun Ozturk, drejtor i Administratës Turke për Bashkëpunim dhe Zhvillim etj.

"Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman" sjell një trajtim tërësor e shumëdimensional të jetës politike, administrative dhe shoqërore të një Perandorie që pati shtrirje në tre kontinente, pikërisht në Europë, Azi dhe Afrikë. Libri është hartuar nga emra të njohur të shkencës në Turqi, si Prof. dr. Ekmeleddin Ihsanoğlu, Prof. dr. Feridun Emecen, Prof. dr. Kemal Beydilli, Prof. dr. Mehmet Âkif Aydin etj. dhe është sjellë në gjuhën shqipe nga ekspertë të fushës si Prof. dr. Xhevat Lloshi, Suzana Tafa etj. Ky botim, përveçse sjell infor-

Takimi i 7-të i Shurës Islame të shteteve Euro-Aziatike

"Burimet, zhvillimi dhe metodat për avansimin e mendimit fetar"

Prej 12-15 Maj 2009 në Stamboll të Turqisë është mbajtur takimi i 7-të i Shurës Islame të shteteve Euro-Aziatike. Në këtë takim morrën pjesë 42 shtete, më shumë se 100 lider fetar, shkenctarë të kësaj lëmie, të cilët janë të lidhur ndërmjet vehte në aspektin fetar, historik dhe kulturor. Në hapjen solemne të Shurës morri pjesë edhe Kryetari i Qeverisë së R. Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, Kryetari Shurë Euro-Aziatike, a njëherit Kryetar i Dijanetit të R.Turqisë, Prof. D-r. Ali Bardakoglu, Reis ul Ulema i BFI, H. Sulejman ef. Rexhepi, si dhe shumë lider të tjerë fetarë. Në hapjen solemne të këtij takimi Kryetari i Qeverisë së R. Turqisë, Rexhep Taip Erdogan bëri hapjen oficiale të sajtit së Shurës Islame: www.avrasya-is.org, ndërsa në fjalën përshëndetëse të tij theksoi se: "Shkenctarët (Alimët) janë ata që duhet të tregojnë rrugën për mbarë shoqëritë". Në këtë takim u shqyrtuar puna e deri më tanishme e Shurës, u bënë analiza të thukta se si dhe çka më tutje duhet vepruar që të ketë frymë

pozitive shoqërore, u bisedua rreth problemeve aktuale të muslimanëve dhe bashkësive fetare nga hapsirat e theksuara. Në këtë takim u diskutuan një sërë temash, ndërsa temë esenciale ishte: "Burimet, zhvillimi dhe metodat për avansimin e mendimit fetar". Në mesin e temave tjera të cilat u bisedua në këtë takim gjatë disa ditëve ishin:

"Gjendja dhe bashkëpunimi i Bashkësive Fetare lidhur me burimet e njohurive fetare në hapsirën gjeografike Euro-Aziatike", "Njohurit burimore fetare dhe vlerat aktuale në hapsirën Euro-Aziatike", si dhe "Institucionet që zhvillojnë njohuri fetare në hapsirën gjeografike Euro-Aziatike".

Kryetari i Shurës Islame Euro-Aziatike, a njëherit Kryetarë i Dijanetit të R.Turqisë, Prof. D-r. Ali Bardakoglu theksoi se: "Ne si lider fetar dhe musliman jemi plotësisht kundër dhunës dhe terrorizmit, të cilat njëherit i gjykojmë, gjithashtu jemi kundër të gjithë atyre që muslimanët i identifikojnë si terroristë për shkak të një grupi. Islami pro-

macion të hollësishëm mbi tema të ndryshme si sistemi i taksave, legjislacioni, drejtësia, financa dhe veprimtaria industriale, është një ftesë e rrallë për studiuesit e historisë së krahasuar për t'i parë institucionet dhe çështjet nga perspektiva e historisë botërore.

Promovimin e librit e hapi me fjalën e tij përshëndetëse, botuesi i veprës në gjuhën shqipe, drejtori i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam (AIITC) Dr. Ramiz Zekaj, i cili shpjegoi arsyet e kësaj sipërmarrjeje të fuqishme për kulturën shqiptare, duke thënë se: "E gjykojmë të volitshëm botimin e këtij libri në gjuhën shqipe sepse është historia e një perandorie të madhe, pjesë e së cilës ishin edhe trojet shqiptare, që ndikoi në konturimin e historisë së njerëzimit, që me potencialin e vet politik e ushtarak u bë faktor ekuilibri në tre kontinente. Është historia e një shteti të mirëorganizuar që progresoi në lëmin ekonomik, kulturor, arsimor e shkencor. Historia e një shoqërie, që i dha popujve shumë dimensione në ecje drejt vlerave dhe në dinamikë." Më tej, ai theksoi faktin se për herë të parë në studimet historike shqiptare vjen një këndvështrim i munguar, pikërisht këndvështrimi i studiuesve turq mbi Shqipërinë. Sipas tij, "Autorët e këtij libri e pikasin, evidentojnë dhe e vlerësojnë ndihmesën e shqiptarëve. Në këtë libër gjejmë informacionin mbi jetën e dinastisë së Qyprillinjëve, të cilët nga viti 1656-



1683 shërbenin si vezirë të mëdhenj në shtetin turk. Ata ndihmuan në konsolidimin e shtetit osman, në një moment kur ai ndodhej para situatave të trazuara të jashtme e të brendshme. Përmendet Koçi Beu ose i quajtur Monteskiye i Lindjes, i cili që në vitet 1630 paraqiti pranë Portës së Lartë projektin e reformave. Vlerësohet puna e dijetarit të madh shqiptar Hoxha Hasan Tahsini ose i quajtur Lomonozovi i Turqisë, që me dijet e gjera në shumë fusha shkencore dha ndihmesë të çmuar dhe për disa vite punoi si rektor i parë i universitetit të Stambollit. E për të arritur tek Shemsedin Sami Frashëri, si autor i enciklopedisë së madhe turke "Komus-ul-alam", i fjalorit turqisht - frëngjisht, e si shkrimtar që e nxori letërsinë nga pallati dhe e çoi tek pop-

ull".
Dr. Halit Ereni, drejtor i përgjithshëm i Qendrës Kërkimore për Historinë në Stamboll, vlerësoi përkthimin e veprës në gjuhën shqipe nga AIITC, duke thënë se "Ky botim përbën një hap të rëndësishëm në fushën e botimeve. Jemi të bindur se ky botim do të jetë një kontribut i rëndësishëm në hulumtimin shkencor të kësaj teme. Artikujt që përmban vepra i ofrojnë lexuesit një paraqitje objektive të historisë së periudhës osmane, të ndërtuar në bazë të dokumenteve arkivore e të kronikave osmane, si dhe të punimeve të specialistëve të sotshëm në këtë fushë. Libri ndriçon jo vetëm aspektet politike e administrative, por edhe zhvillimin e kulturës, të arsimit e të shkencës në ato rajone dhe gjatë atyre periudhave që ato kanë qenë në për-

bërjen e Perandorisë Osmane."

Botimi origjinal u publikua në gjuhën turke nga Qendra Studimore e Historisë, Artit, Kulturës Islame (IRCICA), qendër e cila sot drejtohet nga dr. Halit Ereni. Vepra është botuar në turqisht në vitet 1994-1998 dhe menjëherë pas u botua edhe në gjuhën arabe e në gjuhën angleze, duke u botuar gjatë viteve 1999-2002. Në vitin 2004 doli botimi i veprës në gjuhën boshnjake dhe së fundmi u publikua në gjuhën shqipe. Pritet që së shpejti vepra të dalë edhe në gjuhën ruse. Dr. Halit Ereni në përmbyllje të fjalës së tij përgëzoi AIITC për punën e lavdërueshme në përgatitjen e këtij botimi.

Më pas përshëndetën dhe ligjëruan për vlerat e librit Dr. Ali Osgun Oztur, drejtor i Administratës Turke për Bashkëpunim dhe Zhvillim (TIKA), si dhe Prof. dr. Beqir Meta Beqir Meta - Drejtori i Institutit të Historisë, Prof. dr. Petrika Thëngjilli - Pedagog në Universitetin e Tiranës, Prof. dr. Dritan Egro - Studiues i historisë, Prof. dr. Nazmi Daka - Pedagog i gjuhës turke dhe specialist i marrëdhënieve civile dhe ushtarake.

Promovimi u pasqyrua gjerësisht në mediat shqiptare, në mënyrë të veçantë në televizionet më të rëndësishme shqiptare, ku iu dedikua minutash special kësaj ngjarje madhore për kulturën shqiptare. Për të pranishmit u dhuruan kopje të librit dhe u shtrua një koktej.



movon vlera, me çka vetë termi ISLAM d.t.th. paqë, siguri, tolerancë, etj."

Liderët e Bashkësive fetare dhe shkençarët e mirënjohur nga hapsirat e Euro-Azisë në fjalimet e tyre analizuan më një theks të veçantë temat e lartëtheksuar.

Në fjalimin e tij Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi theksoi: "Shikuar historikisht, jeta fetare islame në Maqedoninë e sotshme, si pjesë e nënqrellit ballkanik, filloi të organizohet me ardhjen e osmanlive në këto troje, ku nën udhëheqjen e tyre, Islami përjetoi një zhvillim dhe zgjerim të shkëlqyer." Ata me përgjegjësi dhe përkushtim e organizonin jetën fetare, ndërtuan objekte

fetare - Xhamia, medrese dhe objekte të tjera të nevojshme, të cilët ishin në funksion të mësimin të Fesë Islame. Organizimi i jetës fetaro-islame gjatë kohës së Osmanlive ishte nën juridikcionin e Shejhul-Islam në Stamboll"-theksoi mes tjerash Kryetari i BFI-së.

Pas katër ditëve të debatoreve të theksuara të takimit të 7 të Shurës së Euro-Azisë për mediumet u shpalos deklarata e përgjithshme e arritur për vendimet e përbashkëta të arritura në këtë takim.

Vendimet më të theksuara ishin:

- Shura Islame e Euro Azisë mendojnë se: Si në shtetet e tyre, po ashtu edhe në tërë botën është e domosdoshme të

arrihet paqë, gjithashtu janë kundër dhunës, terrorit si dhe ndaj islamofobisë;

- Të themelohet një Institut për hulumtime islame Euro Aziatike;

- Të ketë përputhshmëri të programeve shkencore të Institucioneve të këtyre shteteve me qëllim që të afrohen në mes tyre dhe sa më lehtë të bëjnë nostrifikimin e diplomave të të diplomuarve në këto shtete;

- Në Turqi të themelohet një Fakultet ndërkombëtar për studime Islamike për studentë nga shtetet e theksuar;

- Të përgatitet dhe të botohet literaturë e përbashkët për shtetet e lartëtheksuara, gjithashtu të bëhet këmbimi i profesorëve dhe shkençarëve të lëmive të ndryshme;

- Të formohet komisioni i përbashkët që do të përgatis programë për njohuri fetare;

- Festat fetare të festohen në mbarë botën islame me të njejtën date; - Autorizohet një komision nën udhëheqje të Kryetarit të Dijanetit të Turqisë Prof. D-r. Ali Bardakoglu, për këto vendime të Shurës Islame Euro-Aziatike të informohet Konferenca Islamike dhe institucionet përgjegjëse të shteteve të lartëtheksuara.

KONKURS

PËR NDARJE TË KREDIVE STUDENTORE PËR VITIN AKADEMIK 2009/10 PËR STUDENTËT TË CILËT STUDIOJNË NË KËTO FAKULTETE:

- FAKULTETI I MJEKSISË;
- FAKULTETI STOMATOLOGJIK;
- FAKULTETI I FARMACISË dhe
- TË GJITHA FAKULTETET TJERA TEKNIKE.

Dokumentacioni i duhur për kredi studentore:

- Kopje të diplomës të shkollës së mesme;
- Kopje të dëftesave të vitit të III dhe të VI;
- Çertifikatë të lindjes;
- Vërtetim prej mjekut;
- Index;
- Vërtetim nga Fakulteti;
- Dy foto;
- Vërtetim për të ardhurat e prindërve (vendi ku punojnë) ose vërtetim nga Enti për punësim (nëse është i pa punësuar).

Afati i dorëzimit të dokumentacionit të sipërpërmendur bëhet prej 25 Maj deri 25 Qershorë 2009.

Bashkësia Fetare Islame në R.M

BURIMET NGA TË CILAT MUSLIMANËT E MAQEDONISË E MËSOJNË ISLAMIN



Me shkuarjen e Osmanlive nga viset ballkanike, muslimanët përjetuan një periudhë të errët, periudhë me shumë mundime, periudhë me shumë padrejtësi dhe diskriminime në lëminë shoqërore, arsimore, ekonomike, politike etj. Pra, në kohën postosmane, muslimanët u bënë viktimë e orekseve të shoqërive joislame, të cilat në emër të hakmerrjes kundër Perandorisë Osmane, shkatërruan gjithçka që ishte islame. Aq më shumë kur në këto vende sundoi sistemi i njëmendësisë, afër pesëdhjetë vjet.

H. Sulejman ef. REXHEPI

Kur bëhet fjalë për muslimanët e Republikës së Maqedonisë, duhet patur parasysh se fati i tyre është i njëjtë me fatin e muslimanëve nga rajonet tjera të Ballkanit. Ata janë ndjekës të Shkollës hanefite në lëminë e drejtësisë islame dhe ndjekës të Shkollës maturidite në lëminë e besimit islam, kurse në aspektin kulturor tradicional i takojnë zonës osmane-turke të botës islame.

Shikuar historikisht, jeta fetare islame në Maqedoninë e sotshme, si pjesë e nënqiellit ballkanik, filloi të organizohet me ardhjen e osmanlive në këto troje, ku nën udhëheqen e tyre, Islami përjetojë

një zhvillim dhe zgjerim të shkëlqyer. Ata me përgjegjësi dhe përkushtim e organizonin jetën fetare, ndërtauan objekte fetare – Xhamia, medrese dhe objekte të tjera të nevojshme, të cilët ishin në funksion të mësimit të Fesë Islame. Organizimi i jetës fetaro-islame gjatë kohës së Osmanlive ishte nën juridikcionin e Shejhul-Islam në Stamboll.

Me shkuarjen e Osmanlive nga viset ballkanike, muslimanët përjetuan një periudhë të errët, periudhë me shumë mundime, periudhë me shumë padrejtësi dhe diskriminime në lëminë shoqërore, arsimore, ekonomike, politike etj. Pra, në kohën postosmane, muslimanët u bënë viktimë e orekseve të

shoqërive joislame, të cilat në emër të hakmerrjes kundër Perandorisë Osmane, shkatërruan gjithçka që ishte islame. Aq më shumë kur në këto vende sundoi sistemi i njëmendësisë, afër pesëdhjetë vjet. Thënë me një fjalë, shekulli njëzetë, ishte një periudhë tragjike në historinë e muslimanëve të trojeve ballkanike, ky shekull filloi me luftë dhe përfundoi me luftë, në të cilat më së shumti u dëmtuan muslimanët dhe qenia e tyre kulturore.

Pas Luftës së Parë Botërore, pra, pas themelimit të Jugosllavisë, organizimi i jetës fetaro-islame ishte nën juridikcionin e Reisul-Ulemasë me seli në Sarajevë, BeH. Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë ishte

pjesë përbërse e Bashkësisë Islame e Mbretërisë Jugosllave, kurse më vonë pjesë përbërse e Bashkësisë islame të SFRJ-së.

Muslimanët e Maqedonisë, ashtu si muslimanët e republikave tjera të federatës jugosllave, preokupim kryesor e kishin ruajtjen e identitetit të tyre fizik dhe kulturën e tyre fetare, sepse nën parollën e vëllazërim-bashkimit të këtij shteti kanë vepruar elite nacionaliste, të cilat ishin rrezik jo vetëm për muslimanët dhe të cilët në mënyrë perfide, nën ombrellën e sistemit ndërmerrin represione të ndryshme kundër popullatës muslimane në territorin e Jugosllavisë.

Duke i patur parasysh mundimet dhe represionet sistem-

atike, muslimanët e nënqiellit jugosllavë më së shumti iu gëzuan shkuarjës së sistemit komunist, respektivisht iu gëzuan ardhjes së sistemit pluralist-demokratik. Por mjerisht, edhe në sistemin e ri, pra në shoqërinë demokratike, a në veçanti në periudhën e ashtuquajtur tranzicione, muslimanët ballafaqohen me shumë sfida dhe peripeti në realizimin e të drejtave të tyre. Si ilustrim se veprime antiislame, në këto mese, ka patur edhe pas ndërrimit të sistemit, janë vënia e kryqave në Saat Kullat në Prilep dhe Manastir. Gjithashtu, edhe sot e kësaj dite uzurpohen sipëfaqe të vakëfit dhe në themelët e xhamive ndërtohen objekte të ndryshme. Shembull më i freskët, në këtë drejtim është rasti i Xhamisë Ibni Pajko në Shkup, në themelet e së cilës, ndërtohet filarmonia e Maqedonisë, ndërsa në themelet e Xhamisë "Burmali" po ashtu në Shkup, planifikohet të ndërtohet hotel.

BURIMET E TË MËSUARIT TË ISLAMIT

Edhe përkundër veprimeve antiislame, si dhe ngushtimit të identitetit të tyre kulturor, muslimanët gjithnjë treguan vitalitetin e tyre, ku përmes organizatës së tyre fetare, BFI-së, jo vetëm që arritën të mbijetojnë dhe të ekzistojnë, ata e kultivuan dhe e zhvilluan jetën fetare në të gjitha dimensionet e saja. Ata, në radhë të parë, duke u bazuar në potencialet dhe mundësitë e veta, e më pastaj në ndihmën e vëllëzërve të tyre nga e gjithë bota, ndërtuan objekte fetare – Xhami, e në përbërje të tyre ndërtuan mektebe për të mësuar fenë, kështuqë sot në Republikën e Maqedonisë kemi rreth mbi gjashtëqind xhami, prej të cilave numri dërmues ka edhe mektebe..

Gjithashtu, ata ndërtuan institucione arsimor-fetare, siç është SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, e cila sot punon dhe vepron me katër paralele të shtrira në disa qytete të vendit, tri prej tyre janë për vajza, ndërsa njëra për meshkuj. Ndërtuan edhe Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, i cili së bashku me Medresenë luajnë një rol shumë të madhë në të mësuarit e Islamit.

TRADITA GOJORE SI BURIM

Muslimanët e Republikës së Maqedonisë, gjithnjë kanë shprehur dëshirë që ta mësojnë fenë e tyre, ku për këtë qëllim kanë shfrytëzuar forma dhe metoda të ndryshme, ndër të cilat është edhe tradita gojore, e cila është një ndër metodat më të vjetra, e cila sot e kësaj dite luan një rol të rëndësishëm në mësimin e fesë, sidomos në gjeneratat e moshuara, të cilat nuk kanë patur mundësi që të mësojnë së paku të lexojnë.

Po ashtu, kjo metodë e të mësuarit e fesë, ka luajtur rol të

rëndësishëm gjatë periudhës së sistemit komunist, sistem në të cilën nuk lejohej të botohej literatura fetare, e aq më pak ajo në gjuhën shqipe, respektivisht cenzurimi i librave fetarë ishte mjaftë rigoroz. Përshkak të kësaj, muslimanët për ta mësuar fenë i shfrytëzonin derset të cilat i mbanin muderisët nëpër Xhamia para namazit të Xhumasë apo para namazit të teravisë gjatë muajt të Ramazanit. Gjithashtu, kjo formë e të mësuarit është shfrytëzuar në tubime familjare, ku tradicionalisht këndohet mevlud, për raste të ndryshme, në të cilat besimtarët e shfrytëzojnë prezencën e nëpunësit fetar, që të mësojnë diçka për fenë e tyre. Përmesë kësaj metode, besimtarët më së shumti mësojnë shartet elementare të Islamit, siç është marrja e abdesit, falja e namazit, agjërimi i Ramazanit etj.

MATERIALET E SHKRUARA SI BURIM

Materiali i shkruar është një ndër burimet kryesore nga i cili muslimanët, jo vetëm që i mësojnë parimet elementare të Islamit, por prej këtij burimi, ata e thellojnë dijen e tyre në shkencat e fesë. Në vijim do të japim disa të dhëna për disa nga materialet e shkruara, që shfrytëzohen për të mësuar parimet dhe dispozitat fetare.

Për herë të parë, në Republikën e Maqedonisë botimet fetar-islame fillojnë në vitin 1959, kur Mexhlisi Ulema i atëhershëm boton "Kycyk Ilmihal", përkthyer nga gjuha serbokroate në atë turke, përkthyer nga H.Qamil Abas. Ilmihali ka 46 faqe dhe i shtypur në dhjetë mijë ekzemplarë. Përmbajtja: Shartet e Imanit, Shartet e Islamit. Përmbajtja e Ilmihalit është i përpunuar në mënyrë decide dhe të qartë.

Duhet theksuar se për herë të parë në vitin 1968 fillon të botohet Takvim për vitin 1968, respektivisht vitin Hixhri 1387/88, në botim të Shoqatës "Ilmije" në Republikën e Maqedonisë, (Shoqatë e nëpunësve fetarë). Takvimi botohet paralelisht në gjuhën turke dhe shqipe. Takvimi për vitin 1975, respektivisht për vitin Hixhri 1394/95, fillon të botohet paralelisht në tri gjuhë maqedone, shqipe dhe turke dhe për herë të parë fillon në Takvim, krahas pjesës kalendarike, të botohen edhe tema fetare, për mes të cilave muslimanët mësonin për fenë e tyre.

Vepra "Hyrye në Islam" e Dr. Muhamed Hamidullah, e botuar në vitin 1985 në botim të Bashkësisë islame në RM. Libri u botua në gjuhën shqipe në përkthim të Bahri Aliut dhe Neshat Xheladinit. Përmbajtja e librit është mjaft e pasur dhe të jep mundësi që të njihesh me fundamentet islame si dhe historinë, kulturën dhe traditën islame. Libri është mjaftë mirë i pranuar nga ana e lexuesëve, e sido-

mos nga intelektualët.

Libri "Kurani mrekullia më e përsosur" të autorit Ahmed Dedat, e botuar në vitin 1986, në gjuhën shqipe nga Bashkësia Islame në RM. Përmes përmbajtjes së këtij libri, muslimanët në mënyrë më të zgjeruar mësojnë për Kur'anin si libër i shpallur nga ana Allahut xh.sh.

"ILMIHAL" për shkallën e tretë të mësimbesimit nga H. Naim Haxhiabdiq, e botuar në vitin 1988 në gjuhën maqedone, në vitin 1990 është botuar në gjuhën shqipe dhe ate rome. Përmbajtja e Ilmihalit është siç vijon:

Pjesa parë

Besimi islam (Akaid) Shartet e Imanit.

Sheriat Ef-Ali Mukkelefin (Detyrat e të rriturëve)

Pjesa e dytë

Detyrat islame (Ibadat) Shartet islame

Sharti i parë islam, Kelimeishchedeti

Sharti i dytë islam, Namazi

Sharti i tretë islam, Agjërimi

Sharti i katërtë islam, Zeqati

Sharti i pestë islam, Haxhi

Pjesa e tretë

Sjellja Islame (Ahlak)

Detyrat ndaj All-llahut xh.sh.

Detyrat ndaj vetëvetës

Detyrat ndaj të tjerëve

Pjesa e katërtë

Historia e shkurtë e Islamit

Në fund të Ilmihalit, si shtesë janë dhënë dhjetë suret e shkurta të Kuranit si dhe lutjet e abdesit.

Materiali përmbajtësor i Ilmihalit është i përpunuar në mënyrë shumë profesionale, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë metodik. Edhe sot e kësaj dite ky Ilmihal më së shumti shfrytëzohet nga muslimanët, edhe pse në qarkullim janë edhe disa Ilmihal të tjerë.

Një rol të madhë dhe të rëndësishëm si burim për të mësuar fenë, te muslimanët e Maqedonisë ka lujatur dhe luan gazeta, respektivisht revista "El-Hilal" (Hëna e Re), e cila filloi të botohet në vitin 1987, në një periudhë kur literatura islame ishte në mungesë të madhe. "El-Hilali" filloi shtypej në tri gjuhë: maqedonisht, shqip dhe turqisht, në një tirazh prej dhjetë mijë ekzemplarëve. "Hëna e Re" që nga botimi i saj e deri në ditën e sotme është duke dhënë kontribut të madhë, në lëminë e përhapjes së dijes dhe mendimit islam ndër muslimanët e maqedonisë, por edhe më gjërë në rajon.

Përshkak të mungesës së materialit fetar të shkruar, furnizimi me këtë literaturë bëhej prej Sarajevës. Librat nga Sarajeva edhe pse ishin në gjuhën boshnjake, ata ishin shumë mirë të pranuar nga muslimanët e Maqedonisë. Kur'anit me përkthim në gjuhën boshnjake, si dhe shumë libra të tjerë të lëmvive të ndryshme edhe sot shfrytëzohen si burim për të mësuar fenë, nga muslimanët që flasin gj. maqedone dhe

boshnjake.

Gjithashtu, në këtë periudhë të përfundimit të ish-sistemit, muslimanët e Maqedonisë, për të mësuar Islamit shfrytëzonin literaturë të botuar në Kosovë. Librat të cilat janë shfrytëzuar si burim për të mësuar fenë, të cilat edhe sot po përdoren janë "Përkthimi i Kur'anit në gjuhën shqipe" "Rregullat e fesë dhe lutjet me sure "Jasinë", "Historia e Pejgamberëve", "Fikhlul Ibadat", "Sufare për mësim të alfabetit arap", etj.

Nga viti 1990, pra kur filloi të merrë fund sistemi monist, shumë libra fetarë, duke përfshirë edhe Mus'hafin në gjuhën arabe, filluan të vijnë si donacion nga Dijaneti i Republikës së Turqisë si dhe nga shumë asociacione të tjera të Turqisë. Librat ishin në gjuhën turke dhe gjuhën shqipe dhe të njëjtë shumë mirë u pritën nga besimtarët e Maqedonisë. Një numër të madhë të këtyre librave, edhe sot e kësaj dite shfrytëzohen nga besimtarët, si psh. "Açiklamali –Ibadet rehberi – Resimlere abdest ve namaz" e përkthyer në gjuhën shqipe. Nga materiali i këtij libri mësohen për parimet elementare të fesë, ndërkaq marrja e abesit dhe falja e namazit ilustron edhe me foto. Sufarja e Ali Hajdar "Kurani Kerim Elifbasi", sufare e cila shumë po përdoret për të mësuar leximin e Kur'anit. Përpos këtyre librave që u përmendën ka edhe shumë të tjera që përdoren si burim për të mësuar parimet islame.

Me ardhjen e sistemit pluralist e demokratik në RM erdhi deri te liberalizimi i fjalës së shkruar, që do të thotë se me një dinamikë të pa parë filloi botimi i librave të ndryshëm, me përmbajtje të ndryshme islame dhe nga botues të ndryshëm. Ndonjëri nga këta botues, nga BFI-ja kërkon pëlqim për botimet e veta, ndërkaq shumica e tyre nuk fare nuk kërkojnë ndonjë pëlqim, andaj kontrolla dhe përcjellja apo vënia e një rendi në lëminë e botimit të literaturës islame është e pamundur. Me keqardhje po përmendim se disa nga botuesit nisën nga aspekti komercial dhe fare nuk çajnë kokën se çfarë materiali të shkruar i oforjnë lexuesit. Nisur nga kjo, roli i nëpunësve fetarë duhet të jetë më përkushtuar në drejtim të selekcionimit të kësaj literature, duke i orientuar besimtarët se cili libër është i mirëfilltë për t'u shfrytëzuar si burim për të mësuar Islamit.

Kur jemi te literatura, duhet përmendur se në kuadër të BFI-së të RM punon dhe vepron Biblioteka Isa Beu në Shkup, e cila në vendlindje e saj, përpos dorëshkrimeve të vjetra ka edhe një numër të madhë librash, të cilat gjithashtu shfrytëzohen nga lexuesit për ta mësuar fenë.

MEDIUMET ELEKTRONIKE

Roli i mediumi elektronike në mësimin e fesë, mund të shihet në

dy periudha kohore dhe atë:

- në ish-sistem, mediumet elektronike ishin të kontrolluara nga politika e sistemit dhe se ato, në atë periudhë jo vetëm që nuk ishin ndonjë nga burimet për të mësuar fenë, por përkundrazi me programet e tyre, në mënyrë sistematike bënë propagandë antifetare.

- në sistemin pluralist-demokratik u hapen shumë medime private-komerciale, si televizione e radio të nivelit lokal dhe nacional. Disa nga këta medime, pronari i të cilave është pjestarë i Fesë Islame, në shemën e tyre programore kanë paraparë edhe emisione fetare, duke angazhuar edhe teologë për realizimin e tyre. Emisionet fetare emitohen më së shumti nata e premte, ditën e premte, para namazit të Xhumasë, gjatë muajt Ramazan si dhe gjatë festive të tjera fetare.

Kur jemi te mediumet elektronike, duhet theksuar se ato kanë influencë të madhe në publik, çka do të thotë se këto mjete janë një burim efektiv në mësimin e kulturës dhe parimeve fetare. Sidomos në kohë të fundit Interneti si mjet shumë dimensional dhe mundësi luan rol të madhë në mësimin e fesë te gjeneratat e reja. Gjatë shfrytëzimit të internetit gjithsesi duhet patur kujdes se çfarë materiali jemi duke lexuar, duhet ditur autorin e tij dhe plasuesin e atij materiali në botën e internetit.

TË MËSUARIT NË MEKTEBE

BFI-ja e RM, si prioritet të veprimtarisë së saj, gjithnjë ka patur organizimin e mësimbesimit nëpër Mektebe. Mektebet janë objekte përcjellse të xhamive, dhe gati secila xhami ka mektebin e vet, në të cilën mësohet feja. Me qëllim që mësimbesimi si veprimtari e rëndësishme, e cila për qëllim ka të mësuarit e diturisë elementare për fenë, organet më të larta të BFI-së kanë sjellur Rregullore për zhvillimin e mësimbesimit nëpër mektebe.

Sipas kësaj Rregulloreje për mësimbesimin, lëndet mësimore do të jenë Kiraet, Akaid, Ibadat, Ahlak dhe Historia Islame, ndërkaq mësimbesimi do të zhvillohet në mektebe, e në rast të mungesës së lokaleve të mektebit, mësimbesimi do të zhvillohet në Xhami, Mesxhid apo në ndonjë lokal tjetër të caktuar nga ana e Muftinive të BFI-së. Mësimbesimin mund ta ndjekin fëmijët shtatë vjeçarë. Të drejtën për mbajtjen e mësimbesimit e kanë personat e autorizuar nga BFI-ja. Mësimbesimi mbahet në katër nivele. Secili ciklus zgjatë nëntë muaj. Mualimët mbajnë regjistër për secilën nivel në mënyrë të veçantë, në të cilat evidentohen të dhënat personale për secilin ndjekës, njësi mësimore të cilën e shpjegon si dhe të dhëna të tjera të nevojshme. Mësimbesimi realizohet në gjuhën amtare të

frekuentuesëve të mësimbesimit, dmth. në gjuhën shqipe, turke, maqedone boshnjake etj.

Plan-programi mësimor për realizimin e mësimbesimit nga lënda e Kiraetit parasheh mësimin e alfabetit arab, drejtleksimin e Kur'anit, të nxënurit përmendsh të sureve të shkurta të Kur'anit, të mësuarit e Texhvidit - rregullat e leximit të Kur'anit.

Nga lënda Ibadat parashihet të mësohet Shehadeti dhe domethënia e shehadetit. Namazi, kushtet e namazit, pastërtia e vendit dhe teshave si kusht për faljen e namazit. Abdesi, vlera e abdesit, farzet e namazit, llojete namazeve etj. Agjërimin si ibadet, të agjëruarit e muajt Ramazan, etj. Zeqati si obligim fetar, detyrimi dhe rënësia e zeqatit, si jepet dhe kujt i jepet zeqati. Haxhi si obligim islam, farzet dhe nijeti i haxhit, kush e ka për obligim që të shkojnë haxh, etj.

Nga lënda e Akaidit parashihet që të mësohet Islami dhe çka do të thotë musliman. Definicioni i Imanit dhe çka është Mu`mini, të besuarit në All-llahun xh.sh.; të besuarit në melaiket, të besuarit në Librat e All-llahut xh.sh.; të besuarit në Pejgamberët e All-llahut xh.sh.; të besuarit në Ditën e Kijametit dhe të besuarit në kada dhe kader.

Nga lënda e Ahlakut, burimet e moralit Islam, detyrat ndaj familjës, prindërve, fafesisit, fqinjëve etj.

Nga lënda e Historisë Islame mësohet historia e pejgamberëve, e në veçanti historia e Muhamedit a.s., historia e Hulefairr-rashidinëve, zgjerimi i Islamit etj.

Në disa mektebe organizohet edhe mësimbesimi për të rritur dhe ate veç për burra dhe veç për gra.

Kur jemi te mësimbesimi nëpër mektebe, duhet përmendur edhe kurset e Hifzit, respektivisht kurset e nxënësive së Kur'anit përmendsh. Kurset e këtilla mbahen nga ana e hafizave, ndërkaq hafiza më të njohur në RM për nga mbajtja e kurseve të hifzit janë Hfz. Mahmud Asllani nga Tetova dhe Hfz. Refik Ajeti nga Likova e Kumanovës.

Në kurset për mësimin e hifzit praktikohet metoda e vjetër, që do të thotë fillimi i nxënësive përmendsh fillon nga faqa e fundit e xhuzit të parë, në vazhdim mësohet faqa e parafundit dhe kështu me rradhë deri nëfaqene parë të xhuzit. Kurset e hifzit i frekuentojnë fëmijët nga mosha shtatë deri në moshën dhjetëvjeçare. Kurset e këtilla, në të shumtën e rasteve zgjasin dy vjet.

TË MËSUARIT E FESË NË SISTEMIN ARSIMOR PUBLIK

Nga viti shkollor 2008-2009 në sistemin arsimor publik është inkuadruar edhe lënda e mësimbesimit, vetëm për klasën e pestë, për të cilën janë shtypur edhe edicioni i duhur për këtë lëndë. Për mësimd-

hënien e kësaj lëndë, Ministria e arsimit dhe shkencës, në bashkëpunim me BFI-në ka angazhuar rreth shtatëdhjetë arsimtar.

Inkuadrimi i lëndës fetare në sistemin arsimor publik është paraparë me ligjin për arsimimin fillor. Lënda fetare shumë mirë është pranuar si nga nxënësit ashtu edhe nga prindërit e tyre.

Për fat të keq dispozitat e ligjit që rregullojnë këtë çështje kundërshtohen nga disa parti politike të cilat janë trashigimtare të idesë komuniste, për të cilën kanë bërë ankesë deri te Gjykata kushtetuese për anulimin e kësaj dispozite ligjore, me motive për ta mbrojtur sekularizmin e shtetit. Dhe kjo mjerisht ndodhi, Gjykata kushtetuese e anuloi këtë dispozitë ligjore, me çka kjo lëndë ndërpritët që të mësohet në bankat shkollore.

TË MËSUARIT E FESË NË SISTEMIN E MESËM ARSIMOR

Nën patronatin e BFI-së të RM, të mësuarit e fesë është organizuar edhe në nivelin e mesëm. Për këtë qëllim BFI-ja e ndërtoi shkollën e Mesme Islame "Medresen Isa Beu" në Shkup, e cila njëherit vazhdon traditën e medreseve të deri atëherëshme me të njejtën emër, që kanë vepruar nga shekulli pesëmbëdhjetë në këto hapsira.

Në vitin 1979 nga ana e BFI-së është marrë iniciativa për ndërtimin e Medresesë, kështu që gjenerata e parë e medresesë është regjistruar në vitin shkollor 1984/85, që do të thotë se gjenerata e parë e diplomuar, nga kjo Medrese doli në vitin shkollor 1987/88.

Në kuadër të kësaj Medreseje, në kohë të fundit janë hapur paralele të shtrira nëpër qytetet vendit, siç është ajo në Shtip për gjininë mashkullore, dhe në Shkup, Tetovë dhe Gostivar për vajzat.

Sipas plan-programit mësimor, në Medrese, përpos lëndëve fetare mësohen edhe lëndë tjera, të cilat janë të parapara të mësohen në shkollimin e mesëm në RM. Mësimi në Medrese dhe në paralelet e saja të shtrira zhvillohet në gjuhën amtare të nxënësve, që do të thotë në gjuhën shqipe, turke dhe maqedone.

SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup luan rol të rëndësishëm në ngritjen e shkallës së vetëdijes arsimore te popullata muslimane, duke dhënë kontribut për përgatitjen në mënyrë profesionale të kuadrit fetarë. Kështuqë shumë nxënës të diplomuar të Medresesë, sot janë duke punuar si nëpunës fetar e të cilët me aftësi të tyre japin kontributin e tyre në të mësuarit e dijes islame te ne.

TË MËSUARIT E FESË NË NIVEL TË LARTË ARSIMOR

BFI-ja me kohë e kuptojë imperativin për nevojat e ekzistimit

të një institucioni të lartë arsimor, andaj mori iniciativën për ndërtimin e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup. Kjo nevojë, në fakt erdhi menjëherë pas diplomimit të gjeneratës së parë të Medresesë Isa Beu.

Në vitin 1995 BFI-ja arriti që ta kompletojë dokumentacionin e duhur dhe vëri gurëthemelin e këtij institucioni të lartë arsimor, me çka filloi ndërtimi i këtij Fakulteti, i cili me procesin arsimor filloi në vitin akademik 1997/1998.

Gjatë një dekade punë, Fakulteti i SHI në Shkup ka dhënë kontribut të madhë në zgjerimin e dijes islame. Kështu gjatë kësaj periudhe kanë diplomuar një numër i madhë studentësh, nga të cilët numër më i madhë i tyre punojnë si nëpunës fetarë, profesorë, arsimtarë si dhe nëpunë të tjera, ku japin kontributin e tyre për ngritjen e edukatës islame të popullata muslimane në këto hapsira.

Fakulteti i SHI nga Ministria e arsimit dhe shkencës ka marrë akreditimin, që do të thotë që ky Fakultet u bashkangjitet fakulteteve tjera për nga zhvillimi i procesit mësimor.

KONKLUDIM

Në fund të këtij referati mund të konkludojmë se muslimanët e Republikës së Maqedonisë janë shumë të interesuar që ta mësojnë fenë e tyre, ndërkaq burimet për ta shtuar dijen e tyre rreth Islamit, relativisht janë të mjaftueshëm.

BFI-ja si organizatë e cila merret me organizimin dhe zhvillimin e jetës fetare, burimeve prej të cilave mësohet islami t'u kushtojë kujdes më të madhë. Për këtë qëllim duhet shfrytëzuar përvoja e vendeve tjera që kanë sukses në realizimin e të mësuarit e Islamit.

Në shfrytëzimin e materialit të shkruar duhet patur kujdes, marrë parasysh se në kohë të fundit tek ne lansohet edicioni i ndryshëm nga grupe dhe sekte të ndryshme. Në këtë drejtim roli i institucioneve arsimore të BFI-së dhe roli i nëpunësve fetare duhet të jetë më i madhë dhe më efikas, për t'u sqaruar besimtarëve muslimanë se ata në këto hapsira tradicionalisht i takojnë shkollës juridike hanefije, andaj të mësuarit e dispozitave të fesë duhet bërë nga literatura përkatse e kësaj fushe. Gjithashtu, duhet sqaruar se paraqitja e grupeve dhe sekteve të ndryshme në këto hapsira, ata janë devijacion nga Islami i drejtë dhe se qëllimi i tyre është përçarja e muslimanëve në këto troje.

Ju falenderi!

(Kumtesa është lexuar në "Takimin e 7-të të Shurës Islame të shteteve Euro-Aziatike" të mbajtur në Stamboll të Turqisë nga 12-15 Maj 2009)

Për ndërtimin e Burmalisë nuk kërkojmë mjete qeveritare!

Nëse lejohet ndërtimi i Kishës Shën Konstatini dhe Elena diku ku më parë nuk ka ekzistuar, përse të mos lejohet ndërtimi i Burmali Xhamisë aty ku ka qenë, aty ku jo rastësisht vendi vazhdon të jetë i lirë që nga viti 1963, thotë Afrim Tahiri, Sekretar i Përgjithshëm i BFI-së. Ai bën të ditur se BFI për ndërtimin e Burmalisë ka iniciuar dhe ka parashtruar kërkesë më 20 prill të vitit 2007. Kërkesa jonë nuk erdhi si reagim ndaj ndërtimit të Kishës në shesh, në fakt, ka mundësi që kërkesa e BFI ta kishte inspiruar qeverinë, thotë Tahiri i cili shton se BFI nuk preferon që objektet e kultit të bëhen objekte nga të cilat shtohet sherri sepse atëherë shoqëria do të jetë shumë larg esencës së asaj për të cilat ndërtohen të njëjtat. BFI shpreson se autoritetet e vendit do të tregohen me përgjegjësi dhe do të vendosin në interes të bashkëjetesës, mirëkuptimit mes qytetarëve, në interes të qytetit të Shkupit dhe integritetit të shtetit.

INTERVISTOI: Valbona Zunçe

Radio Shkupi: Një nga temat aktuale gjithsesi është kërkesa e BFI-së për ndërtimin e Burmali Xhamisë në sheshin e Shkupit, vendimi i qeverisë për ndërtimin e Kishës "Shën Konstatini dhe Elena" gjithashtu në sheshin e Shkupit pikërisht në vendin ku ka qenë shtëpia e Nënë Terezës, ju lutem të na flitni për iniciimin e ndërtimit të Burmali xhamisë dhe si po rrjedhin punët?

z. Tahiri: Bismil-lahir-rahmanir-rahim. Bashkësia Fetare Islame është organizatë e vetme e cila organizon jetën fetare të myslimanëve të Maqedonisë, ajo është e pavarur në organizimin e jetës fetare, në edukimin, arsimimin fetar dhe në vakëfet, veprimtarinë administrativo-financiare dhe me angazhimet e saj ka dëshmuar dhe dëshmon se kultivon vlerat islame në jetën e përditshme dhe në mënyrë dinjitoze përkujdeset për kulturën shpirtërore dhe materiale të myslimanëve. BFI pra ka lidhshmërinë historike dhe është pronare e veprimtarisë historike për mbrojtjen e të cilave vepron duke u mbështetur në Kur'an, Sunnet, në Kushtetutën e saj dhe në aktet normative që dalin nga e njëjta si dhe në Ligjin për pozitën juridike të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz të Maqedonisë. Lidhur me Burmali Xhaminë, BFI në asnjë moment nuk ka qenë e heshtur, dokumentacionet flasin se BFI edhe gjatë sistemit komunist ka reaguar kundër çdo plani urbanistik që në atë vend kishte



paraparë ndonjë lloj ndërtimi, kështu kemi edhe për periudhën e viteve të nëntëdhjeta e të mos flasim për dekadën e parë të këtij shekulli, në veçanti nga viti 2007 e këndej kur BFI - Burmali Xhaminë e kishte në agjendën e saj për të kërkuar leje ndërtimi, gjë të cilën e parashtrroi në vitin 2007.

Kërkesa jonë për kthimin e kësaj xhamie nuk ka të bëjë me denacionalizim të pronës së BFI, sepse Burmali Xhamia nuk përfshihet nga Ligji për denacionalizim, ajo është prishur para vitit 1945, këtë po e themi që sa më mirë të perceptohet mënyra e veprimit të BFI-së në realizimin e këtij synimi.

BFI në bazë të Kushtetutës së saj dhe Ligjin për pozitën juridike të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz, ka parashtruar kërkesë duke u mbështetur në nevojën e myslimanëve të Shkupit për xhami në anën tjetër të Vardarit, duke pasur bindje se Shkupit i takon dhe duhet t'i kthehet një monument unikat dhe reprezentativ siç ka qenë Burmali Xhamia, duke e shikuar Shkupin si një qytet, si një tërësi, sheshin si shesh i të gjithëve dhe jo vetëm të komunës Qendër. Në rast se dikush Shkupin e shef të ndarë nga lumi Vardar ose disa nga komunat, atëherë ç'nevojë ka të zgjedhim kryetar të Shkupit dhe këshilltarë në nivel të qytetit!? E tani kur ka vendim për ndërtimin e Kishës Shën Konstatini dhe Elena diku ku më parë nuk ka ekzistuar, përse të mos lejohet ndërtimi i Burmali Xhamisë aty ku ka qenë, aty ku jo rastësisht vendi vazhdon të jetë i lirë që nga

viti 1963, aty ku e kërkon vendi.

Radio Shkupi: Mirëpo tani kur u aktualizua përsëri ndërtimi i kësaj xhamie në sheshin e Shkupit, BFI inicioi ndërtimin e saj pasi që Qeveria solli vendim për ndërtimin e kishës në sheshin e Shkupit, apo ka iniciuar më herët?

z. Tahiri: BFI ka iniciuar dhe ka parashtruar kërkesë më 20 prill të vitit 2007, kurse vendimi qeveritar për ndërtimin e kishës në Shkup dhe xhamisë në sheshin e Tetovës ishte më 29 janar 2008, pra kërkesa jonë nuk erdhi si reagim ndaj vendimit në fjalë, në fakt, ka mundësi që kërkesa e BFI ta kishte inspiruar qeverinë. Sidoqoftë nëse ju kujtohet, vendimin e qeverisë neve e mbështetëm dhe përmes një komunikate për opinionin ku për herë të parë publikuam edhe kërkesën tonë lidhur me Burmalin Xhaminë dhe njëherit bëmë të ditur se vetëm në qytetin e Shkupit gjatë ish sistemit kanë qenë të rënuara dhjetëra xhami. Iniciativat e rikthimit të objekteve të kultit neve i përkrahim, ato paraqesin mundësi për kthimin e shumë xhamive të rënuara gjatë ish sistemit.

Radio Shkupi: Ju lutem na thoni diçka lidhur me historikun e Burmalin Xhamisë?

z. Tahiri: Burmalin Xhamia është ndërtuar në vitin 1495 ashtu siç shkruan në mbishkrimin që ka qëndruar në hyrje të xhamisë, "Triumfuesin kundër mosbesimtarëve dhe politeistëve, Mehem Beu". Kjo xhami ka qenë e njohur edhe me emrat Karli Zade dhe Ogli Mehmet Beu. Sidoqoftë më së shumti njihet nën emrin Burmalin, emër të cilin e fiton si rezultat i minares së saj të ndërtuar në formë burmeje. Vlen të theksohet se kjo xhami sikurse edhe të gjitha xhamitë ka pasur edhe objekte të tjera përcjellëse, por ajo që e dallon këtë nga shumë të tjera është se krahas hanit dhe turbes kjo xhami ka pasur edhe medresenë Karli Zade e cila është numëruar nga medresetë më të njohura. Rrënimin e kësaj xhamie ishte nga regjimi rrënuar serb, pra nga okupatorët serb në vitin 1924 që në vend të saj në vitin 1925 të ndërtojnë objekt militant që nuk arriti ta mbijeton tërmetin e vitit 1963. Fakti se Xhamia kishte edhe objekte të tjera përcjellëse, në veçanti medresenë Karli Zade, rrënimin e saj është konsideruar si sulm kundër fesë, diturisë dhe kulturës. Këtë akt të okupatorëve serb e kanë dënuar edhe Shoqëria e popujve në Gjenevë.

Radio Shkupi: A kemi raste të ngjashme në Maqedoni sikur kjo e Burmalin xhamisë?

z. Tahiri: Po ka raste të shumta si në Shkup, ashtu edhe në qytete të tjera. Qyteti i Shkupit ka pasur 127 xhami, dhjetëra xhami kanë qenë të prishura nga okupatorët serb, nga periudha e Mbretërisë Jugosllave, nga okupatorët bullgar, e më pastaj nga sistemi komunist. Xhamia e fundit e rrënuar në Shkup ka qenë ajo e Faik Pashës e cila u rrënuar në vitin 1989, xhami kjo e cila gjithashtu ka qenë në anën tjetër të Vardarit. Në këtë drejtim për disa xhami Rijaseti i BFI-së është njoftuar se Muftinia e Shkupit ka formuar këshilla iniciues për ndërtimin e disa xhamive, sikurse ajo e Faik Pashës, Arastës etj. Kur jemi në këtë temë, patjetër të ndalemi edhe te Xhamia e sheshit të Tetovës për të cilën ka vendim qeveritar, dhe më e dhimbshmeja, xhamia e vetme në qendër të Prilepit, pra Çarshi Xhamia e cila për dallim nga të tjerat u shkatërrua në vitin 2001 dhe pa ndonjë arsytim juridik, BFI dhe myslimanët e Prilepit pengohen të fillojnë me punë.

Radio Shkupi: Si i komentoni deklaratat e ambasadorëve të huaj lidhur me Burmalin Xhaminë, ose më mire të themi për ndërtim paralel edhe të kishës, edhe xhamisë?

z. Tahiri: Gjithsesi se janë të drejta, neve i përshëndesim dhe nuk do të pranojmë tjetër pos zgjidhje të drejtë. Neve për asnjë moment nuk e kemi lidhur Burmalin Xhaminë me kishën e cila është edhe pjesë e PDU, ndërtimi i kësaj kishë lidhet me ndërtimin e xhamisë në sheshin e Tetovës e njohur si Tupan (Çarshi) Xhamia, e cila fatkeqësisht, për dallim nga kisha e paraparë në Shkup, nuk arriti të inkorporohet në PDU të Tetovës. Xhamia Burmalin për dallim nga Kisha Shën Konstatini dhe Elena, ndërtohet mbi themelet e vjetra, dhe BFI për ndërtimin e saj nuk ka kërkuar mjete qeveritare. Sidoqoftë, nëse lejohet ndërtimi i Kishës në një vend ku më parë nuk ka ekzistuar, përse të mos lejohet ndërtimi i Xhamisë aty ku ka qenë. Protestat që ishin kundër ndërtimit të kishës dhe arsytimi se po harxhohen para të qytetarëve për ndërtime fetare, se ndërtohet në vend ku arkitektonisht nuk përputhet, në rastin tonë, nuk mund të ketë arsytime të këtrilla dhe nuk presim se dikush mund të proteston kundër ndërtimit të xhamisë. Çështje e vërteta, neve nuk kemi protestuar kundër kishës dhe nuk presim dikush të proteston kundër xhamisë,

njëherit, secila bashkësi fetare është përgjegjëse për ngritjen e objekteve të veta dhe nuk kanë të drejtë të përzihen në punët e njëra-tjetrës se në çfarë vende duhet të ndërtojnë. BFI ka marrëdhënie të mira me të gjitha bashkësitë fetare në vend, dhe nuk dëshiron që autoritetet e vendit të sjellin vendime jo të drejta me të cilat do ndikojnë negativisht edhe në marrëdhëniet mes bashkësive fetare dhe qytetarëve.

Radio Shkupi: Si e shihni inkuadrin e shoqatave dhe organizatave joqeveritare në kërkesën për ndërtimin e Burmalin xhamisë?

z. Tahiri: Inkuadrin e shoqatave dhe organizatave joqeveritare ishte rezultat i vendimit qeveritar për ndërtimin e kishës në sheshin e Shkupit. Në fakt, ata u paraqitën sikur iniciues dhe kërkonin përkrahje për kthimin e Burmalin Xhamisë. Ky është gabim ose lëshim për të cilin mendoj se është rezultat i mosformimit të tyre. Me këtë rast do të kisha shtuar se në bazë të Ligjit për pozitën juridike të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz në RM dhe Kushtetutës së BFI, të drejtë për ndërtim të xhamisë ka vetëm BFI. Në rastin konkret nuk ka pasur nevojë për atë lloj iniciative, sepse BFI veç më kishte parashtruar kërkesën e saj. BFI është e gjithë myslimanëve të Maqedonisë, përfaqëson të gjithë myslimanët, është institucioni më i vjetër në vend, ka ekzistuar para se të ekzistojë Burmalin Xhamia dhe lus Zotin të ekzistoj deri në kiamet, kurse shoqatat dhe organizatat joqeveritare, shumica prej tyre, fatkeqësisht ngrënë zërin vetëm kur u pëshpërit dikush në vesh. Vlen të përmendim se BFI në realizimin e këtij synimi po punon në përputhshmëri me ligjin dhe në frymën e komunikimit që ka me institucionet dhe organet përkatëse, andaj veprimet e pamatura eventuale të shoqatave mund të shkaktojnë pasoja, duke dëmtuar projektin. Andaj, do t'i kisha përkujtuar se në bazë të Kushtetutës së BFI, Këshillit iniciativë për ndërtim të ndonjë xhamie mund të formojnë vetëm myftinitë, e në rastin konkret Myftinia e Shkupit, gjë të cilën edhe e ka bërë dhe çdo lloj këshilli tjetër është në kundërshtim me Ligjin. Në anën tjetër, marrë parasysh se shoqatat dhe organizatat në fjalë janë të themeluara nga pjesëtarë të islamit, pra edhe anëtarë të BFI, neve besojmë se në rast se BFI do të kërkon që besimtarët ta ngrinin zërin rreth ndërtimit të xhamisë, shoqatat do të kenë mundësi për të kontribuar.

Radio Shkupi: Si qëndron punët me denacionalizimin e pronave të BFI-së?

imin e pronave të BFI-së?

z. Tahiri: Lidhur me denacionalizimin e pronave të BFI-së punët shkojnë shumë ngadalë, një pjesë e vogël është kthyer, një pjesë nga ajo që është e llojit që duhet të kompensohet dhe që është ofruar kompensim BFI nuk ka pranuar, dhe për lëndët në fjalë është ankuar në instanca më të larta, ka një pjesë për të cilën kemi vendime pozitive, mirëpo ato ende nuk konsiderojmë për të përfunduar pasi që kanë ankesa nga ana e Prokurorisë publike, kurse për një pjesë tjetër ende nuk kemi përgjigje. BFI shpreson në drejtësi, dhe në zgjidhje të shpejtë të këtij problemi i cili do të jetë në të mirë të të gjithëve, por në të mirë edhe të integritetit të shtetit në strukturat euroatlantike, në të kundërtën, drejtësia duhet të fitohet përmes gjykatës ndërkombëtare.

Radio Shkupi: Cilat do të jenë format e veprimit në të ardhmen lidhur me Burmalin Xhaminë?

z. Tahiri: BFI është duke vepruar në të gjitha nivelet dhe do të vazhdon së vepruari deri në realizimin e këtij synimi. Si institucion që ka vepruar në këtë drejtim edhe gjatë ish sistemit, por edhe gjatë këtij sistemi, do të vazhdojmë me mençuri dhe në frymën e komunikimit që kemi me institucionet dhe organet kompetente. BFI nuk preferon që objektet e kultit të bëhen objekte nga të cilat stohet shëri sepse atëherë shoqëria do të jetë shumë larg esencës së asaj për të cilat ndërtohen të njëjtat. BFI shpreson se autoritetet e vendit do të tregohen me përgjegjësi dhe do të vendosin në interes të bashkëjetesës, mirëkuptimit mes qytetarëve, në interes të qytetit të Shkupit dhe integritetit të shtetit. Pra BFI shpreson se me lejen e Zotit, do të respektohet drejtësia, do të përmirësohet padrejtësia historike dhe sërish do të ngrihet simboli i triumfit kundër ateizmit.

Radio Shkupi: Për fund i nderuari Sekretar i Përgjithshëm i BFI-së, z.Tahiri, ju falënderojmë dhe u dëshirojmë suksese në realizimin e synimeve tuaja!

z. Tahiri: Ju falënderojmë gjithashtu për ftesën dhe njëherit shfrytëzoj rastin t'u falënderoj juve, Radio Shkupin dhe të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike për kontributin e dhënë lidhur me Burmalin Xhaminë.

Intervista është emetuar në Radio Shkupi më 24.04.2009

Humanizmi dhe Dashuria per Natyren Njerezore

Shkruar nga Fethullah Gülen

Dashuria nuk është vetëm një nga temat më të frekuentuara në diskutimet e ditëve tona, ajo është gjithashtu një prej debateve më esenciale. Në të vërtetë, dashuria është një trëndafil në besimin tonë, një mbretëri për zemrat që kurrë nuk vyshken. Mbi çdo gjë tjetër, vetëm Zoti i paanshëm e thur universin si dantellën në avlëmendin e dashurisë, muzika më mahnitëse dhe më magjiplote në gjirin e jetës është gjithmonë dashuria. Marrëdhënia më e fortë midis individëve që i jep formë familjes, shoqërisë dhe kombit është dashuria. Dashuria universale shfaqet vetë kudo në kozmos, në faktin që çdo pjesëz ndihmon dhe mbështet një pjesëz tjetër.

Kjo është e vërtetë në një shkallë të tillë që faktori më kryesor në thelbin e ekzistencës është dashuria. Si një zë i veçantë në korin universal, pothuajse veprimi dhe sjellja e çdo krijese në mënyrën e njohur të tij, në harmoni me motivin magjik që e ka marrë prej Zotit, është një melodi për dashurinë. Nëse ky shkëmbim me dashuri prej ekzistencës të ndjenjat njerëzore dhe prej një krijese në një tjetër, ka zënë vend përtej dëshirave të tyre, kjo ndodh sepse Vullneti Hyjnor i zotëron tërësisht ata.

Prej kësaj perspektive, njerëzimi “në mënyrë të ndërgjegjshme” merr pjesë në këtë simfoni që po luhet në ekzistencë. Nga shfaqja e dashurisë në natyrën e vet të vërtetë, qeniet njerëzore hetojnë se si mund ta demonstrojnë atë në një rrugë njerëzore. Prandaj, pa shpërdorimin e dashurisë në mendjen e tyre dhe për hir të saj në karakterin e tyre, çdo njeri duhet të ofrojë ndihmën dhe mbështetjen e vet të vërtetë për të tjerët. Njerëzit duhet ta mbrojnë harmoninë e përgjithshme që ka qenë vendosur në thelbin e ekzistencës duke marrë parasysh si ligjet e natyrës, ashtu dhe ligjet që janë bërë për të administruar jetën njerëzore.

Humanizmi është një doktrinë për dashurinë dhe ndjenjat njerëzore, artikuluar në mënyrë të pamatur këto kohë, dhe që ka një potencial lehtësisht të manipulueshëm nëpërmjet interpretimeve të ndryshme. Disa qarqe provojnë të imponojnë një kuptim të turbullt dhe abstrakt të humanizmit për popujt e hutuar prej xhihadit në Islam dhe dyshimeve të lindura në zemrat e tyre. Duhet të jetë e

“Në strukturën e parimeve universale të Islamit, shqyrtimi dhe mendimi për dashurinë është shumë i ekuilibruar. Shtypësit dhe agresorët e kanë mohuar këtë dashuri, sepse pikërisht shfaqja si e dashurisë, po ashtu edhe e mëshirës, i ka bërë shtypësit më agresivë, gjithashtu i ka inkurajuar ata të shkelin të drejtat e të tjerëve.



vështirë të përputhësh me humanizmin qëndrimin e çuditshëm të kampionëve të “mëshirës dhe dhembshurisë”, për ata që janë përzier në anarki dhe terror për të shkatërruar unitetin e një vendi, me ata që kanë vrarë pa mëshirë njerëz të pafajshëm si një pjesë e veprimtarive shumëshkullore që synojnë shkatërrimin e mirëqenies për një komb, dhe akoma më keq, për ata që e bëjnë këtë në emër të vlerave fetare, për ata të krisur që akuzojnë Islamit për lidhje me aktet terroriste.

Çdo besimtar duhet të ndjekë të Dërguarin e Zotit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, në kumtimin e së vërtetës. Ata kurrë nuk duhet t'i braktisin njerëzit që përcjellin parimin e lumturisë në të dy botët. Bashkëpunëtorët dhe shokët e Profetit, të quajturit sahabet, të cilët si një bashkësi, janë një shembull i gjallë i mishërimit të së vërtetës prej Profetit, janë bërë shembulli i maturisë dhe ekuilibrit në çdo çështje.

Disa njerëz të veçantë prej gjeneratës fatbardhë që menjëherë ndoqën sahabet, shkuan te Kalifi për të mësuar se si do ndëshkoheshin nëse aksidentalisht do të shtypnin një karkalec. Kur vështrojmë në muret e jashtme të xhamive dhe minareve tona që rrezatojnë dritë, shikojmë gropëza që janë bërë për zogjtë për të zënë vend në to, kjo është shprehje e thellësisë së dashurisë të të parëve tanë. Historia është ndërthurrur me shumë akte të tilla humane: vepra që mbrojnë kafshët si edhe njerëzit.

Në strukturën e parimeve universale të Islamit, shqyrtimi dhe mendimi për dashurinë është shumë i ekuilibruar. Shtypësit dhe agresorët e kanë mohuar këtë dashuri, sepse pikërisht shfaqja si e dashurisë, po ashtu edhe e mëshirës, i ka bërë shtypësit më agresivë, gjithashtu i ka inkurajuar ata të shkelin të drejtat e të tjerëve. Për këtë arsye mëshira nuk duhet të shfaqet te popujt që kërcënojnë dashurinë universale. Shfaqja e mëshirës për një shtypës është veprimi më i pamëshirshëm ndaj të shtypurit. Kështu, ne duhet të shfaqim mëshirë për ata që gabojnë pa dashje ose që ndiejnë pendim për gabimet e tyre. Profeti ka thënë:

Ndihmoni vëllezërit tuaj nëse ata janë shtypës ose viktimë. Ju mund t'i ndihmoni shtypësit duke i bërë ata të ndalojnë shtypjen e tyre (për të tjerët)! [1]

Qendra Islame Wil

1. Historiku i xhamisë

Nëse do të klikoni në webfaqen e qytetit të Wil-it, menjëherë do t'ju bëhet e qartë, pse në Wil jetojnë dhe punojnë aq shumë mërgimtarë. Ejani në Wil, punoni dhe jetoni, është motoja e këtij qyteti jo edhe aq i madh në aspekt gjeografik por i bukur dhe i hapur për të gjithë!

Ndoshta kjo apo ndoshta ndonjë moto tjetër ka bërë që 26% nga popullata e saj e përgjithshme (17.800 banorë) në Wil, të jenë migrant, nga të cilët afër 2500 muslimanë me kombësi të ndryshme. Numri më i madh i muslimanëve është shqiptarë pastaj turk, boshnjak dhe disa nacionalitete tjera!

Ky qytet shtrihet në Zvicrën lindore dhe largon nga kufiri i Gjermanisë dhe i Austrisë me nga 30 km.

Në vitin 1970 hyri këmba e gjeneratës së parë shqiptare në këtë qytet, i cili qytet atë botë nuk dukeshite sikur sot! Infrastruktura dhe standardi ishte edhe më i ulët se në trojet e ish Jugosllavisë, rrëfen migranti i parë në Wil. Ai vazhdon duke thënë se nuk paramendonim që këtu mund të vije koha të falet pesëkohëshi i namazit në xhami dhe me xhemat! 10 vite më vonë gjetëm mundësinë së paku të shkojmë në një xhami në qytetin Zürich dhe të falnim namazet e Bajrameve!

Në vitin 1988 filluan persona të caktuar t'i vizitojnë lokalet e xhamive turke. Ata paguanin anëtarësinë e duhur dhe thelloheshin dita ditës më mirë në fenë e tyre. Ritja e numrit të xhematlive shqiptarë sidhe ritja e interesimit për fenë, bëri që këta të interesohen për një lokal tjetër i cili do të shërbente si xhami dhe do të mundëshin të dëgjojnë ligjeratat e tyre në gjuhën amëtare! Kështu që në vitin 1990 në rrugën Zürcher, marrin me qira xhaminë e parë shqiptare në Wil, me një sipërfaqe prej 72 m².

Shtimi i shpejtë i xhematit bën që dy vite më vonë të kërkohet një lokal më i madh për plotësimin e nevojave të xhematit. Në pjesën jugore të qytetit gjendet lokal me 320 m², në të cilin edhe sot e kësaj dite gjendemi.

Gjatë viteve të shumta ka tentuar kryesia dhe xhemati që ti shërbejnë Islamit dhe xhamisë me aktivitete të ndryshme sidomos me sjelljen e Imamëve të ndryshëm gjatë muajit Ramazan. Në vitin



1998 përfundimisht zgjidhet ky problem edhe ate, vjen Imami i rregullt, i posa diplomuar në Al Az`har të Kairos i cili më vonë edhe magjstron. Sot numron xhamia afër 800 antarë të rregullt dhe përkujdeset për ceremoni fetare për më tepër se 2000 musliman në rrethinë.

Kryesia

Në bazë të statutit të qendrës, kryesia përpëhet nga 11 anëtarë të kryesisë dhe 3 në këshillin mbikqyrës.

Abdullah Mustafa – Kryetar; **Sami Mustafa** – Nënkryetar; **Ibrahim Saliu**-Arkatar; **Hikmet Selami** – Sekretar; **Amir Muaremi** - Zëdhënasi i Kryesisë.

Antarët e Këshillit:

Mulqi Nuredini, Shefik Xheladini, Shenazi Idrizi, Fatni Xheladini, Alireshat Ismani, Eshtref Jusufi

Imami

Sikur që lartpërmendëm, imami i rregullt është mr. Bekim Alimi, i cili sipas rregullores së xhamisë, duhet të udhëheq me

namazet e ditës, përgaditjen e ligjeratave të xhumasë, ligjeratave të ditës së diel, zhvillimin e mësimbesimit Islam në xhami, mbajtjen e mësimt Islam nëpër shkollat e qytetit, kryerjen e ceremonive Islamo-fetare etj. Imami mban përgjegjësinë kryesore për kultivimin e jetës fetare në rrethinë.

Aktivitetet e përgjithshme

Aktivitetet mund të ndahen në përgjithësi në dy grupe kryesore:

Aktivitetet eksterne, gjegjësisht aktivitetet që kryhen jashtë murrave të xhamisë dhe

Aktivitetet e mbrendshme

Mësimbesimi islam në shkollat zvicërane

Nga aktivitetet e jashtme mund të përmendim disa shembuj. Xhamia e Wil'it që nga dita e parë e hapjes së saj si dhe me punësimin e rregullt të imamit të saj ka tentuar të jetë një qendër e hapur për të gjithë muslimanët që jetojnë dhe veprojnë në këtë rrethinë pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre. Xhamia e Wil'it ka tentuar të jetë poashtu një qendër me dyer të

çela edhe për jomuslimanët që kanë shprehur interesim për njohjen e islamit apo për pyetjet e përgjithshme.

Nga sukseset madhështore të mirënjohura në Zvicër është depërtimi mësimbesimit islam nëpër shkollat shtetërore në Wil dhe rrethinë. 1 tetori i vitit 2000 është data e artë kur për herë të parë fillon mësimi zyrtarisht në klasat e larta të tetëvjeçares (klasa e 7-të, 8-të dhe 9-të) në shkollat Lindenhof dhe Sonnenhof. Aty zhvillohet mësimi në gjuhën gjermane për të gjithë nxënësit musliman, në form paralele me mësimin fetaro-krishterë. Dmth. kur të krishterët zhvillojnë në klasat e tyre mësimin krishterë, në kabinetin islam mbahet mësimi ynë.

Islami ligjerohet të martat, të mërkurat dhe të enjtes para dite dhe pasdite. 17 lekcione mbushin agjendën javore. Mungesat dhe notat e lëndës fetare regjistrohen poashtu në dëftesat kryesore të vitit. Ndjekja e mësimt fetarë është fakultative. Planprogrami mësimorë përpilohet nga mësimdhënësi (Imami) i cili krahas studimeve islame ka vizituar kurse të ndryshme të nivelit shtetërorë në metodologjinë dhe didaktikën e punës me nxënës. Momental këtë lëndë e vizitojnë 225 nxënës në tre shkollat të ndryshme.


Raportet e xhamisë me komunën

Xhamia ka një vend të merituar në komunën e qytetit. Pjesmarjet aktive të imamit si dhe përfaqësuesit të xhamisë, z. Abdullah Rexhepit, student në fakultetin ekonomik pranë universitetit të St. Gallen-it, në projekte të ndryshme, si dhe në komisionin për integrim bëjnë që xhamia dhe muslimanët të kenë autoritetin e duhur. Në këtë

kontekst është me rëndësi të përmendet përpilimi i një rregullore të përgjithshme e ashtuquajtur "Regullorja e bashkëjetesës në Wil" për të cilën angazhim të veçantë ka treguar edhe xhamia.

Me pozitën e Imamit tonë si nënkryetar, në Bashkësinë Islame për gjitha nacionalitetet në Zvicrën lindore, e ashtuquajtur DIGO, shënon Xhamia Wil një aktivitet edhe më tepër.

Xhamia Wil ofron shërbim edhe më të gjërë për bashkatdhetarët e sidomos për nënshtetasit e Republikës së Maqedonisë. Në lokalin e xhamisë mbahet dita konsulare, dmth.



konsolata e RM në Bern ofron shërbimin e saj katër herë në vitë për Zvicrën lindore. Takimi i ardhshëm do të mbahet më 20 qershorë 2009. Këta ishin disa shembuj nga aktivitetet e shumta për të cilat në formë të hollësishme mund të flitet në një rast tjetër.

Aktivitetet e mbrendshme, gjegjësisht interne

Nga aktivitetet e shumta të mbrendshme të xhamisë mund të theksohen disa prej tyre. Angazhimi me nxënësit, angazhimi me rinistët, ligjeratat e ditës së premte që zhvillohen edhe në gjuhë gjermane, webfaqja e xhamisë, ekskurzionet me nxënësit si dhe me rinistët etj.

Nxënësit e xhamisë

Ashtu si shumë xhamia te tjera në Zvicër, kemi dhe ne një xhami te bukur në Wil. Edhe pse është në një ish fabrikë, prapë se prapë shkojmë ne nxënësit dhe nxënëset me dëshirë të veçantë në mësim-besim.

Çdo të diel dhe të mërkurë mësojmë në të. Mësimi fillon të dielat prej orës 8.30 deri 10.15 dhe zhvillohet në katër paralele, kurse grupi tjetër, për të cilën zhvillohet mësimi në tre paralele, fillon në orën 10.30 e deri në orën 12.00. Të mërkurat nga ora 13.00 dhe deri në 14.00.

Numri i kolegeve dhe kolegëve të mi që e ndjekin këtë mësim është 191.

Imami ynë, Bekim Alimi, me një aftësi të veçantë në punë me rinistët dhe nxënësit bën që me dëshirë të e presim ditën e diel apo të mërkurën. Ai na mëson si duhet ti lutemi Zotit 5 herë ne ditë, si duhet me marë abdes e cilat janë kushtet e Imanit dhe Islamit.

Per me ju lutur Zotit duhet ditur suret dhe pasi që i kemi mësuar suret, fillojmë me shkronjat arabe që janë 28, prej elifit e deri te gajni.

Kush e përfundon leximin e shkronjave arabe, fillon me një Bismillah në Kur'an. Mbas disa viteve punë të palodhshme, përfundon edhe hatmeja e shumëpritur. Me sa më kujtohet mua, në çdo vit 10-15 persona kryejnë hatme dhe dalin përpara xhematit ku i u përgjigjen pyetjeve të shumta nga Imami në praninë e xhematit. Duaja e hatmes sjell me veti edhe shpërblime të mëdha nga familja por edhe nga xhamia.

Sikur klasat shkollore që bëjnë ekskurzione të ndryshme, këtë na e ofron neve edhe xhamia. Shëtije të paharueshme nëpër parqe internacionale sidhe xhamia në shtete fqinje, janë atraktiviteti ynë vjetorë. Krahas leximit të mevludit tradicional, lexojmë ilahije dhe recitale dhe pjesë teatrale. Ja tëtë herë me rradhë Xhamia Wil organizon Kuiz – gara në dituri për të gjitha xhamiat shqiptare në

Zvicër. Ka qenë kënaqësi, kur disa herë në komisionin e kuizit kanë marrë pjesë profesorë të medresesë, të cilët kanë shpreh fascionimet e tyre për organizimin.

Përgaditi: Nuran Qazimi, nxënëse

Rinistët Musliman - Wil

“UMMAH-WIL” përbehet nga 50 aktivistë të rregullt dhe 9 të tjerë që udhëheqin me këtë grup. Aktivistët jetojnë, punojnë apo studiojnë në qytetin Wil SG dhe në rethinën e tij. Origjina e tyre është prej Mitrovicës deri në Strugë!

Ky forum e shtrinë aktivitetin e tij nën kulmin e xhamisë Wil dhe synon kryesisht aktivizimin e jetës fetare tek gjenerata e re.

Takimet e tyre të rregullta mujore si dhe aktivitetet sportive krijojnë përshtypje pozitive jo vetëm tek të rinjtë muslimanë por edhe tek fetë tjera që jetojnë në fqinjësi me ne.

Aktivitetet e forumit shtrihen kryesisht në këto lëmi, organizim i debateve mes Imamëve që jetojnë dhe veprojnë në Zvicër, si dhe debate me rinistët e partive politike vendase apo edhe të feve tjera.

Organizimi i ditëve sportive, darkave të përbashkëta, ekskurzione të ndryshme brenda si dhe jashtë Zvicrës etj. Përmes këtyre aktiviteteve arrimë diturinë dhe pjekurinë e nevojshme islame. Ky forum ekziston ja 6 vite të plota, me një ripërtrim dhe ristrukturim në këtë vit.

Përgaditi: Meriton Salihi, udhëheqës i grupit!

Nga ekskurzionet mund të përmendim vizitën e 46 rinistëve të xhamisë, qytetit me renome historike islame në Spanjë, Kordoba, që u zhvillua në fund të muajit maj 2009.

Kuizi tradicional mbahet çdo Ramazan në të cilin garojnë nxënës dhe nxënëse shqiptare nga të gjitha xhamiat e Zvicrës. Nxënësit pranojnë një muaj më herët 300 pyetje dhe përgjigje dhe në Natën e Kadrit pas ngrënies së iftarit pozicionohen në vendet e tyre ku fillon garimi. Shpërblimet e mirëfillta gëzojnë zemrën e fëmiut dhe motivojnë për pjesëmarrje për vitin e ardhshëm.

Synimet e mëtutjeshme

Deri më sot xhamia e Wil'it nuk ta tentuar të blej ndonjë lokal apo ndërtesë. Synimet e saja kanë qenë pak më të gjëra edhe atë për ndërtimin e një xhamie nga themeli. Deri më tani është blerë vendi me një sipërfaqe 1450 m² dhe momentalisht janë duke u përgatitur planet e objektit të ri.

Shpresojmë nga Allahu xh.sh. të na ndihmojë në ndërtimin e xhamisë re, ku me siguri do të ju informojmë juve të nderuar lexues të kësaj gazete të famshme islame.

Imam Bekim Alimi



ZGJOHU VIA-POLITIKA

Sekretar i Myftinisë së Shkupit

Skender BUZAKU

Bashkësia Fetare Islame është Institucioni i vetëm fetar në Republikën e Maqedonisë i cili është i thirrur për organizimin dhe kultivimin e jetës dhe vlerave fetare, kurse Kryetari i BFI të R.M Reis ul Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi është personaliteti më i lartë i jetës fetare i cili përfaqëson muslimanët brenda dhe jashtë vendit.

Është fakt i pamuhueshëm se BFI është institucion me traditë shumëshekullore dhe i njëjti është bartës dhe kultivues i traditës dhe kulturës të popullit tonë. Meqenëse BFI dhe Reis ul Ulema kryejnë obligime dhe punë të përditshme të nivelit të lartë e të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutën dhe aktet normative të Institucionit në fjalë, nuk ka kohë që të merret me disa lëvizje apo shoqata për të cilat opinioni i gjërë nuk e dinë se: Kush i formoi? Përse dhe cilave qarqe u shërbejnë ato? Në fakt, shumë lëvizje akoma edhe vet nuk janë definuar për vendin që e duan në shoqëri.

Ragimi i një lëvizje që numëron vetëm dhjetëra anëtar siç është "Zgjoju" ndaj deklaratës së Reis ul Ulema, përbën shkallën shumë të ulët të kulturës së komunikimit me një lider fetar të një institucioni të lartë të vendit. Qëndrimet dhe thirrjet e tilla për të kundërshtuar ndërtimin e tempujve fetar nuk rezultojnë aspak për të krijuar një klimë multifetare, dhe multikulturore siç e parasheh Kushtetuta e Maqedonisë, e nëse nuk e dini edhe Marrëveshja korrnizë e Ohrit.

Së pari duhet theksuar se kjo lëvizje nuk posedon asnjë kompetencë e as që është ndonjë faktor politik apo fetar që të kërkon nga Reis ul Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi i cili është Kryetar i mbi një milionë muslimanëve të këtij vendi që të jep deklarata kundër ndërtimit të kishës në sheshin e Shkupit. Kjo farë lëvizje qytetare është themeluar apo zgjuar dje (tre-katër vite), dhe njëkohësisht



nuk posedon kurrfar legjitimiteti, aq më tepër kur ajo "zgjohet" vetëm sipas porosive.

BFI ka bërë kërkesë që moti për kthimin e Burmalit Xhamisë dhe për të njëjtën gjë Muftinia e BFI Shkup ka formuar edhe Këshill iniciativ për ndërtimin e së njëjtës, atë kohë "Zgjoju" fare nuk ka ekzistuar në faqen e dheut.

KUSH E KA FAJIN PËR KOMUNËN QENDËR TË SHKUPIT

Ndarja territoriale e Shkupit ishte një atak i papërshkrueshëm për shqiptarët e Shkupit. Shqiptarët u përjashtuan nga Komuna Qendër, thënë më drejt, nga sheshi i kryeqytetit, e pikërisht për këtë gjë BFI nuk ka pasur mandat politik ta zgjidh e as që atëkoh (2003) është pyetur nga faktori politik shqiptar që ka participuar në qeveri.

Por u bë si u bë, përqindja e shqiptarëve të Komunës Qendër u zhduk, kjo komunë mbeti pa gjuhën shqipe, pa flamurin shqiptar dhe pa asnjë këshilltar shqiptar

apo musliman dhe BFI duhet të mendojmë seriozisht se si ta bind një këshill të pastër të etnitetit maqedonas të kësaj komune që të votojë apo miratojë PDU i cili do të ishte në favor të muslimanëve të Shkupit. Nuk di por sipas informacioneve që kam, në nivel të qytetit të Shkupit, propozimi për ndërtimin e kishës në sheshin e Shkupit ka kaluar pa u penguar nga këshilltarët shqiptarë, së paku deri më tani nuk kam dëgjuar se dikush prej tyre në këtë drejtim iu është dëgjuar zëri, e as nuk kam njohuri se ndonjëri prej tyre ka kërkuar që të parashohin edhe ndërtimin e Burmalit Xhamisë. Tani pyesim Lëvizjen "Zgjoju" se çfarë përgjegjësie ka BFI që komuna Qendër e Shkupit duket sot ashtu siç është? Pse faktorëve politik shqiptar u vjen mërzi apo ndoshta nënçmim që kur janë në pyetje disa interesa kombëtare dhe fetare ta konsultojnë BFI?

BFI ka mandate t'i përdor të gjitha mekanizmat e mundshme për ruajtjen dhe kultivimin e jetës fetare, të arsimojë gjenerata të reja, të kthejë dhe mbroj pronat e

saj, ndërtimin dhe rindërtimin e xhamive në të gjitha pjesët e vendit në këtë rast jo vetëm të Xhamisë së Burmalisë, por edhe të tjerat siç janë xhamia e Jelen Kapanit, xhamia e Faik Pashës, Arastës e shumë të tjera të cilat kanë ekzistuar këndej dhe andej lumit Vardar, ani se nga të ashtuquajtur politakan lidhur me kërkesat e BFI-së mund të dëgjohej: "BFI po e tepron me kërkesat!" Ska gjë, BFI angazhohet t'i realizon objektivat e veta, kurse për vështirësitë me të cilat ajo ballafaqohet si rezultat i dobësisë së subjekteve të tjera, do të vie koha kur për të gjitha jepet llogari.

Pa e zgjatur tepër, BFI ka kërkuar me kohë kthimin e Burmalit Xhamisë, në veqanti pasi që nga 2006 e këndej maketa e Burmalit Xhamisë qëndron në kabinetin e Reis ul Ulemasë, maketë të cilën e kanë parë shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm të cilët gjatë këtyre tre viteve e kanë vizituar BFI-në. BFI ka reaguar qartë dhe në kohë sa herë që është dashur dhe po e kryen punën e vet edhe me

Komunën Qendër të Shkupit e cila nga Muftinia e BFI-së të Shkupit ka marrur edhe kërkesë për ndryshimin e PDU, respektivisht kërkesë për inkorporimin e xhamisë në PDU.

ÇFAR PËR SHTËPINË E NOBELISTES NËNË TEREZA?

Reagimi, apo siç bënë të ditur disa medime, dënimi i deklarimit të Reis ul Ulemasë nga "Zgjoju" dhe Shoqata e historianëve, ishte tamam sikur Reis ul Ulema të kishte përmendur Nënë Terezën, apo sikur të ishte shprehur: "Kisha duhet të ndërtohet mbi themelet e shtëpisë së Nënë Terezës" ose "Neve mbështesim ndërtimin e Kishes mbi themelet e shtëpisë së Nënë Terezës" e të ngjashme. Kuptohet, Reis ul Ulema nuk është shprehur kështu, ai as që ka përmendur themelet, shtëpi apo ndonjë emër konkret. Mirëpo ja, dikush ose duan muhabet, ose janë vetëm të destinuar për të shpifur dhe për të dëmtuar vetveten – mendoj shoqërinë tonë. Sidoqoft, ajo çfarë duhet të din opinionin lidhur me BFI-në është se BFI ka për obligim ti mbron pronat e veta. Deri më tani asnjëherë nuk është vendosur në shërbim të mbrojtjes së pronave private të dikuj ose të ndonjë badhkësie tjetër fetare. BFI gjithashtu prezantoi në inaugurimin e shtëpisë së Nënë Terezës, me çka edhe ka shfaqur respekt ndaj saj, por ajo që domosdoshmërisht vlen të theksohet është se BFI në atë inaugurim prezantoi me përfaqësues të Reis ul Ulemasë, pra nuk morri pjesë vet Reis ul Ulema, gjest ky që ishte si rezultat i faktit se ajo shtëpi nuk u ndërtua mbi themelet e vjetra të shtëpisë së humanistes. Megjithatë BFI përsëri është e pafajshme, ajo nuk ka votuar as planin global urbanistik e as atë detal, pra përsëri fajti u ngelet subjekteve politike.

Më kujtohet shumë bukur që në këtë manifestim ishte i pranishëm dhe kishte fjalë edhe zv.kryeministri Abdulhaqim Adem, prezentuan edhe Ministri i kulturës së Republikës së Kosovës, biografi i Nënë Terezës z.Dom Lush Gjergji si dhe mysafir dhe diplomatë të lartë nga vendi dhe jashtë.

Në këtë manifestim ishte pjesëmarrëse edhe "Zgjoju", edhe Kisha katolike e vendit të cilën asnjëherë nuk e kemi dëgjuar të reagon lidhur me themelet e shtëpisë e cila tanimë është ngritur diku tjetër. Vërtetë është për t'u habitur se si katolikët e vendit fare nuk i dëgjojmë lidhur me këtë temë dhe as "Zgjoju" nuk u është drejtuar Kishës Katolike. Kurse të gabohet adresa e institucioneve nuk është alamet i mirë.

Sa i takon asaj se Reis ul Ulema i BFI-së h. Sulejman ef. Rexhepi dhe BFI a përkrah projekte shqiptare apo anti-shqiptare, "Zgjoju" nuk është kompetente ta vlerësojë, e dinë ata që duhet ta dinë dhe sikur askush të mos e din, e din Ai i Gjithdijshmi. Kurse sa i përket historianëve, është mirë t'i përkujtojmë se për shqiptarët e Maqedonisë me iniciativë të BFI-së dhe kryetarit të saj Reis ul Ulemasë u mbajt Simpoziumi "Shqiptarët e Maqedonisë" në lokalet e Medresesë "Isa Beu" më 20-22 dhjetor 1991 ku morrën pjesë historian nga të

gjitha trojet shqiptare. Më pastaj edhe të gjitha materialet u mblodhën dhe atë kohë ishte i angazhuar i ndjeri prof.dr.Masar Kodra për botimin e materialeve, mirëpo i ndjeri nuk u ndihmua nga historianët e tjerë dhe më në fund edhe botimin e bëri BFIM më 1994. Si rezultat i kësaj pune, Reis ul Ulema ishte objekt i sumeve të vazhdueshme nga qarqe antishqiptare, kurse historianët e vendit tonë nuk bënë asgjë në mbrojtjen e një kontributi kombëtar. U dasht që mbrojtja të vie nga Republika e Kosovës, respektivisht nga prof.dr.Muhamed Pirraku.

Prandaj sa për ilustrim kësaj lëvizje të vockël i parashtrij disa pyetje:

Pasi juve thirreni se jeni transparentë dhe mbronni kinse interesat e shqiptarëve, respektivisht intetresat e muslimanëve sepse populli shqiptar në këtë vend janë musliman, pyesim: Çfarë kontributi keni dhënë për vullnetin e popullatës tonë lidhur me inkorporimin e mësim-besimit në sistemin publik shkollor, pasi dihet se popullata jonë në të cilin thirreni – kuptohet me pa të drejtë, mbi 95% është për mësim-besim? Çfarë keni bërë për inkorporimin e Çarshi (Tupan) Xhamisë në PDU të Tetovës, sepse e njëjta sikurse Kisha në sheshin e Shkupit, është dashur të bëhet me donacion qeveritar? Pse nuk zgjoheni kur USHT-së i shkurohet buxheti nga Qeveria me çka vihet në pyetje funksionimi i tij normal, apo mendoni se do t'u lahet ndërgjegja me një reagim "as ngrohtë e as ftohtë"? Pse? Pse dhe shumë Pse-ja, bëjnë të qartë se nuk u mjafton vullneti i popullit që ju të zgjoheni! Zgjimi i "Zgjoju" me këtë rast, me sa duket nuk është për të ndihmuar diçka, por thjesht për të dëmtuar projektin. "Zgjoju" pasi që ndërtimin e kishës e hedhi në Gjuqin Kushtetues, nëse nesër BFI e fiton lejen për ndërtimin e Burmalit Xhamisë, sigurisht se e njëjta nga ndonjë lëvizje qytetare maqedonase do të ankohet në Gjyqin Kushtetues, kjo mund të ndodh edhe pse Reis ul Ulema H.Sulejman ef.Rexhepi për këtë xhami siç është deklaruar nuk ka kërkuar mjete qeveritare.

Realiteti është ky, i hidhur por nuk është ndryshe. Shoqata të ndryshme kurdisen për të minuar ndërtime. Thirren në emër të popullit. Sikur në të kaluarën kur thirreshin në emër të popullit për t' rrënuar objekte fetare! Sidoqoft, BFI nuk bën të befasohet, ajo duhet ta njoh mirë popullatën, anëtarësinë e vet, ajo duhet t'i shfleton regjistrat - teftaret e veta, të sheh sa anëtarë ka, kush janë ata që përkujdesen për xhamitë, dhe kush asnjëherë nuk kanë "gabuar" të regjistrohet si të atillë që i takojnë Islamit. BFI patjetër të kujdeset edhe për ata që aty për aty, apo kur u paraqitet nevoja ose kur u pëshpërisin, tentojnë të manipulojnë me xhaminë.

Zot na ruaj nga ata që me vetëdije dëshirojnë të dëmtojnë, nga ata që nuk dinë si të reagojnë e as se si kërkohet ndihma!

Teksti është botuar në gazetën ditore "Lajm", më 28 Maj 2009, e Enjte.

Kujt i reagojnë "Zgjoju" dhe historianët tanë ?

(përkitazi me reagimin e Lëvizjes Qytetare "Zgjoju" dhe Shoqatës së Historianëve Shqiptarë lidhur me deklaratën e Reisul Ulema Sulejman. ef. Rexhepi për ndërtimin e kishës dhe xhamisë në qendrën e Shkupit)

Ka kohë që në opinionin tonë po problematizohet çështja e ndërtimit të kishës ortodokse në qendrën e Shkupit dhe të gjithë ne jemi dëshmitarë të reagimeve të llojllojshme në këtë drejtim. Pro dhe kontra ndërtimit të kishës uprononcuan edhe shoqata joqeveritare, edhe bashkësi fetare, edhe parti politike dhe individë të ndryshëm e intelektualë. Mjerisht, zëri i "Zgjoju" dhe i historianëve tanë mbeti sikur i shterur dhe nuk u dëgjua shumë. Për çudi, ky zëri sikur u ngjall pas deklaratës së Reisul Ulema Sulejman ef. Rexhepi i cili nuk tha gjë tjetër përveçse e theksoi një parim islam i cili sikurse xhamitë, për shtëpi të Zotit i njëjtit kishat dhe sinagogat. Pra, as prijësi i BFIM e as cilido musliman i vetëdijshëm nuk mund të ketë asgjë kundër ndërtimit të kishave. Kjo ishte porosia e Reis Ulemasë të cilës "Zgjoju" dhe historianët tanë të respektuar u përpoqën ti japin krejtësisht tjetër dimension duke u përpjekur të poentojnë dhe në opinion të krijojnë përshtypje se ata qenkan mbrojtësit ekskluziv të vlerave tona shpirtërore e kombëtare.

Pa dashur të polemizojmë me askend dhe pa kurrfarë qëllimi të nxehtësë së gjakrave, dëshirojmë të rikujtojmë edhe një herë se BFIM është institucion i cili merret me organizimin dhe zhvillimin e jetës fetare islame në vend e shtëpi, detyrë parësore e sajë është të realizojë projektet dhe synimet e veta dhe të besimtarëve muslimanë. Njëri nga këto synime tona, tani e njëzet vjetë, është rimëkëmbja e Xhamisë Burmalit që dikur gjendej në sheshin e Shkupit dhe kishte pamje unike të tërë Ballkanin. BFIM e ka kërkuar me ngulm dhe përherë do ta kërkojë

hapësirën dhe vendin e merituar që ju takon islamit dhe muslimanëve në këto hapësira, duke mos i diskriminuar ata që janë të ndryshëm por edhe duke mos lejuar të diskriminohet vetë. Për këto shkaqe dhe për shumë të tjera që nuk dëshirojmë ti theksojmë me këtë rast, po e shprehim publikisht indinjatën dhe habinë tonë nga akuzat që "Zgjoju" dhe Shoqata e Historianëve Shqiptarë" i drejtuan kah Reisul Ulema Sulejman ef. Rexhepi dhe BFIM. Kuptohet se as njeriu i parë i BFIM e as institucioni që e udhëheq ai nuk janë dhe nuk mund të jenë "kundër vlerave të historisë dhe kulturës shqiptare dhe nuk mund të përkrahin shfrytëzimin e parave të shqiptarëve për qëllime anti-shqiptare". BFIM vetëm mendon se këto janë çështje që më shumë prekin në sfera dhe në nivele të interesimit të institucioneve të tjera që përkujdesen për trashëgiminë tonë kombëtare.

Dhe, krejt në fund, jemi të detyruar të themi se reagimi i përmendur është vërtetë i pakuptueshëm dhe me adresë të gabuar. Pyesim publikisht : pse "Zgjoju" dhe historianët tanë nuk e shfrytëzuan praninë e paradokoshme të të respektuarit Dom Lush Gjergji në Shkup si një biograf i Nënë Tereze për ta aktualizuar çështjen e ndërtimit të kishës ortodokse mbi themelet e shtëpisë së sajë? Dhe, pse nuk po i drejtohen komunitetit katolik të Maqedonisë lidhur me këtë çështje ?

(Ky reagim i Shërbimit për Informim të BFIM është dërguar në të gjitha medimet shqipe por nuk është publikuar në asnjërin nga ata)

Dukuritë negative në shoqëritë moderne

Abaz ISLAMI

Konceptet e fesë Islame në vete përfshijnë rregulla, parime, preferenca, etj, andaj besimi në All-llahun xh.sh dhe obligimet që dalin ndaj Krijuesit dhe shoqërisë, janë ndër-tuar në baza të shëndosha dhe të fuqishme. Besimin në Allahun f.p. që posedon njeriu duhet reflektuar pozitivisht dhe fuqishëm në përditshmëri. Reflektimi i tyre në shoqëri duhet të ekziston në çdo aspekti që nga etika, toleranca, respekti, etj. Ngritja e individit në shoqëri bëhet përmes etikës, ndërsa ajo llogaritet një nga shtyllat kryesore në Islam. Dukuritë negative dhe patologjike që i kemi prezentë në shoqëri janë rezultat i mungesës së besimit, praktikimeve fetare dhe etikës.

Zhvillimi industrial, ekonomik, infrastrukturor janë disa nga të arriturat e njeriut në shekullin e XXI. Të gjitha këto të arritura shoqërore janë të theksuara në shumë sfera të ndryshme e në veçanti në atë medicinal, ekonomik, etj. Sigurisht që individit i këtij shekulli është i prirë të shijon të dhëna të reja në aspektin e zhvillimit njerëzor. Teknologjia aktuale është edhe një fakt se njerëzimi po shkon me hapa të shpejtë e të mëdhej, që në kontinuitet po ofron gjëra që shpesh herë të bënë të krijosh opinion se ndoshta shkenctarët arrijtën kulmin e gjithë asaj që mund të shpiket dhe të zbulohet. Edhe për kundër shumë të arriturave në aspektin teknologjik, pastaj në telekomunikim, energjia bërthamore, industrializmi, etj, përsëri njerëzimi është në një situatë të palakmueshme. Shekulli në të cilin tani më jemi në vete po demonstron mjaft turbulli dhe jetë të paparishikueshme për njeriun. Dukuritë negative dhe patologjike janë imponuar marrëzisht, ndërsa në të shumtën e rasteve janë duke e ngulfatur një pjesë të shoqërisë. Amoraliteti, lojërat me fat, narkotizmi, tregtia me qenie njerëzore dhe shumë dukuri janë manifestues të realitë të asaj që është duke vepruar individit në botën moderne.

AMORALITETI

Në bazë të shumë studimeve dhe përvajave shkencore, në konstatimet e shkenctarëve të mëdhenj islamik, por edhe nga ata të botës perëndimore janë dhënë mjaft sinjale të cilat na flasin për rreziqet që shkaktojnë paraqitja e shumë dukurive të reja negative në shoqëritë moderne. Brenga kryesore e shoqërisë moderne është amoraliteti një dukuri që po merr përmasa teje të mëdha,

pasoja të së cilës jemi duke i përjetuar, por ama si duket rezultati i saj i përgjithshëm do të shfaqet tek gjenerata e re që është duke ardhur. Të gjitha këto dukuri na i ka zbulu Kur'ani dhe si të tilla na flet vazhdimisht duke na përkujtuar se këto kanë qenë prezente edhe te shoqëritë e më parshme dhe se prej këtyre kanë pasur pasoja shumë të mëdha.

“Thuaje besimtarëve të ndalin shikimet (prej mëkatit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më pastër për ata. Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.” (Suretu en-Nurë: 30)

Ajo që buron nga libri i shenjtë Kurani f.l është se nga ky libër na shpalosen të gjitha masat preventive për parandalimin e paraqitjes së tyre.

“Dhe mos iu afroni imoralitetit, sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është rrugë shumë e keqe.” (Suretu el Israë: 32)

“Mos iu afroni imoralitetit”, nga kjo porosi ne mund të definojmë në mënyrë precize çështjen e amoralitetit, ku në mënyrë shumë të qartë Zoti na drejtohet duke e thënë “Mos iu afroni imoralitetit”, e nuk drejtohet me fjalët “Mos iu bëni imoralitet”. Dispozitat fetare janë të asaj natyre që e ndërtojnë dhe edukojnë shoqërinë që në moshë të re. Fillimisht është obligim fetar që prinderit t'i dërgojnë apo marrin fëmijët e tyre në objektet fetare (xhami) që nga mosha 7 vjeçare. Ndjekja e mësim besimit fetar është edhe një arsye që bënë fëmijët të jenë të edukuar në bazë të principeve fetare. Nga ana tjetër është obligim që prinderit t'i edukojnë pasardhësit e tyre në frymën e pastër Islame.

Afërsia prindore, mësimet fetare, edukimi shkollor, ndjekja edhe respektimi i parimeve fetare janë elementet kryesore që bëjnë individin të jetë i shëndosh dhe të ketë ardhmëri të ndritur. Edhe pse ekzistojnë ligje shoqërore dhe kode etike përsëri po vërejmë se dukuritë negative dhe patologjike nuk po mungojnë bile bile kohëve të fundit po ballafaqohemi me të dhëna trishtuese. Ngjarjet si abozimet, keqpërdorimet janë karakteristika që të bëjnë të kuptosh se njeriu i shek. XXI, e që është pjesëmarrës në realizimin e po atyre dukurive është i barabartë me një krijesë që i mungon karakteri, posedon ndërjegje të ulët dhe besim jo të pastër.

Shkenctat shoqërore edhe pse janë duke u marrë me analizime rreth shkaqeve të paraqitjes së këtyre dukurive, a njëherit duke

themeluar rregulla për parandalimin e tyre apo së paku për zvoglimin e tyre, përsëri nuk janë në gjendje të gjejnë një formulë e cila do jetë efektive dhe pozitive.

TREGTIA ME QENIE NJERËZORE

Njeriu është krijesë që Zoti e ngritë në të gjitha aspektet në krahasim me krijesat tjera deri në atë nivel që e bëri zëvendës të Tij në tokë. Po bindjet, njeriun shpesh herë e kanë bërë që të injoron besimin dhe udhëzuesit (të dërguarët), duke kërkuar shumë më shumë se sa që i takon. Në mungesë të besimit veprimtaria e tij në shumë raste është në kundërshtim me rregullat e fesë dhe në kundërshtim me atë në çka është i pajtuar All-llahu f.p.

Viktimit e këtij injorimi ka qenë gjinia femrore dhe fëmijët të cilët në shumë shoqëri nuk janë llogaritur si krijesat të Zotit. Fati i tyre ka arritur deri në atë nivel sa që janë shfrytëzuar edhe për tregti. Sa për ilustrim, ne do të definojmë fatin e tyre tek shoqëritë tjera: Me shpërthimin e Revolucionit Francez, ekzistonte parolla: “Liria, Vëllazëria dhe Barazia”, mirëpo kjo nuk ka vazhduar edhe për gratë. Vazhdimisht sociologët, historianët, psikologët dhe feministët bëjnë përpjekje që të definojnë statusin e femrës në shoqëri, për fat të keq edhe pse gjithnjë mundohen të zbusin atë, përsëri në asnjë formë nuk mund të definojnë ashtu siç bëri Islami. Shumë individ për interesa të mëdha personale i kanë shfrytëzuar ata për tregti. Dukuri të cilën edhe intuitionet më të larta ndërkombëtare kanë probleme se si ta eliminojnë. Sa e sa ligje kanë hy në fuqi në Evropë kundër tregtisë me njerëz, mirëpo edhe kjo nuk arrijti që definitivisht të korë sukses. Në anën tjetër një numër të madhë të konventave ndërkombëtare të cilat janë miratuar për të penguar këtë dukuri por përsëri edhe kjo është duke u injoruar. Konventën e fundit të miratuar në Strasbur nga Këshilli i Evropës më sakëtësisht nga sekretari i përgjithshëm, Teri Dejvis, është vlerësuar se Konventa paraqet një “gurrthemel dhe një armë efektive për luftën kundër robërimit modern”.

Rezultatet dhe të dhënat që publikohen nga institucionet përkatëse mbi këtë dukuri patologjike shoqërore rreth tregtisë me qenie njerëzore janë alarmante dhe shqetësuese, dhe se e gjithë kjo mund të ketë një epilog të rënd.

Në bazë të shumë studimeve dhe përvajave shkencore, në konstatimet e shkenctarëve të mëdhenj islamik, por edhe nga ata të botës perëndimore janë dhënë mjaft sinjale të cilat na flasin për rreziqet që shkaktojnë paraqitja e shumë dukurive të reja negative në shoqëritë moderne.

LOJËRAT ME FAT

Ashtu siç po zhvillohet shoqëria në të njëjtën formë po zhvillohen dhe rriten dukuritë negative. Evoluimi i shoqërisë nuk duhet reflektuar negativisht tek ata, mbase kemi mjaft dukuri pozitive përmes së cilave është ngritë dhe ndërtuar civilizimi njerëzor ndër shekuj. Dukuritë pozitive edhe më tej duhet zhvilluar e përpunuar me qëllim të mos bëhet zhvlerësim i gjithë asaj që ndërtuan gjeneratat e kaluara. Kur flasim për gjeneratat e kaluara e kemi fjalën për shoqërinë myslimane e cila mjaft kontribuoi i dha njerëzimit. Ajo që buron nga burimet Islame gjegjësisht nga Kurani dhe sunneti, në vete ndërthen rregulla për sjellje, aty ekzistojnë parime dhe principe të ndryshëm, ndërsa të gjitha këto urtësi janë pjesë e një shoqërie të shkëlqyer. Respektimi i parimeve dhe principeve fetare sigurisht që jep frytet e veta si në aspektin individual po ashtu edhe në atë shoqëror. Lojërat me fat, sigurisht se në bazë të parimeve fetare Islame luftohen, për arsye se janë elemente që e shndërrojnë individin në një qenie të pa dobishëm, të pa aftë për organizimin e jetës së tij individuale dhe asaj familjare. Ato llogariten një nga veprat e djallit që kanë pasoja mararamendëse negative me karakter të ndryshëm. Më bukur na flet Allahu f.p, në librin e Tij, fisnik:

“Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj:” Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta) për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre.” (Suretu el Bekare: 219)

Në bazë të këtyre ndërtohet dhe merr formë shoqëria. Sigurisht që sot fillimisht dinamika është duke e bërë të vetën, individin e ka shndërruar në një element që dinë të fiton në mënyrë të pandershme, mashtron, vjedhe, të jetë i pamoralshëm, etj. Baraspeshimi dhe bilanci i vlerave njerëzore kanë determinuar zhvillimin e fuqishëm të myslimanëve për të cilin rezultat janë të gjithë dëshmitarë.



Koncepti i sunnetit në edukimin e individit (3)

5. FORMIMI I PERSONALITETIT PËRMES ASAJ QË ËSHTË MUNDUR

Përmes nxitjeve, përkatësisht, këshillave peygamberike, Sunneti i ka motivuar besimtarët formimi i personalitetit të ishte në suaza të shfrytëzimit të mundësive, duke e marr në konsideratë faktin se ndikimi i veprës në jetë është më i fuqishëm se ndikimi i fjalëve. Në Kur'an është theksuar: **“A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni? Ndërsa ju e lexoni librin (Tevratin). A nuk po mendoni?”** (Kur'an, 2:44) **“O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e punoni!”** (Kur'an, 61:2,3)

Është fakt se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesellem duhet të ishte për myslimanin shembulli më i bukur për faktin se Kur'ani ishte mishëruar në jetën e tij praktike. Në pyetjen drejtuar Ajshes r.a.h. cili ka qenë morali i Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi vesellem, ajo ishte përgjigjur në atë se : **“Moral i tij ka qenë Kur'ani.”**

Përmes instruksioneve ose direktivave të tij, i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesellem ka sqaruar vlerën dhe ndikimin e veprës së përkryer, duke e vënë theksin në frytin nga e cila buron paqja. **“Nuk i ka besuar Kur'anit ai, i cili i lejon ndalesat e tij.”** (Tirmidhi) **“Çdo njeri që ligjëron do**

të jap llogari para Allahut (për ligjëratën e tij).“ (Bejheki) **“Shembulli i atij që njerëzve ua mëson të mirën por që e harron veten është sikur fitili që u bënë dritë njerëzve por që e djeg vetveten.“** (Bezzar) **“Njeriu, nuk do të arrij nivelin e besimtarit të përsosur për deri sa zemra e tij të mos ishte (e lidhur ngushtë) me gjuhën e tij, të mos ishte paradoksale vepra e tij me fjalën dhe për deri sa të mos ishte fqiu i qetë nga të këqijat e tij.“** (Asbehanu)

Vlen të theksohet këtu fjala e Aliut r.a. : **“Ai, i cili është nominuar imam (prijës) i njerëzve para se gjithash le të filloj me edukimin e vetes para se të filloj të merret me edukimin e të tjerëve, të filloj edukimin e tyre me sjelljet e veta para se t'i edukoj ata me fjalë. Mësuesi dhe edukuesi i vetvetes është më prioritar për t'u respektuar se mësuesi i njerëzve dhe edukuesi i tyre.”**

6. FORMIMI I PLOTË JO PARCIAL

Tipar shumë specifik i metodologjisë peygamberike në formimin e individit gjithsesi është pikëpamja tërësore, gjithëpërfshirëse. Sunneti nuk i ka kushtuar vëmendje vetëm një aspekti të formimit të personalitetit islam por i ka kushtuar vëmendje serioze të gjithë aspekteve që ndërliken me ngritjen dhe ndërtimin e personalitetit të tij. Nuk është koncentruar në

zhvillimin mendor në llogari të shpirtit, as të shpirtit në llogari të organizmit dhe as të organizmit në llogari të shpirtit. Asnjë segment nga segmentet e këtyllë nuk është përqendruar në llogari të segmenteve të tjerë por përkushtimi i sunnetit është fokusuar dhe vazhdon të ishte i përgjithshëm, gjithëpërfshirës, i balancuar larg çdo radikalizmi.

Përkushtimi i sunnetit në formimin e mendësisë islame dhe zhvillimit të potencialeve mendore, ia vlen të prezantohen këto hadithe:

“Atij që Allahu ia dëshiron të mirën e udhëzon në fe.”

“Adhurimi më i vlefshëm është edukimi (mësimi), ndërkaq segmenti më i vlefshëm në fe është besnikëria (sinqeriteti).“

“Ai që ka marr rrugën e kërkimit të diturisë, me anë të saj Allahu ka për t'ia lehtësuar rrugën për në xhenet.“

Përkushtimi i sunnetit në formimin e personalitetit të myslimanit në aspektin mental e psikologjik do të kishim prezantuar këto hadithe:

“Nuk zhvillohen zemrat me gjëra ushqimore dhe pije të shumta nga motivi se zemrat janë sikur bimë, vdesin nga uji i tepërt.“

“Çdo gjë ka arenë (skelë), arena, përkatësisht, skelë e zemrave është dhikri (të përmendurit) e Allahut. Asgjë nuk mund të ndikoj në shpëtimin nga ndëshkimi i Allahut aq sa mund të ndikoj dhikri. As xhihadi (lufta e shenjtë për në rrugë të Allahut)

pyetën të pranishmin. Edhe nëse këputet shpata së luftuari,” ishte përgjigjja e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi vesellem. “ (Bejheki)

Përkushtimi i sunnetit në formimin e personalitetit në sferën e shëndetit, të trupit të shëndosh ashtu që me sukses të mund të ishte i fuqishëm dhe i aftë me i zbatuar obligimet dhe përgjegjësitë. Në këtë kontekst do të kishim veçuar këto udhëzime, përkatësisht, këto këshilla peygamberike:

“Për çdo sëmundje ka ilaç, kur ilaçi të qëlloj sëmundjen do të shërohet me ndihmën e Allahut fuqplotë.“ (Muslim)

“Shërohuni! Për atë se Allahu i gjithëfuqishëm nuk ka lënë sëmundje e të mos kishte shërim me përjashtim një sëmundje (që nuk ka shërim nga ajo). Cila është ajo pyetën të pranishmit? “Pleqëria”, ishte përgjigjja e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi vesellem.“ (Ahmedi, Nisaiu)

“Besimtari i fuqishëm është më i vlefshëm dhe më i dashur te Allahu se besimtari i dobët.“ (Muslim)

“Fëmijëve tuaj t'ua mësoni gjuajtjen e shtizës, notimin dhe kalërimin.“

“Edhe ndaj trupit (organizmit) tënd ke të drejta.“

“Personi që ngulfat veten do të ngulfatet në zjarr, ai që e vret (godet) vetën do të vritet në zjarr, ai që përshkon veten do të përshkohet në zjarr.“ (Buhari)

Vazhdon...

MËSIMBESIMI FETAR

ANULIMI I MËSIMBESIMIT akt antipopullor dhe antibashkëkohor

“... Sot përfshirja e fesë në sistemin arsimor është realitet i pamohueshëm në të gjitha shtetet evropiane të cilat shquhen me një demokraci të tipit më të lartë si Gjermania, Austria, Anglia, Danimarka, Zvicra, Norvegjia, Belgjikë, Suedia, Kroacia, Slloveni, Bosnja dhe Hercegovina, etj”.

Shaqir ef. FETAHU

Vendimi i fundit i Gjykatës kushtetutare të RM me të cilin anulohet mësimbesimi nëpër shkolla indinjo pa masë popullatën e Maqedonisë pa marrë parasysh kombinimin dhe përkatësinë rajonale në vend. Kjo si duket ka habitur dhe ka lënë gojë hapur edhe faktorët e ndryshëm të vendit dhe ato ndërkombëtarë, si për nga joserioziteti i subjekteve me peshë shtetërore, poashtu edhe për nga aspekti mosvetidijes për një vlerë të çmueshme bashkëkohore siç është fenomeni besim dhe fe.

Padyshim, se Vendimi i gjyqit kushtetues është joracional, kontravers jo i natyreshëm dhe si i tillë antipopullor dhe në kundërshtim me vlerat bashkëkohore dhe demokratike, edhe ate për këtë arsye:

E Para: Marrë parasysh rrjedhat e kohës dhe kahjet e botës moderne në të gjitha sferat, padyshim se prezenca e mësimi fetar në sistemin arsimor paraqet një hap të rëndësishëm në integrimin e shoqërisë tonë në rrjedhat bashkëkohore demokratike dhe si i tillë do të konsiderohej si një ngjarje e madhe historike dhe civilizuese për vendin ku jetojmë dhe popullin të cilit i takojmë. Me këtë po i jepet fund një epoke të zymtë dhe destruktive, respektivisht sistemit ateist komunist që përshkonte çdo fushë të aktivitetit njerëzor, në veçanti në fushën e sistemit arsimor. Kjo do të shënonte aktin e fundit dhe dështimin e procesit vandal të pabesimit - ateizimit dhe të largimit të njeriut nga Zoti, proces ky që ishte pjellë e komunizmit pansllavist, që kishte për qëllim zhveshjen e njeriut nga ndjenjat fetare, nga besimi në Zot për ta kthyer atë në Zotin e rrejtshëm,

njeriun - Zot. Me këtë edhe njëherë do të vërtetohej se çdo drejtim, qoftë ai politik, ideologjik, etj që për qëllim ka luftën kundër ndjenjave fetare, konkretisht kundër fesë, shpie në rrugë të paqëllimë dhe të kundërt me natyrën e njeriut dhe si i tillë është e gjykuar në humbje. E kaluara e fundit vërtetoi se tentimi i komunizmit pansllavist për t'u larguar Zoti nga njeriu dhe shoqëria solli njerëzimin në disfatë të vërtetë në të gjitha sferat e jetës shoqërore, ashtu që në atë ekonomike solli varfëri, në atë morale-anomali dhe varfëri shpirtërore, në atë kulturore-injorancë, në ate shkencore-prapambeturi, në atë njerëzore - satamiken, në atë politike - njëanshmëri, në atë juridike tirani e padrejtësi, etj. Ky tentim në mënyrë të paskrupullt vendosi në shërbim dhe keqpërdorim edhe begatitë dhe vlerat më të larta të njerëzimit, si institucionet kulturore e shkencore, mjetet e informacionit, ligjin dhe mekanizmat tjera dhe e gjithë kjo me dekada të tëra solli nënçmimin e dinjitetit njerëzor, shkatërrimin e marrëdhënieve ndër-njerëzore, ateizimin e gjeneratave të reja, tentimin për të majmunizuar njeriun dhe shkencën në përgjithësi,

rrëzimin dhe djegien e thesarit material dhe shpirtëror, e në veçanti të atyre fetare e kulturore, grabitjen dhe plaçkitjen e pasurisë private të familjeve, individëve, bashkësive të ndryshme fetare, etj, arrestimin dhe burgimin e njerëzve fetar e shkencor, uzurpimin e të drejtave fetare e kombëtare, vrasjeve, gjenocideve, etj, në veçanti kjo u demonstrua dhe në mënyrë më të egër u ushtrua kundër Islamit dhe pjesëtarëve të tij.

Pra, me rënien e sistemit

ateist, monist, komunist dhe me fillimin e rrjedhave demokratike normalisht filloi procesi i vetëdijesimit të lirë në të gjitha sferat e jetës dhe filloi krijimi i kushteve dhe hapësirës për trasimin e një jete të lirë në të gjitha sferat, pra edhe në atë fetare, sferë kjo që më tepër u sulmua dhe u dëmtua në fushën shpirtërore dhe materiale. Dekada e fundit paraqet hapësirë më të madhe dhe të lirë për fillimin e një procesi të rehabilitimit në sfera të ndryshme, e në veçanti edhe në sferën fetare-shpirtërore. Kjo e fundit është e domosdoshme kur dihet se gjatë sistemit komunist u krijua një zbrazëti e madhe e varfërisë shpirtëror - fetare. Si të gjitha subjektet kompetente në sferat e tyre profesionale edhe subjektet fetare, pra edhe ajo islame në këtë kohë kërkon pozicionin e vet në shoqëri për të kryer detyrën e vet në kohë dhe vend me qëllim të evitimit të dëmeve, ripërtirjes së saj në sferën ku ajo është kompetente me qëllim të udhëheqjes së popullit në atë sferë që i takon asaj, për të ngritur vetëdijen fetare të çdo një individ dhe për ta shtrirë atë në hapësira të ndryshme ku është e nevojshme sipas standardeve tashmë të definuara dhe të vërtetuara në botën moderne.

Hapi i parë i tentimit të realizimit të shtrirjes së fesë në shoqëri i bërë në sistemin arsimor, paraqet një segment nga shumë segmentet e kycjes së fesë në praktikën e proceseve të ndryshme shoqërore.

E Dyta: Shtrirja e vlerave fetare në sferat e ndryshme të jetës njerëzore dhe shoqërisë është proces modern, racional, psikologjik, etik, etj. pa të cilin nuk mund të paramendohet zhvillimi dhe ardhmëria e njeriut. Kjo është nevojë e patjetërsueshme e

njeriut dhe e drejtë e çdo populli dhe si e tillë është e garantuar me të drejtat ndërkombëtare, ndërsa sot edhe kërkesë me rëndësi e qarqeve ndërkombëtare. Nisur nga fakti se Maqedonia është përcaktuar për një të ardhme demokratike dhe inkuadrim në rrjedhat moderne atëherë përfshirja e vlerave fetare në të gjitha segmentet e jetës, ne veçanti atë arsimore, është ndër kushtet për atë inkuadrim dhe për një ecje të vërtetë drejt ardhmërisë së shëndoshë dhe të vërtetë.

Këtë e vërteton fakti se sot përfshirja e fesë në sistemin arsimor është realitet i pamohueshëm në të gjitha shtetet evropiane të cilat shquhen me një demokraci të tipit më të lartë si Gjermania, Austria, Anglia, Danimarka, Zvicra, Norvegjia, Belgjikë, Suedia, Kroacia, Slloveni, Bosnja dhe Hercegovina, etj.

E Treta: Kam bindje se inkorporimin e lëndës fetare në sistemin arsimor e arsyeton edhe përcaktimi i shumicës së prindërve, fëmijëve, opinionit më të gjerë, e pse të mos themi edhe të një pjese të madhe të intelektualëve, si dhe arsimtarëve të cilët drejt për së drejti do të ballafaqohen me këtë fenomen.

Deri më tani nuk është hasur ndonjë rezervë publike ndaj fenomenit fe në arsim, që nuk do të thotë se kjo nuk ekziston te një numër i vogël të cilët nuk kanë forcë intelektuale dhe shpirtërore të çlirohen nga e kaluara e hidhur ateiste ose të cilët nuk janë të aftë të çlirohen nga bindjet antifetare ateiste të trashëguar nga e kaluara e hidhur.

E katërta: Ajo që gjith më tepër arsyeton inkorporimin e vlerave fetare në sistemin arsimor është anomali dhe dukuritë e kohës në të cilën

jetojmë, kohë kjo në të cilën rininë tonë me të madhe e sulmon narkomania, alkoolizmi, bixhozi, prostitucioni, homoseksualizmi, lezbeizmi, sida, kriminaliteti, vjedhja, etj. Marrë parasysh se feja-besimi në Zot i Cili mbikëqyrë njeriun dhe veprat e tij, **është bazë e moralit njerëzor** (Fihte) dhe e cila tendencën kryesore e përqendron në formimin e personaliteteve të shëndosha fizikisht dhe shpirtërisht, atëherë padyshim se edukata dhe kultura fetare me parimet e saja të shenjta do të luante rol të veçantë dhe tejet të rëndësishëm në shërimin dhe formimin gradual të rinisë duke formuar personalitete dhe gjenerata të shëndosha të cilat do të ishin të gatshme dhe të forta që në të ardhmen të marrin në duart e veta fatin e popullit në të gjitha sferat e jetës. Me të drejtë Volteri thotë se sikur edhe të **“mos ekzistonte Zoti do të ishim të detyruar ta mendojmë atë”**, ndërsa Bertrand Raseli thotë se **“njeriu i bardhë është në mbarim e sipër, jo pse nuk posedon përparim shkencor dhe material, por pse është privuar nga besimi në Zot dhe moral”**. Që do të thotë se jeta shoqërore pa Zot dhe fe është e pamundshme dhe e pakuptimtë.

E pesta: Kultura fetare

është tejet e rëndësishme, e pse të mos themi edhe e domosdoshme edhe për vet procesin arsimor, për arsye se me absorbimin e vlerave fetare arsimimi si imperativ i shenjtë i kthehet burimit dhe shpirtit të vete me të cilin element do ta rikthejë dritën dhe të parit e vet për të vazhduar rrugën drejt qëllimit kryesor të jetës- njohjes së Krijuesit, parim ky që është bazë i zhvillimit dhe përparimit njerëzor, me çka do tu përgjigjet pyetjeve kryesore që vetvetiu i drejtohen njeriut në këtë botë si: **Kush është ai? Nga dhe pse erdhi në këtë botë? Çka është pozicioni i tij në këtë botë? Çka është qëllimi i tij në këtë botë? Ku do të shkojë?, etj.**

Mos të harrojmë se sot feja është gjithë më aktuale dhe më e kërkuar. Sa më tepër të zhvillohet shkenca dhe zbulimet e tyre aq më tepër ndihet nevoja e vlerave fetare, fundja, shkenca ka nevojë të domosdoshme për vlerat fetare me qëllim që ajo të vëhet në shërbim të njeriut, e jo kundër tij, siç thotë edhe vet Ajnshtajni se **“feja pa shkencë është invalid, ndërsa shkenca pa fe është e verbët”**

Ajo që duhet të kuptohet dhe të jetë më se e qartë është fakti se shekulli 21 për parim do të ketë besimin në Zot dhe profesionalizimin e

njeriut(dituria), të vetëdijshëm se **“epokat e zhvillimit dhe ngritjeve të fuqishme gjatë historisë kanë qenë gjithmonë edhe epokat e besimit të fuqishëm”**(Gete).

Inkorporimi i fesë në sistemin arsimor është një hap drejt asaj që u tha më lartë dhe mund të konsiderohet një nismë e vogël në rrugën e arritjeve të mëdha në kohën dhe vendin ku jetojmë dhe veprojmë, por ekzistojnë edhe standarde tjera të shumta të cilat kërkojnë pozicionin e vet në këtë hapësirë të varfërisë shpirtërore, që tashmë janë realizuar dhe vërtetuar në botën përparimtare, si: shtrirja e vlerave fetare në sfera tjera të jetës si në spitale e qendra medicinale, kazerma ushtarake, uzina, universitete, institucione, kopshte të fëmijëve, konvikte, etj. Këtë fenomen më së miri e njohin njerëzit të cilët kanë jetuar në rrethana të vendeve perëndimore ku feja me të vërtetë zë një vend shumë të rëndësishëm. Kjo për ne ndoshta mund të jetë utopi, por për botën moderne kjo është realitet dhe praktikë e zakonshme, për arsye se në të njëjtën kohë janë kërkesa të kohës dhe nevojë e humanizimit të aktiviteteve tona kudo që jetojmë dhe veprojmë. Mos ndjekja e kësaj rruge do të ishte një veprim që përkon me jo realitetin dhe mosnjohjen e kohës

dhe kërkesave të saja në përgjithësi.

Subjektete e llojit të ndryshëm, ne veçanti Gjykata kushtetutare, të cilët synojnë pengimin e këtij procesi, drejtë tradhtojnë besimin e popullatës, tregojnë edhe njëherë se edhe më tutje nuk janë pastruar nga konceptet e sëmura ateiste – komuniste, si edhe më tutje i kundërvihen rrjedhave të natyrshme të kohës si dhe inkuadrimit tonë të përgjithshëm në botën e garës në mes civilizimeve, kulturave dhe hapjes së hapsirave që në humanizimin e botës të merr pjesë aktive edhe besimi – feja. Edhe njëherë vërtetojnë se nuk kanë forcë intelektuale, politike për një rrugë reformuese, për krijimin e ambientit të një tranzicioni të vërtetë në poret e jetës shoqërore dhe politike.

Megjithatë, duke analizuar kahjet e njerëzimit në sfera të ndryshme, atëherë tentimet për asgjësimin e vlerave fetare, pra edhe të inkorporimit të mësimbesimit në shkolla, janë joproduktive, reacionare, mbyllje në vete, komzervim në të kaluarën, mbyllje e frymës së ngritjes së njeriut, pengim i hapsirës për një kultivim të shëndoshë të vlerave të ndryshme pra, edhe të vlerave fetare.



PROMINENCA AKLIMATIZUESE E SISTEMIT ISLAM DHE MODELET POLITIKE TE AKROPOLIT EUROPEREHDIMOR (2)

Ne stërlartësinë e vërtetimit të autenticitetit të tij, Kuranit dhe sunetit, kanë të drejtë të komentojnë dhe nga i njëjti të prodhojnë përfundim çdo pjestarë i tij, natyrisht nën kuptueshmërinë e nivelit të caktuar të arsimit dhe përgatitjeve intelektuale të çmuara në trajta poliedrike dhe polisemike.

TAXHUDIN HAMIDI

Së andejmi në shtetin islam, pushteti i popullit është pushtet i zbatimit të këtij sistemi e jo pushtet i krijimit dhe formimit të tij. Ky pushtet i kësaj natyre, nënkupton se ai nuk ka mundësi ta ndryshoj këtë sistem, e as që mund ta përdorë pushtetin e vet në kundërshtim me te dhe as në atë që shpie në ndryshimin e tij.

Pushteti i popullit është pushtet ekzekutiv. Ai ekzekuton ligjin ekzistues hyjnor dhe nuk është pushtet formues që krijon ligj të ri dhe e zbaton.

Pra sistemi islam me dispozitat e qeverisjes shariatike e vendos qeverinë jo të krijoj ligje të reja, përkundrazi thërret në realizimin dhe zbatimin e ligjeve të shpallura përmes kuranit. Atëherë a mund të thuhet se sistemi i qeverisjes sipas dispozitave kuranore është identik me sistemin e sodit demokratik. Themelet e demokracisë janë vendosur nga ana e revolucionit francez me 1789, sistemi demokratik ka qenë si reaksion dhe luftë kundër teorisë së të deleguarve të Zotit, e cila ka qenë e shpërndarë në europë në kohëzgjatje prej afro dhjetë shekujsh.


Kjo teori ka proklamuar që mbretërit si pasoj të kenë qeverisje absolute, të përkrahur nga ana e klerikëve të kishës romako-katolike.

Për ate fillimisht demokracia ka qenë e themeluar si protest kundër pushtetit hyjnor dhe i gjithë pushteti të i dhurohet njeriut, që vet të udhëheq dhe rregulloj jetën e vet me ligje të pakufizuara.

Tranzicioni nga teoria e të deleguarve të zotit deri në teorinë e pushtetit të popullit nuk ka qenë proces i qetë. Ajo ka kaluar përmes rrugës revolucionare më të përgjakur në botë, ai ka qenë revolucion francez 1789. E cila për moto ka pasur: "vare mbretin e fundit në zorat e klerikut të fundit".

Dr. Sefer el-Hawali ka thënë: "Revolucioni francez ka përfunduar me disa rezultate shumë të rëndësishme".

Gjithsesi atje për herë të parë në historinë e europës krishtere, është lindur shteti republikan jo-religjioz. Filozofia e saj është e bazuar në qeverisje në emër të popullit, në vend të qeverisjes në emër të zotit... Ashtu që nëni gjashtë i deklaracionit i të



drejtës nga viti 1789 pohon se : "LIGJI ËSHTË SHPREHJE E VULLNETIT TË POPULLIT". Kjo do të thotë që ligji nuk është shprehje e vullnetit të kishës ose i vullnetit të zotit. Në bazë të këtij shpjegimi mund të konkludojm se demokracia duke i dhënë të drejta absolute njeriut të përpilij ligje. Ai ka shndëruar vullnetin e njeriut në zot. Të

shprehimi me preciz. Zot i ri (NEW GOD) në sistemin pushtetit demokratik janë

aspiratat dhe dëshirat e njeriut. Është konfirmuar se sistemi demokratik është një ndër sistemet më të lehtë i cili shteteve perëndimore u krijon mundësin përmes antarëve të parlamentit që të përzihen në punët e shteteve në mënyrë të ligjshme.

Ngase anoncimi i vlerave të sistemit demokratik ka asfiks fazën panegjirik dhe është pritur edhe nga vendet joperendimore të justifikojn daljen nga rrethi vicioz.

Megali i vlerave euro-perëndimore për vendet jo të zhvilluara, paksa më duket si denoncim nga veziri për autorin shqiptarë i shekullit të XVI. Se Jahja bej kishte shkruar një elegji për princ Mustafën ekzekutuar në konjë nga "i ati i tij Sulltan Sulejman Kanuni në 1533, Jahja beu me zgjuarsi iu përgjigj :

"NE E DËNUAM ATË ME PADISHAHUN, POR NE E QAMË ATË ME NJERËZINË".

Përmendëm se sistemi demokratik u epafinua si protestë kundër teokracisë dhe ekzistencializmin dhe nihilizmin ua përshkruajti të gjitha botëkuptimeve teologjike pa mos i vërë t'i nënshtrohen trajtimit të daktiloskopisë.

Ndoshta në mënyrë aproksimative në këtë kontekst paksa do të na ndihmoj proverbi porullorë: "AI I CILI ËSHTË DJEGUR PREJ TËMBLIT I FRYNË KOSIT". Shumë nga studiuesit, teokracinë në perëndim e krahasojnë me teokracinë islame. Teokracia islame është diçka krejtësisht e ndryshme nga teokraci e cila në Evropë ka përjetim të hidhur. Teokracia e bazuar në islam nuk paraqet qeverisje të asnjë shtrese klerikale, por në të pushtetin e ka tërësia e bashkësisë islame, duke i inkorporuar të gjitha shtresat dhe klasat. Atë që sot e quajmë teokraci rrjedhë nga gërshtimi i pozitës cesaropapiste , ku paraqitet rendi kishtar centralist i quajtur teokraci.

Principi ideologjik pushteti në dorë të popullit , parim i cili është themelues i mendimit të shkollës demokratike , është zhvilluar deçenie para revolucionit francez 1789.

Mirëpo sistemi parlamentarë është themeluar në Angli një shekull para revolucionit francez. Në sistemin politik parlamentarë kushtetuta është dëshmi e legjislacionit të drejtë.

Mirëpo, nga ana tjetër, kompozitorët e kushtetutës nuk janë forca qytetare ose përfaqësuesit e popullit , por ata janë ose qendrat organizuese të fuqisë brenda aparatit shtetëror ose janë elita e cila është ngushtë e lidhur me qarqet politike të pushtetit.

Por kjo nuk është e gjithë. Në sistemin demokratik ekziston edhe një dukuri inkoherente në këtë sistem komentimi i kushtetutës i lejohet vetëm gjyqit kushtetues, siç potencuam i përbërë nga personalitete të emëruar, mirëpo anëtarët e zgjedhur të parlamentit ose disa tjerë në të nuk kaf i të drejtë. Athua kjo do të thotë se pushteti në sistemin demokratik qenka në duar të popullit. Kurse në të drejtën e shariatit islam.

Ne stërlartësinë e vërtetimit të autenticitetit të tij, Kuranit dhe sunetit, kanë të drejtë të komentojnë dhe nga i njëjti të prodhojnë përfundim çdo pjestarë i tij, natyrisht nën kuptueshmërinë e nivelit të caktuar të arsimit dhe përgatitjeve intelektuale të çmuara në trajta poliedrike dhe polisemike.

Midis të tjerave kjo modelin e sistemit të islamit ia ka ruajtur vitalitetin me një ndërtim ekuilibruet skofiare kompozicional harizmatik.

Pra sistemi islam na tregohet më qytetarë, liridashës dhe pluralist në krahasim me të tjerët. Nga koha e Descartesit e kënde perëndimorët të cilët shiqimin e tyre në botë e bazojnë në kuantitet e jo në kualitet, mendohet se kuantiteti dëmton rëndë demokracinë. Sistemi demokratik në perëndim i intereson apo si preferencë ka shumicën prej 51% në relacion me 49%, nëse shumicën e votave për moment e pranojmë si racionale, ky konstatim na dërgon në përfundim se regjimi nazist i Hitlerit, i cili erdhi në pushtet me mbështetjen e shumicës despotike, rigjide e të dhunshme, ka qenë racionale.

Mirëpo kur merret si shembull gjermania naziste, atëherë bëhet distancimi i argumenteve për mbështetjen e vullnetit të shumicës.

"Zoti ynë bëne të sotmen tone më të mire se të djeshmen, ndërsa të nesërmen tone më të mire se të sotmen".

DOMOSDOSHMERIA E ZGJIDHJES ISLAME

Nesim BAJRAMI viti III-të

Pse i thërrasim njerëzit dhe thërrasim vetëveten në islam?

I thërrasim të tjerët në islam, ngase përmes hyrjes së tyre në islam, ata dalin nga errësira në dritë dhe udhëzohen në rrugën e drejtë. Përse thërrasim që tërë jeta të bëhet islame? Për të dal nga ngatëresat shqetësimet dhe dënimi i saj (jetës). I thërrasim të tjerët në islam, ngase ai është rregull i vetëm i All-llahut xh.sh, me të cilin ata do të udhëzohen, dhe në të cilin rregull ata do të gjejnë lumturin.

Pastaj, pse ne myslimanët thërrasim vetveten tonë në islam? Thërrasim veten tonë në islam, ngaqë ne në fakt pretendojmë islam, por nuk e praktikojmë atë në jetën tonë, e as që jetojmë jetë islame, të cilën gjë na porositi All-llahu xh.sh...

Athua vallë, ku është islami në ligjet tona? Ku është islami në edukatën tonë? Ku është islami në kulturën tonë? Ku është islami në masmediumet tona? Ku është islami në sjelljet tona personale e shoqërore? Ku është islami në traditat tona shoqërore? Ku është islami në organizatat tona në përgjithësi?

Me të vërtetë ne po jetojmë anash islamit, dhe për këtë arsye, duhet të i kthehemi atij. Duhet të i kthehemi islamit dhe të jetojmë si besimtarë të vërtetë të kësaj feje, me qëllim që të vazhdojnë ndaj nesh begatitë, ashtu siç desh All-llahu i Madhëruar për ne: "...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë time, zgjedha për ju islam, fe..."

Po qe se shikojmë në logjikën e besimit, do të vërejmë dhe do të kuptojmë se, ne nuk mund të jemi besimtarë, nëse nuk jetojmë me islam dhe për islam, nëse islami nuk bëhet program për jetën tonë, ndërsa Kur'ani rregull për shoqërinë tonë, dhe nëse e drejta islame nuk gjykon në të gjitha çështjet tona. Nuk ka besim pa këto gjëra. Domosdoshmëria e besimit dhe domosdoshmëria e përmbajtjes dhe angazhimit tonë për fjalën: La ilaha il – All-llah Muhamedur-resul-lull-llah, na e bën të domosdoshme që të gjykojmë sipas islamit, ti kthehemi atij dhe ta praktikojmë atë si të tërë.

Kjo është logjika e besimit, dhe po të gjykojmë sipas kësaj logjike, jemi të

obliguar ti kthehemi Kur'anit, Sunetit, dhe Islamit, të gjithë duke përfshirë këtu edhe sundimtarë edhe të sunduar, sepse për ndryshe akuzohemi për hipokrizi dhe mosbesim, padrejtësi dhe mëkat, ndërsa ai i cili do të na akuzoj për gjëra të tilla është Kur'ani Famëlartë, siç thotë All-llahu xh.sh. në kaptinën "el-Maide", në tri ajete që vijnë: "E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu ata janë mohues"; "...E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti All-llahu ata janë mizorë (të padrejtë)"; "E kush nuk gjykon sipas asaj që All-llahu e zbriti, të tillët janë mëkatar të dalur jashtë rrugës së Zotit". Dhe athua mundë t'u iket këtyre tre ajeteve Kur'anore?!

Logjika e besimit na obligon neve që t'i kthehemi islamit plotësisht, e jo vetëm ndonjë aspekti nga aspektet e tij, apo vetëm ndonjë parim nga parimet e tij. Prandaj ajo që na brengos është fakti i hidhur se, në shtetet islame dhe në shoqëritë të cilët njihen si islame, Islami është i kufizuar vetëm në ndonjë parim nga parimet e tij.

Islami praktikohet vetëm në një kënd të jetës sonë, dikujt edhe ky kënd i vogël i duket i tepërt, bile as xhamija nuk i është lënë islamit e as minberin, të cilin duan ta bëjnë vend në të cilin nuk do të flitet fjala islame, por fjala të cilën e dëshiron qeveria! Dhe mjer për atë që nuk e respekton një gjë të këtyre, ai burgoset arrestohet, apo përjeton fat të hidhur dhe mbaron me fund të panjohur. Ndërsa ne jemi te obliguar ti kthehemi islamit të plotë, jemi të obliguar ti kthehemi islamit pasi duke marrë parasysh se ai është program jete, i cili rregullon jetën si të tërë, në çdo aspekt: në shtëpi, në shkollë, në xhami, në universitet, në gjykatë, në fushë, në fabrikë, në rrugë dhe në çdo aspekt tjetër. Madje duke marrë parasysh se ai (Islami) është shpallje që e shoqëron njeriun, ai e udhëzon dhe është ligj për të, prej djepi deri në varr. Ai është ligj dhe program jete për të, prej lindjes së tij deri në vdekje. D.m.th. Islami i përfshin të gjitha parimet të cilat kanë të bëjnë me çdo aspekt të jetës së njeriut, prandaj ne duhet të i kthehemi islamit të plotë, në çdo aspekt dhe periudhë jetësore. Me këtë nënkuptojmë se në islam qëllimi final është lidhëshmëria e shkëlqyer me All-

llahun xh.sh. Ky synim duhet të jetë ideal i jetës dhe i përpjekjeve tona. "Ti, o njeri që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt" (El-Inshikak:6)

"Dhe se te Zoti yt është Fundi (kthimi i cdo gjëje)." (En-Nexhëm:42)

S' do mend se Islami ka edhe synime tjera humane dhe shoqërore, por nëse ndalemi pak dhe mendojmë, do të vërejmë se të gjitha ato në fakt janë në shërbim të synimit më të lartë, qëllimit të qëllimeve: arritjes së pëlqimit të All-llahut xh.sh.

Islami, esenca dhe thelbi i të cilit është njëshmëria (teuhidi) me çdo ligj dhe udhëzim të tij synon që ta gatuaj njeriun që të bëhet rob i vërtetë i All-llahut e jo i gjërave tjera jashtë Tij.

Nuk ka fare dyshim se njeriu nuk është krijuar vetëm për të ngrënë e për të pirë, për t'u dëfryer e për të u zbavitur, por për një qëllim më të lartë. Ata që jetën e kuptojnë si arenë e kënaqësive, e harxhojnë veten mu si kafshët. Për ta Kur'ani Famëlartë thotë: "...Ndërsa ata që nuk besojnë, e kënaqin veten dhe hanë siç ha bagëtia..." (Muhamed:12).

Është thënë: I marrë jeton për të ngrënë, kurse i mençuri hanë për të jetuar". Jeta nuk mundë të jetë qëllim në vetvete, patjetër duhet të egzistoj një qëllim tjetër më sublimë për të cilin jetohej. Për ç'qëllim bëhet fjalë?

Materialistët në filozofinë e vet kësaj pyetje s'i gjejnë dot përgjigje të shëndoshë, kurse besimtarët pohojnë: "Njeriu jeton për ta njohur krijuesin e vet të gjithëfuqishëm, për ta adhuruar atë dhe për ta çuar në vend emanetin si mëkëmbës i Tij në tokë. Këtë Kur'ani e shpjegon shumë qartë duke e përmendur qëllimin e krijimit të xhinëvë dhe njerzve: "Dhe Unë nuk i krijova xhinët dhe njerzit, vecse për të më adhuruar" (Edh-Dharijat:56)

Çdo krijesë në gjithësi me përjashtim të njeriut, është krijuar për t'i shërbyer krijesës tjetër. Njeriut, pra të cilit i është nënshtruar gjithçka në gjithësi, është krijuar për t'iu bindur All-llahut, për ta adhuruar atë, për ta çuar në vend emanetin. Ç'krijesë fisnike dhe e ndershme na qenka njeriu, zotëri në gjithësi dhe rob i krijuesit të vetëm.

Mus'ab ibn Umejri r.a

Semi AJETI viti III-të

Mus'abi ibn Umejri r.a lindi në një shtëpi me plot bollok, krenari dhe pozitë, dhe nuk kishte në Meken prej djelmohave të cilët iu gëzoheshin të mirave të prindërve të tyre siç iu gëzonte Mus'abi r.a. Ka qenë djalë i pashëm i bukur, ka qenë oratorë i Meke dhe prezantonte në shoqëritë dhe ndjenjat e përkundër moshës së re që kishte. Ka qenë stolia e ndjenjave dhe shoqërive, përgjegjësit e shoqërive gjithmonë u kujdeseshin që Mus'abi r.a të jetë në mes të prezantuesve sepse ai kishte një pamje elegante dhe një mendje mbizotëruese që hapeshin para saj zemrat dhe dyert.

PRANIMI I ISLAMIT

Në atë kohë që erdhi Pejgamberi a.s filloi në gjithë Meken të bëhet biseda e tij, dhe feja e tij e re, i cili i filloi të thërras në këtë fe. Ky djalosh, Mus'abi r.a ishte që dëgjonte më së shumti për këtë fjalë, u dëgjua se i Dërguari i All-llahut Muhamedi a.s dhe ata që besuan me të po mblidhen për çdo ditë larg nga kurejshët në shtëpinë e Erkam bin Erkamit r.a. Nuk zgjatën shumë dilemat për të dhe shkoi te shtëpia në të cilën ndodheshe Pejgamberi a.s dhe shokët e tij që të shohë se çka po ndodhë. Ai e pa të Dërguarin e All-llahut që po i takonte shokët e tij u lexonte Kur'an dhe falej me ta. Kështu që çdo fjalë të Kur'anit që e ndëgjonte filloi të ndikonte në zemrën e tij dhe ti shtohet dashuria ndaj Islamit.

Nëna e tij quhej Hannas bint Malik ajo njihej me një forcë të madhe në personalitetin e saj dhe ishte e frikshme, kurse Mus'abi r.a askujt në sipërfaqen e tokës nuk ju frikonte siç i'u frikonte nënës së tij sepse kundërshtimi i nënës së tij ishte tmerr që nuk mbahej. Prandaj vendosi që të fsheh besimin në islam derisa All-llahu të vendos për shfaqjen e besimit të tij.

Vazhdoi Mus'abi r.a të shkonte te shtëpia e Erkamit r.a dhe të ulej me të dërguarin e All-llahut xh.sh kurse ai ishte i qetë në besimin e tij dhe i frikësohej hidhërimit të nënës së tij e cila nuk dinte asgjë për besimin e djalit të saj në Islam.

Veç se në Mekë ato ditë nuk

“ Shikoni këtë njeri, (Mus'ab in Umejrin) zemrën e të cilit e ka ndriçuar All-llahu me nurin (dritën) e Vet. Më kujtohet mirë kur e shihja, e ai ishte me prindërit e vet të cilët e ushqyen me ushqimet më të mira, por të gjitha këto i la nga dashuria e madhe që kishte ndaj All-llahut dhe Pejgamberit a.s”

fshihej asgjë mga spiunët kurejshë të cilët ishin në çdo rrugë dhe ndiqnin çdo shenjë që vinte nga ana e myslimanëve.

Dhe një ditë Othman ibn Talha e pa Mus'abin r.a duke hyrë fsheturazi në shtëpinë e Erkam bin El Erkamit r.a pastaj e përcolli edhe më tej ku e pa atë duke u falur pas Pejgamberit a.s dhe me shpejtësi shkoi te nëna e Mus'abit për ti treguar se Mus'abi është bërë mysliman. Kur e dëgjoi nëna e tij këtë gati u çmend.

Nuk i mbeti Mus'abit ti frikësohet kujt pasi që nëna e tij ndëgjoi për hyrjen e tij në Islam, ai qëndroi me forcë dhe trimëri para nënës, familjes dhe parisë së Meke të cilët ishin mbledhur rreth tij e ai po u lexonte nga Kur'ani të cilin i dërguari a.s ua pastronte zemrat dhe ua mbushte me urtësi, nder dhe drejtësi. Dhe ajo që pritej prej nënës së tij edhe ndodhi. E mori nëna e tij një sopat dhe donte ti'a hiqte kokën, ndërkohe kur e ktheu kokën ka biri i saj e pa dritën e imanit që ndriçonte në fytyrën e birit të saj. Kur e vërejti këtë te biri i saj e la por puna që bëri ishte se e mori Mus'abin dhe e lidhi për një direku të shtëpisë me qëllim që mos të shkon në shtëpinë e Erkamit dhe të takohet me Pejgamberin a.s.

HIXHRETI I TIJ R.A

Kur dëgjoi Mus'abi se disa myslimanë filluan të emigrojnë në Etiopi vendosi që të gjej një moment kur rojet e tij nuk do të jenë të vëmendshëm te hikë dhe të emigrojnë me myslimanët tjerë. Pasi qëndroi një kohë në Etiopi u kthyen me një grup mylianë. Pasi që u kthye nga Etiopia nëna e tij u mundua që përsëri ta mbyll por ai u betua se çdo kush që do të ndihmon nënës së tij për kapjen e tij do ta vras. Kur Pejgamberi a.s i urdhëroi shokët e tij që të udhëtojnë për së dyti herë në Etiopi Mus'abi shkoi te nëna e tij duke qarë që të përshëndetet . E luti nënën e tij që të dëshmon shehadetin mirëpo ajo me vendosshmëri nuk pranonte një

gjë të tillë.

Nga kjo Mus'abi e la familjen e tij te pasur dhe shkoi me shokët e Pejgamberit a.s ku e dinte se nuk do ta ketë jetën sikur që e kishte me familjen e tij, pasi që donte të sakrifikon për All-llahun xh.sh.

Pas kësaj ndodhi Mus'abi jetonte një jetë të varfër saqë kur e shihnin shokët e tij me rrobe të shkyera thonin: E kam pa këtë Mus'abin dhe nuk kam pa njeri më më shumë të mira derisa ishte te prindërit e tij mirëpo të gjitha i la vetëm për All-llahun dhe të dërguarin e tij.

Pejgamberi a.s në lidhje me këtë gjest madhështor të Mus'abit thoshte: “ Shikoni këtë njeri, zemrën e të cilit e ka ndriçuar All-llahu me nurin (dritën) e Vet. Më kujtohet mirë kur e shihja, e ai ishte me prindërit e vet të cilët e ushqyen me ushqimet më të mira, por të gjitha këto i la nga dashuria e madhe që kishte ndaj All-llahut dhe Pejgamberit a.s”

I la të gjitha të mirat jetonte në varfëri dhe uri vetëm e vetëm që të arinë kënaqësin e All-llahut xh.sh.

DËRGIMI I TIJ NË MEDINE

Lajmi për ardhjen e Pejgamberit a.s kishte filluar të përhapet shumë. Ky lajm kishte arritur edhe në Medinë banorët e së cilës filluan të kushtojnë interes të madh. Kjo bëri që te Pejgamberi a.s në Mekë të shkojnë 12 të deleguar nga Medineja edhe atë 8 nga fisi Hazreth dhe 4 nga fisi Eus, fise të cilat deri në atë kohë ishin në armiqësi të madhe mirëpo me pranimin e Islamit e haruan gjithë armiqësinë që kishin.

Ky grup u takua në Akabe ku idhanë besën Pejgamberit a.s për aplikimin e fesë Islame. Besa të cilën e mori Pejgamberi a.s përmbante 6 pika: Të mos adhuronin Zot tjetër pos All-llahut, të mos vidhnin, të mos bënë zina, të mos vrisnin fëmijët, të mos shpifnin, dhe mos të kundërshtojnë gjërat e mira.

Pasi që medinasit u kthyen për në Medine dhe pasi që kishin pranuar islamit, Pejgamberi a.s e dinte se duhet tu dërgoj një njeri që do tua mëson islamit. Pasi që Mus'ab in Umejri ishte më i aftë për këtë opunë vendosi që ta dërgoj Mus'abin që Medinasve tua mëson Islamit.

Me të shkuar Mus'abi në Medinë u vendos në shtëpinë e Es'ad ibn Zurareja njeri i cili e kishte pranuar Islamit dhe aty filloi që njerëzve tu paraprij në namaz dhe tu'a mëson Islamit. Personi i cili e kishte marë Mus'abin në shtëpinë e tij e mori dhe e dërgoj nte kusherinët e tij Sa'd ibn Muadhi dhe Usejd ibn Hudejri.

Sa'd ibn Muadhi kur e pa se Mus'abi ishte ulur dhe po i mësonte njerëzit e porositi shokun e tij Usejd ibn Hudejrin që të shkon dhe ta qorton Mus'abin. Usejd ibn Hudejri e mori shigjetën që kishte dhe u nis drejt Mus'abit. Zurarja i cili po e shoqëronte Mus'abin i tha: Ky është prijësi i fisit të vet lute Zotin që ta udhëzon. Mus'abi i tha: Po që se ulet do ti flas.

Usejdi me shigjetë në dorë u afrua te Mus'abi dhe i tha: çka ju solli juve këtu doni ti mashtroni të dobtit? Për të mirën tuaj më mirë lëshojeni këtë vend. Mus'abi i tha: A nuk ulesh pak të ndëgjosh? Ndëgjom dhe po që se të pëlqen ajo që do të tregoj pranoje po që se jo atëherë mos e prano. Usejdi i tha: Kështu është me të drejtë dhe e la shigjetën dhe u ul pran Mus'abit. Mus'abi me oratorinë e madhe që ia kishte dhënë Zoti filloi që ti fliste rreth islamit dhe parimet e saja madhështore. Pas kësaj filluan të lexojnë edhe Kur'an dhe gjat leximit të Kur'anit filloi që fytyra e Usejdit të shëndritë. Këto fjalë e mahnitën Usejdin dhe tha: Kjo fe është madhështore a mund të më tregoni si mund të hy në këtë fe? Ata i thanë duhet të lahesh dhe të dëshmosh shehadetin.

Pasi që i kreu të gjitha punët që i thanë ai u tha: Pas meje është edhe një njeri i cili nëse e pranon islamit nuk do të mbetet nga fisi ynë njeri pa e pranuar Islamit. E ai është Sa'd ibn Muadhi.

Më pas Usejdi pasi që veç më e kishte pranuar Islamit u nis për te shoku i tij Sa'd ibn Muadhi i cili u tha shokëve të tij: Po vjen Usejdi mirëpo nuk e shoh se po vjen me atë mendje që shkoi.

Kur u kthye Usejdi Sa'ad ibn Muadhi i tha: Hë çkemi? Ai i tha shko dhe ti shife. Shkoi Sa'd ibn

Muadhi te Mus'abi të cilin poashtu e bindi që ta pranon islamin.

Pasi që e pranoi Sa'd ibn Muadhi Islamin u kthye fisit të vet dhe i tha: ç'mendim keni për mua? Ata i thanë: Ti je i pari ynë. Po për mendimet e mija si mendoni? Ata thanë: Ti gjykon me drejtësi mes nesh. Atëherë u tha: Unë nuk pranoj që të ju flas për derisa nuk e pranoni Islamin. Me këtë i gjithë fisi në të cilin Pejgamberi a.s e kishte dërguar Mus'abin e pranuan Islamin. Saqë thuhet se gjat një viti sa qëndroi Mus'ab ibn Umejri në Medinë nuk mbeti asnjë shtëpi pa e pranuar Islamin. Prej këtu numri i muslimanëve filloi të rritet dhe keqtrajtimet dhe fyerjet ndaj Pejgamberit a.s filluan të marin fund.

A thua pse Pejgamberi a.s e zgjodhi mu Musa'bin për ambasador të parë në Medinë kur kishte njerëz më të moshuar se ai, dhe me më shumë pozitë se ai. Kjo ishte nga shkak se Mus'abi kishte një moral të mrekullueshëm dhe u njihte te Pejgamberi a.s si Mus'ab es Salihin (Mus'abi i të mirës).

Ishte morali i mirë dhe devotshmëria e madhe e Mus'abit që Pejgamberi a.s ia la në dorë ardhmërinë e qytetit më me rëndësi ku njëherit mendonte të ngrit edhe shtetin e parë islam. Ndikoi morali i tij i mirë që të rrit numrin e myslimanëve nga dymbëdhjetë sa ishin mysliman në Medinë në shtatëdhjetë e pesë. Nga Mus'abi mund të mësojmë se sa mund të ndikojë morali i mirë të njerëzimit dhe ta marrim si shembull që edhe ne të ndikojmë te shokët e tanë me moralin tonë. Ç'do herë duhet të mundohemi që dikush të na merr lakmi për moralin që kemi dhe me plot krenari të themi se kjo është morali që na mëson Islami ngase Islami thotë morali është mbi të gjitha.

Vdekja e Mus'abit

Në luftëra myslimanët e kishin traditë që një person ta zgjedhin që ta mbaj flamurin me qëllim që me valimin e flamurit të dihet gjendja e myslimanëve në luftë dhe ajo të jetë një kurajo për luftë. Mbajtja e flamurit ishte një punë e rëndë, pasi që armiqet të parin që e sulmonin ishte personi që e mban flamurin me qëllim që të hap panikë në mesin e myslimanëve. Për këtë qëllim Pejgamberi a.s personat që do ta mbanin flamurin kur hynin në luftëra i zgjidhte persona të zgjuar dhe trima. Në luftën e Uhudit personi i cili do ta mbante flamurin Pejgamberi a.s

e zgjodhi Mus'ab in Umejrin.

E dimë se luftën e Uhudit myslimanët e humbën nga pakujdesia e disa luftëtarëve.

Kur lufta mori përmasa të mëdha një nga mushrikët Ibn Kame iu vërsul Mus'abit i cili e mbante flamurin në dorë. Ibn Kame iu afrua Mus'abit dhe ia këputi njërin dorë me të cilin e mbante flamurin.

Pas kësaj Mus'abit i ra flamuri në tokë por ai me trimërinë e madhe që kishte përsëri nuk u dorëzua por vetëm thoshte: **"Muhammedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm All-llahut aspak, kurse All-llahu do t'i shpërblejë mirënjohësit"**. (Ali Imran 144)


Ky ajet ijepte vullnet Mus'abit dhe e mori flamurin me dorën tjetër mirëpo mushriku u kthye dhe ia këputi edhe dorën tjetër. Atëherë Mus'abi u përul dhe e mori flamurin në pjesën e gjoksit duke thënë ajetin e lartëpërmendur. Atëherë mushriku u vërsul dhe e mbyti Mus'abin me shtizën e vet.

Pas përfundimit të luftës Pejgamberi a.s u kthye me shokët e vet që të gjejnë të vrarit që kishin rënë shehid në këtë luftë. Gjatë kërkimit e gjetën edhe Mus'ab ibn Umejrin i cili kishte mbetur me fytyrë në zallë. Kur e pa Pejgamberi a.s Mus'abin në atë gjendje i masakruar i rodhën sytë lotë. Pastaj i urdhëroi shokët e tij që ta pregaditin për ta varrosur. Hababi tregon: Nuk kishim asgjë për ta mbuluar përveç një rrobe të tij, e cila nëse ia mbulonim koken iu zbulonin këmbët e nëse ia mbyulonim këmbët iu zbulonte koka. Atëherë Pejgamberi a.s tha: **"Vendoseni atë robë kah koka ndërsa në këmbë vendosini gjethje"**

Ky ishte Mus'ab ibn Umejri i cili prej personit më të pasur në shoqërinë të cilën jetonte u shëndrua në një person më të varfër person cili nuk kishte edhe me çka të varroset. Pa dyshim se këtë e bëri nga dashuria e madhe që kishte ndaj All-llahut xh.sh dhe të dërguarit të Tij.

Ky pra ishte Mus'ab ibn Umejri njeriu i cili u shpërngul dy herë për në Abisini për hirë të

All-llahut, si më i zgjuari u dërgua në Medinë si ambasadorë i parë ku u bë shkak të pranohet Islamin i gjith fisi dhe vdiq shehid. All-llahu qoftë i kënaqur me të.



AMNESTIA

Shaban TAIRI viti i III-të

Kriminaliteti është një dukuri e cila ka qenë dhe është prezent nëpër të gjitha shoqëritë dhe vendet ku jetojnë njerëzit. Nuk mund të gjejmë asnjëherë, as individ e as shoqëri ku nuk është paraqitur ndonjë epidemi e kriminalitetit. Këtë dukuri vazhdimisht e ka luftuar feja, çdo fe qiellore, apo religjionet e përhapura nëpër botë; nuk e pranon as logjika e as ndërgjegjja e njeriut me mendime të drejta, por edhe pse njerëzit kanë pasur udhëheqës të cilët u janë kërcënuar popullit me dënime, përsëri askush deri sot nuk ka mundur ta zhduk kriminalitetin, edhe pse çdo kush e lufton. Lufta dhe vrasja në mes njerëzve është krimi i parë i cili është kryer nga lloji njerëzor, edhe pse kanë qenë ndër njerëzit e parë, ata nuk kanë qenë imun ndaj xhelozisë dhe mërisë në mes vet gjinisë njerëzore. Por si në çdo shoqëri, kur janë paraqitur devijimet,

është hulumtuar nga njerëzit që të gjendet edhe ndëshkimi për ato vepra, ato fe të cilat kanë pasur shpallje, e kanë rregulluar këtë çështje nëpërmes urdhrave të Zotit, ndërsa ato të cilët nuk kanë pasur shpallje, i kanë rregulluar këto ligje në bazë të ideve të themeluesve apo udhëheqësve të tyre. Të gjithë popujt e kanë ditur se në zbatimin e ndëshkimeve ka dobi për shoqërinë dhe është masë preventive që mos të vjen aq lehtë dhe të përfitohet bindje në popullatë se mund të kryejnë krim kur të duan. Por edhe siç e cekëm më parë, zbatimi i ndëshkimeve është i dobishëm për shoqërinë njerëzore. Ai shërben për të parandaluar njerëzit nga kryerja e mëkateve. Në këtë mënyrë, çdo individ i shoqërisë do të jetë më i sigurt për jetën, nderin, pasurinë, reputacionin, lirinë dhe dinjitetin e tij. Zbatimi i ndëshkimit është e kërkuar nga ana e fesë, ku në një hadith i

Dërguari i Allahut thotë: "Zbatimi i një ndëshkimi në tokë është më i dobishëm për banorët e saj, se sa shiu që bie 40 mëngjese". Çdo veprim që çon në mos aplikimin e ndëshkimeve konsiderohet ndalim i zbatimit të dispozitave të përcaktuara nga ana e Zotit, kjo gjë është e ndaluar, sepse ndihmon në përhapjen e veprave negative në shoqëri. Gjithashtu, nuk lejohet sipas porosive të shariatit që dikush të ndërmjetësoj për kriminelin, kur ne e dimë se ai është kryerësi direkt i aktit, dhe dikush të ndërmjetësoj për faljen e tij, pa marrë parasysh se personi a është i rangut të lartë në shoqëri, i pasur, apo nga loza mbretërore. Për këtë drejtohet i Dërguari i Zotit në një hadith: "Ai që ndërmjetëson për të penguar zbatimin e një ndëshkimi të detyruar nga Allahu, konsiderohet kundërshtar i urdhrin të Tij", po ashtu në një rast nga koha e të Dërguarit a.s. kur një grua nga një fis me autoritet kishte vjedhur, që mos të zbatohet mbi të sanksioni për vjedhje, i cili është amputimi i dorës, ato deshën të ndërmjetësojnë te i Dërguari i Allahut duke e dërguar si ndërmjetës Usame b. Zejdin, të cilët e dinin se ai është i dashur te i Dërguari i Allahut, por kur dëgjoj për këtë Pejgamberi a.s. u revoltua aq shumë sa që u drejtua shokëve të tij duke u thënë se popujt e mëparshëm janë shkatërruar kur nuk i kanë zbatuar dënimet mbi ata persona me autoritet, ndërsa kur i varfri kryente ndonjë krim, ata e ndëshkonin, pastaj iu drejtua Usames duke i thënë se a do të ndërmjetësosh që mos kryhet e drejta e Allahut xh.sh.? Po sikur edhe bija ime Fatimja të kryente vjedhje, unë do t'ia preja dorën". Mund të ndodh që njeriu nuk e vlerëson siç duhet rrezikun e kriminit që ka kryer një person dhe ndjen dhembshuri për ta ndëshkuar, por mëshira ndaj shoqërisë ka më shumë prioritet se mëshira ndaj individit. Ibn Abdul Berri ka thënë se të gjithë juristët mysliman janë dakord se gjykatësi është i detyruar të zbatojë ndëshkimin e përcaktuar kur ai informohet për kryerjen e kriminit në vendin ku jeton ai. Zbatimi praktik i këtij legjislacioni në disa vende islame ka rezultuar në rritjen e qetësisë dhe sigurisë publike, si edhe në mbrojtjen e pronës së individëve dhe jetën e tyre. Bashkimi Sovjetik është detyruar kohët e fundit që ta ashpërsoj ndëshkimin e kriminelëve, pasi ka rezultuar se dënimi me burg nuk ka ndikuar pozitivisht në

uljen e rasteve të vjedhjes, vrasjes, dhunimit, etj. Kështu, p.sh. në disa raste është dhënë ndëshkimi kapital duke e dënuar vjedhësin me pushkatim.

PENDIMI I KRIMINELIT

Por, edhe për skaj kërkesës së ndëshkimit, nuk është lënë anash falja aty ku tolerohet të falet, sepse edhe Allahu xh.sh. në kuran thotë: "Ata të dy prej jush që bëjnë atë (i m o r a l i t e t - z i n a) , ndëshkoni; e në qoftë se ata pendohen dhe përmirësohen, atëherë hiqni dorë prej tyre, pse All-llahu pranon fort pendimin dhe mëshiron shumë. (Nisa, 16). Po ashtu thotë: "Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t'i rrihni ata me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u pranoni dëshminë më kurrë. të tillët janë të pabesueshëm. Me përjashtim të atyre që më vonë pendohen dhe përmirësohen, vërtet All-llahu është që shumë falë e mëshiron" (Nur, 4-5). Sikur dhe: "Përveç atyre, të cilët pendohen përpara se t'i kapni (të hyjnë nën pushtetin tuaj), atëherë dijeni se Allahu është Mëkatfalës, Mëshirbërës." (Maide, 34);

Pra, Zoti në këto ajete, pranon pendimin e tyre, nuk i len jashtë mëshirës së Tij, por nëse ata kapen dhe fillon procedura e gjyqimit ndaj tyre, atëherë nuk ka kush që mund tua fal atyre. Prandaj, dijetarët islam kanë thënë: "Nëse kaçakët (banditët), që dalin në rrugë për të frikësuar njerëzit, për t'i grabitur, apo për t'i vrarë, pendohen para se t'i kapin organet kompetente, masa penale që e ka obliguar shariat për raste të tilla në të drejtën e tyre nuk zbatohet, por ata falen.

Institucionin e faljes ne e hasim edhe nëpër popujt e mëparshëm, të cilët kryerësit të ndonjë veprë penale, ia fal gjykatësi, ku si shembull konkret mund të marrim të Dërguarin e Allahut, Jusufin a.s. i cili ishte kryeministër i Egjiptit, i cili ua fali vëllezërve të tij krimin e më parë që kishin kryer ndaj tij. Gjithashtu është e njohur edhe ngjarja me të Dërguarin e fundit të Zotit, Muhamedin a.s. i cili ishte një ndër personat më të torturuar në Mekke, i pësoj të gjitha mynxyrat që ia kujtonin banorët e Mekkes për gjatë 13 viteve derisa zgjati thirrja e tij në këtë qytet, ai nuk gjeti prehje shpirtërore, derisa bëri migrimin

me besimtarët, e kur arritën fuqi ushtarake, dhe morën iniciativën që të mos e lënë qytetin e shenjtë nën duart e idhujtarëve, në vitin e 9 sipas hixhretit ata u nisën për ta çliruar Mekken, e me të arritur atje, me çlirimin dhe depërtimin aty, kur të gjithë armiqtë e tij pritnin kur do ta jep urdhrin e tij për ti ekzekutuar dhe për tu hakmarrë, ai u drejtua nga masa e njerëzve duke u thënë: çka mendoni se do të veprojmë me ju? Ata thanë: Ti je fisniku, biri i fisnikut, shpresojmë se do të na falësh! Atëherë Pejgamberi a.s. u tha: "Ai tha: "Sot nuk ka qortim kundër jush, All-llahu ju faltë juve; Ai është më mëshirues i mëshiruesve!" (Jusuf, 92). Dhe ata shkuan të lirë dhe të falur për krimet e tyre që kishin kryer ndaj të Dërguarit a.s. edhe pse e kishte mundësinë e dënimit. Ku ne e dimë se edhe vet Pejgamberi a.s. çdo herë kur i paraqitej dikush për të kërkuar hakmarrje, ai u propozonte faljen para ndëshkimit.

Përmendëm se për dënimin e kryerësit të ndonjë veprë penale ka dënim por edhe nëse nuk dënohet me vdekje, ka masë për shpërgimin e kundërvlerës së kriminit. Një fenomen të tillë e kemi të njohur edhe te populli shqiptarë, të cilët në bazë të kanunit të Lekë Dukagjinit e kanë pasur të rregulluar çështjen e hakmarrjes. Ku sipas këtij kanuni, nëse i thua dikujt se do t'a falësh, nuk të lejohet të kthesh më prapë fjalën. Sipas këtij kanuni, nëse dikush kryen vjedhje nga një fshat i huaj, dhe gjenden se i cilit fshat është, dënimin e paguan i tërë fshati, nëse gjenden gjurmët e sendit të vjedhur në oborrin e shtëpisë së tij, atëherë ai e paguan dënimin, edhe për vrasje, nëse dikush vret, ai vritet dhe gjaku është një për një, gjithashtu dënimi nëse i falet, atëherë është i obliguar të paguaj 6 qese, 100 desh dhe gjysmë kau gjobë. Pajtimi i gjakut apo i varrës shpaguehet me 6 qese për gjak, dhe 3 qese për varrë.

PEZULLIMI I DËNIMIT NË RASTE SPECIFIKE

Nëse të aplikuarit e sanksioneve përkatëse është pjesë e politikës legjislative, atëherë në kuadër të saj bën pjesë, gjithashtu edhe pezullimi i aplikimit të ca dënimeve në raste specifike, e kjo ndodh në manifestimin e jashtëm të delikuençës kur në fakt ekziston pengesë objektive për mos aplikimin e tyre. Muhamedi a.s. p.sh. nuk i ka mbytur hipokritët, të cilët haptazi e kanë

manifestuar hipokrizinë e tyre. Për këtë Muhamedi a.s. i ka thënë Umerit r.a. i cili kishte kërkuar të dënohen hipokritët, ku i thotë: "Urrej nëse fillojnë arabët të përfojnë se si Muhamedi i vret shokët e tij". Pra, qëllimi i tij me mos dënim ishte që mos i largoj ata nga feja. Na është i njohur rasti ku i Dërguari a.s. amnistoi nga dënimi më rigoroz njeriun që është penduar, këtë e bënte për të arritur efekte të caktuara. Gjithashtu në sunenin e Ebu Davudit transmetohet të ketë thënë: "Ndalohet që gjatë përleshjeve me armikun të aplikohen masat ndëshkuese"; "Ndalohet aplikimi i prerjes së dorës së varfrit, në kohë kur mbretëron varfëria". Imam in Kajjimi në lidhje me këto thotë: Ky është sanksion i vërtetuar i Allahut, kurse i Dërguari i Allahut e ka ndaluar që përgjatë luftës nga frika që kjo të mos shkaktoj atë që Allahu e urren më shumë se mos aplikimin apo pezullimin e aplikimit të dënimit, siç është shembulli dezertimi i fajtorit në radhët e armikut nën ndikimin e moskujdesit ose hidhërimit. Ky është mendim edhe i Umerit, Ebu Derda, Hudhejjes, etj. Gjithashtu edhe Ahmedit, Is`hak b. Rahavejhi, Euzai e të tjerë, pohojnë se masat ndëshkimore nuk aplikohen në vendin e armikut. Po kështu thotë edhe Ebu Kasim el Hirki në Mustesarin e tij: Dënimet nuk do të ekzekutohen mbi myslimanin në vendin e armikut për shkak se Bushër b. Ertadin e kanë nxënë luftëtarin që ia kishte vjedhur mburojën dhe i tha: sikur të mos e kisha dëgjuar Pejgamberin a.s. të thotë: "Nuk bën të pritët dora në luftë", tani do ta kisha prerë dorën. (Ebu Davudi). Umeri r.a. gjithashtu ka dhënë urdhrë që mos të ndëshkohet komandanti i luftës, komandantin e çetës apo luftëtarin e thjeshtë gjatë luftës dhe gjendjes në betejë. Gjithashtu edhe Hudhejfe b. Jeman nuk e kishte dënuar Velid b. Ukbeh, i cili ishte epror ushtarak, por kishte konsumuar alkool, e Hudhejfe nuk e dënoi pasi tha se me këtë vepër do ta trimërojmë armikun kundër nesh.

Megjithatë, pezullimi i aplikimit të dënimit me shkas, është çështje të cilën e parasheh edhe vet shariat, siç është pezullimi i dënimit të gruas shtatzënë ose gjdhënëse, pastaj dënimin në kohën e nxehtë dhe të ftohtë ose gjatë sëmundjes. Por kur interesi i shoqërisë dhe dobia është më e madhe se sa të falet, atëherë kuptohet se ka përparësi aplikimi i dënimit mbi te.

Fati i dialogut ndërftetar

Artan Fuga

Në filozofinë bashkëkohore perëndimore ka një preokupim të madh lidhur me kushtet dhe rrethanat e dialogut midis individëve dhe grupeve shoqërore që iu përkasin feve, kulturave, gjuhëve, traditave morale, racave, kombësive të ndryshme. Sidomos në botën e sotme të globalizuar ky aspekt merr një rëndësi të veçantë për shkak të faktit se si rezultat i përzierjes së popullsisë që më parë jetonin disi të veçuara, për shkak të emigracionit të brendshëm që vjen si pasojë e eksodeve të forta rurale, por edhe si rezultat i flukseve migratore të jashtme, brenda të njejtimit qytet, zonë urbane, apo krahinë, tanimë ndodh që jetojnë individë dhe raca të perzjera, individë me besime, përkatesi etnike, gjuhe krejt të ndryshme prej njeri tjetrit.

Në kushtet e shoqërive demokratike, sikurse aspiron të behet edhe shoqëria shqiptare, nuk duhet harruar se lidhur me dialogun ndërftetar ka lindur një avantazh i madh, por edhe një vështirësi e madhe. Avantazhi i madh ka të bëjë pikërisht me faktin se të gjitha komunitetet dhe individët kanë tanimë mundësinë e madhe dhe të lumtur per të shprehur lirisht dhe pa asnjë kufizim idetë e tyre, bindjet e tyre fetare, kulturat e tyre specifike. Por, nga ana tjetër, lind rreziku i krijimit të ndarjeve të mëdha socio-kulturore dhe komunitariste brenda të njejtës shoqëri, lind rreziku i krijimit të moskuptimeve, keqkuptimeve, i tëhuazimeve të ndryshme të banorëve të të njejtimit qytet, midis shtetasve të të njejtimit komb, midis fqinjëve, dhe përse jo, edhe brenda familjeve kulturalisht mikste.

Shoqëritë multifetare sikurse është edhe jona, kanë brenda edhe bukurinë mahnitëse të një larushie kulturash, besimesh, ritesh, që vijnë nga thellësitë e historisë, por përmbajnë edhe rrezikun e përçarjeve apo ndarjeve komunitariste që mund të marrin forma dhe shkallë të ndryshme mprehtësie.

Autorë të njohur në shkencat humane dhe në filozofi janë marrë prej kohësh me këtë problem, mendim të cilin ne na duhet t'a lexojmë pa rreshtur nëse duam që të njohim sfidat që qendrojnë përpara dialogut tonë ndërftetar dhe nëse kemi synimin që të evitojmë që ky dialog apo specifikat e besimeve të ndryshme të kthehen në vija ndarëse konfliktuale midis

grupeve të besimit që ekzistojnë në Shqipëri.

Qysh prej disa dekadash, Pol Lazarsfeld, një nga përfaqësuesit më të njohur të « Shkollës së Kolumbias », arrinte të bënte zbulimin e madh se individë në shoqëritë e sotme moderne nuk reagon ndaj fakteve të ditës, ndaj ngjarjeve politike, ndaj mediave, thjesht dhe vetëm në rrugë individuale. Qendrimi individual është një e dhënë që vjen prej statusit demokratik të gjithësecilit që gëzon të drejta dhe liri individuale, por kjo nuk do të thotë se edhe realisht, nga pikëpamja e rrafshit sociologjik, individët kanë qendrimë, besime, reagime, që janë thjesht individuale dhe mund të injorojnë krejtësisht vlerat e bashkësive profesionale, familjare, krahinore, apo edhe fetare të grupit të cilit ata i përkasin.

Lazarsfeld duke studjuar sjelljen e këtyre grupeve primare, ku bëjnë pjesë edhe komunitetet fetare, shprehet se individë ka prirjen psikologjike të njehsohet me bashkësinë e vlerave të komunitetit ku ai jeton për shkak se ka nevojë t'i largohet ankthit individualist, pra shpesh ka prirjen t'i largohet një gjykimi të pavarur, duke fituar siguri kolektive brenda grupit të vet të përkatesisë qoftë, sikurse shprehej ai, edhe duke paguar faturën e konformizmit. Lazarsfeld nuk mungonte pra të fliste për « beneficin e konformizmit ».

LIDHJET E REJA SHOQËRORE

Nga kjo pikëpamje, gjykoj se duhet mbajtur parasysh se pas rënies së komunizmit në Shqipëri, me ndërtimin e lidhjeve të reja shoqërore dhe me praninë e prirjeve të reja politike, ekonomike dhe demografike, u shpërbënë shumë grupe të mëparshme socio-profesionale dhe krahinore, ndërkohë që individë nisi të njohë një shpërndarje nga grupi i vet primar sikurse është familja dhe kolektivi i punës apo edhe vetë opinionin publik i zonës së ngushtë ku ai jetonte më parë. Ndërkohë lindën ose më mirë të themi rilindën komunitetet fetare dhe nisën të marrin të drejtën qytetarisë shprehjet e lira të lidhjeve të besimit.

Në këtë plan, sikurse thekson Lazarsfeld, individë në shoqërinë demokratike ndodhet brenda një situatë disi të dyzuar, apo edhe kontradiktore. Nga njera anë ai është që qenie qytetare me të drejt-



Shqipëria, sikurse dihet, është vend multifetar për shkak të ekzistencës së katër komuniteteve kryesore, që përmbledhin besimtarë të moshave dhe krahinave të ndryshme, por edhe për faktin se ekzistojnë variante besimi që kanë hyrë rishtazi te ne dhe kanë, edhe ato, disa komunitete numerikisht të vogla besimtarësh, por gjithësesi të pranishme.



ta individuale, dhe një shtet demokratik e kërkon diçka të tillë, por nga ana tjetër, pikërisht për shkak të një mjedisi shoqëror demokratik, individë njehsohet dhe reagon gjithnjë e më fort në bazë të vlerave të tij grupale, duke përfshirë, në rastin e besimtarëve, edhe përkatesitë apo traditat e tij fetare.

Kështu ka vend të mbahet parasysh një farë tensioni që krijohet midis statusit juridik dhe politik individual të qytetarit dhe statusit të tij kolektiv, pra si qenie brenda komuniteteve të ndryshme. Ekzagjerimi i përmasës individuale çon drejt një individualizmi që bjerr vlerat morale të gjithkujt dhe e atomizon shoqërinë, ndërsa ekzagjerimi i përmasës komunitariste, ciladoqoftë ajo, përmban rrezikun e komunitarizmit, pra të përmbylljes së individit brenda rrethit të ngushtë të grupit në të cilin ai bën pjesë.

Nga të dhënat sociologjike që janë mbledhur, gjykoj se ndër ne përkatesitë fetare të besimtarëve të ndryshëm nuk i kanë mbyllur ata brenda një ndërgjegjeje dhe lidhjeje të ngushtë ekskluzive të përcaktuar nga feja e tyre.

Për arsënye nga më të ndryshmet, të cilat mund të debatohen, fatmirësisht konstatohet se lidhja shoqërore e përgjithshme ndërindividuale sot te ne nuk mbetet e fragmentuar brenda afiniteteve të caktuara shpirtërore dhe fetare që individë të ndryshëm kanë me njeri tjetrin. Nga përsonat e anketuar, rezulton se vetëm 13,76 % e tyre me banim në periferitë urbane dhe 08,72 % e atyre me banim në qendrat qytetare të marra në konsideratë, pohojnë se kanë marrëdhënie të dobëta ose të rralla me individë që iu takojnë besimeve të tjera fetare. Të tjerët gjykojnë se pavarësisht besimeve që kanë, bashkëpunimi i tyre profesional, miqësor, fqinjësor, etj, nuk mbyllet brenda një rrethi të ngushtë komunitarist.

Parë nga ky plan, mund të thuhet se megjithëse shoqëria e sotme shqiptare nuk i njeh enklavat me bazë fetare, përsëri nuk është se s'vihen re edhe qendrimet e ndryshme komunitariste që kanë të bëjnë me prirje që ten-tojnë t'a mbyllin individin ekzkluzivisht vetëm brenda rrethit të ngushtë të grupit fetar, t'a shtyjnë atë që veç reagimit të përbashkët në planin e vlerave shpirtërore fetare, të mbajë disi nën presion edhe qendrimet për çështje të botës profane sikurse është politi-

ka, lidhjet miqësore, dashurore apo martesore, mënyrat e veshjeve, si edhe të kërkojnë të mbivendosen mbi të drejta dhe liri që kushtetuta demokratike ia njeh ekskluzivisht individit dhe vetëm atij.

Sa për të marrë një shembull, dëshëroj të përmend të dhënë sociologjike sipas së cilës nga të anketuarit që shprehen se shkojnë për ditë në një institucion fetar, 40,35 % e tyre na kanë pohuar se nëse ndonjë i afërm apo mik i tyre do të kishte idenë dhe dëshirën për të ndërruar besim fetar, atëhere ata do t'a kishin quajtur këtë një turp, një mosrespektim nga ana tij të traditave të të parëve, dhe do të ushtronin të gjithë ndikimin e tyre që kjo gjë të mos ndodhte. Raporti midis besimeve fetare këtu shndërrohet në një raport midis turp dhe nderit, pra kthehet nga një dialog në një marrëdhënie morale që i vendos tjetrit etiketa morale denigruese. Etiketimi moral denigrues jo vetëm e bllokoi dialogun ndërfe-tar në rrafsh ndërindividual dhe më gjerë, por e zëvendëson debatin me argumente me një proces stigmatizimi të tjetrit në planin moral, psikologjik dhe social, duke krijuar kushtet që dialogu ndërfe-tar të kthehet në një marrëdhënie të ngrirë, të forcojë disi me anë të presionit psikologjik kufijtë e komunitetit shpirtëror, duke i hapur rrugë prirjeve komunitariste, e më së fundi, duke shënuar ato vija mbi të cilat mund të ngrihet një konflikt social i caktuar.

Të gjitha këto janë shkallë dhe nuancime graduale që nisin me diferencën kulturore dhe fetare, çka është një pasuri shoqërore e paimagjinueshme për shoqërinë, dhe nëse nuk kuptohen si duhet, fatkeqësisht, mund të çojnë shkallë shkallë drejt një fragmentarizimi voluntarist që jo vetëm mund të përgatisë parakushte për konflikt shoqëror, por nis edhe të tregojë shenja të rënies në kundërshtim edhe me të drejtat individuale brenda një shteti ligjor.

Nga pikëpamja filozofike, sikurse na argumentojnë filozofë të ndryshëm perëndimorë, ta zemë sikurse argumenton filozofi amerikan Riçard Rorty apo filozofi italian Umberto Ecco, urat e dialogut ndërfe-tar mund të hidhen të shëndosha veçse nëse pranohet se leximi i çdo teksti, rregullit moral të shkruar, pra edhe i atyre të shenjta, sikurse edhe i librave filozofikë klasikë, i ligjeve, apo i çdo norme të kodifikuar sipas parametrave ligjërues të ndryshëm, lejon vend për interpretime të ndryshme.

Cdo tekst, nëse do të shpreheshim me gjuhën e filozofisë, lejon hapësira pak a shumë të gjera, dhe shërben si edhe

pretekst për interpretime të ndryshme. Pa rënë aspak në pozitë e një relativizmi metodologjik të sëmure që i shpërbën të gjitha referencat, filozofikisht sot nuk diskutohet se edhe vlerat morale, mësimet fetare, tekstet e ndryshëm, duke ruajtur besnikërisht origjinën dhe vlerat e tyre absolute, përmbajnë edhe një dimension të spikatur interpretativ në varësi të kohës, të gjendjeve konkrete, të rrethanave të veçanta dhe të reja që i sjell vetë koha dhe zhvillimi shoqëror.

Po të shikojmë në një rrafsh më të gjerë ndërkombëtar do të vërejmë se brenda të gjitha llojeve të besimit ka diskutime dhe debate lidhur me interpretimin jo të bazave teologjike, por të zbatimit të tyre konkret lidhur me probleme shoqërore sikurse janë marrëdhëniet politike, sistemet politike, apo të problemeve që kanë të bëjnë me situatat e sotme bashkëhore sikurse janë luftërat, paqja, planifikimi familjar, sëmundjet sikurse janë sida, apo edhe të mënyrës së realizimit të disa akteve jetësore sikurse janë përshtetja ato martesore, familjare, mënyrat e ndërtimit të simbolikave fetare në formë veshesh apo shenjash të tjera karakteristike, marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, etj.

Dialogu ndërfe-tar nuk është një dukuri vetëm brendafetare. Ai përfshin edhe një debat të kuptueshëm dhe fare të natyreshëm edhe midis besimtarve dhe jobesimtarëve, laikëve, ateistëve, për probleme që kanë të bëjnë me kuptimin e botës, së shoqërisë dhe të vetë njeriut. Lidhur me këto probleme askush, as feja, as shkenca, as filozofia, nuk mund të pretendojë më se ka ekskluzivitetin e trajtimeve të sakta, pikërisht sepse ato nuk mund të jenë veçse gjykime interpretuese. Të gjitha këto forma të mendimit dhe të ndërtimit të vlerave shpirtërore kanë si qëllim human realizimin kushteve të paqes, të mirëkuptimit dhe të konsolidimit të pozicionit të njeriut në botë dhe të përgatitjes së tij për të përballuar sfidat që kanë të bëjnë me jetën apo edhe me vdekjen e tij.

Nuk duhet të harrojmë se nga pikëpamja filozofike, qysh prej Kantit, filozofia, edhe shkenca, nuk konceptohen më si të ndara dhe armiqësore me njera tjetrën, por si dy rregjistra të ndryshëm, komplementarë, të të kuptuarit të botës, si dy mënyra plotësuese të leximit të botës dhe të njeriut, ku asnjëri prej tyre nuk mund të ketë superioritetin absolut ndaj të tjerave.

Sikurse e thonë me të drejtë në shkrimet, pohimet e tyre në intervista, apo edhe sikurse del nga vetë anketa jonë sociologjike, nga ato që lexojmë lidhur me

deklarime të drejtuesve fetarë apo teologëve të shquar të botës së sotme, fetë e ndryshme, pavarësisht dallimeve, kanë edhe tipare të përbashkëta. Besimi të mistikja, te ideja e të gjithëfuqishmit, te pavdeksia e shpirtit, aq më shumë insistimi te ruajtja dhe konsolidimi i vlerave morale sikurse janë ndershmëria, respekti ndaj tjetrit, dashuria dhe miqësia, toleranca, falja, etj., karakteristika të çdo besimi fetar, përbëjnë atë bazë ku fetë e ndryshme te ne, por edhe filozofët, gazetarët, sociologët, shkencëtarët, prindërit e çdo lloj besimi, besimtarë, laikë, skeptikë apo edhe ateistë, kanë një hapësirë të gjerë jo vetëm dialogu të shëndoshë, por edhe bashkëpunimi dhe mirëkuptimi të thellë.

Kuptohet qartë, sikurse e kanë venë mirë në dukje teologë të shquar të kohëve tona apo të së kaluarës, ky bashkëpunim dhe dialog nuk përjashton dhe nuk çënon aspak besnikërinë e çdo besimtari, kleriku, filozofi, shkencëtari, apo qytetari të thjeshtë ndaj parimeve të fesë së tij. Nuk është, pra, aspak fjala për të shuar dallimet dhe diferencat në besime, sepse kjo do të na krijonte një botë shumë të trishtët dhe uniforme, por është fjala për diçka tjetër, për atë parim të madh që personalitete të ndryshme e kanë shpjeguar aq bukur, pra të

dialogut midis të ndryshmeve, të gjetjes së pikave të përbashkëta në diferencat në perceptimin e botës dhe të mistikes, të bashkëpunimit brenda dallimeve në perspektiva, të një hapësire publike të opinionit ku secili duke ruajtur po të dojë edhe me fanatizëm parimet e botëkuptimit të tij të veçantë dijë të shohë te tjetri pika që i bashkojnë në një të tërë unike që iu shfaqet në forma të ndryshme.

Si metaforë po përdor atë që ka dhënë Jalal al-Din Rumi kohë më parë : Disa njerëz nga India sollën një elefant të madh dhe e futën brenda një dhome të errët ku mund të vinin t'a vizitonin persona të ndryshëm. Secili prej tyre e dinte se kishte të bënte me një qenie të madhe, por nuk e shihte atë, vetëm mund t'a prekte me dorë në vende të ndryshme. Ata që e prekën te trompa e hundës thanë se kjo qenie ishte si një llullë. Ata që e prekën te këmbët, u shprehën se ajo i ngjante një shtylle. Të tjerë që prekën pjesën e pasme të saj, ishin të bindur se ajo kishte formën e një froni. Ata që i prekën vetëm veshët gjykonin se ajo ishte në formën e një gjetheje stërmadhe. Elefanti – thotë Rumi – ishte e njejtja qenie, por perceptimet e njerëzve ishin të ndryshme. Koncepti i së ndryshmes nuk nënkupton medoemos kontradiktoren.

Nisur prej këtej, një nga për-



faqësuesit e sotem më të njohur të sufizmit turk, Fetullah Gulen, shprehet se : « Dialogu ndërftuar sot shtrohet si një detyrë dhe hapi i parë për t'a vendosur atë është të harrohet e kaluara, të braktisen argumentet polemike dhe t'iu jepet përparësi pikave të përbashkëta, të cilat janë disa herë më te shumta sesa pikat e dalimeve. »

SPJEGIMET

Fatmirësisht, feja, filozofia, shkenca i kanë të gjitha këto potencialitete. Mjafton të kthejmë sytë nga trashëgimia e shkencëtarve të tillë si Anjashtajni, Haizenbergu, Nils Bori, etj. për të kuptuar se në letrat, ditaret, librat apo tekstet filozofike që ata na kanë lënë insistojnë fort te ideja se shpjegimi vetëshkaksor i botës nuk mund të jetë i tillë, aq i hekurt, aq i sigurt, aq i plotë, aq pretendues saqë të japë shpjegime të ngurta dhe të mjaftueshme për të mos i lënë hapësira besimit të mistikja.

Në filozofinë bashkëkohore mbizotëron ideja se shkaku dhe pasoja nuk janë veçse mënyra njerëzore, të kufizuara, të kuptimit të botës së menduar prej njeriut. Kategoritë racionale nuk janë veçse forma interpretative të botës.

Filozofi i sotëm gjerman

Habermas lidhur mesa më sipër theson : « Shumësia e perspektivave interpretative përbën arsyen që na bën të themi se përse një refleksion monologjik, cilido qoftë ai dhe që çon në formulimin e maksimave të pranueshme si ligje të përgjithëshme, nuk e shtron parimin e universalitetit. Vetëm si pjesmarrës në dialog përfshirës që synon mbërritjen e konsensusit ne mundemi të ushtrojmë virtytin e empatisë ndaj diferencave tona reciproke, të cilat dalin në pah gjatë perceptimit të një situatë të njejtë të përbashkët. »

Filozofi Habermas ka pra një kuptim krejt novator mbi konceptin e universale dhe të universalitetit. Ky koncept nuk qendron te një ide apo maksimë e vetme që përjashton të tjerat. Përkundrazi, ai formohet nga shumësia e tezave interpretative të ndryshme.

Përtej idealiteteve që krijojnë kategoritë logjike ndodhet qenia, e cila nuk mund të jetë veçse e interpretuar nga simbolikat logjike të shkencës dhe të filozofisë, fatmirësisht në të mirë të njeriut, të teknikës dhe të përparimit, por që, në çdo rast, nuk mund të barazohen kurrësesi me vetë qenien si të tillë.

Shoqëria shqiptare, sidomos sistemi i saj masiv i të nxënimit shkollor, ka shumë për të bërë në mënyrë që të shkëputet nga materializmi i keqkuptuar dhe i vulgar-

izuar tej mase në vitet e shkuara.

Ka një fushë të gjerë bashkëpunimi edhe midis feve të ndryshme për hir të shëndoshjes morale të shoqërisë sonë. Debatet nga një herë edhe të eksituara për numurin e besimtarëve të çdo feje, për hamendjet subjektive lidhur me pyetje disi « luksoze » se të cilës fe kanë qenë patriotët tanë të mëdhenj, qoftë edhe për çështje principiale sikurse janë ato lidhur me unicitetin apo trinitetin e qenies hyjnore fuqiplotë etj. nuk duhet të mbulojnë kurrësesi mundësinë e dialogut konstruktiv, pra në shërbim të një kauze të përbashkët.

Le të mbajmë në konsideratë këtu se të anketuarit tanë, ndonëse pohojnë me gojë plotë faktin se marrëdhëniet ndërftare në vend janë përgjithësisht tolerante dhe në respekt të bashkëjetesës së plotë, ata shprehin edhe një farë qendrimi kritik mbi shkallën e bashkëpunimit të komuniteteve të ndryshme fetare që funksionojnë në shoqërinë e sotme shqiptare. Vetëm 23,41 % e të anketuarve, pra afërsisht një ndër katër të anketuar, shprehin se ka një farë bashkëpunimi ndërftar në Shqipëri. Pjesa tjetër e tyre është shumë skeptike përse më sipër.

Dialogu ndërftuar sikurse cilado formë tjetër dialogu shoqëror dëmtohet nëse dialoguesit janë të mbyllur krejtësisht brenda sistemit të vlerave dhe të botëkuptimit të tyre. Mendimtarë të shquar në fushën e filozofisë, antropologjisë dhe të komunikimit, sikurse është edhe Gregory Bateson, i shkollës së Paolo Altos në Kaliforni, shpjegojnë sot se çdo individ apo komunitet i mbyllur vetëm brenda sferës së vlerave të veta bëhet i paafte që të kuptojë tjetrin, biles, më shumë se kaq, humbet pra edhe aftësinë për të kuptuar veten sepse e « gjykon veten sipas vetes ».

Në këtë mënyrë, sikurse e ka shprehur edhe filozofi francez Zhak Derrida, tjetri, hapja ndaj tjetrit, përpjekja për t'a pranuar tjetrin, për t'a kuptuar tjetrin, është një kusht i mundësisë për të kuptuar veten. Vetja kuptohet nëpërmjet tjetrit. Respektimi dhe mbajtja e një dialogu me tjetrin, në kuptimin e një individi apo grupi që iu përmbahet besimeve dhe vlerave të tjera fetare dhe kulturore është mjeti kryesor për të mos u mbyllur brenda obsesioneve kulturore brendapërfshirëse, e cila do të shkaktonte pastaj edhe një çrregullim tërësor të kujtdo në marrëdhëniet e tij me botën dhe me veten.

Fatmirësisht te ne nuk konstatohet në përgjithësi një mbyllje e besimtarëve të feve të ndryshme brenda universit të vlerave dhe besimeve që ata ushqejnë.

Shkaqet lidhur me këtë gjendje janë të shumta lidhur me këtë gjendje hapjeje ndaj tjetrit. Ato vijnë për rrethana edhe nga më paradoksalet. Nganjëherë këtu ndikon EDHE cektësia e besimeve fetare ndër shqiptarët, që jo rrallë paraqiten skeptikë ndaj çdo forme argumentimi shkencor, filozofik, ideologjik apo fetar. Nga të anketuarit tanë, përshebull, na rezultoi se shumë prej tyre që shprehen si besimtarë jo gjithëmonë besojnë në pavdekësinë e shpirtit. Pyetjes « A besoni te pavdekësia e shpirtit ? » i janë përgjigjur pozitivisht 52,62 % e të anketuarve. Po kështu përmend faktin se diskutimet me temë fetare zënë një vend boll të ekuilibruar mes debateve të tjera midis shqiptarëve të sotëm, të cilët me thënë të drejtën kanë shumë halle dhe shqetësime për t'iu bërë ballë. 16,43 % e të anketuarve tanë përgjigjen se tema e dialogut të përditshëm kur hasin besimtarë të tjerë të së njetës fe është ajo me natyrë kyesisht fetare. Të tjerët pohojnë se rrahin një tematike larushe çështjesh.

Parë në këtë prizëm gjykoj se është me rëndësi fakti që individë të besimeve të ndryshme jetojnë përgjithësisht në hapësira sociale, profesionale, fqinjësore të përzjera, çka është edhe produkt i të gjithë historisë sonë kombëtare. Pra, fakti që Shqipëria nuk përbën një model enklavim territorial të komuniteteve të ndryshme fetare ka një domethënie të rëndësishme në nxitjen e marrëdhënieve kryesisht të hapura midis njerëzve me besime fetare të ndryshme. Por, nga ana tjetër, në disa zona periferike me qendrat e mëdha urbane, për shkak të eksodeve masive dhe disi të përshpejtuara konstatohen grumbullime njerëzish, familjesh, individësh me përkatësi rajonale, fisnore të përbashkët, e për, rrjedhojë, si një fakt kolateral, edhe me identitet të përbashkët besimesh fetare. Nga anketa del se përgjigjedhënës të ndryshëm pohojnë se tani, si rezultat i ndryshimeve të fundit demografike, jetojnë më afër se më parë me besimtarë të së njetës fe. Nga të anketuarit në periferitë urbane të tillë janë 23,85 % e tyre, kurse nga të anketuarit në brendësi të qendrave qytetare, këtë përgjigje e japin 19,05 % e tyre.

Është e udhës që për të mos i mbyllur qytetarët brenda hapësirave simbolike disi homegjene dhe për t'a lehtësuar dialogun horizontal midis tyre, qoftë edhe me natyrë dhe tematikë fetare, koha ka ardhur që edhe organet e specializuara t'a mbajnë parasysh këtë të dhënë shumë parësore në kuadrin e politikave të tyre për administrimin dhe rregullimin e territorit.



ECEJAKE FETARE

Në rrugën e progresit

Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: " (Përkujto o Muhamed) **Kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!** Ata thanë: "a do të veshë në te ata që bënë çrregullime dhe që derdh gjacket, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!" Ai tha: " Unë e di atë që ju nuk e dini!"

Ky realitet njeriun udhëheq tërë jetën e tij sepse njeriu jeton me rregulla të natyres të krijuara nga Allahu xh.sh.. Ky fakt duhet të mirret parasysh si kriter, parim sipas të cilit bëhet cilësimi apo vlerësimi për një ngjarje apo vepër, apo rregull sipas të cilit duhet të kryhet një punë.

Ismet BYTYQI

Qëllimi Islam është ecje përpara, zhvillim i përgjithshëm, përparim komplet i njeriut në tri drejtime: shpirtëror, moral dhe material.

Shpallja e Islamit ndriçon anët pozitive të jetës së njeriut, andaj Islami me gjithë fuqinë që ka, duke u kushtëzuar me kritere dhe qëllime, ndërthen në vete ligje dhe rregulla hyjnore të shpallura nga Allahu xh.sh., që të jenë si parime të qarta për të kryer apo për mos të kryer një punë.

Islami me gjitha kriteret, parime e rregulla është komatibile me zhvillimin natyror të kësaj bote, andaj Islami gjenë veten dhe është zgjedhje me garanca të shëndosha për suksese në këtë proces.

Qëllimi parësor i Islamit është që njeriun ta pajis me veti dhe cilësi të mira, ta bëjë njeriun, njeri. Të luan njeriu rolin e mëkëmbësit në tokë, halife- pasiqë si i tillë është dedikuar krijimi i tij. Andaj fushëveprimi në këtë botë, në të cilën mbisundojnë ligjet e natyres, duhen të jenë të kanalizuar në drejtim të plotësisht të urdhërave të Allahut xh.sh. me garanca të plotë për një rrugë drejt progresit.

Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: " (Përkujto o Muhamed) **Kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!** Ata thanë: "a do të veshë në te ata që bënë çrregullime dhe që derdh gjacket, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!" Ai tha: " Unë e di atë që ju nuk e dini!"

Ky realitet njeriun udhëheq tërë jetën e tij sepse njeriu jeton me rregulla të natyres të krijuara nga Allahu xh.sh.. Ky fakt duhet të mirret parasysh si kriter, parim sipas të cilit bëhet cilësimi apo vlerësimi për një ngjarje apo vepër, apo rregull sipas të cilit duhet të kryhet një punë.

Nga kjo kuptojmë se logjika Islame është logjike e shëndoshe në baza të natyres që ka krijuar Allahu xh.sh., që nuk mundet të bije ndesh në asnjë kohë pa marr parasysh se në cilën etap të zhvillimit është natyra. E gjithë kjo vetëm për një arsye: sepse normat e shariatit duhet të përputhen kushteve natyrore të kohës së vet dhe nënqellit ku banojnë besimtarët, kushte të cilat bijen në kategorin e të ndryshuarit

në kohra të ndryshme dhe vende të ndryshme.

Për tu arritur ajo që u cekë në fillim, se qëllimi i Islamit është ecje përpara, zhvillim i përgjithshëm, përparim komplet i njeriut në tri drejtime : Shpirtëror, moral dhe material. Doemos, faktorët që shtyn njeriun në këto drejtime janë: Ibadeti (përkujtimi i madhërimit të Allahut xh.sh.- lutjet), puna dhe arsimit.

MADHËRIMI I ALLAHUT XH.SH.

Lutjet dhe kërkesat drejtuar Allahut xh.sh. nga njeriu, të shoqëruara me përkujtimin e madhërisë të Allahut xh.sh. duhet të jenë të mishëruara me motive të pastërta. Motiv fisnik që vë në lëvizje moralin, që të shtyn për një veprim progresiv. Ide bërthamore organizuese si individuale ashtu dhe shoqërore për të nxitur drejt progresit shpirtëror dhe moral.

Arsyeja, argumenti që sillet nga Kur'ani, me fjalët e të Madhëruarit, Allahut xh.sh. janë në përëuthshmëri me ate që tham deri më tani: " **Ti lezo atë që po të shpallet nga libri (Kur'ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarit dhe të irituarit, e përmendja e Allahut është ma e madhja (e adhurimeve); Allahu e di ç'punoni ju.** " (El- Ankebut: 45)

Arsyeja, e dalur nga ky ajet Kur'anor, është tërësi e motiveve për të përligjur vendimin e Allahut xh.sh. se vetëm nëpërmjet lutjeve, namazit, njeriu mund të shmanget nga të shëmtuarit dhe të irituarit, kuptohet nëse kryhet me të gjitha rregullat e parapara në shqyrtimin domethënës të ajetit. Në gjdo pjesë të namazit përkujtohet madhëria e Allahut xh.sh., kursesi nuk duhet te lejohet lutjet të kenë motive vetiake, egoiste se ashtu bije ndesh me parimet Islame. Duke u nisur nga interesi apo të mira materiale të fituara nga forca apo të të menduarit nga potenciali i njeriut, vetëm për përfitime personale të kësaj bote duke harruar parimet themelore Islame. Andaj Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: " **E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkon begatitë e Allahut, por edhe përmendnie shpeshherë Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim.** " (E- Xhumua: 10)

Gjallërimi i jetës (punës) bëhet pasi të kryhet namazi. Koncepti Islam për lutje dhe punë është aq i artë saqë nuk le vend për hamendje, ashtu është ndërtuarë saqë mundëson progres stabil dhe permanent si në aspektin shpirtërorë dhe atë material.

Progresi nuk ka fund, nuk mbaron deri sa nuk mbaron jeta në këtë botë. Derisa gjallëron shpirti në trupin e njeriut, përzjerje e botes së mbrendshme të njeriut, mozaiku i vetive psikike, ndërgegjja e vetëdija, ndjenjat e tjer. Dhe çenia e gjallë me pamjen e saj të jashtme e që emrohet nejrri. Andaj allahu xh.sh. në Kur'an thotë: " **Dhe kur ta kem përsosur atë dhe t'i kem dhënë nga ana ime shpirt, ju menjëherë përlunju atij (në sexhde).** " (Sad: 72)

Progresi është proces i pandërprer, varg ndryshimesh sipas ligjeve të caktuara që sjellin një prodhim si rezultat i asaj që thot Allahu xh.sh.: " **Dhe t'i kem dhënë nga ana ime shpirt** " (Sad: 72)

Me vet faktin se njeriu i'u është dhënë shpirtë nga Allahu xh.sh. pasiqë është krijuar në mënyrë ma të përsosurë, i'u është mundësuar që me vetëdije të nxen dituri dhe të ketë dëshirë që në bazë të asaj diturie të ecë përpara dhe të jetë progresiv. Allahu xh.sh. thotë: " **E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve)...** " (El- Bekare: 31)

Pa mëdyshje, progresi është proces zhvillimi pa fund, rezultat i brendësisë së njeriut e quajtur shpirt. Tërësi e vetive të tija psikike, ndjenjave, vetëdijes etj. E gjithë kjo dhunti nga Allahu xh.sh. është për njeriun, shkëlqim i së shenjtës në mbrendsin e trupit të njeriut.

PUNA

Përdorimi i forcës së mendjes dhe të krahut (vegla e mjete të punës), për të prodhuarë të mira materiale apo për të krijuar vlera shpirtërore, kjo veprimtari në Islam quhet veprimtari e ndërgegjeshme prodhuese. Veprimtari e cila në sistemin Islam është e organizuar në mënyrë të qartë në gjdo aspekt, në veprimtari apo detyra që kryhen çdo ditë nga njeriu, në industri, shkencë e bujqësi apo të një fushe tjetër. E quajtur në terminologjinë Islame: Profesion (Mjeshhtëri- Zanat).

Veprimtari e cila ka për bazë sinqiritetin dhe humanitetin, e asesi

njeriu të bëhet rob i punës dhe i veglave të punës, ashtu siq përmendet në filozofin idealistike të Hegelit me termin " ELINASION". Ma vonë dhe në filozofit tjera siq është dhe ajo marksiste etj...

Pasiqë njeriu të izolohehet vetëm në përfitime personale dhe të mira materiale duke harruarë misionin e punës sipas mësimëve Islame, humbë identitetin e tij dhe nuk mban llogari për kapacitet e tija shpirtërore e trupore, këshut ngadal dhe përfiton një identitet të ri i cili nuk të qon në rrugën e progresit, por të shkatrrimit. Andaj Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: " **E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar për tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej gjdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë.** " (El Bejine: 5)

Transemtohet nga i dërguari i Allahut xh.sh, Muhamedit a.s. se ka thënë: " **Veprat janë sipas qëllimeve dhe çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim...** " (Muttefekun alejhi)

ARSIMI

Nxënja e diturisë, e mundësuar në sistemin e një programi sipas shkolles Islame, për të edukuar besimtarët, mbështet në një parim i cili është i zbritur para 14 shekujve, ajet i parë me të cilin dhe fillon shpallja e Kur'anit. Parim i cili garanton progres të njerëzisë si në aspektin shpirtëror dhe material. Ky parim ka emër dhe mbiemër në suretu El-Alak: 1, Allahu Xh.sh. thotë: " **Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).** " (El- Alak: 1)

Arsimi, duhet të jetë bazuar në emrin e Zotit, i cili di gjithçka, çka është në dobi të njeriut e çka nuk është. Prej të cilës dituri duhet të ketë dobi feja, vetë ai, familja e tij e gjithë bota si ajo njerëzore, bimore, shtazore etj...

Andaj dituria duhet të jetë e mishëruarë me motive humane e asesi egoiste. Nxënja e diturisë në emër të Zotit të bënë që të mos frigo-hesh, i sinqertë, të bënë stabil, je në mëshirën e Zotit, Dhuruesit të Madh, i cili mësoi njeriun për të gjitha çështjet që janë në dobi të tij. Mësoi rrugën e progresit të sigurtë: " **I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.** " (El- Alak: 5)

Trajtimi Biblik dhe Kuranor në lidhje me konsiderimin e Marisë si “Nëna e zotit”

Një ndër çështjet më kontradiktore dhe të theksuara në historinë njerëzore është çështja e Merjemes/Marisë dhe birit të saj. A ishte (A është) ajo nënë e njeriut apo e zotit?! Ajo, a e lindi zotin, apo njeriun? Nëse ajo ka lindur zotin, qenia e saj çfarë duhet të jetë? Me këtë këndvështrim ajo duhet të jetë hyjneshë?

Senad Maku - Ulqin

Si Kurani ashtu edhe Bibla kur lexojmë për historinë e Merjemes/Marisë nënës së Isaut a.s./Jezuasit, na tregojnë se ajo ishte e bekuar dhe se Zoti e dalloi me besim dhe karakter, gjithashtu e lartësoi mbi të gjitha gratë e botës.

Këtë e vërtetojnë si Bibla ashtu edhe Kurani Famëlartë. Bibla fillimisht tregon kontaktin dhe dialogun në mes Engjëllit dhe Marisë ku thotë se: “Engjëlli hyri te ajo dhe tha: “Tungjatjeta, o hirplote, Zoti është me ty; ti je e bekuar ndër gratë”. (Luka 1:28)

Gjithashtu edhe Kurani Famëlartë e tregon këtë dialog ku thotë: **Përkujto kur engjujt i thanë: “Oj Mejreme, Allahu të dalloi ty (me besim e karakter), dhe të lartësoi mbi gratë e botës”.** (Ali Imran 42)

Në vazhdim këto dy libra na e pëshkruajnë edhe më tutje takimin-bisedën e Engjëllit me Merjemen/Marinë, ku thuhet se:

“Por kur e pa atë, ajo mbeti e shqetësuar nga fjalët e tij, dhe pyeste vetveten çfarë kuptimi mund të kishte një përshëndetje e tillë. Dhe engjëlli i tha: “Mos ki frikë, Mari, sepse ke gjetur hir para Perëndisë. Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë, dhe do t’ia vesh emrin Jezus”. (Luka 1:29-31)

Ndërsa Kurani Famëlartë e tregon në këtë mënyrë: **“Përkujto kur engjëjt i thanë: “Oj Mejreme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit) emri i të cilit është Mesih, Isa, bir i Merjemes, i famshëm në Dunja e Ahiret dhe nga të afërmit (e Zotit)”.** (Ali Imran 45)

Përgjigja e Merjemes/ Marisë ndaj Engjëllit ishte:

“Dhe Maria i tha engjëllit: “Si do të ndodhë kjo, përderisa unë nuk njoh burrë?”. Dhe engjëlli duke u përgjigjur, i tha: “Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ty dhe pushteti i Shumë të Lartit do të të mbulojë me hijen e vet...”. (Luka

1:34-35)

Kurani thotë: **Ajo tha: “Zoti im, si mund të kemë unë djalë e mua s’më ka prekur njeriu (nuk jam e martuar) “? Ai (Allahu) tha: “Ja, kështu, Allahu krijon çka të dojë. Kur Ai vendos për një çështje, vetëm i thotë: Bëhu! Ajo menjëherë bëhet”.** (Ali Imran 47)

Gjatë lindjes së Jezusit/ Isaut a.s., që ishte një mrekulli në vehte sa ishte foshnje dhe që Bibla nuk e cek, dhe me qëllim është e larguar kjo mrekulli nga Libri i të Krishterëve Bibla, është rasti ku Jezusi/ Isau a.s. foli kur ishte foshnje në djep. Kur populli e akuzonin nënën e tij Merjemen/Marinë për tradhëti pasi që e panë me foshnje, sepse ajo nuk ishte e martuar. Duke i thënë: Si mund të kesh lindur fëmijë pa qenë e martuar? Kur dihet se prej çfarë familjeje të ndershme je, si ke mundur ta bësh një krim të tillë? Këto akuza dhe pyetje i bëheshin Merjemes sikur të ishte autore e krimet. Merjemja (Maria) nuk u përgjigjte, heshte dhe bënte me shenjë kah foshnja e porsalindur që të flisnin me të, i cili do t’u përgjigjej pyetjeve dhe akuzave që i bënin asaj. Zoti i Plotfuqishëm bëri mrekulli që Isau a.s. të flasë qysh foshnje i vogël dhe ti demantoj shpifjet dhe akuzimet ndaj nënës së vet. Këtë ngjarje e tregon Kurani Famëlartë, ku thotë:

“Dhe duke e bartur ngryk shkoj me të te të afërmit e vet ata i thanë: “Oj Merjeme, ke bërë një punë shumë të keqe!” Oj motra e Harunit, babai yt nuk ishte njeri i prishur e as nëna jote nuk ka qenë e pamoralshme! Atëherë ajo u dha shenjë kah (Isai). Ata thanë: “Si t’i flasim atij që është foshnjë në djep?” Ai (Isai) tha: “Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë Pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqatë për sa të jemë

gjallë! Më ka bërë të mirësjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë as të padëgjueshëm! Selami (shpëtim prej Allahut) është me mua ditën kur u linda, ditën kur të vdes dhe ditën kur të dal (prej varrit) i gjallë!” Kjo është (fjalë) e vërtetë, rreth Isait, birit të Merjemes në të cilin ata shkaktajnë dyshime. (Merjem 27-33)

KONTRADIKTAT

Gjithashtu Allahu xh.sh. në Kuranin Famëlartë në lidhje me Isaun a.s. dhe Nënën e tij Merjemen thotë: **“Mesihu, bir i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit tjerë). Ja, si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj sesi i kthejnë shpinën të vërtetës!”.** (Maide 75)

Ajetet na shtjellojnë dhe na tregojnë se Merjemja/ Maria ishte dhe do të jetë një grua e dalluar dhe e lartësuar mbi gratë e botës. Ajo ishte e drejtë dhe e ndershme, duke hedhur poshtë shpifjet që i bëhen nga Jehuditë duke e konsideruar atë të pamoralshme edhe sot e kësaj dite, ndërsa për të krishterët ju tregon se, mos e ngritni në shkallën e hyjnisë, sepse si ajo po ashtu dhe Isai, fëmiu i saj, ishin që ushqeheshin si njerëzit e tjerë. Allahu xh.sh. ju sqaron argumentet e tyre, por ata pastaj ia kthejnë shpinën të vërtetës.

Një ndër çështjet më kontradiktore dhe të theksuara në historinë njerëzore është çështja e Merjemes/Marisë dhe birit të saj. A ishte (A është) ajo nënë e njeriut apo e zotit?! Ajo, a e lindi zotin, apo njeriun? Nëse ajo ka lindur zotin, qenia e saj çfarë duhet të jetë? Me këtë këndvështrim ajo duhet të jetë hyjneshë? Dhe sërish kthyerje në paganizmin e lashtë grek, nëpër


hyjni dhe hyjnesha të shpikura nga imagjinata njerëzore, e jo në të kundërtën për të cilën kishte ardhur h. Isau a.s./ Jezusi, që vetëm një Zot të vërtetë të adhuronin njerëzit siç vepronte nëna e tij Merjemja/ Maria dhe ai a.s.

Në disa nga sektet të Krishtera (Katolikët-Protestantët-Ortodoksët), sa i përket nënës së Jezusit, Marisë së Virgjër e cila e ka lindur Jezusin, konsiderohet, apo quhet Nëna e Zotit.

Kisha ortodokse autoqefale shqiptare, sikur edhe kishat tjera ortodokse, Marinë e njeh si lindëse e Zotit (theotocos). Në historinë e krishterimit, që prej shek. V diskutohet çështja se Maria ka lindur Jezu Krishtin Zot apo Jezu Krishtin njeri. Shën Cyrilli nga Aleksandrija thotë: “Nëse Jezu Krishti është Zot, atëherë edhe virgjëresha e shenjtë (Maria) që e ka lindur atë është theotocos-nëna e Zotit. Prandaj, mendimi i pranuar nga ortodoksët është se Maria ka lindur Zot dhe kështu është nëna e Zotit”.

Nëna e Jezusit e posedon një pozitë të lartë në Krishterim. Sepse si rrjedhojë logjike vjen se nëse Jezusi është me të vërtetë është Zotë, atëherë nëna e tij duhet të titullohet “Nëna e Zotit”. Por, asnjë i krishterë nuk pretendon se Maria është gruaja e Zotit. Në vitet në vazhdim është kultivuar një sërë mënyra të respektimit deri në adhurim dhe lutje drejtuar saj, edhe pse në realitet ajo nuk ishte përpos nënë biologjike e Jezusit. Ajo konsiderohet “si ‘arka e Besëlidhjes’ ku Hyji banon në mesin e popullit (...) është Tempulli i Zotit, (...) vendi i pranisë së Zotit, Shenjtorja e gjallë i të Shenjtueshmit.”

Duke pasur parasysh adhurimet e devijuara që bëhen në Krishterizëm, duke adhuruar krijesat e Zotit të Madhëruar, duke i hyjnizuar ato, nuk duhet lënë anash pa e elaburuar çështjen e Nënës së Jezusit, Marinë (Merjemen), gjë që siç e cekëm më



Kjo skulpturë e vjetër (fotoja në të djathtë) prej shekujsh në Francë (Kolegjiata e Montrealit, Yonne Francë), paraqet kurorëzimin e "virgjëreshës" Mari nga Triniteti. Besimi në trinitet çoi në nderimin e Marisë si "Nënë e Perëndisë"

lartë, që të krishterët e quajnë Marinë si Nënë e zotit (Teodokos) apo lindësja e zotit të cilët disa sekte krishtere si ajo ortodokse të cilët e adhurojnë dhe bëhet pjesë e Trinitisë së Shenjtë e cila zë një vend të veçantë.

Për shembull, në kishën ortodokse të lindjes, ikonat e Jezusit, Marisë (nënës së Jezusit), Trinitetit etj. i paraqesin si simbole adhurimi dhe luten me përkushtim dhe besim të veçantë. Një vepër referimi për ortodoksinë greke, shpjegon: "Me besim dhe përkushtim të veçantë, ne nderojmë më të shenjtën Nënë e perëndisë, nënën e zotërisë tonë, dhe kërkojmë mbrojtjen dhe ndihmën e saj". Një ndër ikonat mund ta vëreni në foto dhe mënyren e shenjtëritimit të Marisë dhe një lloj Triniteti:

Në vitin 431 të erës sonë, në Efes u mbledh këshilli i tret ekumenik, ku u diskutua se çfarë natyre ishte Krishti... Po ashtu vendimi që u mor në Efes, me anë të të cilit roli i Marisë u lartësua nga bartëse e Krishtit në mbartëse e perëndisë, jo vetëm që hodhi bazën për shëndërrimin e Marisë në një kult, por shkaktoi edhe përçarjen e parë të madhe brenda kishës... Ky debat vazhdon deri në ditët e sotme.

Në librin "Ti afrohem i Jehovait", shkruan: "Në shekullin e parë të krishterët patën shumë bekime frymore. Por Jezusi dhe apostujt parathënë se adhurimi i vërtetë do të korruptohej e do të humbiste. (Mateu 13:24-30; Veprat 20:29-30) Pas periudhës apostolike doli në skenë i ashtuquajtur i krishterim. Klerikët e saj përvetësuan mësimet dhe praktika

pagane. Gjithashtu, e bënë gati të pamundur afrimin me Perëndinë, duke përshkruar atë si një Trinitet të pakuptueshëm...". Kisha Zotit i dha formë të njeriut dhe njerëzve ua prezantonte Zotin në fizionomi të njeriut. Nën ndikimin e religjionit krishterë njerëzit, që nga fëmijëria Zotin e paramendonin në këtë trajtë njerëzore dhe materiale. Kështu Krishti Zot ndodh bashkërisht me njeriun historik të Jezusit nga Nazareti. Pra vetë Zoti ka qenë i mishëruar në njeriun përgjatë historisë. Fanatizmi është zell i shërbyesve të Kishës për t'u imponuar njerëzve një hyjni me pamje njeriu. Duke parë që Krishterimi u ndikua më tepër nga fetë pagane dhe doktrinat e saja kishin rite pagane, kjo e shtyri historianin o njohur Will Durant të thoshte: "Krishterimi nuk e shkatërroi paganizmin; e adoptoi atë...".

NDIKIMI NGA FETË PAGANE

Nëse studiohen hollësisht besimet dhe kulturat e lashta na del se çështja e Marisë si "nënë e zotit" është ndikuar më tepër nga fetë pagane. Krishterimi në formën e vet origjinale ka qenë po i njëjti besim në një Zot me të cilin Zoti i ka porositur të gjithë të dërguarit, pejgamberët e Vet që t'ia komunikojnë njerëzimit. Ishin Romakët ata që kur pranuan krishterimin, e kishin të vështirë të hiqnin dorë nga zotërat e tyre mitologjike dhe të bëheshin monoteistë. Gradualisht këto mite u shkrinë brenda krishterimit "zyrtarë", si p.sh.: Paganizmi u pranua nga kisha dhe nga ajo çdo disident shkishërohej. Këtë madje e

pranon edhe vetë pastori i protestantizmit Dr. Fehmi Cakolli ku thotë: "Si në Judaizëm ashtu edhe në Krishterizëm, mund të gjenden elemente pagane. Nuk mund të paneh se nuk përmban ndonjë element pagan, përkatësisht pa pasur elemente të religjioneve të tjera".

Gjatë shekullit të 11 para erës sonë (para Krishtit) pasi e pushtuan Efesin (bregu perëndimor i Turqisë së sotme), perandori të ndryshme. Pushtuesit hasen në njerëz që njiheshin për adhurimin e perëndeshës së nënave, një hyjneshe që më vonë do të njihet si Artemisa Efesiane. Kulti i Artemisë kishte lëshuar rrënjë të thella në Efes. Para kohës së mbretit Kres, Cibela, Nëna e perëndive, ishte hyjnesha kryesore që adhurohej në vend. Duke krijuar një lidhje gjenealogjike midis mitit të Cibelës dhe mitit të perëndive greke... nga mesi i shekullit të gjashtë para erës sonë, filloi puna për ngritjen e tempullit të Artemisë, pasueses së Cibelës. Kështu, adhurimi i Cibelës dhe i Artemisë u zëvendësua me adhurimin e Marisë, nënës së perëndisë. Ashtu siç pohohet: "Kulti i Marisë në Efes... është një traditë që vazhdon të praktikohet deri në ditët e sotme, traditë që nuk mund të shpjegohet pa bërë lidhjen me kultin e Artemisë". Në parathënien e Eduard Gibonit, në History of Christianity, lexojmë: "Nëse Paganizmi u pushtua nga Krishterimi, është po kaq e vërtetë që krishterimi u korruptua nga paganizmi..

"Adhurimin ndaj Marijës as Bibla vetë nuk na autorizon t'i lutemi asaj. Shumë vetave që i luten

Marisë, u është mësuar se mund të bekohen duke përsëritur një sërë lutjesh specifike, si p.sh. lutjen: Ave Maria, Ati ynë, etj. Libri "Simbolet e Katolicizmit" (anglisht) thotë se për katolikët: "forma më e përhapur e adhurimit të Marisë është padyshim ajo me anë të rruzave".

Po të bëhet me tutje një studim në lidhje me fetë pagane dhe krishterimit, do të vërejmë shumë ngjashmëri gjë që tregon se krishterimi ka qenë shumë i influencuar nga besimet dhe ritet pagane të cilët vetë krishterimi i huazoj dhe iu përshtat besimeve të tyre. Konkretisht mund të cekim, pasi që jemi duke folur për Marinë, nënën e Jezusit, atëherë mund të vërejmë që ngritja e saj në shkallën e hyjnorës siç pamë më lartë është ndikuar nga fetë pagane, këtë mund ta argumentojmë edhe me disa fakte tjera si p.sh. tek ikonat të cilat shfaqen nëpër kisha dhe manastire në të cilën është e pikturuar Marija duke e mbajtur fëmijën e saj Jezusin në krah, apo diçka të ngjashëm, është një huazim i marrur nga kultet e lashta të perëndive pagane, si:

Perëndesha egjiptase "Hator" shpesh është shfaqur duke e mbajtur fëmijën e saj "Horusin" në krah dhe duke i dhënë gjë. Ajo është paraqitur në mënyrë ikonografike në formën e "Marisë" së krishterë, me fëmijën e saj "Jezusin". Gati në të gjitha provincat e perandorisë romake gjendeshin kultet e perëndeshës së "Izis-it". Kulti i fundit që mbeti ishte vendi më i shenjtë në ishullin Fildë, u mbyll në vitin 560 të e.s. nën urdhrin e perandorit Justinijan (527-565). Në ngjashmëri mund të gjendet edhe tek Perëndesha Babilonase "Semirami" dhe Zoti i personifikuar në bir; gjithashtu tek Perëndesha Indiane "Devka" dhe foshnja e saj "Krisna"; Perëndesha Indiane "Isi" si dhe foshnja e saj "Isvara", etj. Të gjitha këto janë kulte dhe rituale pagane të cilat më vonë i huazoj krishterimi.

Këto mund ti elaborojmë edhe me fotografi të ngjashme që tregojnë ritualet pagane tek Marija dhe Jezusi: **(Foto 1)**

Fotografia e mëposhtme përmban tri skulpturat që tregojnë një ngjashmëri të madhe në mes Marisë me Jezusin dhe skulpturave tjera pagane të besimeve tjera. Në të majtë të fotografisë është Perëndesha e Egjiptit Izisi me djalin e saj Horusin, në mes është Maria me djalin e saj Jezusin, ndërsa në të djathtë Perëndesha romake Mater Matuta. **(Foto 2)**

Gjithashtu një ngjashmëri në mes Marisë me fëmijën e saj Jezusin, mund ta gjejmë edhe tek Budizmi Nëna e zotit me fëmijën e saj, dhe krahasimi i Marisë me Jezusin. **(Foto 3)**

Shumë të krishterë, sidomos katolikët dhe ortodoksët vizitojnë vendet e shenjtë që i përshkruhen Marisë (si Efesi në Anadoll dhe

Nasira në Palestinë). Në kishë vend të posaçëm kanë portretet e Marisë respektivisht skulpturat e saj. Besimtarët për shpëtimin e tyre i kërkojnë që të ndërmjetësojë. Besohet se Maria, me përfundimin e jetës në këtë botë është ngritur në qiell dhe jeton bashkë me të Birin. Vetë ajo me shpirt dhe me trup është ngritur në qiell. Në Dhjatën e Re nuk ka njohuri definitive për ngritjen e Marisë në qiell. Ky besim bazohet në doktrinën e kishës katolike për shenjtërimin dhe nderimin e Marisë.

Duke parë devijimin e popujve nga rruga e vërtetë dhe ndryshimin e librave të shpallura prej të Madhit Zot. Allahu xh.sh. para 14 shekujsh dërgoi pejgamberin e Tij, të dërguarin e Tij, të fundit Muhamedin s.a.v.s. dhe me fjalën finale të Tij, dërguar njerëzimit. Librat e mëhershme nuk u ruajtën ashtu siç u shpallën. Bibla e sotme është një përzierje e gjurmëve të mbetura të fjalëve të Zotit, me fjalët e profetëve, historianëve, autorë dhe njerëzve të tjerë, që as vet autorët e librave nuk dihen saktësisht.

Feja Islame, Kurani është ai që ringjalli dhe e përtëriu fenë e Isait a.s./ Jezusit dhe fenë e të gjithë të dërguarve të tjerë para tij. Pika kryesore me të cilën Islami apo Kurani ka ardhur, është sqarimi i konceptit të Zotit, e cila është edhe esenca e vërtetë e fesë. Koncepti i Zotit në Krishterizëm ka arritur deri në atë shkallë sa që Zoti të krahasohet me vetit dhe cilësitë njerëzore, duke iu shoqëruar Zotit shok, duke i bërë ortak, duke e adhuruar dikë tjetër në vend të tij, gjithashtu duke adhuruar nënën e




Foto 1

Jezusit dhe duke e quajtur atë si Nëna e Perëndisë, etj.

Kurani është një udhëzues i cili e ndanë dritën nga errësirat dhe na tregon në mënyrë perfekte, çka mund të besohet, e çka nuk mund të besohet nga Bibla.

Fetë e rreme kanë të përbashkët një koncept bazë lidhur me Zotin: ose pretendojnë se të gjithë njerëzit janë zota, ose se natyra është Zot, ose se Zoti është një pjellë e imagjinatës së njeriut. Pra, mund të thuhet se mesazhi bazë i feve të rreme është se Zoti mund të

adhurohet në formën e krijimit të Tij. Fetë e rreme e ftojnë njeriun në adhurimin e krijimit duke e quajtur krijimin ose disa aspekte të tij Zot. P.sh., Pejgamberi Isai a.s./ Jezusi, i ftoi pasuesit e vet të adhuronin Zotin, por ata që pretendojnë të jenë pasues të tij sot i ftojnë njerëzit në adhurimin e Jezusit, duke pohuar se ai ishte Zot.

Nëse marrim Budën, ai ishte një reformator që solli një sërë parimesh humaniste në fenë e Indisë. Ai nuk pretendoi të ishte Zot, e as nuk ua sugjeroi pasuesve të vet që ta shëndrrojnë në objekt adhurimi. Megjithatë, sot shumica e budistëve, e konsiderojnë atë si Zot dhe i përkulen idhujve të bërë sipas parafytyrimit të tyre për Budën.

Duke vënë në zbatim parimin e identifikimit të objektit të adhurimit, ne lehtësisht mund të dallojmë fetë e rreme dhe natyrën e shpikur të origjinës së tyre. Siç ka thënë Zoti i Plotfuqishëm në Kuranin Famëllartë:

“Ata që ju adhuronin përveç Allahut, nuk janë tjetër vetëm se emra që i pagëzuan ju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të mos adhuronin tjetër vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë”. (Jusuf 40)

Po ashtu Zoti i Madhëruar në Kuranin librin e Tij të fundit të shpallur Muhamedit s.a.v.s., i tërënjek vërejtjen njerëzve, sidomos të krishterëve, në lidhje me Jezusin dhe Nënë e tij, ku thotë:

“Mesihu, bir i Merjemes,



Foto 2

nuk është tjetër, vetëm se i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit tjerë). Ja, si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj sesi i kthejnë shpinën të vërtetës! Thuaju: A adhuroni pos Allahut atë që nuk mund t'ju sjellë as dëm as dobi? Allahu është që dëgjon (ç'thoni) që di (ç'veproni)". (El Maide 75-76)

“Dhe kur Allahu tha: “O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: “Më besoni mua dhe nënës time dy zota pos Allahut!?” (Isai) Tha: “Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, ti do ta dije. Ti e di ç'ka në mua, e unë nuk di ç'ka në Ty. Ti je më i dijsmi i të fshehtave!” Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, pos asaj që Ti më urdhërove; ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta, kam qenë përcjellës i tyre, e pasi që më more mua, Ti ishe roje (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send!”. (El Maide 116-117)

Komentuesi shqiptarë i Kuranit (Tefsirologu) Hafiz Ibrahim Dalliu, kur i komenton këto ajetet e sures El-Maide 75 dhe ajetin 116-117 thotë: “Zoti e ka bërë të pavlerë besimin e të krishterë me tri mënyra:

Isai ka nënë. Atëherë, ai njeri që ka nënë, është i krijuar dhe ai që është krijuar, kurrë nuk bëhet Zot.

Isai dhe e ëma hanë ushqim, dhe ai që ka të tilla nevoja nuk është Zot.

Isai është i dërguar nga ana e Zotit. Atëherë, Ai njeri që është i dërguar profet nga ana e Zotit, nuk bëhet vet Zot.

KOTËSITË

Pra, Zoti u thotë të krishterëve se hazreti Isai a.s./ Jezusi, është një peygamber si të gjithë peygamberët e kaluar para tij; Zoti, ashtu siç u ka dhënë peygamberëve të tjerë mrekullira, për të vërtetuar profetësinë e tyre, po ashtu i ka dhënë edhe Isait a.s.; prandaj, ashtu siç nuk u thuhet zot peygamberëve të tjerë, po ashtu nuk duhet t'i thuhet zot as Isait a.s.. Nëse ata thonë se Isai ka lindur pa baba..., atëherë thuaju atyre: Po, Adem, që është krijuar pa baba edhe pa nënë, përse nuk i thoni zot?

Ndërsa për ajetet 116-117, thotë: “Pyetja që i madhi Zot, do ti bëjë Isai a.s./ Jezusit, “A ti u ke thënë njerëzve...” është për tu mbyllur gojën të krishterëve dhe për t'ua nxjerrë në shesh se besimi i tyre është i kotë; ndryshe përse duhej të pyeste Zoti, kur e dinte që Isai nuk kishte thënë atë fjalë? Kjo pyetje nuk do të bëhet për të sqaruar



Foto 3

ndonjë gjë që nuk di Zoti, por do të bëhet për t'u treguar të krishterëve me gojën e Isait se ata, kanë një besim të kotë”.

Doktrinat themelore të krishterimit nuk bazohen në Bibël, por në mite të lashta-greke, egjiptiane, babilonase dhe të vendeve të tjera. Revista “Christian Century” në numrin e 20-27 Majit, 1998, citon fjalët e një pastori i cili pranon se Triniteti është “një mësim i kishës dhe jo një mësim që erdhi nga Jezusi”. Në fund të fundit, dogma e Trinitetit është një koncept që doli në shekullin e katërt.

Tek Ungjilli i Barnabes theksohen fjalët e Jezusit ku tha:

“Kur Zoti të më marrë nga bota, Satanai përsëri do ta ngre këtë alarmë të mallkuar, ashtu që do të të bëjë që mosbesimtarët të besojnë se unë jam Zot dhe bir i Zotit, për ç'shkak, fjalët e mia dhe mësimet e mia do të njollosohen, ashtu që do të mbesin mezi tridhjetë besimtarë”.

Po ashtu Jezusi tha: “Unë nuk ju kam krijuar, por Zoti, Krijuesi ynë, i cili ju ka krijuar, do t'ju mbrojë. Sa më përket mua unë kam ardhur në botë që të përgatisë rrugën për të dërguarin e Zotit, i cili do t'ia sjell botës shpëtimin. Por, ruani e të mos mashtroheni, ngase do të vijin shumë profet të rrejshëm, të cilët do t'i marrin fjalët e mia edhe do ta helmojnë Ungjillin tim”.

Profesor Abdul Ahad Davud, më parë i njohur si David Benjamin Keldani, ish prift katolik, kur flet në lidhje me nënën e Jezusit, Marinë dhe për Perëndinë e vërtetë, thekson: “Të proklamosh tri qenie njerëzore në kreun e Perëndisë dhe

të rrëfesh se i Gjithëfuqishmi, i Përvetshmi ishte përfytyruar dhe lindur nga Maria virgjëreshë është një fyerje e rëndë e ligjit të Zotit dhe idhujtaria më e madhe”. “Formula e përkujdesjes së krishterë (dëshmia e të krishterit): “**Në emër të Atit, Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë**”, as që e përmend emrin e Zotit! Ky pra është Zoti i të Krishterëve! Ndërsa “**Bismillahirr-rrahim**” (në fenë Islame) që do të thotë: Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit, është në kundërtënie të madhe me formulën e trinitisë”.

Mbi gjithë të tjerat, Kurani erdhë që ta largoi njeriun nga adhurimet të ndryshme pagane, ta largoi njeriun nga rruga e shtrembër dhe ti udhëzoi në rrugën e drejtë ashtu siç bënë edhe të dërguarit e Zotit xh.sh.

Orientalistja e famshme Italiane dr. Laura Veccia Vaglieri në librin e saj “An Interpretation of Islam”, ku thotë:

“Peygamberi Arab, me zërin i cili ka qenë i frymëzuar me lidhje të fortë me Krijuesin e Vet, ua ka predikuar monoteizmin më të pastër adhuruesve të fetishtit dhe ithtarëve të krishterimit dhe judaizmit të prishur... Duke iu falënderuar Islamit, paganizmi në të gjitha format e tij të ndryshme qe mundur. Vizioni i kozmosit, rritatet religjioze dhe traditat e jetës shoqërore qenë liruar nga të gjitha lajthitjet, të cilat i patën degraduar, kurse mendimi njerëzorë qe liruar nga paragjykimet. Njeriu më në fund qe i vetëdijshëm për dinjitetin e tyre. I përulëj vetëm Krijuesit dhe

Sunduesit të mbarë njerëzisë... “.

Kurse Allahu xh.sh. në Kuran i drejtohet Muhamedit s.a.v.s., thuaj atyre që trillojnë:

“Thuaj: “**Ata që trillojnë gënjeshtër për Allahun, nuk kanë për të shpëtuar**”. Ata kanë një përjetim në dunja, pastaj kthimi i tyre është vetëm te Ne, e Ne do të bëjmë që ata të shijojnë dënimin e dhembshëm për shkak se nuk besonin”. (Junus 69-70) “E ti jobsimtarëve jepju afat, afatizoi ata pak”. (Tarik 17)

Si përfundim iu japim një këshillë Ithtarëve të Librit, sidomos të Krishterëve, duke iu lexuar fjalët e Zotit të Plotfuqishëm ku thotë:

“**O ithtarë të librit, përse nuk i besoni ajetet (Kuranin) e Allahut, e duke e ditur të vërtetën? O ithtarë të librit, përse, duke qenë se ju e dini të vërtetën e ngatëroni me gënjeshtër dhe fshihni realitetin?**”. (Ali Imran 70-71)

Gjithashtu jua citoj edhe fjalët nga vet Bibla e tyre ku tregon mashtrimin e bërë ku thotë:

“**Ata e ndryshuan të vërtetën e Perëndisë në gënjeshtër dhe adhuruan dhe i shërbyen krijesës në vend të Krijuesit, që është i bekuar përjetë**”. (Romakët 1:25)

Por e vërteta do të dalë njëherë e përgjithmonë në shesh dhe atëherë do tju bëj të lirë dhe ta zgjidhni rrugën e drejt dhe besimin e vërtet në një Zot, ku po ashtu në Biblën e tyre shkruan: “**Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bëjë njerëz të lirë**”. (Gjoni 8:32)

LEXIMI I KURANIT PËR TË VDEKURIT

Rexhep Ziberi

Lidhur me leximin e Kur'anit famëlartë për të vdekur në mesin e dijetarëve Islam hasim në divergjenca mendimesh, në përgjithësi lidhur me këtë çështje ata janë ndarë në dy grupe:

a) Shumica e dijetarëve Islam duke përfshirë dijetarët e Medh-hebit Malikij, Hanbelij, Hanefij dhe shumicën e dijetarëve të Medh-hebit Shafij pretendojnë se leximi i Kur'anit famëlartë për të vdekurit është i lejuar do të thotë se sevapi i leximit të Kur'anit nga i gjalli i arrin të vdekurit, natyrisht duke e mbrojtur mendimin e tyre me faktet vijuese ku ata bazohen.

Çdo adhurim që mund të zëvendësohet në gjendje materiale i gjalli mund t'ia adreson të vdekurit, siç është: Sadakaja, Duaja, leximi Kur'anit, kryerja e Haxhit etj.

1. Allahu f.p me gjuhën e Ibrahimit a.s në Kur'anin famëlartë thotë: "O Zoti im! më bën mua nga ata që falin namazin, e edhe prej pasardhësve të mi, dhe pranoje lutjen time o Zoti im. Zoti ynë! më fal (gabimet) mua edhe prindërve të mi fali edhe të gjithë besimtarët, ditën kur jepet llogaria." Ibrahim 40-41. Pastaj për Muhaxhirët e Medines thotë: "Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: Zoti ynë! Falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues." El Hashr 10.

2. Pejgamberi a.s në varrimin e një Sahabi tha: "Lutuni për vëllain tuaj dhe kërkoni nga Allahu që ta përforcoj sepse tani ai pyetet".

3. Transmeton Aishja r.a.n.h se një Sahab e pyeti Pejgamberin a.s dhe i tha: "Nëna më është mbytur dhe mendoj se (nëse do të ishte gjallë) nëse do të kishte folur ajo, do të më kishte urdhëruar që të jap sadaka për të dhe nëse jap sadaka për të a ka sevap ajo? Pejgamberi a.s i tha: "Po".

4. Ibni Abasi transmeton se dikush e pyeti Pejgamberin a.s se a bën të jap sadaka për të vdekurin? Pejgamberi a.s i tha: "Po", ndërsa Sahabi i tha: "Ty të kam dëshmitarë se kopshtin e nënës time do ta jap sadaka për shpirtin e saj".

“

“Ai i cili kalon pran varrezave dhe e lexon (suren Ihlas) Kul-huvall-llahun njëmbëdhjetë herë dhe sevapin ua dedikon të vdekurve, Allahu i jep këtij sevape aq sa ka të vdekur” Hadith.



5. Ibni Kudameja thotë: "Nuk di se ka kundërthënie në mes dijetarëve se sevapi nuk i arrin të vdekurit!"

6. Pejgamberi a.s në varrimin e një Sahabi thotë: "Lutuni për këtë vëllain tuaj dhe kërkoni nga Allahu që ta përforcoj sepse tani ai pyetet."

7. Pejgamberi a.s thotë: "Lexoni Jasinin për të vdekurit tuaj"

8. Pejgameri a.s një vajze e cila e pyeti për kryerjen e Haxhit për babain e vdekur të saj i tha "bëje Haxhin për të".

9. Pejgamberi a.s thotë: "Allahu fuqiptotë dënimin e të vdekurve e lehtëson me lutjet e të gjallëve."

10. Pejgamberi a.s thotë "I vdekuri dënohet nga nga të qarit e të gjallit" (Këtë hadith gjërë e gjatë e ka elaboruar Jusuf el-kardavi në fetvat e tij).

Këto fakte që ndamë ishin vetëm disa nga faktet direkte dhe indirekte që flasin për atë se sevapi i të gjallit i arrin të vdekurit edhe pse shumica e dijetarëve Islam kanë radhitur me qindra fakte tjera që flasin për këtë çështje

ARGUMENTET E ATYRE QË MENDOJNË NDRYSHE

b) Imam Shafiu dhe një pjesë e vogël e Shafive janë të mendimit se të vdekurit asgjë nuk i arrin nga sevapi i këndimit të Kur'anit, ndërsa duhet potencuar se Shafitë nuk mohojnë atë se sevapi nga agjërimi namazi haxhi i arrin të vdekurit për pos leximit të Kur'anit famëlartë. Argumentet në të cilat bazohen këto dijetarë janë:

Ajetet Kur'anore në suren "Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar.(En-Nexhm,39) dhe Hadithi i Pejgamberit a.s i cili thotë: "Kur të vdes i biri Ademit i ndërpriten punët e tij për pos tre punëve: Lëmosha e rrjedhshme, një dituri me të cilën shërbehen të tjerët pas tij, dhe një evlad i mirë i cili lutet për ta pas tyre."

DEMANTIMI I FAKTEVE

Ibn Hazm el-Endelusi në këtë çështje e kritikon Imam Shafiu dhe atë pakicë të Shafive

që mendojnë se leximi i Kur'anit famëlartë është i ndaluar të lexohet për të vdekurit duke u nisur nga ajo se është po Ai Allah xh.sh i cili thotë se i vdekuri i cili ka lënë vasijet duhet të realizohet ajo, është po Ai Allah xh.xh i cili në disa ajete thotë se besimtarëve që luten për vete dhe për të vdekurit e tyre. Sa i përket ajetit që merr për bazë imam Shafiu, ibni Hazmi thotë se ky ajet nuk mund të merret për argument se sevapi nga leximi i Kur'nit nga i gjalli nuk i arrin të vdekurit, sepse ky ajet është i deroguar dhe aspak nuk ka të bëjë me çështjen e leximit të kuranit për të vdekur.

Lidhur me argumentin e dytë të Shafiu, ibni Hazmi thotë se ju harroni se argumentin që ju e merrni për bazë është po ai argument që flet se sevapi i të gjallit i arrin të vdekurit, sepse pjesa e fundit e hadithit thotë: "edhe një evlad i hajrit", e ky evlad ç'do të bëj tjetër për prindërit e tij pos lutjeve për ta dhe veprave që do t'ua përkushtoj atyre!?

Nga ana tjetër nëse i vdekuri ka dobi nga përshëndetja e të gjallit me selam kur ai kalon pran varrezave, atëherë pse të mos ketë dobi i vdekuri nga leximi i Kur'anit famëlartë!

Pejgamberi a.s thotë "... Sureja el-Mulk është mbrojtje nga zjarri për të vdekurin." Mandej drejtpërdrejtë në transmetimin e Aliut r.a, Mësuesi i njerëzisë tha: "Ai i cili kalon pran varrezave dhe e lexon suren Ihlas njëmbëdhjetë herë dhe sevapin ua dedikon të vdekurve ai sevap shkon te të vdekurit por edhe ky ka sevap" Në një transmetim tjetër thuhet "Allahu i jep këtij sevape aq sa ka të vdekur."

Nga ana tjetër dihet se Muhamedit a.s i është lejuar ndërmjetësimi në ditën e kijametit si dhe do të jetë i mundësuar vetë ndërmjetësimi Kur'anit famëlartë, në këtë analogji pse të mos lejohet leximi i Kur'anit për të vdekurit!?

Konkluzioni i kësaj çështje është se sipas shumicës së dijetarëve Islam, duke përfshirë edhe dijetarët e Medh-hebit tonë Hanefij, sevapi i të gjallit i arrin të vdekurit dhe shumica e dijetarëve Islam janë të mendimit që në fund të çdo ibadeti për të vdekurin duhet të thuhet: "O Zot përcjella këtë ibadet shpirtit të filanit."

ZHVILLIMI I MUZIKËS GJATË SHEKUJVE PAS SAFIJUDIN URMEVIJUT (I)

“Në shekullin e XVII marëdhëniet në sferën e muzikës fillojnë edhe me perendimin, në këtë konotacion kemi një muzicent nga Polonia, Alberto Bobovio Leopolitano Bobowski, i cili më vonë mer emrin Ali Ufki. Ai mësoi në Enderun, gjatë mësimëve muzikore mësoi t’i bjer edhe një vegle muzikore me emrin Santur. Merr pjesë edhe në orkestrin e pallatit mbretërorë në kohën e Sulltan Ibrahimit dhe Mehmedit të katërt (1640-1648)”

M-r. Abaz JAHJA

Safijudin Urmeviju konsiderohet si një ndër fytyrat më eminente në historinë e teorisë së muzikës. Ai në veprat e tij të mirënjohura në vendosjen e sistemit të teorisë së muzikës ka qenë model për gjeneratat që kanë vijuar pas tij. Sistemi i Safijudinit është hulumtuar dhe analizuar gjërësishtë po thuaj se nga ana e mbarë trojeve Islame.

Në shekujt që vijojnë pas këtij teoricienti shumë të famshëm, dallojmë edhe disa fytyra tjera që kanë ndjekur rrugën e tij dhe kanë bërë analiza mbi sistemin e tij, ndër të cilët do të veçojmë:

Muzicenti dhe Letrari i njohur nga Azerbejxhani Hatib el Erbili (Ebu Abdullah Bedredin Muhamed), me veprën e tij “Urxhuzetul-Engam” të cilën e shkroi në vitin 1329. Kaligrafi nga Tebrizi, Shehabedin Abdullah Sajrafi, me veprën e tij “ Hulasatul-Efkar fi Ma’rifetil-Edvar”. Matematicienti i njohur Xhemaludin Abdullah el-Mardini, me veprat: “ Mukaddime fi Ilmi Kevaninil-Engan dhe “Urxuhe fi Sherhin-negamat”, Të gjithë këta të cilët i cekëm kanë analizuar sistemin e Safijudinit. Në Iran mund t’i numërojmë: Shemsedin Muhamed el Amuli me veprat “ Nefajisul-Funun” dhe “Arajisul-Ujun”. Në veprën e fundit enciklopedike i kushton një vëllim çështjes së muzikës. Hasan Kashani i cili në veprën e tij “Kenzut-Tuhaf” i kushton rëndësi të veçantë çështjes së muzikës.

STAMBOLLI QENDËR E ARTIT DHE KULTURËS

Me çlirimin e Stambollit në vitin 1453 nga ana e Fatih Sulltan Mehmedit, Stambolli Shëndërrohet në kryeqytet dhe aktivitetet kulturore dhe artistike vazhdojnë të koncentrohen në këtë qytet të madhë. Në lëminë e muzikës vazhdojnë punimet edhe nëpër qendrat e ndryshme të Anadolisë. Jusuf Dede

nga Kërshhiri shkroi veprën “Risalei Musiki” në vitin 1410 ku edhe ky e analizon veprën e Safijudin Urmevijut.

Po ashtu në këtë periudhë e kemi edhe Hëzër bin Abdullah i cili shkroi veprën “ Kitabul Edvar” në vitin 1441 në gjuhën Turke.

Ka fundi i shekullit XV i kemi edhe Ladikli Mehmed Çelebi me veprat e tij të mirënjohura “ Zejnul el-Han fi Ilmi T’elifi vel-Evzan” dhe “Risaletul-Fethijeh” (1484-1485).

Në lindje e kemi edhe teoreticientin e madh muzikorë Abdul Kadir Meragi, por ne këtu nuk do të flasim gjërësishtë për të, për shkak se kemi folur në shkrimet paraprake.

Në këtë shekull dallojmë edhe Nuredin Abdurrahman Xhami me veprën e tij “Risalei Musiki” (1485), si dhe Haxhi Bajram Veliju i cili njihet edhe si themelues i Tarikatit Bajrami, dhe Eshrefoglu Rumi i cili ka komponuar mjaftë vepra në fushën e muzikës fetare.

Shekulli XVI karakterizohet me aspektin e komponimeve dhe kompozitorëve si dhe me paraqitjen e solistëve të shumtë. Në veri të Turkistanit kemi Zejnul Abidin el Husejni me veprën “Kanunu Ilmi ve Amelijjil-Musiki” dhe Nexhmudin Keukebij Buhari me veprën “Risalei Musiki”.

Në trojet e Perandorisë Osmane dallojmë: Sejdi me veprën “ el Matlla”, për të cilin ende nuk kemi të dhëna të sakta, si dhe Udij Dervish Mahmud me veprën “Mekasidul Edvar”. Është me rëndësi të theksojmë se kemi edhe Sulltanë të cilët janë marë dhe kanë qenë edhe personalisht muzicentë, si Sulltan Bajezidi i dytë 1481-1512, si dhe djali i tij Shehzade Korkut. Evlija Çelebiju në veprën e tij të mirënjohur “ Sejjahatname” thekson se Sulltan Bajezidi i dytë tre herë në javë ka organizuar dhe ka angazhuar një orkestër të veçantë nga ana e muzicentëve të dalluar me qëllim terapije për të sëmurit mental.

Shekulli XVII shënon një përparim të madhë në sferën e artit dhe

kulturës në përgjithësi. Në këtë shekull vërehet edhe ndërtimi i shumë urave. Kjo fillon me ardhjen e Sadrazamit, Kepryly Mehmed Pasha.

RREZATIMI I KULTURËS DHE ARTIT ISLAM

Evlija Çelebiju në veprën e tij “ Sejatname” në mes tjerash flet edhe për format e ndryshme muzikore si dhe për llojet e instrumenteve (veglave) muzikore të asaj kohe.

Në këtë shekull qendrat më të njohura të muzicentëve janë: Kajroja, Bagdadi, Halebi, Shami (Damasku), por koncentrimi i madh në lëminë e veprimtarisë së muzikës fillon drejt Stambllit, aty fillojnë edhe të mblidhen muzicentët nga qendrat e ndryshme Islame si edhe nga perendimi.

Në këtë shekull dallojmë edhe një fytyrë shumë eminente dhe me rëndësi të veçantë, Hatib Dhakirij Hasan efendiun. Muzicentë dhe

kompozitorë në lëminë e muzikës fetare, posaçërishtë i dalluar në format muzikore të xhamisë.

Format muzikore në muzikën fetare të cilat i komponoi ai janë: Tevshih, Temxhid, Tesbih, Na’t, Mersije dhe Salate.

Një kompozitor tjetër është edhe Aziz Mahmud Hudai, jetoi në periudhën e Kanuni Sulltan Sulejmanit dhe Muradit të katërt. Po ashtu është edhe poet i cili ka edhe divanin (përmbledhjen e poezive) e tij.

Në gjysmën e dytë të shekullit XVII dallojmë muzicentimin më të madh të këtij shekulli. Njihet me emrin Hafiz Post, por emir i tij i vërtetë është Tanburi Mehmed efendiun.

Lindi në Stamboll dhe u rrit nën mbikqyrjen e poetit të madh Nailiut. Si i ri mësoi Kur’anin përmendësh dhe më pas vazhdoi mësimet te Kaligrafi i mirënjohur Hatat Mahmud efendiun. Mësoi llojet e kaligrafisë si Thuluth dhe Ta’lijk. Ishte një solist i mrekullueshëm. Mësimet në lëminë e muzikës i mori nga Kasim Pashallë Osmani. Ka komponuar vepra të ndryshme. Në veprën “Atrabular” thuhet se ka afër një mijë komponime, por deri sot kanë arritur vetëm shtatëmbëdhjetë.

Më lartë përmendëm se në këtë shekull marëdhëniet në sferën e muzikës fillojnë edhe me perendimin, në këtë konotacion kemi një muzicent nga Polonia, Alberto Bobovio Leopolitano Bobowski, i cili më vonë mer emrin Ali Ufki. Ai mësoi në Enderun, gjatë mësimëve muzikore mësoi ti bjer edhe një vegle muzikore me emrin Santur. Mer pjesë edhe në orkestrin e pallatit mbretërorë në kohën e Sulltan Ibrahimit dhe Mehmedit të katërt (1640-1648). Ai njihete disa gjuhë perendimore dhe lindore dhe në vitet e fundit punoi edhe si përkthyes i vetë Sulltanit. Komponoi forma të ndryshme muzikore, por kulminacionin e arriti me veprën e tij “ Mexhmua-i Sazu Soz”, në vitin 1650, ndërsa vdiq në vitin 1675.



SI TU FLASIM FËMIJËVE TANË PËR ALL-LLAHUN XH. SH.*

Mr. Rejhan Neziri

Muhammedi a.s. si një peygamber që fillimisht është dërguar në një shoqëri ku vajzat e vogla varroseshin për së gjalli, urdhëronte trajtimin e barabartë të fëmijëve dhe shfaqjen e dashurisë së njëjtë, si ndaj djemve ashtu edhe ndaj vajzave.

Njeriu vetë në Islam quhet si "ahsen-i takvim" (qenie e krijuar në formën më të bukur), po i tillë do të konsiderohet, normalisht edhe fëmija apo i vogli i njeriut. Andaj edhe për fëmijët flitet si në Kur'an ashtu edhe në Sunnet. Kurse Omeri r.a., ishte ai që në cilësi të kryetarit të shtetit islam (halif), fëmijëve deri në moshën madhore u kishte lidhur nga një pagë prej 100 dirhemësh.

1. Vlera e fëmijëve në Kur'an

Kur'ani thekson se prindërit nga brendia dhe që nga lindja ndiejnë një dashuri dhe ngrohtësi ndaj fëmijëve. Kjo kuptohet nga ajo që disa herë në vend të fjalës "fëmijë", Kur'ani e përdor fjalën "kurratu ajnin" (loçkë, burim ngushëllimi e gëzimi, qetësi e syve), e në disa vende të tjera e shpreh atë vajtimin dhe vuajtjen e hz. Jakubit ndaj të birit të tij të humbur Jusufit dhe qorrimin e tij për të. Po edhe ajetet që flasin për gjendjen shpirtërore të nënës së Musait a.s. kur ajo detyrohet ta hedhë të birin në lumin Nil. Pastaj flitet edhe për djelmoshat e Xhennetit, të cilët i përshkruan si „margaritarë të derdhur“. Në Kur'an drejtpërdrejtë për fëmijët flasin 297 ajete, kurse ajetet që në mënyrë indirekte flasin për fëmijët arrin shifrën prej 342 sosh. Në raportet baba – fëmijë, Kur'ani thuhet gjithnjë e shpreh fjalën „bunejje“ (biri im).

2. Vlera e fëmijëve në Sunnet

Si rahmet për mbarë njerëzimin, në planin edukativ të fëmijëve, Muhammedi a.s. në fillim e çrrënjosi trajtimin jo të barabartë midis djemve e vajzave, e pastaj e ndaloi mallkimin e fëmijëve dhe përmes hadithit „Kush nuk tregon dhembshuri e rahmet ndaj më të vegjëlve tanë, ai s'është prej nesh“ e ka mbjellë në shoqëri dashurinë dhe ngrohtësinë shpirtërore ndaj fëmijëve.

Kur po ndërronte jetë djali Ibrahim (deri sa akoma pinte gjë prej nënës së tij), Muhammedi a.s. e merr në gjoks dhe e puth, ndërsa sytë i rridhnin lot. Abdurrahman bin Afi e pyet: "A edhe ti po qan, ja

“

Ajeti kur'anor që thotë se: "All-llahu është Ai i Cili ju krijoi ju (në një gjendje) të dobët (e nevojtarë për ndihmën e të tjerëve...)", sot vërtetohet edhe nga shkencën e pedagogjisë dhe e psikologjisë se: "fëmija ka nevojë për kujdes dhe mbrojtje të të tjerëve".

Resulallah?". Ai i tha: "Ky vajtim vjen nga mëshira e dhembshuria. Sytë qajnë, kurse zemra është e dëshpëruar, mirëpo ne e themi vetëm atë me çka do të jetë i kënaqur Krijuesi ynë. Ibrahim, ne jemi shumë të dëshpëruar që po ndahesh prej nesh!".

Kur një beduin e sheh Pejgamberin a.s. se si ai i puth fëmijët, si me ironi e pyet Pejgamberin a.s.: "Do me thënë, ju po i puthkeni fëmijët, hë?! ... Ne, ne nuk i puthim asnjëherë". Pejgamberi a.s. i përgjigjet: "Çfarë të bëj unë nëse Zoti ta ka shkulë nga zemra mëshirën e dhembshurinë?".

Ai shpesh i puthte, i ledhatonte fëmijës, i merrte në krah apo edhe në prehër, bënte shaka me ta, luante me ta, i bartte në shpinë madje dhe në namaz...

Kur një ensari e kap fëmijën e quajtur Rafi' bin Amër se si ky po i shkund me gurë hurmat e tij, e sjell te Pejgamberi a.s. dhe i ankohet për këtë veprim, Muhammedi s.a.w.s. i drejtohet Rafiut duke i thënë: "Or bir, pse po i shkund me gurë hurmat e zotërisë?", Ai i përgjigjet: "Isha i uritur, ja Resulallah, dëshiroja ta ngopja barkun". Atëherë Muhammedi a.s. i thotë: "Edhe një



herë kur të të hahen hurma, mos i gjuaj me gurë, porse mblidh prej atyre që kanë rënë poshtë dhe haji!". Pastaj, duke ia ledhatuar kokën Rafiut bëri një dua për të: "O Zot, fryja barkun këtij fëmije!".

Në një rast ai shprehet kështu: "Disa herë bëj nijet ta fali gjatë namazin, mirëpo kur e dëgjoj vajtimin e ndonjë foshnje, e shkurtoj atë, me qëllim të mos i jap siklet nënës së fëmijës".

Edhe pse krahas ajeteve kur'anore edhe vetë ai ishte që ua tërhiqte njerëzve vërejtjen për hushu (koncentrim dhe përkushtim) në namaz, mirëpo kur ishin në pyetje fëmijët, ai tregonte një mirëkuptim dhe tolerancë të jashtëzakonshme: i bartte në shpinë, i ulte, i lëshonte...

B. Rëndësia e familjes në edukimin fetar

Ajeti kur'anor që thotë se: "All-llahu është Ai i Cili ju krijoi ju (në një gjendje) të dobët (e nevojtarë për ndihmën e të tjerëve...)", sot vërtetohet edhe nga shkencën e pedagogjisë dhe e psikologjisë se: "fëmija ka nevojë për kujdes dhe mbrojtje të të tjerëve".

Muhammedi a.s. thotë: "Secili fëmijë lind në fitrah (i pastër dhe me prirje për ta pranuar të vërtetën), e

pastaj prindërit e tij e bëjnë hebre, ose krishter ose mexhusijj (zjarrputist), e nëse prindërit e tij janë muslimanë, ai bëhet musliman".

Sipas studimeve psiko-pedagogjike, institucioni i vetëm në moshën e fëmijërisë që fëmijën e drejton rrugës për t'u bërë njeri, është familja. Po ashtu, sipas këtyre studimeve, është përcaktuar raporti midis familjes dhe fesë dhe janë radhitur – sipas rëndësisë – faktorët më relevantë në formimin fetar të fëmijës: 1. familja, 2. idetë e vetë personit fëmijë, dhe 3. shkolla (arsimimi).

Një karakteristikë e kësaj moshe të re të fëmijëve është **imitimi**. Ata si zakonisht brenda familjes e imitojnë babanë dhe nënën si dhe anëtarët e tjerë, nëse ka. Prandaj edhe mbjellja dhe ngjallja e ndjenjave fetare te fëmijët e kësaj moshe është shumë me rëndësi. Shpesh mund të vërejmë se si fëmija i moshës 3-4- vjeçare, në fillim e shikon babanë ose nënën se si ata falin namaz, i vështron mirë ata e më pastaj mundohet të bëjë sikurse ata, të imitojë faljen e namazit, shtrimin e sexhades, heqjen e tesbihëve, ngritjen e duarve për dua etj.

Prandaj, kjo moshë është shumë

vendimtare për edukimin fetar të fëmijës, dhe nga kjo varet nëse nesër fëmija pasi ta kalojë periudhën e fëmijërisë e të futet në periudhën e rinisë, do ta braktisë fenë me gjithë çfarë ka, apo do t'u kapet edhe me shumë parimeve të saj.

C. Ndjenjat kryesore me rastin e arsimimit të besimit në Zot

Sipas psikanalizës, e cila ndër të tjera i studion ndjenjat dhe paraqitjen si dhe zhvillimin e tyre, te njeriu ekzistojnë dy ndjenja kryesore: ndjenja e dashurisë dhe ndjenja e lidhshmërisë (varësisë).

Po edhe imani në fakt është një koncept që në të njëjtën kohë e përfshinë edhe shpresën edhe frikën.

Psikologët thonë se zhvillimi sentimental (ndijimor) te fëmijët paraqitet më herët se ai racional apo mendor. Një fëmijë më shumë e do atë që ia ka shprehur dashurinë më parë, sesa ndonjë person tjetër, sado i rëndësishëm të jetë ky i fundit. Andaj edhe duhet përfutur zemrën e tyre (e jo mendjen fillimisht), te ajo zemër duhet futur dashurinë, besueshmërinë, shpresën dhe lidhshmërinë.

D. Parimet kryesore gjatë mësimit të besimit në Zot

Qysh në fillim duhet thënë se disa parime të edukimit të përgjithshëm, si: shmangia nga kërcënimi, kritika, krahasimi kundërshtar, nxitja e xhelozisë etj., vlejnë në të njëjtën kohë edhe për edukimin fetar, gjegjësisht në mësimin e besimit në Zot.

Psikologët e fesë thonë se fëmija ballafaqohet me fenë që nga mosha 2 vjeçare, kurse pas moshës 3-4 vjeçare përmes pyetjeve "si dhe pse?" fëmija fillon ta mësojë bazën e sendeve, ndaj edhe fuqinë krijuese të Zotit.

Këto njohuri të shkurta na bëjnë me dije edhe një herë se te fëmija ekziston ndjenja dhe mendimi fetar, ndaj dhe me vete e bartin pyetjen se si të kanalizohen këto ndjenja e mendime, çfarë edukimi fetar na nevojitet. Sot pra nuk bisedohet më rëndësia dhe ndikimi që ka feja në jetën e njeriut dhe të fëmijës, kjo pyetje nuk parashtrohet më. Mirëpo sot diskutohet se cilat metoda e mjete duhen përdorë gjatë edukimit fetar, e sidomos gjatë mësimit të besimit në Zot. Besimi apo imani është një çështje shumë delikate, andaj edhe duhet pasur kujdes të veçantë se si i plasohet dhe i servohet fëmijës.

Për këtë, nga ana e pedagogëve dhe psikologëve të fesë, parashihet të ndiqen këto parime bazë:

a. Të merret për bazë dashuria ndaj All-llahut xh. sh.

Një prej parimeve të Islamit është që fëmijët të trajtohen me dashuri në çdo kohë e në çdo situatë. Sidomos në mësimin e imanit duhet ndjekur një metodë mësimore që mbështetet në dashuri, sepse siç

pamë më lart, një prej ndjenjave bazë të fëmijës është edhe ndjenja e dashurisë, e shpresës dhe e lidhshmërisë. Andaj edhe gjatë mësimit të parimeve të fesë duhet përdorur këto ndjenja fisnike, sepse kjo i jep fëmijës gëzimin e papërshkrueshëm pse ai jeton.

J.J. Rousseau lidhur me këtë thotë: "Ndjenja e parë e një fëmije është që ai ta dojë vetveten. Ndjenja e dytë që lind nga kjo e para është t'i dojë ata që i afrohen atij..."

Njeriut, për nga natyra dhe psikologjia e tij, i pëlqejnë sjelljet e buta, fjalët e mira dhe gjuha e ëmbël. Këtë na e bën me dije edhe ajeti kur'anor në të cilin All-llahu i drejtohet Muhammedit a.s. me fjalët: "Ti ishe i butë ndaj tyre, sepse All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të kishin hequr dorë prej teje..." (Alu Imran, 3:159).

Ajo çka si një gabim i madh shpesh bie në sy është frika e pavend që krijohet te fëmija ndaj Zotit. Një psikiatriste turke thekson se viteve të fundit në klinikat psikiatrike të fëmijëve është rritur dukshëm numri i pacientëve. Simptomat e shfaqura tek ata janë: ndjenja e shqetësimit të thellë, bërtitja, vajtimi, goditja e thyerja e sendeve... Në bazë të analizave të tyre ka rezultuar se faktori kyç që ka ndikuar në paraqitjen e çrregullimeve të tilla ka qenë doza e tepruar e "frikës nga Zotit".

Forma më e shpeshtë se si po mbillet gabimisht frika ndaj Zotit ndodh në periudhën kur fëmija dëshiron të sillet i pavarur e nga ana tjetër prindërit besojnë që fëmija duhet të sillet sipas dëshirave të tyre dhe kur insistimi i tyre në këtë drejtim, edhe përsëri kërcënimeve e dënimeve, shkon huq e nuk pi ujë, atëherë ata mundohen ta fusin në kokën e fëmijës frikën ndaj Zotit me fjalët: "Ai fëmijë që nuk e dëgjon nënën e vet, Zoti e bën gurë", "Ai që e braktis ushqimin në pjatë, Zoti do ta djegë në Xhehennem", "Ai që thotë fjalë të ndyta e të këqija, Zoti e bën memec, të pagojë"...

Në disa familje zhvillimi i vetëdijes dhe ndërgjegjes nuk bëhet përmes marrjes model të prindërve me sjelljet e mira të tyre, porse përmes frikës prej Zotit dhe përmes presioneve fetare, duke i thënë se All-llahu e shënon në defter (fletore) çdo gabim që bëhet dhe se për këtë do ta dënojë në zjarr. Një rast i këtillë është shënuar në klinikën që u përmend më lart me një fëmijë të përmend më lart me një fëmijë të moshës 3 vjeçare që tregonte çrregullime në sjelljet e tij. Pas analizave të kryera, konstatohet se gjyshi i fëmijës sa herë kur ka dashur ta largojë fëmijën nga ndonjë veprim i padëshirueshëm, e ka frikësuar atë me dënimin e Zotit.

Pedagogia Bejza Bilgin thotë: "Kur isha e vogël, Zotin ma paraqitnin (prezantonin) si një qenie prej së cilës duhet frikësuar gjithnjë, duke më thënë: Zoti shikon çdo gjë që e bën ti, prandaj nëse rren e

mashtro, Zoti të nëm e të mallkon. Unë duke i dëgjuar shpesh dhe vazhdimisht këto fjalë, zura të mendoj se Zoti është një qenie që di vetëm të dënojë. Mirëpo më vonë pasi u rrita e kuptova se puna nuk ishte ashtu, porse këto fjalë ata m'i kishin thënë për të më heshtur mua ose për mos i shqetësuar ata."

Pedagogët dhe psikologët e fesë thonë se është gabim që fëmija të edukohet duke e frikësuar atë me Zotin apo me dënimin e Zotit, sepse kjo shkakton trauma të paparashikueshme për fëmijën dhe mund të lërë pasoja të rënda për në të ardhmen. Para së gjithash te fëmija përveç frikës ndaj Zotit, krijon edhe një hidhërim e zemërim ndaj Tij.

Kjo nuk do të thotë që fëmijës nuk duhet përkujtuar frika e të mos i zihet fare në gojë, sepse kjo shkakton një kundërefekt tek ai dhe e lazdron atë tej mase, mirëpo duhet qenë i matur dhe në plan të parë gjithnjë të vjen dashuria ndaj Zotit e jo frika ndaj Tij. Tekfundit vetë Zoti shprehet se "mëshira ime ia ka tejkualuar hidhërimin e zemërimin Tim".

Sipas pedagogëve të fesë, fëmijëve Zotin duhet prezantuar më shumë si një Qenie që do, që mbron, që ka mirëkuptim e tolerancë, që fal gabimet, që më shumë shpërblen sesa dënon. Pra ky mendim pozitiv ndaj Zotit duhet të vjen në shprehje më tepër.

Nëse bash duam ta përmendim dënimin e Zotit, atëherë në rast gabimi te fëmija, atij duhet thënë se Zoti njeriun nuk e dënon menjëherë, porse i njuh pak kohë për t'u penduar nga gabimi... Për më tepër pedagogët preferojnë që për frikën ndaj Zotit fëmijëve të fillohet t'u flitet vetëm pasi ata t'i mbushin 10-11 vjet, që në fakt është edhe mosha kur te fëmija fillon të zhvillohet ndërgjegjia dhe është mosha kur mjaftueshëm është kompletuar edhe zhvillimi mendor i cili ndihmon në të kuptuarit më të lehtë të koncepteve: drejtësi-padrejtësi, faj, dënim, sevap, shpërblim, mëkat, xhennet, xhehennem...

b. Të sillemi me tolerancë e mirëkuptim ndaj fëmijëve

Muhammedi a.s. është simboli i mirëkuptimit dhe tolerancës, dhe këtë e ka shprehur sidomos ndaj fëmijëve, madje siç thamë, edhe në momentet kur kërkohet hushuja, koncentrimi më i madh, pra nmë namaz...

Gjatë zhvillimit të tij mendor dhe gjatë zgjimit të ndjenjës fetare tek ai, fëmija herë-herë parashtron pyetje interesante, herë-herë të pakuptimta po madje herë-herë edhe jo të përshtatshme fetarisht lidhur me Zotin. Në këtë rast menjëherë duhet përkujtuar fjalë e Muhammedit a.s. se "fëmijët deri në moshën madhore nuk janë përgjegjës për punët e fesë..." dhe nuk duhet kritikuar fëmijën me ashpërsi të vrullshme.

Këtë tolerancë që Islami ua njuh fëmijëve, duhet përdorë drejtë e në

kohë të drejtë. Sidomos kur janë në pyetje disa të meta e gabime të lehta të cilave nuk u ikin dot as edhe të rriturit, nëse këto i bëjnë fëmijët, atyre nuk duhet thënë se keni bërë mëkat, gjynah.

Për ne me rëndësi është ta përmendim edhe faktin se njëri prej emrave të Zotit është edhe *Halim* (i Butë ndaj robërve të Tij) dhe se kur e urdhëron Musain e Harunin për te Faraoni, i cili ishte zullumqari më i madh në tokë, pasi ai e konsideronte veten për zot, u thotë: "Shkoni që të dy te faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij thuani fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet" (Taha, 20: 43-44).

Me këtë rast mund të bashkohet fjala e Muhammedit a.s. me të cilën ai e ndalon ndërhyrjen e menjëhershme te fëmija kur ai bën ndonjë problem me mendimet e pedagogut më të madh të Perëndimit, J.J. Rousseau-së: "...kur të kenë dëshirë, fëmijët duhet të shpërthejnë, të vrapojnë e të bërtasin. Sepse këto sjellje të fëmijës, janë nevojë e trupit që po zhvillohet e forcohet. ... Gjithnjë të keni respekt e mirëkuptim ndaj lojërave, dëfrimeve e instinkteve të këndshme të fëmijës."

Edhe Ibni Halduni thotë që nëse jemi të ashpër me rastin e korrigjimit të gabimeve që i bën fëmija, kjo do të shkaktojë dëm te ai e jo dobi. Këto korrigjime e përmirësime duhen bërë duke ia fituar zemrën dhe duke u sjellë me butësi ndaj tij.

Sipas kësaj pra, si në rastet tjera, ashtu edhe në rastin e mësimit të imanit, ndaj fëmijëve duhet sjellë me tolerancë e me butësi. Për shembull, një fëmijë që shpreh fjalë jo të hijshme nga aspekti fetar e moral, menjëherë nuk duhet kritikuar ashpër e të dënohet, porse në vend të kësaj atij duhet sqaruar me një gjuhë që e kupton ai se ato fjalë nuk janë të mira, se janë jo të hijshme për njeriun...

Mirëpo, kur është në pyetje toleranca, nuk duhet tejkualuar dozën edhe këtu, sepse kjo shkakton lazdrimin e fëmijës, ndërkaq lazdrimi i fëmijës ka efekte edhe më të rënda. Me këtë ai e humb besimin ndaj vetvetes dhe, meqë gjithçka po e fiton lehtë e pa vështirësi, fillon të besojë se njerëzit tjerë janë një mjet i thjeshtë që i shërbejnë këtij për realizimin e qejfeve të tij. Ndërkaq kjo do të thotë që ai ta humbasë respektin edhe ndaj vetvetes po edhe ndaj të tjerëve.

c. Parimi i përshkallëzimit (suksesivitetit)

Në mësimin e besimit në Zot, pas parimit të dashurisë e tolerancës, një parim tjetër që duhet pasur parasysh është edhe përshkallëzimi, suksesiviteti. Në pedagogji nuk diskutohet më çështja e ndjekjes së metodës "nga më e lehta drejt më të rëndës". Në fakt edhe Kur'ani e Sunneti e ndjekin dhe e porosisin e rekomandojnë këtë metodë.

Qysh nga mosha kur fëmija fillon

të parashtrijë pyetje për Zotin, atij duhet dhënë përgjigje të sakta, të hapura, të kuptueshme, serioze e larg shakave dhe larg dyshimeve. Këtë na porositi edhe Muhammedi a.s. në shumë hadithe të tij, ndër të cilat edhe këto: „Trajtoni njerëzit sipas nivelit të tyre“, „Flituni njerëzve aq sa ata të mund t'ju kuptojnë“, „Lehtësoni e mos vështirësoni, jepni myzhdë e mos mbillni zemërim e pesimizëm“. Mutesavvufi (mistiku) i njohur Sehl b. Abdullah et-Tusteriu (v. 237 / 886) ka thënë: “Isha nja 3 vjeç. Natën zgjohesha dhe e shikoja dajën tim se si falej. Një ditë mu kthye dhe më tha: ‘A s’po e përmend Allahun?’ Unë i thash: ‘Si ta përmend?’ Ai më tha: ‘Kur të shkosh të flesh, pa e lëvizur gjuhën, me zemër thuaj 3 herë: ‘All-llahu është dëshmitari im, Ai është me mua dhe më sheh mua’. Unë disa net me radhë e përsërita këtë dhe për këtë e njoftova dajën tim, kurse ai më tha: ‘Tash e tutje përsërite nga 7 herë’. Pasi kaluan disa net përsëri më tha: ‘Tash e tutje thuaj nga 11 herë’. Fillova ta ndiej në zemër ëmbëlsinë e kësaj fjale. Pasi kaloi një vit, daja më tha: ‘Ato fjale që t’i mësova mbaji mend mirë dhe thuaj deri sa të shkosh në varr. S’ka dyshim se këto do të sjellin dobi edhe në dunja edhe në ahiret’. Unë vazhdova kështu me vite të tëra. Kësaj radhe fillova ta ndiej ëmbëlsinë e kësaj fjale në botën time të brendshme. E më pas, daja im më tha: ‘O Sehl, a i ka hije një personi të bëjë mëkat, nëse Zotin e ka dëshmitar, i cili Zot e sheh dhe është bashkë me të?’. Metoda e shkallëshkallshmërisë duhet ndjekur edhe në mësimin e parimeve të besimit, një herë *Kelimetu’t-Tewhidin*¹, pastaj *Kelimetu’sh-shehadetin*², pastaj *Kushtet e Islamit*, pastaj *Kushtet e Imanit*...

Një metodë e mirë për mësimin e këtyre parimeve është edhe forma “**pyetje – përgjigje**”. Shpesh nëpër familjet tona ndodh që gjyshi apo gjyshja t’i mbledhë nipat e mbesat dhe i pyet: “Sa zota ka?”, fëmijët të gjithë një zërit thonë: “Njëëë!”, “Rob të kujt jemi ne?”, “Të All-llahut”, “Ummet i kujt jemi ne?” – “Ummet i Muhammedit a.s.”, “Si quhet feja jonë?” – “Islam”...

ç. Të merret parasysh faktori kohë dhe vend

Me rastin e edukimit fetar një prej çështjeve që duhet marrë në konsideratë është edhe faktori kohë dhe vend. Kjo do të thotë që për këtë qëllim duhet shfrytëzuar edhe ditët e premtë (të xhumaja) dhe bajramet si dhe netët që karakterizohen me ndonjë vlerë të veçantë fetare si nata e mi’raxhit, e beratit, e kadrit etj. Në këto kohë fëmijës duhet sjellë ndonjë dhuratë apo diç që ngjashme me çka do t’i tërhiqet vëmendja fëmijës se këto janë kohë e raste të veçanta. Do të ishte mirë që këto dhurata vetë të kenë ndonjë tipar, shenjë apo karakter fetar. Me këtë

fëmijës do t’i përgatitet terreni për të parashtruar pyetje rreth dhuratës po edhe rreth ditës apo natës për çka i është sjellë dhurata. Kjo ka ndikim të madh në vetëdijen e fëmijës.

Përpos faktorit kohë, edhe faktori i vendit është shumë me rëndësi. Sidomos xhamia dhe atmosfera e saj kanë një efekt të veçantë mbi fëmijën. Të merren ata përdore duke i pastruar e veshur solemnisht, të prezantojnë në faljen e namazit me xhemat, si në xhuma, bajram e teravi, të dëgjojnë ezanin e ikametin, po Kur’anin dhe salavatet e sidomos duatë, është një ndjenjë e papërshkrueshme për fëmijën që s’e harron lehtë.

Nëse e marrim parasysh situatën e muslimanëve këtu në Perëndim ku shumica e xhamive janë thjesht vetëm mesxhide, pa minare e kupola, pa ezan që thirret përmes minares..., duhet organizuar shëtitje të veçanta ose familjare ose grupore nëpër vendet ku ka xhami të mirëfillta dhe duhet treguar atyre pjesët e brendshme dhe të jashtme të një xhamie si dhe funksionet e tyre; nëpër shtëpi është mirë të gjenden orë që në kohë të caktuara e thërrasin ezanin; në këto net e ditë të mëdha të dëgjoen bashkërisht me të gjithë anëtarët lexim Kur’ani dhe ilahije, të shikohen njësoj edhe filma apo programe me karakter fetar dhe me këtë rast t’u sqarohen fëmijëve disa nga elementet më interesante e më atraktive për zgjimin e vetëdijes fetare te fëmija. Prindit dhe përgjithësisht të rriturit këto mund t’i duken si sende të pakuptimta e të pavlerë, mirëpo për botën fëmijërore kanë një kuptim e domethënie të madhe e të pamohueshme, çka do të vazhdojë të rrijë e freskët gjatë kohë në kujtesën e fëmijës...

d. Fëmijës t’i ofrojmë karakter shembullor dhe ideal

Fëmija i moshës parashkollore, i cili tregon prirje për imitim dhe kopjim të sjelljeve e lëvizjeve të më të rriturve, para së gjithash ka nevojë edhe për një model që do ta imitojë deri në imtësitë më të vogla. Prandaj, modelin më të mirë e më pozitiv, mund ta ofrojnë vetë babai dhe nëna e fëmijës. Për atë, në fillim, babai është njeriu më i fuqishëm, më i mençur, më i suksesshëm në botë, kurse nëna gruaja më besnike, më e butë, më e dashur e më e ngrohtë në botë. Këto ndjenja e mendime që fëmija i ka ndaj prindërve të tyre duhet shfrytëzuar maksimalisht për procesin edukativ fetar. Nëse prindërit presin që fëmija i tyre nesër të ketë edukatë fetare e t’i manifestojë në jetë mësimet më sublimë të Islamit, ky Islam e këto mësimet duhen jetësuar në përditshmërinë e babait dhe nënës. Në një familje ku nuk ushtrohet dhe praktikohet asnjë nga mësimet dhe porositet fetare, aty nuk pritet që fëmija të del i edukuar fetarisht. Thjesht nga fakti se jeta nuk pranon e nuk njih zbrazëtitirë. Nëse nuk e mbush me fe e me atmosferë fetare, do të mbushet me pafesi e me sjellje

tjera që bien ndesh me mësimet e fesë në fjalë.

Fëmija i kësaj moshe ka nevojë të marrë shembull e model më trimin, më bujarin, më fisnikun, më të mençurin, më... më... më... Prandaj, një rol të veçantë në këtë drejtim luajnë edhe tregimet apo përrallat me karakter fetar, si historia e pejgamberëve, historia e Muhammedit a.s. dhe e shokëve të tij fisnikë, ngjarjet e rëndësishme historike ku ndonjë musliman i mirë luan rolin kryesor dhe më të ndershëm, më fisnik e më guximtar, që fëmijës do t’i shërbejë si model, ai të lakmohet pas njeriut trim, fisnik, të drejtë e të ndershëm, me çka në fakt ai pa hetuar do të lakmohet pas vetë vlerës së trimërisë, drejtësisë, ndershmërisë etj....

Tekste me karakter të këtyllë pedagogjik fetar, të përgatitur sipas grupmoshave të caktuara, për fat të keq në gjuhën shqipe gjenden shumë rrallë, nëse jo edhe aspak. E kjo do të thotë se mungon edhe leximi i tregimeve apo përrallave të këtylla para se fëmija të shkojë në shtrat, me çka do të kishte përfituar një qetësi të madhe shpirtërore...

e. Duhet shfrytëzuar egocentrizmin e fëmijës

Sipas psikologjisë së zhvillimit të fëmijës, vitet 2-6 janë vitet kur fëmija, nga aspekti i aftësive mendore, e jeton atë që quhet ‘egocentrizëm’. Është periudha kur ‘fëmija e zbulon mjedisin e tij, kur ai beson se ky mjedis e rreth është krijuar vetëm për të e për t’i shërbyer atij dhe kur ai nuk i përfill njerëzit e tjerë’. Me këtë, fëmija vetveten e sheh në qendër të bisedës, të lojës, të dashurisë... Pra, sipas fëmijës së kësaj moshe, gjithçka tjetër sillet e mbështillet rreth tij. Një formë tjetër e kësaj ndjenje të egocentrizmit është edhe finalizimi, sipas së cilës gjithçka e ka qëllimin e vet pse është apo pse vepron ashtu siç vepron: Dielli shkëlqen për të ndriçuar dhe ngrohur, lumi për të lundruar me anije mbi të...

Ndikimi i këtyre ndjenjave vazhdon edhe për shumë vite te fëmija, prandaj është shumë me rëndësi të shfrytëzohet kjo ndjenjë edhe në edukimin fetar të tij. Atij duhet sqaruar se gjithçka që gjendet rreth tij, All-llahu e ka krijuar për t’i shërbyer atij (fëmijës). Me këtë rast ajetet që flasin për këtë të vërtetë do të jenë shumë domethënëse në këtë drejtim. Për shembull: “All-llahu është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën, dhe Ai lëshoi prej së larti ujë (shi), e me të nxjerr fruta si ushqim për ju, dhe për të mirën tuaj u vuri në shërbim anijet, të lundrojnë nëpër det me urdhrin e Tij, e në shërbimin tuaj i vuri edhe lumenjtë. Për ju nënshtroi diellin dhe hënën që në mënyrë të zakonshme vazhdimisht udhëtojnë. Për ju përshtati edhe natën e ditën” (Ibrahim:32-33). Të këtylla janë dhe ajetet 10-17 të sures en-Nahl (16).

Përpos kësaj, fëmijëve të kësaj moshe duhet thënë se All-llahu

xh.sh. i do krijesat e Tij, dhe se më shumë prej të gjithëve i do fëmijës, i mbron dhe i ruan nga të ligat. Këto fjale e të ngjashmet ia lakmojnë shpirtin fëmijës.

Atij duhet thënë se Zoti na ka dhënë shumë të mira sa ne nuk mund t’i numërojmë, se Ai nuk na dënon menjëherë për gabimet tona, porse Ai pret që ne të pendohemi për to, dhe se për punët e sjelljet e mira ai na shpërblen shumëfish...

Është e vërtetë se fëmija ka dëshirë e tij fëmijërore që ai dëshiron t’i plotësojë, andaj edhe në këtë drejtim duaja (lutja) luan një rol shumë vendimtar. Përmes duave, fëmija qetësohet e relaksohet shpirtërisht. Në fillimi fëmija nuk mund të bëjë dallimin se ç’mund të lypet prej Zotit drejtpërdrejtë, andaj edhe pa pra mund të bëjë dua: “O Zot, ma jep këtë e atë...”. Më vonë ai zhvillohet pak dhe fillon ta kuptojë duanë pak më ndryshe, si në shembullin e mëposhtëm:

“Një fëmije të klasës së parë nëna e tij i kishte thënë t’i bëjë dua Zotit dhe t’i lutet për çfarëdo që të ketë qejf. Fëmija që moti kishte pas dashur një lodër aeroplani elektronik. Këtë dua ja se si ia shfaq nënës së vet: “Unë e di se Zoti nuk do të ma hedhë këtë aeroplan nga qielli, mirëpo mund që në zemrën tënde ta japë dëshirën: ‘T’ia marr fëmijës tim një aeroplan elektronik’, dhe ti do të ma blesh”.

Ashtu siç mund të shihet, fëmija duanë e sheh si një mjet për realizimin e dëshirave të tij egocentrike. Këtu me rëndësi është që fëmija të mësohet t’i lutet vazhdimisht Zotit, ta bëjë shprehi këtë, qoftë edhe për sende të këtylla fëmijërore, sepse kjo do ta mbajë atë në kontakt të përhershëm me Zotin. Është shumë mirë t’i mësohen disa dua e lutje dhe këto t’i lexojë veçanërisht para se të shkojë në gjumë, ndër të tjera edhe kjo: “O Zot, më ruaj mua, babanë tim, nënën time, vëllezërit dhe motrat e mia dhe të gjithë besimtarët!”, dhe t’i bëhet me dije se pasi ta ketë lexuar këtë dua atë dhe familjen e tij do ta kenë mbrojtur tërë natën melekët që do të qëndrojnë gjithnjë pranë tyre...

* Kjo është një ligjëratë që e kam mabjtur në tribunën fetare në xhaminë e Rorschachut më 06.10.2007. Për këtë jam mbështetur kryesisht në këto dy vepra të profesorëve të mi të nderuar: Dr. Mehmet Emin Ay, *Çocuklarımızın Allah’ı Nasıl Anlatalım* (Si t’ua sqarojmë fëmijëve tanë All-llahun), Stamboll, 1994 dhe Dr. Mustafa Öcal, *Din Eğitimi ve Öğretiminde Metodlar* (Metodat e arsimit dhe edukimit fetar), Ankara, 1991.

¹ Fjalën: „La ilahe il-lall-llah“ (S’ka zot tjetër pos All-llahut).

² Fjalën: „Esh’hedu en la ilahe il-lall-llah ve esh’hedu enne Muhammeden abduhu ve rasuluhu“ (Dëshmoj se nuk ka zot tjetër pos All-llahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij).

SHQIPERIA NGA SHKEPUTJA ME SHTETIN OSMAN, DERI NE DEBIMIN E ISMAIL QEMALIT

Shteti te cilin Ismail Qemali e shpalli si te pavarur ne fund te 1912, dhe qe iua beri te ditur fuqive te medha nepermjet telegrafit, do te gjente jehone vetem ne Vjene dhe Rome, pasiqe Italia dhe Austria kishin interesat e tyre per krijimin e nje shteti shqiptar. Nderkohe konferenca e ambasadoreve qe u mbodh ne Londer me 7 Dhjetor 1912, e njohu Shqiperine si shtet autonom nen Osmanet.

Me marrjen e autonomise se Shqiperise nga osmanet, shtetet ortodokse ballkanike te cilat kishin nje shqetesim te madh mbi krijimin e mundshem te nje shteti shqiptar ne Ballkan, i coi te fundet qe ti deklarojne lufte Turqise dhe keshtu te cojne ne fillimin e luftes se Pare Ballkanike. Malazezet i deklaruan Kryqezate (lufte te Shenjte) Turqise te parët me 8 Tetor 1912, dhe nisen pushtimin e tokave shqiptare. Me 13 Tetor Greqia, Bullgaria dhe Serbia i cuan kercenime Portes se larte qe te 'rrespektonte kristjanet' e shtetit te saj apo perndryshe do te ishin ne lufte, gje qe coi te fundmen qe me 17 Tetor ti shpalli lufte Bullgarise dhe Serbise. Ne 18 Tetor, valles Panortodokse Ballkanike iu bashkangjit edhe Greqia, me lufte kunder Turqise dhe tokave shqiptare ne Ballkan. Si rrjedhoje, greket pushtuan gjate kesaj lufte Janinen, Selanikun, Sazanin, Himaren, Gjirokastren dhe Korcen. Serbet pushtuan Kosoven, etj.

Ismail Bej Qemalit nje nga deputet me influenciale shqiptare ne parlamentin osman, qe ne kete kohe po shkonte ne Stamboll per te biseduar gjendjen e krijuar me kabinetin qeveritar, iu kerkua rruges qe te takohej me princin malazez Mirko, ne Trieste. Mirkoja i kerkoi Ismailit qe te deklaronte pamvaresine e Shqiperise, duke e njohur te fundit per Mbret te saj nese ky do te njihite posedimet malazeze ne Veri te Shqiperise. Pas ketij takimi Ismaili u kthye ne Shqiperi, ku ne Durres kerkoi qe te shpalle pavaresi per tokat shqiptare qe nuk kishin rene akoma nen pushtimin panortodoks. Por popullsia e Durresit nuk e mbesheteti Ismail Qemalin dhe shoket e tij por i rrefuzoi ata si 'agjente dhe provokator'. Kjo gje e coi Ismail Qemalin me aktivistet e tij te largohen nga Durresi per ne Vlore, ku me 28 Nentor 1912 ai deklaroi Shqiperine shtet me vete.

Shteti te cilin Ismail Qemali e shpalli si te pavarur ne fund te 1912, dhe qe iua beri te ditur fuqive te

medha nepermjet telegrafit, do te gjente jehone vetem ne Vjene dhe Rome, pasiqe Italia dhe Austria kishin interesat e tyre per krijimin e nje shteti shqiptar. Nderkohe konferenca e ambasadoreve qe u mbodh ne Londer me 7 Dhjetor 1912, e njohu Shqiperine si shtet autonom nen Osmanet. Por renia e Janines ne duart e grekeve dhe Shkodra ne duart te malazezeve coi Italine dhe Austro - Hungarine qe te kerkonin largimin e trupave turke nga Shqiperia autonome me 8 Maj 1913. Ne traktatin e paqes te 30 Majit 1913, shteti Osman u detyrua qe ti njohe fuqive panortodokse Ballkanike te gjitha terroritoret qe ato ia kishin marre Turqise ne kete lufte, dhe Shqiperine ia la 'nen kujdes' Fuqive te Medha. Per kete arsye me 29 Korrik 1913 Konferenca e Ambasadoreve ne Londer vendosi qe Shqiperia te ishte nje principate autonome - nen kontrollin e gjashte Fuqive te Medha.

Si rrjedhoje, Fuqite e Medha Evropjane morren ne duart fatet e Shqiperise pas-Osmane. Per kete: një komision prej shtatë anëtarësh përfaqësues te gjashtë Fuqive te Medha dhe një shqiptar - u ngarkuan me detyren e administrimit te Shqiperise. Ky komision duhej qe të shpërndante "autoritetet ekzistuese", dmth, ndër të tjera Qeverinë e Vlorës, duhej të përpunonte një "Statut organik" dhe pastaj, të organizonte një forcë ndërkombëtare xhandarmërie për të rivendosur rendin. Sunduesi i ri i Shqiperise do te ishte një princ i zgjedhur drejtpërdrejt nga Fuqitë e Medha. Në qershor 1913, trupat e fundit turke u larguan nga Shqiperia dhe vendi ngeli pa ndonje qeveri reale. Qeveria e Vlorës nuk u njihite nga askush dhe diplomati francez Pol Kambon (Paul Cambon) e quante atë "ndërmarrje austriake".

Ne kete kaos politik e social ne vend, pushteti i Shqiperise ishte ndare ne dy zona kryesore. Ai i Durresit i udhehequr nga Esat Pashe Toptani dhe ai i Vlores nga Ismail Bej Qemal Vlora. Ndersa qarku i

qeverise se Vlores u perbente nga elemente pa ndonje peshe ekonomike dhe politike ne vend ne ate kohe si Mihal Grameno, Luigj Gurakuqi, Terenc Toci, Qamil Haxhifeza etj, qarku i Durresit u perbente nga aristokracia e Shqiperise se Mesme qe kishte force e pushtet tradicional ne vend.

Ky fakt çoi shume elemente te 'qeverise se Vlores' qe te dezertojne per ne "Qeverine e Durresit", ku Esat Pashe Toptani me 12 Tetor 1913 formoi "Pleqesine e Shqiperise se Mesme" per te administruar vendin dhe per ti treguar Komisionit Nderkombetar te Kontrollit (KNK) qe po vinte per ne Shqiperi - per te caktuar te ardhmen e saj - se kush ishte ne kontroll te vendit. "Pleqesia e Shqiperise se Mesme" perbehej nga personalitete si Mehdi Frasheri, Josif Bageri, Dervish Hima, Mithat Frasheri etj. Faik Konica merrte gjithashtu pjese dhe ishte numri dy de-fakto i kesaj pleqesie pas Esat Pashes.

Ne te njejten kohe qe ne Shqiperi vendi ishte ne kaos politik te brendshem, ne viset veriore dhe jugore te Shqiperise, forcat greke dhe serbo - malazeze po kryenin masakra te papara kunder popullit te roberuar shqiptar. Ushtrite malazeze dhe serbe qe nga vjeshta e vitit 1912 dhe pergjate luftes se Pare Boterore kishin marre masa teper represive kunder shqiptareve, duke i debuar ata, vrare, djegur e biles edhe konvertuar me dhune ne ortodoksi dhe sllavizem. Numri i shqiptareve qe u konvertuan me dhune fene nen presionin e organeve pushtuese serbe arrinte ne disa qindra. Ne Gjakove psh. u konvertuan me dhune rreth 1200 veta, ne Peje dhe rrethine rreth 10200 veta, nder te cilet nje hoxhe dhe nje dervish. Konvertime te shumta te fese pati dhe ne Plave, ne Guci, ne Rugove, ne Brane etj. Ata qe kundershtonin konvertimin ne kristjanizem zakonisht pushkatoheshin. Ne shume fshatra te komunes se Strellcit, per shkak te qendreses se shqiptareve u bene plackitje, u dog-

jen shtepi dhe u vrane shume njerëz.

Ne pergjigje te kesaj situete tragjike qe popullata shqiptare po vuante ne Ballkan me renien e Shtetit Osman, qarqet politike shqiptare ne Shqiperi dhe Turqi (komiteti i Kosovareve ne Stamboll), sebashku me ato Zhon Turke te Stambollit filluan qe te organizojne rrezistencen shqiptare per te ciluar Kosoven, Camerine dhe viset e tjera shqiptare nen pushtimin Panortodoks. Per kete nje plan Ballkanik u projektua qe do te shihte nje aleance turko - bullgare - shqiptare. Per kete pune kongresi zhonturk me 13 Gusht 1913 vendosi qe te conte ne Shqiperi si Princ te vendit ministrin Osman te luftes, Izzet Pashen - qe ishte me origjine shqiptare. Por perpara dergimit te tij ne Shqiperi, ne vend u dergua Bekir Gebrene Aga qe do binte dakort me lideret shqiptare per planin ne fjale dhe per dergimin e armatimeve dhe ushtareve shqiptar nga Turqia per reprezaljen e pergjithsme kunder pushtimit panortodoks Ballkanik. Esat Pashe Toptani, Ismail Bej Qemali dhe shume udheheqes te tjere shqiptare te kesaj kohe rane dakort ne planin e Bekirit. Megjithate luhatja e Esat Pashes pas ardhjes se Vidit ne Shqiperi - ndaj Bekir Gebrenese, e coi te fundit qe te bashkepunojte me afer me Ismail Qemalin dhe grupin e Vlores per kryengritjen e planifikuar ne Shqiperi dhe ne trevat shqiptare ne Ballkan kunder kolonizimit panortodoks. Por punet nuk hecen ashtu sic do te kishin deshiruar shqiptaret. Plani i Bekir Gebrenese deshtoi pasiqe sic flitej armiqte e Ismail Qemalit, e spiunuan planin e tyre tek konsulli serb ne Vlore, P. Gavrilovic i cili i shqetesuar nga reprezalja e mundshme shqiptare ne Kosove, Cameri etj, lajmeroi per kete plan KNK.

KNK-ja, filloi te kontrolloje anijet austriake, pas ketij spiunimi (qe ishin mbeshetese te planit kryengrites) ne brigjet shqiptare me 6 Janar 1914 me oficeret e saj hollan-

dez ku edhe u zbuluan mjaft armatime dhe ushtarë. Pas zbulimeve KNK-ja arrestoi rreth 200 ushtarë shqiptarë që qendronin te fshehur në gadishmeri per kryengritjen. E shqetesuar nga plani kryengrites i shqiptareve KNK-ja morri nje mase te gjere arrestimesh dhe pyetjesh ndaj udheheqesve militante shqiptar, nder te cilet mund te permenden Cerciz Topulli, Ismail Qemali etj, pervec Bekir Gebrenese dhe rrethit te tij te ngushte qe u arrestuan gjithashtu. Pas arrestimeve te bera, koloneli Hollandez Der Veer e denoi Bekir Gebrenese, heroin shqiptar kunder shovinizmit grek ne Janine, me vdekje: sebashku me grupin e tij te ngushte komplotues. Pervec kesaj KNK i kerkoi Ismail Qemalit qe te jape doreheqje nga kryesia ne qeverine e Vlores dhe te largohet nga vendi me 24 Janar 1914.

FATET E SHQIPERISE NE DUART E KAPTERR VIDIT

Pas Korrikut te 1913, kur Fuqite e Medha ne Konferencen e Amabasadoreve ne Londer, vendosen qe te krijonin 'Shqiperine Londineze', ceshtja kryesore qe ngeli pa u sqaruar ne tryezen e zoterinjeve koloniale evropjane ne lidhje me ceshtjen shqiptare ishte se kush do ta administronte kete vend. Shqiperia ishte vend me popullsi muslimane, me tradita dhe lidhje te forta Islame, por qe u rrethonte nga padronet e saj agresive kristjane. Pasiqe osmanet nuk kishin me fuqi qe te nderhynin ne ceshtjet shqiptare pas mundjes se tyre ne luften e pare Ballkanike, pazari mbi fatet e Shqiperise iu la ne dore dy fuqive katolike perendimore qe edhe mundesuan krijimin e Shqiperise Londineze qe te ekzistonte si 'buffer' shtet mes perendimit katolik dhe panortodoksise Ballkanike: Italise dhe Austro-Hungarise. Shqiptaret qe ne kete pazar evropjan, qe nga Nentori i 1912 ishin ne meshire te fuqive evropjane, qe ne fillim i treguan atyre se ata parashihnin qe Shqiperia si shtet me shumice muslimane qe ishte - te udhehiqej nga ndonje princ musliman.

Perpjekja per te siguruar administrimin e fatit te popullit shqiptar nga shqiptaret (musliman qe perbenin shumicen) u pa edhe ne bashkepunimin qe Ismail Qemali dhe kampi Esadist i Durrësit i ofruan Bekir Gebrenese, per te sjelle ne Shqiperi Izet Pashen si princ te vendit. Nga propagandistet me te zjarrte shqiptare qe deshen te shihnin ne Shqiperi ardhjen e nje princi musliman me origjine shqiptare, ishin njerez si Dervish Bej Bicaku, Kadri Bej Peqini, Faik Konica etj. Kerkesa qe Shqiperia te udhehiqej nga nje princ musliman ishte nje kerkese jetike e popullit shqiptar, i cili e kishte pare tashme sesi ishte fati i kompatrioteve te tyre qe kishin rene nen sundimin e mbreterive kristjane te Ballkanit. Por Austro - Hungaria dhe Italia, qe tashme kishin marre

ne duart e tyre freret e Shqiperise nuk i perfillen kerkesat e shqiptareve. Ne te kundert, fuqite ne fjale parapane keta princa te mundshem qe mund te instaloheshin ne Shqiperi per te trashегuar vendin: princ Gjika i Rumanise, duka Ferdinand i Montespierit, princi Karl von Urach, princi Maurice von Schaumburg-Lippe, konti i Torinos, princi Artur i Connaugh-it, etj.

Në dhjetor te 1913, pas shumë pazaresh me njeri tjetrin, Italia dhe Austro - Hungaria ranë dakord me ne fund për një princ qe do te 'privatizonte' Shqiperine. Ky ishte Vilhelm fon Vidi (Wilhelm von Wied) (1876-1945), qe vinte nga një shtëpi e vjetër e Renanisë, të shpronësuar nga Napoleoni. Vilhelm Vidi nje ish-kaptër në ushtrinë prusiane ishte nip i mbretëreshës së Rumanisë. Duke qene se mjerani ne fjale vinte nga nje e kaluar si kaptër, Kajseri i Gjermanise nuk e pelqeu aspak pazarin qe bente nje ish-kaptërri e tij mbret te shqiptarëve. Ne fakt edhe vete Vidi nuk kishte dashur qe ta pranonte kete pune, por pasiqe te mjerin e kishte bindur tezja dhe xhaxhai, ai e kishte pranuar postin qe iu afrua. Por sic duket qenia e Princ Vidit protestant, me karriere kaptërri, etj do tua kete lehtesuar me shume punen fuqive te medha ne heqjen dhe terheqjen e Vidit ne rastet qe ato mund ta shihnin te nevojshme. Keshtu qe finalisht më 7 mars 1914, ne një luftanije austro-hungareze te shoqëruar nga njësi të flotës Italiane, angleze e franceze Princi tragjiko-komik i shqiptareve, Vilhelm Vidi do te zbarkonte ne

Durrës per te qëndruar si princi i pare historik kristjan i Shqiperise ne historine e saj moderne. Vidi qendroi ne Shqiperi per rreth gjashtë muaj.

Qe perpara se Vidi te vinte ne Shqiperi, shqiptaret lajmin e 'privatizimit' te atdheut te tyre nga nje kaptërri i tille e priten me urrejtje, tallje dhe jo-seriozitet. Per kete ata edhe i kerkuan 'princit kaurr' qe t'u bente 'synet' e musliman nese do te donte qe tu bente Princ i Shqiperise. Ne kete arene pasigurie dhe tragjikomodie te te ardhmes se kombit shqiptar, Esat Pashe Toptani; daja i Ahmet Bej Zogollit, do te ishte perfutuesi i vetem qe do te luante me kaptërri ne fjale per qellimet e tija karrieriste. Qe kur Vidi erdhi ne Shqiperi, Esati qe e kishte vizituar Vidin edhe me pare ne Evrope e coi te fundit ne xhamine e Durrësit, per ti treguar shqiptareve se princi ne fjale ishte pro-Islamik. Politika me dyfytore e Esat Pashes, ku ne njerene u tregonte si mbrojtës i interesave shqiptare, e ne anen tjetër iu serviloste Vidit, e quan te fundit qe te caktojte Esat Pashen si minister te brendshem dhe te luftes se qeverise Vidiste.

Qeveria qe Princ Vidi themeloi ne Shqiperi pas ardhjes se tij u kryesua nga Turhan Pashe Permeti, qe me pare pati sherbyer si ambasador i shtetit Osman ne Shen Petersburg. Ne kete qeveri, pervec pjesemarrjes se elementit shqiptar, nje vend te vecante pati edhe elementi i huaj te cilet e rrethonin Vidin si keshilletare te tij, agjente etj. Per keto arsye qeveria e Princ Vidit u bë shpejt fole

intrigash ku grupet pro-Italiane u perleshnin me mafien pro-Austriake per influence. Me statusin organik qe KNK-ja i pergatiti Shqiperise nen Vidin, ku te fundit e shpalli si princ te Shqiperise me te drejte qe fronin e tij ta trashegonte, e la vendin qe te ishte pre e grabitjeve kolonialiste perendimore. Ky akt u sanksionua ne nenin 4 te statusit organik te Shqiperise, ku nepermjet tij parashihej qe vendi duhej te rrespektonte kapitulationet qe shteti Osman i pati dhene fuqive Perendimore me pare.

Nje nga aktet me kriminale qe rregjimi i Vidit kreu kunder Shqiperise kishte lidhje me problemin e kufijve te vendit. Duke pare fatet tragjike te Shqiperise ne duart te ketij kllouni, kryeministri grek Elefterios Venizellos nxiti haptas qe ne Gjirokastrë te formohej "qeveria e Vorio Epirioteve", te kryesuar nga Jorgji Zografos i cili shpalli jugun e Shqiperise si zone greke. Perballe ketij puci antishqiptar ne Jug te Shqiperise, princ Vidi dhe qeveria e tij kuislinge nuk bene asgje me shume pervecse te nenshkronin protokollin fameqej te Korfuzit (Maj 1914), sipas te cilit qeveria Vidiste iu njihte autonominë "qeverise Vorioepiriothe" te Korces dhe Gjirokastrës nen Zografon. Nen kete autonomi Greqia i morri Shqiperise nga Vidistet edhe Himaren te cilen e udhehiqte Spiro Spiromilo.

Shitja dhe copetimi, qe ish-kaptërri gjerman i beri tokave Shqiptare me 'Protokollin e Korfuzit', shkaktoi indinjatë te thelle ne qarqet patriotike shqiptare ane e



mbane vendit. Protesta shperthyen kudo ne vend kunder kesaj tradhetie kombetare qe Vidistet i bene Shqiperise, dhe hileve qe KNK-ja i beri atdheut te tyre ne favor te Greqise. Gazeta "Populli" e Sali Nivices dhe Muco Qullit si dhe gazeta "Taraboshi" e Terenc Tocit nga Shkodra i dhane nje jehone te vecante ketyre ngjarjesh maskarado qe qeveria kuislinge po i bente Shqiperise. Edhe pse Turhan Pasha nen presionin mbare popullor u mundua qe te terhiqej nga "Protokoll i Korfuzit" qeveria Vidiste finalisht e rinjohu dhe ripertieru kete protokoll antishqiptar me 23 Qershor 1914.

Ne valen e protestave kunder qeverise kuislinge Vidiste, në Maj te 1914, patriotet shqiptare te Shqipërisë së Mesme, të bindur plotesisht ne tradhetine qe "princi kaurr" po i sillte atdheut te tyre, të cënuar dhe ofenduar rende si musliman nga karakteri i krishterë i "oborrit" të Vidit, rroken armet per ti treguar Vidisteve dhe padroneve te tyre, se Shqiperia ishte atdheu i shqiptareve.

KRYENGRITJA POPULLORE SHQIPTARE KUNDER DIKTATORIT – VILHELM VIDIT

Me 17 Maj 1914, kur qeveria kuislinge e Durresit firmosi "Protokollin e Korfuzit" nepermjet te cilit Jug u Shqiperise u shpall si republike autonome greke qe do qendronte vetem formalisht nen kufijte e Shqiperise, ne Shqiperine e Mesme vullnetaret patriote tiranas te mobilizuar per mbrojtjen e vendit te tyre vendosen qe te marshonin per ne Durres nga ku ata do tu nisnin per ne jug kunder vorio-epirioleve. Por qeveria Vidiste dergoi xhandaret e saj hollandeze qe te shtypi vullnetaret shqiptaret kunder ndonje rrezistence te mundshme kunder vorio-epirioleve te Jugut. Me 17 Maj 1914 te Ura e Limuthit prane Tiranes xhandaret internacionale iu treguan forcen e armeve shqiptareve. Ky akt i hapur antishqiptar nga qeveria koloniale Vidiste beri qe ne 18 Maj 1914, populli patriot i Tiranes dhe fshatrave perreth te rrevoltohej dhe te cohej me arme ne dore ne mbrojtje te vendin. Kjo ishte data e fillimit te kryengritjes popullore shqiptare kunder administrates koloniale Vidiste. Kryengritja shqiptare kunder rregjimit kolonial te Durresit, dhe simpatia qe shqiptaret e Shqiperise se Mesme ushqenin per Esat Pashen deri ne ato momente, pasiqe ai i pati dhene atyre mjaft arme dhe municione, beri qe Princ Vidi ta deklaronte te fundit tradhtare ndaj qeverise dhe te kerkoje arrestimin e tij. Per kete arsye, naten e 19 Majit, gjenerali hollandez Tomson rrethoi shtepine e Esatit dhe pas disa bresherishe zjarri kunder shtepise se tij, mundi qe te detyroje Esatin qe te dorezohet. Megjithate Vidi nuk mundi qe te merrte ndonje hap me teper kunder Esatit, pasiqe interesat

italiane ne ate, bene te fundit qe ta dorezoje Esatin ne legaten italiane e cila me pas e coi ne Itali.

Megjithate Vidi sic duket nuk kishte arritur qe te kuptonte akoma se me arrestimin e Esat Pashes ai nuk mund te shtypte kryengritjen e popullit shqiptare kunder rregjimit te tij kolonialist. Shqiptaret qe tashme kishin marre nen kontroll Tiranen pas incidentit te Ures se Limuthit, po e shihnin fare qarte se per ke po punonte rregjimi i Vidit, i cili ruhej nga austriake, italiane, romune dhe hollandezet. Nga propaganduesit kryesor kunder rregjimit te Vidit ne kete kohe mund te permendim gjeneralin shqiptar Arif Hikmetin (nga Kalkandelet), myftiun e Tiranes Musa Qazimi, Mustafa Ndroqin, patrioti i shquar dhe mbeshetesi i Ismail Qemalit ne Vlore - Qamil Haxhifeza nga Elbasani etj. Shqiptaret tashme duke pare fatin e Durresit, ku Vidi pati vene si kryebashkiak te tij sekretarin serb te Peshkopit te Durresit: Gjurakovicin, e kuptuan qarte se rregjimi Vidian nuk ishte tjetër gjë vetem se nje pushtim pankristjan i Shqiperise. Zera mes shqiptareve e shikonin Vidin jo vetem si jo-shqiptar, por pati nga ata qe thonin se ai ishte cifut, qe kishte per qellim shkaterrimin e Islamit, gjë qe i rrevoltoi jashte mase shqiptaret.

Lajmet qe spiunet e shqetesuar te Vidit conin ne Durres per ngjarjet e Tiranes, e cuan te fundin qe te kerkoje ti shtypi kryengritesit shqiptare me dhune. Per kete ne 20 Maj, majori Roelfsema morri nje grup malesoresh nen Isa Buletin qe te pushtonin kodrat e Rrashbullit. Ndersa gjenerali Saar me 200 xhandare hollandeze, 300 malesore nen udheheqjen e Simon Dodes sebashku me kolonjarin Bajram Fevziu iu drejtuan Tiranes. Por kur malesoret arriten ne Shijak dhe kuptuan arsyen e rekrutimit te tyre qe ishte lufte kunder shqiptareve - i treguan gjeneralit Saar se ata nuk do te luftonin kunder vellezerve te tyre. Megjithate gjenerali Saar vendosi qe te marshoje drejt Tiranes me xhandaret e tij hollandez. Por sapo doli nga Shijaku, ai u ndesh me kryengritesit shqiptare te cilat i munden trupat Vidiste dhe arriten qe te vrasin shume prej tyre dhe te zene rob vete gjeneral Saar dhe disa ushtare te tij, pervec 300 malesoreve te cilet nuk luftuan kunder vellezerve te tyre shqiptare.

Pas kesaj fitore te pare, kryengritesit shqiptare cuan flamurin e tyre me gjysme hene ne Tirane, Kavaje, Linxe dhe ne te gjitha anet e Shqiperise nen kontrollin e tyre dhe deklaruan fillimin e rrevoltes se pergjithshme kombetare kunder rregjimit despotik te Vidit. Patrioteve shqiptare ne kete kryengritje iu bashkangjiten edhe shume muhaxhire boshniake, dibrane dhe kosovare te cilet po e shihnin qarte qe rregjimi Vidist po punonte per Serbine.

Ne 23 Maj 1914, pasiqe patriotet

shqiptare kishin marre Tiranen dhe Shijakun, iu drejtuan Rrashbullit qe u mbante i pushtuar nga trupat Vidiste nen aventurinerin gjerman, Baron Gumpferberg dhe Roefselma. Pasiqe thyen rrezistencen e tyre iu drejtuan Durresit dhe depertuan deri ne lagjet e jashtme te qytetit. Por te perballur me vullnetaret internacionale: gjermane, austriake, italiane, romune, etj dhe inferior ne municione, ata u detyruan te terhiqen ne kodrat e Rrashbullit pas luftimesh te pergjaksme. Ne kete kohe, i trembur nga avancimi i shqiptareve, kapterr Vidi u arratis ne luftanijet italiane qe ishin ne brigjet e Durresit.

Kur patriotet shqiptare morren vesh per arratisjen e 'Princit' i cuan atij fjale se nuk do ti benin gje nesi ai do tu kthente ne pallatin e tij dhe te bisedonte me ata si burra. Duke marre keto garanci, Vidi u kthye ne pallat. Shqiptaret qe tashme kishin peng te tyre gjeneral Sarrin dhe princ Sturdzen (atasheun Romun ne Shqiperi) dhe mbanin te rrethuar Durresin, i liruan keta te fundit dhe i cuan te Vidi qe ti conin atij fjale qe te shpallte amnisti te pergjithshme dhe qe Komisioni Internacional qe po ia shiste Shqiperine grekut, te shkante dhe tu takonte me ata per te biseduar fatet e Shqiperise dhe jo me kapterr Vidin. Pasiqe Vidi ra dakort me kerkesat e shqiptareve, iu coi atyre nen flamurin Italian Mehmet Pashe Derrallen si perfaqesues te Komisionit Ndekombetar, qe te hynte ne bisedime ne Shijak.

Pas takimit te pare me Derrallen, K. Nderkombetar i vizitoi kryengritesit shqiptare serisht me 28 Maj ne Shijak. Ne kete takim patriotet shqiptare i kerkuan Nderkombetareve qe te investonin ne Shqiperi, te ndertonin rruge, shkolla, rregull dhe qe Shqiperine ta linin nen mbrojtjen e Turqise apo te nje Princi Musliman. Disa dite me vone ky komitet vizitoi edhe Kavajen, ku u prit mire si ne Shijak. Edhe ketu patriotet Kavajas i kerkuan Komitetit Nderkombetar pak a shume kerkesat e Shijakasve, dhe keta theksuan se nuk e njihnin Vidin dhe qeverine e tij si legjitime ne vend. Te njejtën kerkese e theksuan me me force me vone patriotet e Tiranes, te cilet i kerkuan Komisionit Nderkombetar te Kontrollit (KNK) qe Vidi te largohet nga Shqiperia.

Gjate kohes qe u benin keto negociata me kryengritesit shqiptare, qeverise se Vidit i erdhen perforcime me mercenare romune, gjermane etj, gjë qe e ben ate te njehet me i sigurte se me pare. Per kete ai vendosi qe ti shkëlmonte marreveshjet e tija qe arriti me shqiptaret e ne vend te dialogut te perdorte dhunen. Megjithate kundershtrimet e malesoreve katolike zhqiptare (qe Vidi kishte rekrutuar ne Durres si mercenare te tij), Vidi vendosi qe te hynte serisht ne lufte kunder kryengritesve shqiptare. Per kete kampi i tij vendosi qe te nder-

tonte 5 kollona me te cilat parashikohej te shtypej kryengritja shqiptare dhe vinja nen kontroll e Shqiperise. Nje nga keto kolona ishte nga Lezha nen Preng Bib Doden dhe trupat e tij katolike lezhiane dhe mirditore. Ne kete aventure mirditoret do tu komandonin nga Gjon Marka Gjoni. Organizimi i malesoreve katolik ne luften e Vidit, shkaktoi shume pakenaqesi ne qarqet italiane ne Shqiperi. Per kete ministri italian ne Shqiperi Alioti protestoi, pasi kjo do te conte shume indinjaten e muslimaneve shqiptar kunder katolikeve.

Ne vijim me qellimet Vidiste per nenshttrim te Shqiperise, koloneli hollandez Tomson organizoi ne Durres nje rrjet te tere policie sekrete me spiune, qe i raportonin atij mbi levizjet e patrioteve shqiptar neper rrethe.

Duke pare organizimet Vidiste kunder tyre, me 3 Qershor 1914 patriotet shqiptare u mblodhen ne Shijak ku vendosen per vazhdimin e luftes se tyre. Ata rane dakort qe Shqiperia duhej te qendronte nen mbrojtjen e Turqise, princ Vidi duhej te largohet nga vendi dhe ne vend te tij ne Shqiperi duhej te vihej nje princ musliman shqiptar. Gjuha shqipe duhej te vazhdonte tu shkruante me germa arabe ne vend te atyre latine, dhe shqiptaret do te mbanin si flamur te tyre kombetar flamurin me gjysme hene - ne vend te atij qe po iu imponohet nga te huajt etj. Kjo mbledhje u njoh edhe si "Alenca e Shijakut". Ajo zgjodhi edhe kryesine e saj. Kryetar i levizjes kryengritese u zgjodh Mustafa Ndroqi, nenkryetar Xhenabi Adili, kurse komandant i pergjithshem Qamil Haxhi Feza.

Ne ditet qe vijuan patriotet shqiptare e shtrine pushtetin e tyre ne Kavaje, Kruje dhe Peqin. Pas disa ditesh, trupat shqiptare iu drejtuan Elbasanit qe e morren ne 23 Qershor. Ne Jug kryengritja e tyre shkoi deri ne Qukes, kurse ne Veri deri ne Milot.

Megjithate spiunazhin qe kolonel Tomson ndertoi ne Durres, ai nuk mundi qe te zbulonte planet e shqiptareve, te cilet me 15 Qershor 1914 ri-sulmuan qytetin. Por edhe pse luftuan me vetemohim, ata nuk munden te clirojne Durresin as kesaj rradhe pasiqe ne rradhet e ushtrise Vidiste gjeneralet dhe ushtaret e rinje gjermane dhe austro-hungarez qe kishin ardhur ne Durres, duke perdorur arme superiore munden qe ti ndalojne ata edhe kesaj rradhe. Besohet se ne kete lufte u vrane rreth 200 vete nga patriotet shqiptare, kurse ne kampin Vidist rreth 40 veta vdiqen, nder te cilet ishte edhe vete kryegestapoja i rregjimit Vidist: koloneli i urryer Tomson.

Kolonel Tomsoni qe u mbante nga shtypi grek si miku i tyre me i madh, ishte nje nga kriminelet kryesore Vidiste qe mbesheteti "Protokollin e Korfuzit" ne favor te Greqise. Duke patur eksperiencen koloniale qe Hollanda morri me

kolonite e saja muslimane, Fuqite e Medha gjeten ne Tomsonin njeriun me adapt per presionin dhe shtypjen e shqiptareve. Me urdhëra te tij u vrane sa e sa shqiptare te pafajshem. Per kete arsye shtypi shqiptar sebashku me qarqet diplomatike te kohes e pershkruanin sjellen e holandezeve ndaj shqiptareve si sjelle padronesh koloniale. Kolonel Tomsoni ishte ai qe vrau Bekir Gebrenene, arrestoi Cerciz Topullin, Ismail Qemalin dhe luftoi me egersi lirine e popullit shqiptar. Nen udhëheqjen e tij u bombarduan sa e sa fshatra, ne menyre qe rregjimit te huaj Vidist ti zgjatej jeta ne Shqiperi.

Pas luftes se Durresit, me 18 Qershor 1914, forcat Vidiste u bene gati per te leshuar reprezaljen e tyre kunder shqiptareve ne kodrat e Rashbullit. Ne luften e Rrashbullit sipas Shtjefen Gjecovit morren pjese rreth 3000 trupa nga te dyja palet. Ne anen e Vidisteve pervec mercenareve te huaj morren pjese edhe shume malesore katolike nga Veriu te udhëhequr nga Gjon Marka Gjoni i cili perpara luftes pati disa sherre kokofertesie me oficeret holandeze ne lidhje me strategjine e luftes. Isa Buletini me disa mercenare te tij morren pjese gjithashtu. Edhe pse lufta filloi me superioritetin e armatimeve te Vidisteve dhe 'strategjive' te gjeneraleve te tij, shqiptaret nen udhëheqjen e Haxhi Qamil Xhametes nga Sharra e Tiranës, korrën nje fitore te bujshme mbi ushtrire kuislinge Vidiste.

Ne fitoren qe perjetuan ne Rrashbull kunder forcave internacionale Vidiste, Shtjefen Gjecovi tregon se dhqiptaret e lumtur nga kjo fitore mbi hordhite Vidiste brohoriten "Padishahem Cok Jasha" (Rrofte Sulltani) – sipas tradites se vjeter te ushtarëve shqiptar ne kohe te Osmanëve. Kjo brohoritje panislamike jo vetem qe i tregoi kapterrit gjermano-romun te Durresit dhe trupave te tija kolonizatore, se krenaria e popullit shqiptar nuk mund te perdhosej nga disa ardhacak te huaj si ai: por ne te njejtën kohe deshmoi per vazhdimesine e ideve panislamike mes shqiptareve te viteve 1913 – 1915.

PADISHAHEM COK JASHA

Pasiqe shqiptaret kane qene ajka e trupave osmane, sllogani "Padishahem Cok Jasha" ka qene edhe motoja e tyre ne sa e sa beteja qe ata ben historikisht per komonwealthin Osman neper bote. Edhe ne kete rast, duke ri-kujtuar lavdite e tyre te meparshme, patriotet shqiptare perdoren slloganin e tyre te vjeter panislamik. Me kete fitore ne Rrashbull, shqiptaret i treguan fuqive koloniale kristjane se identiteti i tyre Islamik ishte pjese e kunderpergjigjes se ketij populli kunder kolonializmit kristjan te Evropes.

Ne panikun qe armiku morri nga fitorja shqiptare ne Rrashbull, lideri kuisling i mirditoreve Gjon Marka Gjoni u detyrua te largohet me vrap

nga lufta. Ne vrap e siper, pasiqe dezertoi mirditoret e tij, ai u fsheh ne nje kafe rruges nga frika se mos e kapnin te gjalle. Ne total forcat Vidiste humben ne kete lufte rreth 150 veta. Te thyer dhe te poshtuar, Vidistet derguan Aqif Pashen qe te bente paqe me patriotet shqiptaret.

Pas fitores se Rrashbullit, kryengritesit shqiptare u sulmuan edhe nga forcat e Preng Bib Dodes nga Lezha. Prenga i shtyre nga majori hollandez Krooni dhe princi romun Mikail Sturdza (atashu romun ne Durres te cilin shqiptaret e liruan me mirebesim me pare) u nis per lufte ne krye te katolikeve te tij kunder kryengritesve shqiptare. Por bajraktaret e Prengut nuk e kishin me qejf kete vellavrasje. Per kete arsye Prenga marshoi deri ne Slinxe dhe kerkoi qe te hyje ne bisedime me kryengritesit. Por atashu romun Mikhail Strudza, qe ishte terbuar nga mossuksesi i tij per te cuar shqiptaret ne vella-vrasje, marshoi vete me trupat hollandeze ne kalane e Ishmit te cilen pasi e bombardoi e morri me ndihmen e Noz Gjoni dhe Bajram Currit. Prenga pas mosdashjes se bajraktareve te tij per lufte, shkoi ne Durres qe te organizoje mirditoret. Nje grup tjetër qe marshoi kunder kryengritesve shqiptare ishte kolona e Elbasanit e perbere ne shumice nga xhandaret hollandeze. Kjo kollone u thye dhe u detyrua te terhiet duke lene dy oficerë rober. Gjithashtu nga Vlorë nje kolone tjetër hollandeze u nis kunder kryengritesve shqiptare. Edhe kjo kolone ashtu si e para, u thye nga shqiptaret prane lumit Seman, duke lene pas artilerine dhe municionet e saj.

Aziz Pashe Vrioni te cilin Vidi me pare e kishte bere minister te bujqesise dhe tregetise, gjithashtu u detyrua nga Vidi qe te marshoje kunder kryengritesve te Tiranës. Por edhe kolona e tij u thye dhe u terhoq mbrapsht ne Korce. Pas ketyre fitores nga kryengritesit shqiptare, Vidistet nuk bene me perpjekje per te hyre ne lufte me shqiptaret. Perpjekje u bene ne dy raste kunder Kavajes qe u bombardua nga anijet austro-hungareze. Gjate muajit Korrik, ne Durres princ Vidi i erdhen vullnetare te shumte nga Rumania qe planifikonin te ripush-tonin Shqiperine dhe te forconin kapterrin romuno-gjerman si despot te Shqiperise.

Ne kohen kur populli shqiptar ishte cuar ne rrevolte kunder despotizmit Vidist, Ismail Bej Qemali qe gjate gjithë kesaj kohe kishte qene jashte Shqiperise, u kthye ne vend. Pas ardhjes, ai shkoi menjehere ne Durres ku iu kerkoi Vidistëve qe te jepnin doreheqje dhe Princ Vidi te largohet nga Shqiperia, dhe vendi te ndahej ne tre kantone sipas modelit Zvicerian. Por Princ Vidi me intrigantet e tij e rrefuzuan propozimin e Ismailit. Pasiqe Ismaili e kuptoi qe qeveria Vidiste dhe qarku i Durresit ishin nje fole intrigantesh, ai u largua per ne Vlore ku themeloi

"Komitetin e Shpetimit Kombetar", ne pergjigje ndaj despotizmit Vidist. Duke vene re se qeveria Vidiste ishte nje kthyer ne nje rrjet anti-kombetar, Ismail Qemali i dergoi nje note proteste Fuqite te Medha, ku iu kerkoi qe te hiqnin Vidi nga Shqiperia dhe ne vend te tij, KNK-ja te merrte ne dore Shqiperine.

Duke perfituar nga qeveria anti-shqiptare e Durresit, kriminelet "vorio-epiriot" te Zografosit dhe Spiromilos kaluan ne revansh ne Jug te Shqiperise. Ne 6 Korrik 1914, vorio-epiriotet organizuan ne Delvine "Kongresin PanEpiriot" ku qe aty grekerit dhe andartet e tyre panortodoks i kerkuan KNK-se qe te rishikonte ne favor te grekerve "Protokollin e Korfuzit". Per kete vorio-epiriotet deklaruan se ishte detyra e tyre si kristjane qe te marshonin ushtarakisht ne tokat shqiptare, ne menyre qe te "mbronin" kristjanet nga "persekutimet" muslimane. Per kete arsye terroristet greke organizuan edhe "ushtrite e shenjta" ne menyre qe te benin kryqezate kunder Shqiperise. Ne ditet qe rrodhen repartet terroriste greke e shtrine "terrorin e tyre te shenjte" ne Kolonje, Korce, Permet dhe Tepelene, ku me mijera musliman shqiptare u vrane, perdhunuan dhe shperngulen me force. Vetem ne fshatin e Hormoves, kryqetaret helene vrane mbi njeqind gra, femije e pleq te cilet pasi qe i futen ne nje kishë, i vrane duke qendruar mbi catite e kishes.

Pas thyerjeve te ushtrive Vidiste, forcat shqiptare nen Qamil Haxhi Fejzen iu drejtuan Lushnjës, Fierit, Beratit dhe Pogradecit te cilat i morren. Atyre ne kete lufte iu ngjiten edhe bujqit e Myzeqese te cilet ishin te pakenaqr me rregjimin Vidist. Pasiqe forcat kryengritese kishin presione ne te gjithë Shqiperine nga Vidistet e Durresit dhe forcat e tyre mercenare, ata u detyruan qe ne 11 Korrik te bejne paqe me grekerit ne Pogradec, dhe te nderpresin perkohesisht luften e tyre kunder vorio-epiriotëve. Por andartet greke nuk e rrespektuan marreveshjen dhe ne gisht pushtuan Beratin, te cilin e lane vetem pas kthimit dhe presionit te forcave kryengritese ne qytet.

Me avancimin e kryengritesve shqiptare anembane vendit qeveria kukull e Durresit po e kuptonte se nuk e kishte jeten te gjate. Per me teper fillimi i luftes se Pare Boterore i angazhoi fuqite evropjane dhe Austro-Hungarine ne konflikthin e ri boteror. Ne kete situatë Vidi qendronte si peshku pa uje. Tashme fatet e kombeve si shqiptaret do tu vendosnin nga lufta boterore dhe jo nga kllounizmi tip Vidist.

Ne 1 Shtator 1914 trupat kryengritese hyne ne Vlore pa lufte. Ismail Qemali qe me pare kishte qene i mendimit se vendin duhej ta merrte nen pushtet KNK-ja, tanime i udhezoi vlonjatet qe t'ia hapin deren qeverise se Tiranës dhe t'i bashkoheshin asaj ne konsolidimin e pushtetit ne vend. Ne keto momente

kur shqiptaret morren ne duar shumicen e qyteteve te Shqiperise, kapterr Vilhelm Vidi u detyrua qe i turperuar dhe i c'nderuar te largohet nga Shqiperia me 3 Shtator 1914.[43] Ne 4 Shtator 1914 kryengritesit shqiptare te kryesuar nga Qamil Haxhi Fejza deklaruan me hyrjen e tyre ne Durres se: "... popullsia e Durresit duhet te jete e njezeshme per te mos pranuar asnje nderhyrje ne qeverine e saj... Meqene se Evropa e ka njohur pamvaresine e popullit shqiptar, sovraniteti i Durresit i perket popullit shqiptar... Ne kete menyre kombi ka te drejte te plote te formoje nje qeveri te rregullt dhe te pavarur dhe te hedhe poshte cdo nderhyrje te huaj ne punet tona, sipas stipulacioneve te drejtes nderkombetare."

Ne 5 Shtator, kryengritesit shqiptare hyne ne Durres. Ne kete kohe ne Kavaje dhe Shijak disa nga kryengritesit deklaruan si Mbret te Shqiperise Princin Burhanudin. Megjithate pas mbledhjes se "Keshillit te Pergjithshem" qe u be po ato dite, kryengritesit vendosen qe te dergojne nje delegacion ne Stamboll te kryesuar nga Haxhi Aliu anetar i Komitetit per Union dhe Progres (Itihad ve Tarikh), qe ti paraqiste Sulltanit kerkesen per caktimin e nje princi musliman per Shqiperine. Ne te njejtën kohe kryengritesit iu kerkuan te huajve qe ishin ne Durres si perfaqesues te KNK-se te largohen nga vendi. Pas marrjes se Durresit, qeveria e Tiranës u shtri edhe ne Shkoder, ku pas disa incidentesh mes katolikeve nen Preng Bib Doden dhe muslimaneve te qytetit, qeveria e Tiranës mundi qe te vendose pushtetin e saj. Gjate shtrirjes se pushtetit te qeverise se Tiranës ne Shkoder, agentet italiane u munduan here pas here qe te rrezojne qeverine pro-Tiranase dhe ne vend te saj te krijonin nje qeveri italofile. Por kjo ide qe u mbeshtet vetem nga Preng Biba dhe spiuni i Esad Pashes, Alush Lohja, nuk u materializua.

Ne kohen kur qeveria e Durresit ishte ende e pastabilizuar, Esat Pashe Toptani i udhezuar nga kryeministri Serb Pashic ne Nish, u dergua ne Diber ku rekrutoi mercenare dhe me ata arriti ne Durres me 2 Tetor per te marre pushtetin. Ne kete moment Durresi ishte i pambrojtur, pasiqe kryengritesit shqiptare kishin derguar nje force prej 4000 vetash kunder Vorio Epiriotëve ne Berat. Esat Pasha qe e gjeti qytetin pa mbrojtje detyroi me shantazh anetaret e Keshillit te Pergjithshem qe ta shpallin ate kryetar dhe komandant te qeverise se re, ose perndryshe ai do ti ekzekutoonte te gjithë.

Me marrjen e pushtetit nga Esati, agjenti italian Alioti me kapiten Kastodlin u kthyen menjehere ne Durres dhe e perqafuan Esatin publikisht. Qe ne ditet e para te pucit te tij, Esati i erdhi ne ndihme si sekretar dhe ideator i krimeve te tija M. Krajewski, nje

cifut nga Sarajeva qe me pare kishte qene ambasadori francez i KNK-se ne Shqiperi. Gjate kryerjes se pucit te Durrësit Esat Pashe Toptani nuk harroi qe te arrestoje edhe Qamil Haxhi Fejzen qe ishte armiku i tij numer nje per pushtet ne qeverine e re.

Pabesia e akteve esadiste i rrevoltoi kryengritesit shqiptar ne kulm. Per kete ata deklaruan Xhihad kunder Esadit, te cilin e akuzuan si aleat te shteteve te krishtera, armike te botes muslimane.

Sulmi i armatosur kunder Esat Pashe Toptanit filloi ne 23 Netor 1914 nen udheheqjen e Haxhi Qamil Xhametes, nga Sharra e Tiranës. Ne sulmin qe kryengritesit shqiptare ben kunder Durrësit, ata u perballen me forcat italiane te cilat me superioritetin e tyre ne armatime e mbrojtjen qytetin; gjate kohes qe Esati morri arratine ne luftanijet italiane qe e prisnin ne det.

Haxhi Qamil Xhameta qe ishte shquar per trimerite e tija ne luften kunder Vidistëve edhe me pare, dogji kullat e Esat Pashes ne Laprake dhe shtepine e tij ne Tirane.

Pas kesaj forcat e Haxhi Qamilit sulmuan qendren e nenprefektures se Tiranës, nga ku debuan mercenaret Esadiste te komanduar nga pijaneci Xhelal Zogu dhe Dine Hoxha.

Brigadat e Haxhi Qamilit sulmuan edhe shume bejlere te tjere tradhetare te Tiranës, te cileve iu kerkua qe te jepnin zekat per fukarenjte dhe te paguanin obligime te tjera ndaj nevojave te luftes. Brenda pak ditesh kryengritesit shqiptare morren pushtet ne te gjithë vendin me perjashtim te Durrësit, ku Esad Pasha u mbyll i mbrojtur nga trupat italiane, serbe, greke e malazeze qe kishin ardhur ne ndihme te tij.

Gjate izolimit qe Esadi do te shihnte ne Durres deri ne Qershor te 1915, Italia, Greqia dhe Serbia do te ishin mbeshetset e tija kryesore me arme dhe municione. Ketu nje rrol te vecante lozi Greqia, ku Venizelosi ne kundërshtim me deshirat italiane per influence ne Durres, i dergoi Esadit me luftanijen "Elia" furnizime me pushke dhe municione. Duke ndihmuar Esadin, Venizelosi shpresonte qe te arrinte synimet e tija ne Shqiperi. Megjithate greket nuk mundën qe te nderhynin per kohe te gjate ne Durres pasiqe italianet protestuan eger per kete.

Por me kalimin e kohes, gjendja ne Shqiperi filloi te keqesohej pasiqe krahinat e Shqiperise se Mesme u gjenden te rrethuara nga ushtrite italiane, serbe e greke qe kishin per qellim shkatërrimin e kryengritjes popullore shqiptare dhe mbajtjen e Esat Pashes ne pushtet. Ne keto kushte pushtimi me 15 Janar 1915 delegatet e 10 nenprefekturave nen kontrollin e patriotëve shqiptare nxorren nje deklaratë ndaj fuqive te medha ku deklarorin se qellimi i levizjes se tyre ishte krijimi i

Shqiperise dhe se ata ishin asnjanes ne konfliktin botëror qe po lindte mes Fuqive te Medha.

Ne 15 Maj te 1915, Haxhi Qamil Xhameta u zgjodh si kryetar i levizjes kryengritesë. Nen Haxhi Qamilin, levizja beri shume reforma ne vend. Haxhi Qamili iu vuri taksa shume bejleresh te pasur. Duhet theksuar se levizja kryengritesë shqiptare nen Haxhi Qamilin morri forma teper puritaniste Islame. Haxhi Qamili psh. shkatëroi mjaft vende supersticionesh fetare, vende ku njerezit kryenin rite magjishe apo adhurimesh jo-reale, ndaloi shtepite publike, pirjen e alkolit ne publik etj. Pasiqe nen pushtetin e Haxhi Qamilit, levizja morri karakter te theksuar Islamik, per Haxhiun popullsia e Tiranës dhe rrethete te tjera krijoi nje rrespekt te vecante. Nder bazat me te fort ate levizjes kryengritesë shqiptare ishin qytezat e Kavajes, Shijakut dhe Tiranës.

Megjithate udheheqja e Haxhi Qamilit nuk zgjati shume pasiqe ne mes te Majit 1915 ushtrite serbe u grumbulluan ne Oher dhe ne Diber per te filluar pushtimin e Shqiperise dhe rrezimin e levizjes kryengritesë. Edhe pas protestave te qeverise se Tiranës dhe rrefuzimit te akuzave serbe se ne Shqiperi fshiheshin agjente austriak, ne 2 Qershor ushtrite serbe filluan marshimin kunder Shqiperise. Justikimin e pushtimit te Shqiperise, serbet e formuluan se ata po vinin ne Shqiperi vetem sa te largonin nga pushteti "ata te huaj qe punonin per llogari te Turqise dhe Austrise". Pas qendresave te ndryshme qe shqiptaret iu bene serbeve ne Qukes, Elbasan, Qafe Kerrabe etj, ushtrite moderne serbe arriten qe te avanconin ne Tirane. Pasiqe i liruuan rrugën Esad Pashes nga Durresi, ato iu drejtuan Tiranës me 13 Qershor 1915, ku pas disa luftimesh dhe kerçenimi per te masakruar te gjithë fshatin e Sharres, arriten qe te bejne Haxhi Qamilin qe te dorezohet. Haxhi Qamili sebashku me 40 kryengrites te tjere shqiptare u derguan ne Durres, ku Xhelal Zogu i denoi me vdekje. Ne ditet qe erdhen pushtuesit serbe vrane gjithashtu edhe patriotet te tjere shqiptare si Cerciz Topullin, Mustafa Qullin, Mehmet Shpendin, Dede Gjo Lulin etj.

Me ekzekutimin e Haxhi Qamilit nga serbet dhe kuislinget e tyre shqipfolës, kryengritja anti-koloniale kombetare shqiptare morri fund. Ne te njejtën kohe vendi u pushtua nga ushtrite malazeze, serbe, italiane, greke, austriake, franceze etj qe u perleshën me njera tjetren gjate luftes se Pare Botërore ne tokat e pushtuara shqiptare. Perfundimi i luftes se pare botërore do ta shihte Shqiperine te destabilizuar politikisht, nen meshiren e fuqive evropjane. Kontrolli Shqiperise prej shqiptarëve si ne ditet e Haxhi Qamilit, do te vinte vetem disa dekada me vone me Ahmet Bej Zogollin kur Fuqite e Medha Evropjane do ta linin Shqiperine si nje shtet te pamvarur, por qe shpejt do te perfundonte ne nje protektorat dhe me vone koloni te Italise fashiste.

LITERATURA SHQIPE NË TRADITËN ISLAME

(Gjuha Shqipe me germa Arabe gjate shekullit te 18 dhe 19te).

Nga: Robert Elsie

Fitorja e Osmaneve mbi Serbet ne fushe Kosove me 28 Qershor 1389, coi hegemonine Serbe ne vdekje ne Ballkan. Si rrjedhoje e renies se hegemonise Serbe ne ballkan, viset Shqiptare pas kesaj date kaluan nga influencia Serbe nen pushtetin Osman. Keshtu qe ne 1415 Kruja, dhe ne 1417 Vlora, Kanina dhe Berati u bashkuan ne federaten Osmane. Ne 1431, e gjithë Shqiperia Jugore u perfshi ne federaten Osmane, dhe qyteti i Gjirokastrës u kthye ne kryeqytetin dhe qender e Sanxhakut te Shqiperise Jugore. Ndersa Shqiperia Jugore u bashkangjit totalisht ne federaten Osmane, Shqiperia veriore edhe pse u bashkangjit ne kete shtet ruajti autonomi te theksuar ne vetvete.

Me ardhjen e tij ne Shqiperi, pushteti Osman solli me vete kulturen e tij te larmishme, qe me vone do te behej edhe pjese integrale e identitetit Shqiptar. Nje fe e re, Islami, u perhap ne Shqiperi, ndermjet jugut ortodoks dhe veriut katolik, fe qe u kthye ne fene dominante te Shqiptarëve. Edhe pse ne dekadat e para te shtetit Osman ne Shqiperi shume pak Shqiptare ishin Musliman, gjate shekullit te 17, rreth 50% e popullsisë se Shqiperise veriore kaloi ne Islam. Katolicizmi Roman dhe Ortodoksia sllavo-helene tek e fundit ishin mbajtese te influencave te huaja ne Shqiperi, te mbushura nga gjuhe te huaja, dhe Shqiptaret ne krahasim me komshinjtë e tyre Helen, Bullgar dhe Serb ishin ndjekes superfaqesor te ketyre feve.

Hasan Kaleshi[1] (1922 - 1976) ne menyre bindese ka sygjerruar se nje nga te mirat kryesore qe pushteti Osman ka sjelle ne Ballkan, ishte ai i ruajtjes se

rraces Shqiptare nga asimilimi sllav, ne te njejtën menyre sic pushtimi sllav i shekullit te 6te ne Ballkan i pati dhene fund procesit te Latinizimit, qe kerçenonte te asimilonte paraardhesit e Shqiptarëve 1000 vjet me pare. Edhe pse Shqiptaret nuk u njohen nga Osmanet si minoritet etnik (pasiqe ata i ndanin njerezit sipas fese dhe jo kombesise), Shqiptaret mundën qe te mbijetojne si rrace dhe ne te vertete te zgjerojne veten e tyre nen pushtetin turk. Ne kete periudhe, Shkodra dhe qytetet e tjera bregdetare Shqiptare morren totalisht formën e qyteteve Shqiptare me popullsi shqiptare.

Ndersa shteti Osman, me organizimin e tij te centralizuar u fokusua ne Stamboll, ai i la Shqiperise kulturen osmane, qe arriti zenitin e saj ne shekullin e 18te. Shqiperia jugore dhe qendrore me qytetet e ripërterirra te Elbasanit dhe Beratit, me xhamite dhe medresete, u kthyen ne qendra te mesimit oriental dhe ne te vertet perjetuan nje rilindje kulturore nen Islam, ne te njejtën menyre sic perjttoi Shkodra dhe Gjakova ne veri. Poete udhetare, artiste dhe shkollare filluan qe te gezojne mbeshetjet e pashallarëve dhe guvernatorëve vendas, ashtu si ne Azine qendrore.

Ne te njejtën menyre sic shkrintaret Shqiptare te shekullit te 16 dhe 17te perdoren latinishten per shkrimet e tyre, shkruesit e pare te Shqiperise Muslimane perdoren menyren Osmane te literatures; shkrimin Turqisht dhe Persisht, per veprat e tyre qe paten nje sukses te theksuar.

- Shkrimtaret Osman me Origjine Shqiptare

- Nje nga shkrintaret me te hershem Shqiptare qe shkroi mes Osmaneve ka qene Mesih i nga Prishtina[2] (1470 - 1512), qe u

njoh ne turqisht si Pristineli Mesih. Mendohet qe Mesih te kete qene Shqiptare nga Prishtina, por qe ka jetuar ne Stamboll qe nga mosha e vogel. Mesih nuk ishte vetem nje poet i rralle, por ne te njejten kohe ishte edhe nje kaligraf i talentuar, qe mbajti postin e sekretarit tek Hadim Ali Pasha gjate pushtetit te sulltan Bajazidit II (1482 - 1512). Njeri i dhene pas kenaqesive sehr oglani (djall qyteti), sic biografi Ashik Celebi e therriri ate, Mesih me shume gjendej ne taverna, neper parqe me shoket e tij sesa ne pune. Edhe pse stili hedonist ne jete mund qe te kete penguar karrieren e tij, Mesih krijoi nga poezite me te mira Osmane te kohes. Nga veprat e tija me te permenduara eshte Murabba-i bahar[3] (poezite e pranveres) te cilat pas publikimi me perkthim latin ne 1774 nga orientalisti Sir William Xhon (1746 - 1794), do te ktheheshin ne poemat me te njohura Osmane ne Evrope, per nje kohe te gjate. Poema fillon sic vijon:

Degjoni oshetimat e nates, ditet e pranveres kane ardhur
te gjithë kopshtet kane ardhur ne jete nga pranvera
Bumi i saj ka hapur dritat e argjendta
Pini dhe kenaquni sepse pranvera do te shkoje shpejt

Me teper origjinale sesa 'Poezite e pranveres' eshte poezia e Mesihit Sehr-engiz (terrori i qytetit), qe u kthye ne prototipin e nje vale te re poetike ne poezine Osmane. Ne 186 verse ai pershkruan bukurite e 46 te rinjve nga Edirneja (Adrianopoja). Kjo poezi eshte nje poezi unike e poezise Osmane te shek te 16te, e cila me talljet dhe ironine humoristike eshte paksa e ndryshme nga poezite mistike dhe tradicionale. Mesih e pranon qe poezia e tij eshte gjynah ne vetete, por ai eshte konfident se Zoti do ta fale ate duke thene: "Zemra ime udhetare eshte thyer ne aq pjese, qe cdo pjese e thyer eshte e lidhur me nje nga ato bukuri".

Nje autor tjeter Shqiptar i shekullit te 16te eshte Jahja Bej Dukagjini[4] (vd. 1575), qe njihet ne Turqisht si Dukagjin Zade Jahja Bej apo Tashkali Jahja. Ai ishte me origjine nga fisi I Dukagjineve ne Veri te Shqiperise, nga zona e Pljevjase ne Malin e Zi te sotshem, qe ishte derguar ne Stamboll per te sherbyer si Jenicere. Jahja Dukagjini ishte krenar per racen e tij Shqiptare. Ne nje nga poemat e tij ai shkruan:

Rraca Shqiptare eshte rraca ime,
E gjithë shtepia ime rronte me shpate.
Tamam si zemer luani,
Si shqiponjat bejne shtepite e tyre mes guresh.

Ky eshte virtyti ne ate qe eshte Shqiptar.

Ai eshte si margaritar, i fshehur mes guresh[5]

Jahja Beu ishte ushtar trim dhe shkrues kurajoz. Ai nuk kishte frike nga opinioni publik apo nga zyrtaret e kohes qe mund tu mos kenaqnin nga poezite e tij. Njehere i akuzuar nga Veziri qe Jahjai kishte shkruar nje elegji per Princ Mustafen e ekzekutuar ne Konje nga i jati i tij Sulltan Sulejman Kanuni ne 1533, Jahja Beu me zgjuarsi iu pergjigje: "Ne e denuam ate me Padishahun, por ne e qame ate me njerezine." Pasiqe ia kishte krijuar shume armiq rreth vetes, ai e pa te arsyeshme qe tu kthente ne cifligun e tij ne Bosnje. Ai vdiq ne te 80-at i zene duke kompozuar divanin e tij ne 1757 (983 A.H.). Nga pese mesnevi-te e tij me e famshmeja eshte Shah u geda (Mbreti dhe lypesi), te cilen Jahja tregon se e ka shkruar per nje jave. Kjo romance metrike idealizon dashurine e paster per nje te ri nga Stamboll qe shquhet per nje bukuri te rralle (i stilizuar si mbret pasiqe ai sundon zemrat e njerezve) nga nje besimtar dashamire (i stilizuar si lypesi). Nje autor tjeter me reputacion i kesaj kohe ishte vellai i Jahjase, Ahmed Bej Dukagjini, i njohur ne turqisht si Dukagjinzade Ahmed Beu.

Te pakten tre shkrues proze nga shkrimtaret e heret Osman duket qe te kene qene me origjine Shqiptare. Ata i perkasin fillimit te shekullit te 16te, qe kompiluan kroniken e papublikuar: Veziri i Madh, Lutfi Pasha (vd. 1564), autor i marrevshjes ne detyrimet e shtetit; dhe Koci Beu nga Korca, keshilltar i Sulltan Muratit IV (1623 - 1640), diskutimi politik i te cilit 'ne semundjet e perandorise dhe menyra sesi me i kuruar ato', bene qe orientalisti Austriak Baron Von-Hammer-Purgstall (1774-1856) ta titulloje ate "Monteskjeu Ottoman".

Gjate pese shekujve te bashke - ekzistences me shtetin Osman, Shqiperia mundi qe te prodhoje shume njerez te medhenje, impakti i te cileve ne kulturen turke ishte mjaft i madh. Ndermjet atyre kishte teologe dhe shkencetare si Hoxha Hasan Tahsini (1812 - 1881), rektori i pare i Universitetit te Stambollit, leksikografi dhe enciklopedisti Sami Frasherit (1850-1904), qe njihet ne turqisht si Shemsedin Sami; poeti pan-Islamist Mehmet Akif (1873-1936), autori i himnit turk me 1921, dhe Riza Tefiku, nje nga filozofet me te medhenje te Turqise gjate periodes se tij. Fatmiresisht gjate shekullit te 18te energjia kreative Shqiptaro-Ottomaneve nuk u limitua vetem kulturen turke, por filloi te rrjedhe edhe per permiresimin e kultureve Shqiptare, ne gjuhe dhe ne kulturen e rilindur.

- Literatura e Bejtexhijve
Tranzicioni nga Turqisht,
Persisht dhe Arabisht ne Shqip si

menyre te shprehuri mes letrareve shqiptare rezultoi ne krijimin e literatures Alxhamiade, nje term spanjoll per letersine Andaluziane, te shkruar me germa Arabe dhe te influencuar nga kultura Islame. Literatura Alxhamiade u zhvillua dukshem gjate kohes Islame ne Portugali dhe Spanje, dhe ne Bosnje dhe Shqiperi gjate periudhes Osmane. Perpjekjet e para te Shqiptareve gjate shekullit te 18te qe te shprehen ne gjuhen e tyre ne vend te gjuheve te orientit, ishin momente decizive tranzicioni te Shqipes, ashtu si edhe tranzicioni nga Latinishtja ne Shqip pati ndodhur ne shekullin e 16 dhe 17te.

Literatura e Bejtexhijve[6] sic kjo periode quhet ne shqip, konsiston nga verse te kompozuar me germa Arabe. Shkrimi Arab qe ishte adoptuar nga Osmanet, tashme u adoptua edhe nga Shqiptaret per tu pershtatur ne sistemin fonetik te shqipes, apo me sakte te dialekteve shqipe. Ky adoptim provoi qe te jete i pamjaftueshem per shqipen, aq sa ishte edhe per turqishten. Por jo vetem skripti ishte oriental. Gjuha e bejtexhive ishte shqipe e miksur me persisht, arabisht dhe turqisht, saqe per shqiptaret e sotshem shpesh eshte e veshtire te kuptohet. Vala e fjaleve dhe shprehjeve te huaja qe hyne ne gjuhen shqipe te kesaj kohe qe u perdoren per te treguar atributed e kultureve dhe fese se re, ishin te panjohura deri ne ate kohe. Futja e shprehjeve orientale ne kete gjuhe e beri edhe kompozimin ne shqip mjaft te kollajste sipas stileve dhe ritmeve qe Osmanet kishin ne poezine e tyre.

Poezia e Bejtexhive u influencua fuqishem nga Turqishtja, Persishtja dhe Arabishtja me modelet e tyre literale qe ne ate kohe ishin ne mode ne Stamboll dhe ne Lindjen e Mesme. Shumica e formave dhe rimave Persiane dhe Turke zune vend edhe ne literatures Shqipe. Kete ne e gjejmë ne poezi apo neper divane si: murabba, (versete), ilahite (kenge fetare), kasidet (poezi ne stil arab) dhe ne gazale (poezi te shkurtira zakonisht lirika dashurie te pelqyeshme mes turqve dhe persianeve). Sistemi ritmik i poezise bejtexhie ishte pothuajse i rrjedhshem edhe pse perpjekje u bene per te sjelle sisteme kuantitative poezishe[7]. Subjekti ne pergjithesi ishte religjioz, qofte meditues apo haptazi edukues, ne sherbim te hapjes se fese. Karakteri spekullues i mjaft prej ketyre verseve e kishte burimin ne mesimet e Islamit; nga burimet autoritative Sunnite deri ne burimet intense Shiite Sufiste dhe me vone, ne burimet me liberale por po aq mistike te panteizmit Bektashian. Disa versete sekulare gjenden gjithashtu; si lirika dashurie, poezi per natyren, per fenomene historike dhe filozofike

dhe here pas here prezenca e mendimit ironik ndaj botes.

Literatura e Bejtexhijve u rregjistrua neper manuskripte, shumica e te cilave sot jane te humbura, apo ne rastin me te mire, jane te pamundura qe te gjenden. Disa kopje te vonshme (por jo origjinale) te manuskripteve ruhen ne Arkivat Qendrore te Shtetit ne Tirane, por shumica e materialeve mbijetuse jane akoma neper duar private, sidomos ne Kosove dhe Maqedoni. Nga manuskriptet qe kane mbijetuar shume pak jane bptuar. Si rrjedhoje, shkrimet e Bejtexhijve jnae nga kapitujt me pak te njohur te literatures Shqiptare.

Poezia me e vjeter Shqiptare ne germa Arabe i kushtohet kafese dhe daton me 1725 (1337 p.h.), dhe eshte shkruar nga Muci Zade, i biri i Mucit, qe ne mesojme qe te kete qene plak ne kohen e shkrimit te poezise. Refreni i poezise eshte: "O Zot, mos me le pa kafe", qe padyshim nga nje familjaritet mjaft te madh per adiktet e kafese. E zbuluar ne nje manuscript ne Korce, qe tashme ruhet ne Tirane, kjo poeme konsiston prej shtatembdhjete strofash me nje ritme AAAB. Njekohehisht kjo eshte poezia me e vjeter qe dihet te jete shkruar ne dialektin jugor (toske).

Poeti i pare kryesor ndermjet Bejtexhijve ishte Nezim Frakulla (1680 - 1760), qe njihet ndryshe si Nezim Berati apo Ibrahim Nezimi. Ai u lind ne fshatin Frakull pranë Fierit dhe kaloi pjesen me te mire te jetes se tij ne Berat, qe ishte nje qender bumi per kulturen Islame te kohes. Frakulla studioi ne Stamboll ku ai edhe shkroi poezite e tij te para ne Turqisht, Persisht dhe ndoshta ne Arabisht, ndermjet te cilave dy divane. Rreth viteve 1731 ai u kthye ne Berat ku dihet qe ai te jete zene ne nje rivalitet letrar me poetet e tjere te periudhes se tij, dhe ne vecanti me Mulla Aliun, myftiun e Beratit. Ndermjet 1731 dhe 1735 ai kompozoi nje divan dhe nje sere poezishe ne Shqip, sebashku me nje fjalor Shqip - Turqisht qe kishte forme versesh. Edhe pse ne nuk posedojme te gjithë divanin original ne kemi kopje te rreth 110 poemash nga ai. Disa nga verset e tij u bene kenge dhe mbijetuan neper shekuj ne forme orale. Nezim Frakulla na tregon ne se ai ishte i pari person qe te kompozoi divan ne Shqip:

Divan kush pat folure shqip?
Ajan e beri Nezimi,
Bejan kush pat folure shqip?
Insan e beri Nezimi.

Versetet e Nezim Frakulles iu bene te njohur Albanologjistit Gjerman Johann Georg von Hahn (1811 - 1869) qe publikoi tete nga poezite e Frakulles[8] ne 1854. Poezite e tij gjithashtu u publikuan ne antologjine e pare substanciale te letersise Shqiptare[9] me 1941, te edituara nga Namik Resuli (1912

– 1985), qe posedonte 62 cope manuskriptesh te divanit.

Divanet e Frakulles permbajne verse qe variojne nga levdata per pashate local dhe fushata ushtarake, te poezi per miq dhe mbeshtetes, poema ndarjeje dhe deshira for miqte e tij dhe te dashurit, pershkrime te natyres ne pranvere, versete religjioze dhe ne vecanti lirika dashurie. Imagjinata e ghazaleve te fundit, disa prej te cilave i dedikohen niperve te tij, jane ato te poezise Turke, Arabe dhe Persiane me shume nga temat e tyre klasike, metaforat dhe iluzionet ku dashuria shprehet si nje semundje qe shkakton poetin te largohet larg, nje dashuri ku dashnori i keq me shikimin e tij mund te shkaktojte plage vdekjeprures, apo peisazhe ku sherbetorja me bukurine e saj mundet qe te skllaveroje pronarin e saj ne nenshtrim.

Nezim Frakulla gezonte patronazhin dhe mbrojtjen e Sulejman Pashes nga Elbasani dhe te Ismail Pashe Velebishtit, i fundit ishte poet per vete. Ne nje kohe pas 1747, pasi qe u kthye nga Stambolli ne kerkim per pune, ai u dergua ne Khotin ne Besarabi (kesaj dite eshte nen Ukraine), ndoshta per emigrim. Ketu ai kompozoi mjaft kaside, njera prej te cilave festoon fermanin qe autorizonte kthimin e tij ne shtepi dhe nje tjetër per udhëtimin e tij ne Berat nepermjet Shkupit dhe Elbasanit. Per mberritjen e tij ne qytetin e fundme, verse qe duket te kete qene popullor mjaft vite pas tij, Frakulla shpall:

Ne Elbasan hym me gzim
Posi sheqer o Nezim

Ndoshta pre intrigave politike apo ndoshta nga polemikat e shpeshta letrare, Frakulla u be i padashur dhe u detyrua qe te largohet nga Berat edhe njeherë, dhe te qendroje ne Elbasan per disa vite. Ne rikthimin e tij ne Berat, ai besohet qe te jete burgosur. Ai vdiq ne moshe te vjeter si i burgosur ne Stambolli me 1760 [1173 P. H.].

Frakulla jo vetem qe e konsideronte veten e tij si poeti i pare qe pati shkruar ne Shqip, por ai e konsideronte veten e tij te barabarte me Sadiun dhe Hafizin e kohes se tij. Kasideja e tij ne Shqip, na tregon ai, jane te krahasueshme me ato te 'Urfi ne Persisht dhe Nefi ne Turqisht. Por shumica e eksperteve do ti konsiderojne keto krahasime paksa te ekzagjeruara. Ndersa Nezim Frakulla pa dyshim kishte iniciative dhe talent, verset e tija Shqipe nuk arriten qe te marrin perfeksionimin letrar te klasikes Perse, pse miksjaja e Shqipes, Persishtes, dhe Turqishtes qe ai perdori nuk ishin te mjaftueshme qe ta lejonin ate qe te arrinte kete shkalle. Cfare ai arriti te krijojte ishte themelimi i bazes se nje tradite te re letrare ne

Shqiperi, qe do te zgjaste per dy shekuj.

Nje bashkekohes i talentuar i Nezim Frakulles ishte Sulejman Naibi[10], qe u njoh gjithashtu si Sulejman Ramazani. Ai u lind ne Berat ku ai kaloi shumicen e jetes se tij dhe vdiq me 1771 [1185 P.H.]. Shume pak tjetër dihet rreth ekzistences se tij, pervecse ai u martua ne Elbasan dhe mendohet qe te kete kaluar disa kohe ne Lindjen e Mesme. Naibi eshte autor i nje divani ne Shqip, ne nje manuskript qe mbijetoi deri me 1944 ne Fier. Ndoshta ky eshte i njejtë manuskript qe eshte thene te kete ekzistuar ne Berat ne 1913. Fatkeqesisht manuskriptit nuk iu be ndonje kopje perpara se te zhdukej gjate Luftes se Dyte Boterore, dhe si rrezultat, ne dime per verset e Sulejman Nebiut vetem nga pak poema qe jane shkruar ne manuskripte te tjera, apo qe kane mbijetuar gojarisht ne kenget popullore Shqiptare, sic eshte Mahmudeja e stolisure. Ndermjet ketyre tete apo dymbedhjete versesh rrjedhese qe jane publikuar, ne gjejmë nje lirike delikate te rrefinuar ne nje varg njezesh, qe shpjegon gezimin e dashurise dhe bukurine e grave. Shqipja e tij eshte me e paster nga fjalet e huaja ne krahasim me Nezim Frakullen. Ne fakt ne nje nga poezite e tij Naibi akuzon Frakullen per perdorim te shume fjalesh turke.

Hasan Zyko Kamberi[11] u lind ne gjysmen e dyte te shekullit te tetembedhjete ne Starje te Kolonjes, fshat Jugor ne Shqiperi, ne rreze te malit Gramoz. Per jeten e tij ne dime vetem se ai morri pjese ne luften Osmane-Austriake, ne betejen e Smederevos, ne lindje te Beogradit prane Danubit, me 1789 [1203 P.H.] ne nje ushtri nen komanden e Ali Pashe Tepelenes. Ai vdiq si dervish, padyshim i sekti Bektashian, ne fshatin e tij te lindjes ne fillim te shekullit te nentembedhjete. Varri i tij ne Starje te Kolonjes u kthye ne teqe qe njihet si tyrbeja e Baba Hasanit.

Kamberi eshte nje nga perfaqesuesit me origjinal te tradites Muslimane ne literaturen Shqiptare, nepermjet punimit te tij kryesor, nje mexhmua (permbledhje) prej 200 faqesh qe nuk ekziston me. Nje manuskript i kesaj permbledhje thuhet te jete derguar ne Manastir ne 1908 – 1910 per tu publikuar, por qe atehere ai ka humbur[12]. Ne te vertet shume pak nga shkrimet e tij kane mbijetuar dhe shume me pak jane botuar. Nder punimet e tij ne posedojme: nje mevlud te shkurter qe eshte nje poezi fetare per lindjen e Profetit Muhamed a.s., rreth dhjete ilahi, himne fetare; dhe mbi pesedhjete poezi sekulare.

Mevludi i Hasanit, i biri i Zyko Kamberit, sic ai e therret vetveten, eshte ndoshta nje nga te paret qe te kompozohet ne Shqip dhe eshte influencuar padyshim nga mevludi

i poetit Turk, Sulejman Celebi (vd 1422). Nje kopje e mevludit te Kamberit, qe konsiston prej 51 kater-rrjeshtash tetefjalesh me nje rime ABAB ekziston sot e kesaj dite ne Arshivat e Shtetit ne Tirane. Ne kete pune dhe ne poemat e tij ate tjera, njera prej te cilave i kushtohet histories se Ibrahimit a.s., Sares dhe Haxherit nga Egjipti, ne veme re nje poet te talentuar, qe kishte me shume se nje dije superfaqesore te dijes teologjike Islame dhe Bektashiane. Verseti sekularist i Kamberit mbulon shume tema. Ne tetefjaleshin e tij Sefer-i Humayun (Fushata e Mbretit) ne tridhjete e tre katerstrofesh, ai pershkruan pjesemarrjen e tij ne betejen e siperpermen-dur te Smedereves duke sjelle nje pershkrim realist te vuajtjeve qe ajo shkaktoi. Ne Bahti im (fati im) dhe Vasijetnameja (testamenti) Kamberi krijon nje shikim ironic, te ashper ne kohe per ne poshte-elartet e fatit, dhe ne vecanti ne fatkeqesite e jetes se tij. Gjerdeku (gjerdani) portretizon veshtiresite dhe problemet e grave te reja qe u martonin sipas zakonit pa qene te afta qe te zgjidhnin burrat per veten e tyre. Ne lirikate e dashurise Kamberi shpreh pakenaqesine e tij me realitetet sociale qe shkaterrojne pasionet. Poema me e famshme e tij eshte Paraja, qe ben nje denim sarkastik ndaj korrupsionit feudal, dhe ne te njejten kohe kjo poezi ndoshta eshte poezia e pare satirike Shqiptare perpara shekullit te njezete. Ajo fillon si me poshte:

Mbreri q'urdheron dynjane
Qe ka vene taraphane
E i presne parane,
Ja di kimene parase

Dhe veziri, q'eshte veqil,
Ze sikur te benet' adil
E mos thote dot kaly-kil
Ja di kimene parase

Sheh Islami, q'ep fetfane,
Qe di qitapete c'thane
Nuke kacirdis parane
Ja di kimene parase

Myfti dhe myderize
Edhe kyrra e vaize
Kane ujdipur' iblize
Ja di kimene parase

Poezite e Kamberit ishin mjaft popullore ne shekullin e nentembedhjete dhe u hapen mes njerezish gojarisht. Ne hyrjen e perkthimit ne Shqip te Iliades se Homerit (Bukuresht 1896), poeti Naim Frasher (1846 – 1900) tregonte: "Nder poetet Shqiptare, Hasan Zyko Kamberi eshte me i famshmi". Gjuha e tij eshte shume here me e thjeshte dhe natyrale sesa e Frakulles dhe Naibit qe jetuan gjysem shekulli perpara tij, dhe per me teper eshte me pak e ngarkuar me terma orientale.

Shkrimi i Hasan Zyko Kamberit dhe i Nezim Frakulles

nuk ishin te pakte ne kritike ndaj shoqerise, sic ne kemi pare, por i perket poetit Bektashian Zenel Bastari[13] qe ne duhet ti kthehemi per shprehjet e para ideologjike te vetedijes shoqerore ne literaturen Bejtexhie. Si shkak i dergradimit te shtetit Osman pashalaret dhe bejleret Shqiptare po luftonin per superioritet ne Shqiperi gjate kesaj kohe. Familja e Bushatllinjve kishte krijuar nje principalitet pothuajse te pavarur ne veri te Shqiperise ne fund te shekullit te tetembedhjete, dhe pashalleku i Ali Pashe Tepelenes (1741-1822) ne Jug te Shqiperise dhe veri te Greqise arriti zenitin pushtetit te tij ne 1811. Ne zonen e Tiranes, familjet Xhelaj dhe Toptani po luftonin per pushtet, lufte qe Bastari e perjetoi ne ate kohe. Me gjendjen ekonomike qe po kthehej e paqendrueshme dhe kryengritjet nje ndodhi ditore, viktimat kryesore te konfliktit social ishin padyshim klasa e ulet e shoqerise ky Bastari, ne ndryshim me shumicen e Bejtexhijve te tjere, duket qe te perkiste.

Kyçyku ishte relativisht nje autor profilik qe shkroi ne dialektin Cam, dhe sic duket eshte poeti i pare Shqiptar qe te kete shkruar peome te gjate. Puna per te cilen ai morri edhe fame eshte perralla romantike Erveheja, qe fillimisht u quajt Ravda (kopeshti), shkruar rreth 1820-es. Kjo perralle poetike flet per aventuren e Ervehese se drejte qe arrin te ruaj nderin e saj perpara shume sprovash dhe problemesh. Burri i Ervehese shkon larg dhe e le ate nen kujdesin e vellait te tij, i cili edhe pse i premton te vellait per miresjellje, mundohet qe ta terheqe ate. Erveheja i rreziston perpjekjeve dhe kerconimeve me vdekje qe kunati i saj i ben asaj. Vellai i terbuar nga inati, hakmerret ndaj Ervehese duke shpifur dhe akuzuar ate per prostitucion, gje qe e con ate te denohet me vdekje me gure nen ligjin e kohes. Erveheja mrekuillisht i shpeton ndershkimit te saj me gure, dhe merret e gjalle nga guret nga nje aristokrat qe kalon aty, i cili pasi qe degjon fatin e saj e con ate ne shtepi tek gruaja e tij. Erveheja pasi qe sherohet nga lendimet e saj, bie serisht viktime e aristokratit qe bie ne dashuri me ate. Ajo rrefuzon serisht dhe i tregon atij se ajo eshte e martuar, gje qe e con aristokratit qe te terhiqet. Me vone nje sherbetor ne shtepine e te pasurit mundohet qe ti afrohet Ervehese, por edhe ai largohet me pas. Sherbetori merr hak kunder Ervehese duke vrare djalin e pronarit te tij dhe duke akuzuar Ervehene si vrasese te tij. Ceshtja me vone qartesohe dhe pasaniku bindet qe Erveheja eshte e pafaj, por ai eshte i detyruar qe ta largoje Ervehene nga shtepia e tij, duke i dhene asaj 400 copa flori si roge per largimin e saj. Por hallet e

Ervehese nuk mbarojne ketu. Derisa ajo eshte duke hecur ne brigje te nje lumi ajo sheh nje hajdut qe eshte gati qe te vritet per arsye se ai kishte vjedhur 400 copa flori nga pasuria e mbretit. Ervehese i vjen keq per hajdutin dhe e shpeton jeten e tij duke dhene te gjithë parate qe ajo kishte me vete. Hajduti me pas e ndjek ate dhe i lutet asaj qe ajo te behet grua e tij, por ajo rrefuzon, dhe hajduti nga inati e shet ate si skllave te kapiteni i nje anije qe mundohet qe ta marre ate gjithashtu. Nje furtune e ze ne kete kohe anijen dhe mbyty gjithke ne anije pervec Ervehese qe del ne breg te nje qyteti te panjohur. Nje besimtar i devotshem i jep asaj rrobat e tij, dhe ne rroba burri ajo shkon tek mbreti i vendit qe e pret ate me rrespekt dhe nderon nje shtepi per ate. Ketu ajo kujdeset per te semuret dhe te verberit dhe kthehet ne nje grua te dashur dhe rrespektuar per veprat e saja te mira. Ne vendin ku Erveheja jeton, mbreti i vendit vdes, dhe ajo zgjidhet si mbreteshe. Nje dite pese te huaj vine ne pallatin e saj: burri i saj dhe vellai i tij, pasaniku, sherbetori dhe hajduti, tre te fundit tashme te verber. Erveheja iu premtonte atyre sherim nese ata pendohet dhe tregojne gjynahet e tyre. Padrejtesia bere kunder Ervehese nepermjet tregimit te tyre behet e ditur, dhe keshu ajo mundet qe ta tregoj vetveten e saj tek i shoqi si grua e nderit dhe e virtytshme qe ajo gjithnje ka qene. Motivi mbrapa ketij tregimi te 'virtytit femeror' gjendet shpesh ne literaturen orientale dhe perendimore. Burimi me i mire per poezine Kycykt duket qe te jete perralla Persiane Tuti-name (Perralla e zogut) nga Zijaudin Nakshabi, qe u inspirua nga shkrimi Sanskrit, Shukasaptati. Teksti ne Shqip prej shtatembdhjet faqesh, konsiston prej 856 rrjeshtash dhe ruhet si manuskript ne librarinë kombetare ne Tirane. Puna e Kycykt eshte gjithashtu nje nga punimet e rralla te Bejtexhijve qe te publikohet ne shekullin e 19te, edhe pse ne nje version te ndryshuar. Publicisti Jani Vreto (1822 – 1900) jo vetem qe e perktheu Ervehene ne Bukuresht me 1888, por e adoptoi ate si perralle te shekullit te 19te dhe e pa te arsyeshme qe te largoje nga ajo te gjithë termat Arabisht, Persisht dhe Turqisht. Versioni origjinal i poemes eshte me i qarte dhe ka karakterin poetic te nje fabule, kurse edicioni i Vretos e tregin ate me epike.

MALAJZIA: NJË QYTETËRIM MES XHUNGLASH

Një nga vendet që më ka tërhequr jashtë mase përpara se ta vizitoja dhe të jetoja në të ka qënë Malajzia. Këtë vend ne shqiptarët jemi mësuar ta shohim në televizionet tona me ndërtesa të larta që përngajnë diku me ato të Hong Kongun apo Taivanit. Megjithatë në perceptimet tona Malajzia shpesh ngatërrohet me xhunglat e relievit tamil – indian të filmit Sandokan, ku heroi po-indian i filmit “Sandokani, Luani i Malajzisë” jep një shikim paksa konfuz mbi vendin, rracat, fetë dhe kulturën e vendit në fjalë. Për habinë tonë më të madhe filmi “Sandokan” nuk është dhënë asnjëherë në Malajzi.

Olsi Jazexhi

Malajzia është një shtet që shtrihet në fund të siujdhesës malajziane, në Azisë Juglindore. Ajo përbëhet prej dy pjesësh, asaj gadishullore dhe asaj ishullore, apo siç ajo njihet më qartë Malajzia Perëndimore dhe ajo Lindore. Pjesa gadishullore e Malajzisë zbret nga veriu ku ajo kufizohet me Tailandën deri në shtetin e Xhohorit, i cili ndahet nga Singapori nga një vijë detare jo më e madhe se dy kilometra në distancë. Pjesa Lindore apo ishullore e Malajzisë që përbëhet nga shtetet e Sabahut dhe Saravakut të cilët shtrihet në ishullin e Borneos, i cili ndahet mes Malajzisë, Indonezisë dhe Brunei Dar-us-Salamit.

Malajzia është një shtet federal i përbërë nga trembëdhjetë shtete të cilat janë: Xhohori, Sabahu, Saravaku, Kelantani, Teranganu, Peraku, Pinangu, Selangori, Malaka, Negri Sembilani, Kedahu, Perlisi dhe Pahangu. Përveç trembëdhjetë shteteve të lartpërmendura deri në vitin 1965 Malajzia përbëhej nga një shtet më shumë i cili ishte Singapori i cili u nda nga federate malajziane pas kontraktave që federate pati me të fundit në vitet 1963.

HISTORIA E MALAJZISË

Historia e lashtë e gadishullit malajzian qëndron e paeksploruar si duhet nga studiuesit e historisë. Të parët e malajasve të sotëm besohet të kenë ardhur nga Mongolia, midis viteve

2500-1500 para erës sonë, për t'u vendosur në brezin bregdetar të Siujdhesës Malaje. Ata kanë rënë në kontakt me kinezët dhe indianët që në kohët më të hershme. Sipas kronikave kineze vendi të cilin ne njohim sot si Malajzi ka patur kontakte te vazhdueshme në histori me Kinën. Kontakte më të shpeshta zona e Malajës ka parë me Indinë sidomos në shekujt e shtatë të erës sonë nga ku vendit ashtu si edhe ishujt e Indonezisë ra nën influencën e madhe të kulturës indiane të përfaqësuar me hinduizmin. Ndikimi i indian është tepër prezent në Malajzi dhe në arqipelagun Indonezian edhe sot. Edhe pse popullatat e ishujve në fjalë janë muslimane, emrat që njerëzit mbajnë janë me origjinë indiane. Ndikimi masiv Indian mes malajsëve mund të shihet edhe mes kryeministrave të sotëm të Malajzisë dhe Indonezisë: Mahatir dhe Sukarnoputri. Megjithatë Malajzia ashtu si edhe pjesët e tjera të gadishullit Malajzian, ku këtu nënkuptojmë ishujt e Indonezisë, Bruneit dhe Filipineve nuk ka qënë e bashkuar politikisht shpesh. Në vendin që sot njihet si Malajzi ka patur mbretëri të vogla të cilat shpesh kanë qënë nën influencën e mbretërive më të fuqishme të kohërave si Kamboxhia apo Sumatra.

Historia e Malajzisë dhe rracës malaje që shtrihet nga Mindanao në Jug të Filipineve e deri në Indonezi është jashtëzakonisht e lidhur me Islamin. Islami për popujt e arqipelagut

Malajzian apo të “Azra Malajas” siç ai njihet nga eksploratorët klasikë arab ka qënë tepër i rëndësishëm. Islami ka qënë faktor civilizimndërtues për këtë botë të largët. Emra si Manila siç quhet kryeqyteti i sotëm i Filipineve kanë të kaluar Islame dhe me emrin original Aman-Illah.

Në rastin prezent të Malajzisë, historia e saj ka marrë pamje historike në shekujt e 13 – 14të kur në gadishullin Malajzian tregtarët jemenitë dhe Indian sjellin mësimet Islame. Kështu në vitin 1400 në shtetin e Malakës ne gjejmë një princ të dëbuar nga ishujt e Sumatres në Indonezi me emrin Paramisvara që themelon mbretërinë e Malakës. Sipas shumë burimesh historike ai besohet të jetë konvertuar në Islam në vitin 1414, në të njëjtin vit që në historinë shqiptare Jakub Shpata, nipi i islamizuar i Gjin Bua Shpatës sundon në Artë të Çamërisë. Paramisvara u ftua në Islam nga një grup misionarësh Indian. Konvertimi i tij i solli Malakës prosperitet i cili më pas do të mbulojë të gjithë gadishullin Malajzian, duke e kthyer mbretërinë në fjalë në bërthamën më të begatë ekonomike të gadishullit dhe qendrën e fesë Islame.

Megjithatë fati i begatisë së Mbretërisë së Malakës nuk zgjati shumë. Në vitin 1511, pra afro 100 vite pas Paramisvarës mbretëria e Malakës ra pre e pushtimit dhe masakrave të inkuizitorëve katolik portugezë nën famëkeqin Alfonso de

Albukuerkue. Portugezët të cilit ishin motivuar në pushtimet e tyre nga ndjenja e rikonkuistës kërkuar të çojnë pushtimet e tyre thellë në gadishullin malajzian. Megjithatë ata hasën në rrezistencën e mbretërive fqinje të Xhohorit dhe Açësë në të cilat siç edhe Shemsedin Sami Frashëri kujton në Kamus Al-Alam, shkuan disa trupa Osmane të cilët u udhëhoqën nga shqiptari Ibrahim Pasha. Sot e kësaj ditë në Malaka ekziston edhe një muze ku gjendet fermani i sulltanëve Osman dhe relike të ushtarëve Osman që shkuan në ndihmë të rezistencës malajziane. Aty duhet të ndodhen edhe relike të anti-kryqtarit shqiptar, Ibrahim Pashës që Sami Frashëri kujton në veprën e tij.

Sundimi portugez mbi Malakën nuk zgjati shumë. Më pushtimin që Portugalia pësoi nga Hasburgët Spanjollë fuqia portugeze morri fund në Oqeanin Indian. Zotërimet e tyre që nga Goa e Indisë, Hormuzi e deri në Malajzi do të pushtoheshin nga kolonialistët të rinj. Ata ishin Hollandezët të cilët nuk kishin shpirtin kryqtar të portugezëve por atë merkantalist. Në vitin 1641 mbretëria e Malakës ra nën sundimin e tyre i cili zgjati për 200 vitet në vazhdim.

MALAJZIA NËN BRITANIKËT

Historia e kolonializmit evropjan pa që me rënien e fuqisë portugeze dhe më pas asaj hollandeze, në Oqeanin Indian të lindte një fuqi e re që do të sundonte mbi këtë botë fizikisht deri në Luftën e Dytë Botërore ndërsa shpirtërisht dhe materialisht deri sot. Ajo ishte fuqia gjuhën e të cilës flet sot Globalizmi. Ishte Britania e Madhe e cila në vitin 1786 e thërritur nga sulltani i Kedahut për ndihmë kundër siamezëve (tailandezeve), përfitoi nga ky i fundit ishullin e Pinangut për Kompaninë Imperiale "British East India Company". Prezenca briatnike në Malajzi do të shihte nga pikat e saja kulminante vitin 1819 kur Sir Thomas Stamford Raffles një nga punonjësit e British East India Company-së do të hidhte bazat për shndërrimin e Singaporit nga një ishull i egër i banuar nga disa malajzianë në qëndrën më të madhe të imperializmit britanik në Azinë e Largët. Pas marrjes së Singaporit në vitin 1824 anlezetë grabitën Malakën nga hollandezët.

Me fuqizimin e industrive luftarake në Evropë nga viti 1850 e mandej Malajzia u kthye në një nga prodhuesit kryesorë të

qymyrit dhe erëzave për ekonominë britanike. Duke importuar në vend emigrantë kinezë në numra të mëdhenj, të cilët zëvendosin për anglezët zezakët që u dërgonin në Amerikë, fytyra e Malajzisë filloi të ndryshojë demografikisht dhe etnikisht. Kinezëria e punësuar nëpër qytete, plantacione dhe miniera i detyroi malajzianët indigjenë të shtyhen nëpër xhunglat dhe 'kampunget' e tyre, ndërsa 'rezidentët' britanikë merrnin sa me hir dhe me pahir toka të sulltanëve vendas. Në vitet në vijim Malajzia do të gjendet e ndarë nga britanikët në shtete të federuara dhe jo-të federuara. Mbi ato sundonin guvernatorët britanik apo siç ata njiheshin në atë kohë "High Commissioner" apo siç kemi ne disa në Tiranë që i thërrasim 'ambasadorë'. Fatin e Malajzisë perëndimore do të ndiqte edhe Malajzia Lindore e cila në vitin 1888 u kthye në koloni të njeriut të bardhë.

ARDHJA E PAMVARSISË

Pushtimi japonez i Malajzisë Lindore dhe Perëndimore sëbashku me Singaporin nga Japonezët në vitin 1942, të cilët me të drejtë deklarorin se kishin ardhur të çlironin Azinë nga pushtimi i njeriut të bardhë, dhe ndryshimi i forcave në arenën botërore pas Luftës së Dytë Botërore detyroi britanikët që të rishikojnë sundimin e tyre në botë. Duke parë se kohët po ndryshonin ata menduan se koha kishte ardhur për ta, të tërhiqeshin nga kolonitë e tyre, por duke bërë atë që lexohet sot në sheshin 'Sun Tech Square' të Singaporit: ku kolonialistët britanikë që u vranë në luftë me kolonialistët japonezët mbahen dhe adhurohen për herojtë më të mëdhenj të Singaporit.

Në vitet 1940 popullata e Malajzisë kishte 50% të saj malajzianë, 37 % kinezë dhe 12 % indianë. Kinezët dhe indianët të shtyrë nga sivëllezërit e tyre në Indi dhe Kinë ishin nga popullatat më ambicioze për të sunduar Malajzinë e kohëve moderne. Qëndrimi i tyre në qytete nën britanikët i kishte shtyrë malajzianët të izoloreshin në fshatrat e tyre, gjë që i sillte të fundmëve frikë dhe dëshirën për krijimin e shtetit të tyre kombëtar.

Për të refuzuar skemat e protektoratëve britanike disa ish-zyrtarë malajzian nën britanik themeluan UMNO-në (the United Malays National Organization) apo Organizata e Bashkuar Nacionale Malajziane më 1946 e cila 2 vjet më vonë do të çonte vendin drejt lidhjes konfederale. Megjithatë lidhja mala-

ziane dhe kërkesa e patriotëve malajzianë për pamvarësi do të kalonte në shumë vështirësi deri në vitin 1957. Vendi gjatë kësaj kohe kaloi do të kalonte një erë lufte civile mes etnive vëndase dhe luftës së sundimtarëve britanik kundër Partisë Komuniste Malajziane. PKM-ja e cila kishte patur pjesë aktive në rezistencën anti-japoneze ishte shqetësimi kryesor i lëvizjes për pamvarësi malajziane dhe eliminimi i saj ishte misioni kryesor i kolonialistëve britanik përpara se ata të lëshonin vendin.

MALAJZIA SI SHTET

Pas konflikteve të ndryshme ideore, etnike dhe kolonialiste, dhe shfarrosjes së rezistencës komuniste, më 31 Gusht 1957, Federata Malajziane u shpall e krijuar duke patur si kryeministër Tunku Abdul Rahmanin, liderin e UMNO-së. Në vitin 1961 ai propozoi krijimin e një federatë pan-Malajziane që do të përshinte Malajzinë, Singaporin, Saravakun, Borneon Verior dhe

Brunein. Bashkimi i propozuar u formua në Shtator të 1963 me përjashtim të Bruneit sulltani i të cilit nuk pranoi ofertën që në fillim, i ndjekur nga Singaporit që u nda nga konfederata në vitin 1965.

Nga data e krijimit e deri në ditët tona një nga problemet kryesore që Malajzia ka hasur vazhdimisht ka qënë konfliktet etnike dhe fetare të vendit dhe zhvillimi i tij. Këto konflikte që burojnë në sundimin e malajzianëve mbi kinezët dhe indianët çuan në ndarjen e Singaporit nga Malajzia, në luftën civile të 1969 dhe tensione që shihen edhe sot në vend dhe mes Malajzisë dhe Singaporit të dominuar nga kinezët. Lufta e ftohtë mes rracave për dominim ka çuar edhe në përplasje fetare në zonë. Dhe një nga arsyt kryesore pse feja Islame është aq shumë e respektuar sot nga sundimtarët e Malajzisë dhe Bruneit rrjedh nga identifikimi i kombësisë me fenë që është një komponent bazë në marrëdhëni-



et etnike të arqipelagut Malajzian.

Megjithatë pas vitit 1974 Malajzia vendi ka parë stabilitet etnik dhe politik të theksuar. Kjo erdhi si rrjedhojë e ndarjes së pushteteve që UMNO-ja ndërtoi në frontin që sundon vendin që nga fillimi i viteve 70. Fronti Kombëtar Malajzian apo Barisan Nasional i udhëhiqet nga UMNO-ja dhe përmbledh në vete partitë e shumicës së kinezve dhe indianëve malajzian. Barisan Nasional dhe politika e tij ka patur kriza sidomos në zgjedhjet e fundit në Malajzi nga dy parti: Parti se-Islam Malaysia (PAS) dhe DAP të cilat nuk pranojnë të jenë aleat të konsensusit të Barisanit. PAS-i përfaqëson krahun fetar malajzian dhe kërkon për implementimin e sheriatit në Malajzi. Kjo parti kontrollon dy shtete në vend, atë të Terenganut dhe Kelantanit ku i fundit udhëhiqet nga Menteri Besari Nik Aziz. Ndërsa DAP apo Partia e Aksionit Demokratik që përfaqëson kinezët e pakënaqur

më trajtimin që ata marrin nga Barisan Nasional kërkon dhënjën fund të sundimit të një grupi në shoqërinë malajziane.

MALAJZIA NËN MAHATIR BIN MUHAMEDIN

Një nga problemet kryesore që Malajzia ka parë që nga krijimi i saj ka qënë ai ekonomik. Një shtet i dalë nga një e kaluar kolonialiste, me dallime të mëdha ekonomike mes indigjenëve dhe kinezve të ardhur, që shtrihet mes xhunglash që përbëjnë afro 80% të territorit të saj, në vitet 70 kishte problem të sajën kryesor zhvillimin e vendit. Duke parë nivelin e ulët të jetesës që vendet përreth Malajzisë kanë, si Tailanda, Indonezia, Kamboxhia etj misioni kryesor i klasës sunduese malajziane ka qënë gjithnjë progresi. Dhe sukcesi i Malajzisë në arenën ndërkombëtare si një nga tigrat ekonomike të Azisë përmban padyshim nga pas emrin e kryeministrit të saj të fundit Mahatir Bin Muhamedit.

Mahatir Bin Muhamedi është një nga ata shumë malajzianë të cilët e kanë parë në sy problemin e zhvillimit rracor në vend. Në vitet 70 kur ishte në Londër ai akuzonte rracën e tij për dembele dhe inferiore përpara kinezve agresivë, gjë që e ktheu të fundit në pre të sulmeve mediatike në Malajzi. Megjithatë pas shumë manovrave politike, Mahatiri që me profesion është doktor, arriti që në vitin 1981 të zëvendësoj Dato Husein Onnin si kryeministër i vendit. Me ardhjen e tij në pushtet Mahatiri ka treguar se është një nga liderët më të hekurt por edhe vizionarë të Malajzisë. Ambicjet e tija politike u panë menjëherë pas ardhjes së tij në pushtet kur i fundit iu hoqi shumë fuqi legjislative nëntë sulltanëve – monarkë të vendit. Në 1987 ai tregoi dorën e tij të hekurt kundër opozitës me arrestime masive, më pas me dënime ndaj bizneseve britanike në vend dhe në 1993 çënoi sërish pushtetin e sulltanëve duke iu hequr të fundëve superioritetin mbi ligjin.

Taktikat autoritative të Mahatirit nuk kanë parë përplasje të tij vetëm me vendasit. Ai është përplasur shpesh në arenat ndërkombëtare me britanikët, amerikanët, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Sorrosin të cilin e akuzoi si kryebanditin çifut të rënies masive financiare të Azisë Juglindore në vitin 1997, me njeriun e bardhë evropian të cilin e ka akuzuar për agresiv dhe grabitqar, dhe biles edhe me çifutët si komb kur akuzoi të fundët përpara pak muajsh për sundues indirekt të botës. Në disa nga përplasjet e tij Mahatiri ka qënë jashtëzakonisht i suksesshëm. Kjo ishte në vitin 1998 kur refuzoi paketat dhe këshillat e FMN-së dhe borxhet milion-dollarëshe që ata i shitën Indonezisë, Koresë së Jugut, Tailandës etj. Rrefuzimi i kolonizimit monetar dhe skemave shkatërrimtare për ekonomitë ku FMN-ja sundon, sëbashku me idetë për krijimin e një monedhe alternative me Dollarin – Dinarit Islam nga Mahatiri e kanë bërë atë një nga personat më të referuar në vendet e botës së tretë që vuajnë nga presionet e hegjemonisë dhe imperializmit perëndimor. E kanë kthyer në një Che Gevara Islamik të shekullit, i cili adhurohet nga Gjiri Persik e deri në Argentinë për guximin dhe vizionin e tij për botën e tretë.

Përplasja më e egër e Mahatirit ndodhi në fund të vitit 1997 kur ai pushoi nga detyra dhe më pas burgosi zëvendësin e tij, dhe njëkohësisht presidentin e Universitetit tim, Anwar

Ibrahimin, pasi që akuzoi të fundit për imoral. Kjo përplasje ka qënë një nga më të rrezikshmet të karrierës së Mahatirit të Malajzisë, pasi që figura popullore e Anwar Ibrahimit revoltoi mbarë Malajzinë.

Ndoshta ka qënë dora e hekurt e Mahatir Bin Muhamedit ajo që arriti të transformojë Malajzinë nga viti 1981 deri në Tetor të 2003 nga një vend agrar në një nga tigrat më të padiskutueshëm të Azisë së Largët në teknologji dhe industri. Vizioni që Mahatiri i dha popullit të tij në këto 20 vite udhëheqje që në Malajzi njihet si Dua Pulu – Dua Pulu apo viti 2020 kur Mahatiri ëndërronte ta shihnte Malajzinë vend të industrializuar, sëbashku me politikat agresive, diktatoriale por edhe vizionare të tij, janë ato që e kanë kthyer Malajzinë sot në një tigër ekonomik. Politika e Mahatirit me investitorët perëndimor ishte e thjeshtë: ai i jepte Microsoftit apo Siemensit toka masive ne prani të qyteteve të mëdha pa iu kërkuar asnjë para për 10 vite me rradhë. Iu ofronte ndihmën dhe sigurinë absolute për investimin e tyre me kusht që të fundit të punësonin popullin, të kishin prodhime të orientuara për eksport dhe pas 10 vitesh ti paguanin taksë qeverisë.

Dëshira agresive e Mahatirit për transferim teknologjie e kanë kthyer Malajzinë sot në prodhuesin numër 1 në botë të kondicionerëve, microchipsave kompjuterikë, në bazën kryesore prodhuese të industrisë japoneze. Shumica e mallrave 'Made in Japan' që shiten sot nëpër botë, kanë vetëm vulën Japan nga mbrapa pse në fakt janë 'Made in Malaysia'. Me politikat proteksioniste ndaj industrive lokale vendi ka arritur sot të prodhojë makinat, elektronikët, avionët dhe qoftë edhe raketat e tij. Janë ambicjet dhe dora e hekurt e Mahatir Bin Muhamedit ajo që Malajzinë që përpara 30 vitesh ishte një xhungël eksperimentale e njeriut të bardhë (orang puteh) të kthehet sot në një nga vendet ku 'orang putehët' e Amerikës, Australisë dhe Britanisë së Madhe sëbashku me ne fukarejtë lëkurëbardhë të Shqipërisë të kërkojmë fatet tona. Është Malajzia e ambicjeve të Mahatirit, Muslimanit Ambicioz nga Malajzia ajo që sot ka godinën më të lartë në botë, KLCC-në dhe në katin e saj më të lartë ndodhet një Xhami, ku njeriu brun dhe i vogël i Malajzisë së Largët i falet Allahut të Tij Madhështor.





Исламска Верска Заедница на Република Македонија
СИУ „Иса Бег Медреса,, – Скопје
Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë
SHMI “Medreseja Isa Beu” – Shkup

Në bazë të Nenit 16 të Statutit të SHMI “Medreseja Isa Beu”-Shkup, si dhe në bazë të Nenit 2 dhe 10 të Rregullores për pranimin e nxënësve si dhe në bazë të vendimit të këshillit edukativo - arsimor nga mbledhja e datës 21. 04. 2009 shpalli këtë:

KONKURS

Për pranimin e nxënësve të rregullt (djem dhe vajza) në vitin e parë të vitit shkollorë 2009/2010

Shkollimi në Medrese zgjatë katër (4) vite shkollore. Nxënësit e rregullt (meshkujt) në Shkup dhe Shtip detyrimisht vendosen në konviktin e Medresesë nga ku ju sigurohet vendosja, dhe ushqimi, kurse nxënëset (vajzat) mësimin e vijnë në Shkup, Tetovë dhe Gostivar dhe udhëtojnë për çdo ditë.

Kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në Medrese duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- **Të mos jenë më të vjetër se 16 vjet;**
- **Të kenë të kryer shkollën fillore me sukses të shkëlqyeshëm ose shumë mirë;**
- **Të jetë i shëndoshë në aspektin psiko-fizik;**
- **Të japë provimin pranues në Medrese.**

Provimin pranues përbëhet nga gjuha amtare, Kiraeti, testi revizional (nga ilmihali i Naim Haxhiabdiqit), dhe psikotesti.

Provimin pranues do të mbahet më datën 22 dhe 23. 06. 2009 në lokalet e Medresesë (f. Kondovë) duke filluar prej orës 08.30.

Dokumentet e domosdoshme për regjistrim janë:

1. **Kërkesa për regjistrim nga kandidati;**
2. **Çertifikata e lindjes nga libri i amzës;**
3. **Dëftesë për kryerjen e klasës së gjashtë (VI), shtatë (VII) dhe tetë (VIII);**

4. **Çertifikatë e mjekut;**

5. **Deklaratë me shkrim nga prindi ose kujdestari i nxënësit se do të bartë përgjegjësi morale dhe materiale për birin e tij gjatë shkollimit;**

6. **Vërtetim nga Muftinia përkatëse e BFI.**

Dokumentacioni për regjistrim dorëzohet në Drejtorinë e Medresesë, degët e Medresesë – Shkup, Tetovë, Gostivar dhe Shtip. Kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve është 19. 06. 2009. Dokumentet e nxënësve të cilët nuk do të pranohen do t'ju kthehen përmes postës në Muftinive përkatëse, kurse për nxënësit që do të pranohen i informojmë me shkrim poashtu përmes Muftinive të BFI.

Dokumentet e pakompletuara nuk merren parasysh.

v.d. DREJTORI

Dorëzohet: Prof. Ibrahim Idrizi

- *Rijasetit të BFI në RM*
- *Muftinive të BFI*
- *Tabloja e shpalljeve në Medrese*
- *Hëna e re*
- *Arkivit*

Në bazë të Nenit 30 të Statutit të Medresesë, si dhe në bazë të Nenit 7 të Rregullores për provimet e pjekurisë, si dhe në bazë të vendimit të këshillit edukativo-arsimor nga mbledhja e mbajtur më 21. 04. 2009, Drejtoria e Medresesë sjell këtë:

SHPALLJE

për afatin e provimeve të pjekurisë në afatin e Qershorit të vitit 2009

Provimet mbahen me këtë orar:

- Më datë **15. 06. 2009** (e hënë) provim me gojë nga lënda e Kiraetit dhe me shkrim nga gjuha amtare, dhe gjuha arabe;
- Më datë **16. 06. 2009** (e martë) provimet me gojë nga lëndët: AKAID FIKH, dhe ARABISHT.

Afati i paraqitjes së provimit është prej **01. 06. 2009** deri më **12. 06. 2009** kurse paraqitja e provimeve pas kalimit të afati nuk merret parasysh.

Provimet fillojnë në ora 08:30

Vërejtje:

Provimet e pjekurisë paguhen 1.000.00 denar për të gjithë nxënësit, me përjashtim të nxënësve të rregullt në afatin e rregullt.

u.d. DREJTOR

Dorëzohet:

Prof. Ibraim IDRIZI

- *Rijasetit të BFI në RM*
- *Muftinive të BFI*
- *Tabloja e shpalljeve në Medrese*
- *Arkivit*

Address: IHS “Isa Beg Medresa” – Skopje, 80-1060 Gj.
Petrov, Republic of Macedonia

Phone: (+389 2) 2058 539; 2058 540; fax: 2058 541

Në bazë të vendimit të Këshillit edukativo-arsimor të SHMI “Medreseja Isa Beu”- Shkup në mbledhjen e mbajtur më datë 21. 04. 2009 drejtoria e Medresesë sjell këtë:

SHPALLJE

për afatin e provimeve me korrespondencë nësesionin e Qershorit 2009

Drejtoria e Medresesë informon nxënësit e regjistruar me korrespondencë se provimet e sesionit të **Qershorit 2009** do të mbahen sipas këtij orari:

Meshkuj dhe Femra: Prej datës 17. 06. deri më datë 19. 06. 2009

- Më datë **17. 06. 2009** nga lëndët: **Kiraet, Akaid, Fikh, Ahlak, Usuli Fikh, Histori dhe civilizim islam, Da've, Retorikë, Tefsir, Hadith, Filozofi Islame dhe Organizimi i BFI.**

- Më datë **18. 06. 2009** provimet me shkrim nga lëndët e gjuhëve

- Më datë **19.06. 2009** provimet me gojë nga lëndët: **Arabisht, Shqip, Maqedonisht, Turqisht, Anglisht, Gjeografi, Histori, Biologji, Mbrojtje, Psikologji, Logjikë, Sociologji, Pedagogji, Matematikë, Informatikë dhe Filozofi e përgjithshme.**

Vërejtje:

Paraqitja e provimeve do të bëhet prej 01.06.2009 deri më 12.06.2009 kurse paraqitja e provimeve pas afatit nuk merret parasysh.

u.d. DREJTOR

Dorëzohet: Prof. Ibraim IDRIZI

- *Rijasetit të BFI në RM*
- *Muftinive të BFI*
- *Tabloja e shpalljeve në Medrese*
- *Arkivit*

Address: IHS “Isa Beg Medresa” – Skopje, 80-1060 Gj.
Petrov, Republic of Macedonia

Phone: (+389 2) 2058 539; 2058 540; fax: 2058 541